

HYRJE	4
Kapitulli I – Stabiliteti Makroekonomik	8
1. Bruto Produkti Vendor (BPV).....	9
2. Struktura e tregut të punës	12
3. Inflacioni dhe çmimet.....	15
4. Bilanci i Pagesave.....	15
5. Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF)	21
6. Konkluzione	27
Kapitulli II – Politikat Tregtare	28
1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit	28
2. Korniza Legjislative dhe Institucionale në Kosovë.....	29
3. Statuti dhe Sfidat.....	29
4. Konkluzione	32
Kapitulli III – Politikat buxhetore	33
1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit	33
2. Korniza Legjislative dhe Institucionale	33
3. Statusi dhe Sfidat	34
4. Konkluzione	39
Kapitulli IV – Shërbimet financiare	40
1. Sektori bankar në Kosovë	40
2. Sektori i sigurimeve në Kosovë	47
3. Tregjet e kapitalit	49
4. Fondi i trustit pensional.....	50
5. Konkluzione	54
Kapitulli V – Statistikat zyrtare	55
1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit	55
2. Korniza ligjore dhe institucionale	57
3. Statusi dhe sfidat.....	60
4. Konkluzione	79
Kapitulli VI – Privatizimi/Likuidimi dhe Menaxhimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Publike	82
1. Kërkesat dhe standardet e BE-së për qeverisje korporatave dhe privatizim	82
2. Privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore	83
3. Qeverisja korporatave, korporatizimi, ristrukturimi, koncesionimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve publike.....	93
4. Konkluzione	108

Kapitulli VII - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike (KBFP).....	113
1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit	113
2. Korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë.....	115
3. Statusi dhe sfidat	120
4. Konkluzione	129
Aneksi A.....	136
Lista e Referencave	137
Lista e Pjesëmarrësve	140

I. HYRJE

Ky është Raport diagnostifikues i Tryezës tematike për ekonomi, financa dhe statistika i cili synon të paraqet gjendjen ekzistuese në këtë sektor duke reflektuar konsensusin e arritur nga të gjithë pjesëmarrësit e Tryezës. Me qëllim të elaborimit të gjendjes ekzistuese, ky raport synon të përmbledhë të arriturat dhe sfidat në këtë sektor në kuadër të procesit të integritimit evropian. Si i tillë, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të mendimeve, pikëpamjeve e vlerësimeve të diskutuara në takimet e Tryezës, të cilat janë mbajtur mes korrikut 2012 dhe prillit 2013.

Raporti është rezultat i një materiali për diskutim të hartuar mbi bazën e dokumenteve publike të institucioneve qeveritare, akademisë, shoqatave të biznesit, organizatave të shoqërisë civile, si dhe projekteve të donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Raporti është pasuruar posaçërisht me prezantimet, kontributin dhe diskutimet nga përfaqësuesit e institucioneve relevante të Republikës së Kosovës, ekspertët e angazhuar dhe pjesëmarrësit në takimet e Tryezës.

Raporti diagnostifikues është dokument punues dhe nuk ka status të një dokumenti politikash. Raporti është dokument me informata të hollësishme për fushat e mbuluara i cili do të shërbejë si input në drejtim të hartimit të një Raporti të përgjithshëm diagnostifikues për gjithë Task Forcën për Integritim Evropian dhe të Propozim Strategjisë Nacionale për Integritim Evropian. Në këtë drejtim kontribut të veçantë do të ofrojnë konkluzionet e dala në takimin plenar të Tryezës (shih Aneksin A).

Ky raport fillon me katër kapitujt e parë me prezantimin e gjendjes ekzistuese në fushën e makroekonomisë, politikave tregtare dhe fiskale si dhe me shërbimet financiare duke elaboruar ndikimin e tyre në rritje ekonomike në vend.¹ Ekonomia e Kosovës gjatë periudhës së pasluftës është karakterizuar me zhvillime pozitive në kontekst të rritjes ekonomike, por vazhdon të sfidohet nga norma e lartë e papunësisë si dhe e deficitit tregtar. Sektori fiskal në anën tjetër konsiderohet të ketë qenë stabil si në kontekst të të hyrave, po ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve. Ky sektor gjithashtu ka kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike duke marrë rolin primarë gjatë kohës kur sektori privat u ballafaqua me vështirësi. Vështirësitë e sektorit real reflektuan edhe në sektorin financiar i cili ngadalësoi ndërmjetësimin financiar si masë mbrojtëse ndaj zhvillimeve në sektorin e biznesit.

Rritja ekonomike gjatë viteve të fundit ishte ndërmjet 4-5%, rritje kjo e cila në periudhën 2005-2008 ishte e nxitur nga sektori privat, ndërsa që nga viti 2009 është sektori publik ai i cili ka marrë primatin në këtë rritje, duke reflektuar një sjellje kundër-ciklike të shpenzimeve qeveritare. Edhe sektori privat vazhdon të mbajë rol pozitiv në rritje, por se efekti i këtij sektori është reduktuar duke reflektuar ambientin e përgjithshëm makroekonomik në rajon. Në anën tjetër, me ndikim negativ në rritjen ekonomike vazhdon të jetë deficitit tregtar i cili karakterizohet me nivel të lartë të importeve të cilat kanë mbulueshmëri prej

¹ Të dhënat e pasqyruara në këtë raport mund të ndryshojnë me rishikimin e KASH-it në ditët në vijim.

vetëm 10% me eksporte. Ky nivel i lartë i deficitit tregtar reflekton në deficit të llogarisë rrjedhëse i cili karakterizon ekonominë e vendit që nga periudha e pasluftës. Mirëpo, me ndikim në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë kategoritë si tregtia në shërbime, në të cilën Kosova ka bilanc pozitiv, bilanci i të ardhurave si dhe transferet rrjedhëse të cilat dominohen nga dërgesat e emigrantëve. Në anën e financimit (Llogarisë kapitale dhe financiare), janë investimet e huaja direkte (IHD) ato që kanë ndikim pozitiv në financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse si dhe investimet tjera. Investimet e huaja direkte vazhdimisht janë karakterizuar me luhatshmëri si rezultat i zhvillimeve në vitet e fundit në vendet e eurozonës që njëkohësisht, paraqesin burimin kryesor të IHD-ve. Sidoqoftë, gjatë vitit 2012, ishte edhe ngadalësimi në procesin e privatizimit që ndikoi në fluksin më të ulët të IHD-ve në vend (rënie për afër 40%). Sa i përket investimeve tjera, kjo kategori më së shumti përmban kreditë tregtare ndërmjet kompanive vendase dhe kompanive jashtë ekonomisë së Kosovës. Kjo kategori në masë të madhe përbëhet nga kreditë në mallra që kompanitë vendëse marrin nga kompanitë jashtë vendit. Përveç këtyre dy kategorive, kategori e rëndësishme është edhe investimet portfolio të cilat kanë vetëm fluks dalës si rezultat i mungesës së instrumenteve për investime në Kosovë. Rrjedhimisht, kjo kategori dominohet nga mjetet e Trustit të cilat investohen në instrumente financiare ndërkombëtare.

Sektori fiskal në anën tjetër vazhdon të karakterizohet me stabilitet në kuadër të të hyrave dhe shpenzimeve. Sidoqoftë, sfiduese vazhdon të jetë rritja e bazës tatimore në vend marrë parasysh se të hyrat nga dogana dominojnë strukturën e të hyrave në buxhet. Rritja e bazës së brendshme tatimore do të mundësonte mbështetje më të vogël të buxhetit nga të hyrat doganore. Të hyrat gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 shënuan rritje prej rreth 12% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2011. Në anën e shpenzimeve, planifikimi buxhetor i aprovuar arrin nivelin e shpenzimeve prej 1.5 miliardë EUR që paraqet rritje vjetore prej 9.3%.

Sektori financiar vazhdon të karakterizohet me stabilitet dhe vazhdimësi në procesin e ndërmjetësimit financiar në vend. Deri në dhjetor 2012 kreditë e sistemit bankar arritën në 1.76 miliardë EUR, që paraqet normë vjetore të rritjes prej 3.8%. Rritja gjatë vitit 2012 ishte më e ngadalshme krahasuar me periudhat paraprake duke reflektuar zhvillimet në sektorin real dhe duke rezultuar që sistemi të i adaptohet ambientin me rrezik më të madh ekonomik. Si rrjedhojë, bankat konsiderojnë se për të ruajtur kualitetin e portfolit kreditor është dashur që të shtrëngohen kriteret për kreditim. Në anën tjetër, depozitat arritën në 2.28 miliardë EUR që paraqet një normë të ngjashme të rritjes me vitet paraprake (rritje vjetore prej 8.3%). Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në dhjetor 2012 ishte 77.4% krahasuar me 80.7% në vitin 2011.

Norma e interesit konsiderohet të jetë relativisht e lartë në ekonominë e Kosovës. Norma mesatare e interesit në kredi gjatë vitit 2012 arriti në 13.4% (krahasuar me 14.1% gjatë vitit 2011). Në anën tjetër, interesi në depozita gjatë vitit 2012 shënoi rritje në afër 3.6% krahasuar me 3.5% sa ishte gjatë vitit 2011. Dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozita gjatë vitit 2012 u ngushtua në 9.85 krahasuar me 10.65 sa ishte gjatë vitit 2011.

Si rezultat i përkeqësimit të performancës së sektorit real të ekonomisë, gjatë vitit 2012 shënoi rënie profiti i sistemit bankar duke rënë në 19.3 milion EUR (36.6 milionë EUR në vitin 2011). Rënia e profitit i adresohet në masë të madhe rritjes së shpenzimeve të provizionimit për mbulimin e kredive jo-performuese. Deri në dhjetor 2012, kreditë jo-performuese si përqindje e gjithsej kredive arritën në 7.5% krahasuar me 7.0 në shtator 2012. Sidoqoftë, është e rëndësishme se sistemi financiar mbetet mirë i kapitalizuar me nivel të adekuatshmërisë së kapitalit që arrin në 17.9%.

Përveç sistemit bankar, pjesë e rëndësishme e sektorit financiar në ekonominë e Kosovës janë edhe fondet pensionale që deri në dhjetor 2012 kishin një pjesëmarrje prej 18% në gjithsej asetet e sistemit financiar. Kjo shtyllë e sistemit financiar dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti), që në dhjetor menaxhonte 739.8 milionë EUR (593.3 milionë EUR në dhjetor 2011). Ky sistem, gjatë vitit 2012 u karakterizua me performancë pozitive marrë parasysh se çmimi i njësisë arriti në 1.117 EUR. Industria e sigurimeve vazhdon të jetë relativisht e thjeshtë në Kosovë dhe të dominohet nga sigurimet e detyrueshme TPL për automjete. Vlera e aseteve të kësaj industrie arrin në 130.4 milionë EUR. Institucionet mikrofinanciare gjatë vitit 2012 kishin performancë negative në kuadër të kreditimit duke shënuar vlerë prej 98.8 milionë EUR krahasuar me 104.7 milionë EUR të vitit 2011.

Në kapitullin e pestë raporti paraqet të arriturat dhe sfidat në kontekst të statistikave të cilat vazhdojnë të jenë prezente në Kosovë. Nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve janë të rregulluar përgjegjësitë mbi përpilimin e statistikave në Kosovë. Rrjedhimisht, ASK është bartëse primare e statistikave të demografike/sociale dhe popullsisë, sektorit ekonomik që përfshijnë llogaritë kombëtare, bilancin tregtar, çmimet etj., ndërsa BQK është përgjegjëse për statistikatat monetare dhe financiare si dhe për bilancin e pagesave. Statistikat e BQK-së konsiderohen se kanë arritur nivel relativisht të lartë të kualitetit duke ju përmbajtur standardeve të FMN-së të prezantuara në manualët e përpilimit. Statistikat zyrtare në Kosovë janë në proces të konsolidimit, mirëpo ASK vazhdon të përballet me mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme institucionale dhe profesionale. Në kontekst të avancimit të statistikave, është konkludim i përgjithshëm se ka hapësirë për përmirësime në koordinim ndër-institucional, bashkëpunim me shfrytëzuesit dhe në gamën dhe frekuencën e statistikave të raportuara në përputhje me standardet e BE-së. Rritja e frekuencës do të mundësonte analizë më gjithëpërfshirëse si dhe identifikim më të mirë të zhvillimeve ekonomike.

Privatizimi si pjesë thelbësore e procesit të tranzicionit gjendet në kapitullin e gjashtë. Privatizimi ka ngadalësuar aktivitetin gjatë vitit 2012 si rezultat i mungesës së bordit. Sidoqoftë, nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, deri në shtator të vitit 2012, vlera e shitjeve arriti në 572 milionë EUR si dhe 60.5 milionë EUR nga likuidimi i ndërmarrjeve. Shuma prej 20% të shitjeve është e rezervuar për punëtorët e NSH-ve të cilat janë privatizuar, pjesa prej 5% rezervohet për shërbimet administrative të AKP-së ndërsa 75% e mbetur është e rezervuar për të zgjidhur ankesat/kërkesat e kreditorëve. Mjetet e gjeneruar nga privatizimi do të kontribuonin në rritje ekonomike nëse së paku

një pjesë e tyre do të lirohet për investime. Procesi i privatizimit pritet të përfundojë në vitin 2016, mirëpo në këtë drejtim kërkohet përkrahje nga institucionet tjera si dhe efikasitet më i lartë i Dhomës së Posaçme. Procesi perceptohet me keqpërdorime dhe shoqërohet me mungesë të një strategjie të përgjithshme me objektiva matëse dhe një konsensusi gjithë-shoqërorë mbi procesin. Menaxhimi i NSH-ve në përgjithësi është në përmirësim e sipër, megjithatë kërkohet zvogëlim i mëtutjeshëm sidomos në kuptim të humbjeve teknike dhe komerciale.

Raporti përfundon me kapitullin e shtatë mbi kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP) me vështrim të përgjithshëm mbi qëndrueshmërinë institucionale, efikasitetin dhe efektivitetin e shfrytëzimit të financave publike. KBFP rregullohet nëpërmjet legjislacionit për sektorë të ndryshëm i cili është gjithëpërfshirës duke përfshirë ligje dhe politika specifike për KBFP, rregulla financiare si dhe ligje suplementare që kontribuojnë në mbarëvajtjen e financave publike. Kapacitetet vendore janë në ngritje e sipër, mirëpo programet e certifikimit duhet lokalizuar dhe bërë të qëndrueshme. Derisa konsiderohet se korniza e përgjithshme e KBFP-së është në përputhje me parimet e përgjithshme të BE-së, zbatimi mbetet larg gjendjes së dëshiruar ku organizatat buxhetore nuk iu janë përshtatur kërkesave të KBFP-së dhe poashtu nuk përdorin sa duhet sistemet për planifikim dhe menaxhim të të mirave publike në kuadër të kornizës ekzistuese legjislative dhe institucionale. Për më tepër kërkohet më shumë vëmendje auditimit të performancës si dhe zhvillimit të indikatorëve për matjen e efektit të shfrytëzimit të mjeteve në shërbim të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Kapitulli I – Stabiliteti Makroekonomik²

Ekonomia e Kosovës në vazhdimësi ka pasur norma pozitive të rritjes ekonomike, norma këto të cilat ishin më të larta se mesatarja rajonale. Sidoqoftë, përkundër normave relativisht të larta të rritjes (rreth 4-5% në 5 vitet e fundit), sfiduese për ekonominë vazhdimisht është norma e lartë e papunësisë. Kjo pasi që, ekonomia e Kosovës kryesisht është e bazuar në aktivitetin tregtar, sektor ky i cili ka kapacitete më të limituar në krijimin e vlerës së shtuar në ekonomi por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Sidoqoftë, rol të madh në neutralizimin e efektit të papunësisë në ekonomi vazhdojnë të luajnë dërgesat e emigrantëve të cilat në disa vitet e fundit arrit vlerën afër 600 milionë EUR.

Parashikimet për përmirësimin e ekonomisë së euro-zonës japin sinjale pozitive edhe për rritjen ekonomike në Kosovë. Rritja ekonomike për periudhën 2013-2015 parashihet të jetë rreth 4% përdherisa gjatë vitit 2013 kjo rritje pritet të jetë 4.1% (FMN, 2012). Rritjen ekonomike për këtë periudhë kryesisht parashihet ta mbështesin rritja e konsumit privat, investimet dhe eksporti në përgjithësi (FMN, 2012).

Konsumi privat pritet të rritet me një normë reale mesatare prej 5.4% ndërkohë që konsumi privat për kokë banori parashihet të rritet me 3.2% mesatarisht, nën supozimin që popullsia rritet me një normë prej 1.6%. Edhe pse konsumi pritet të sigurojë mbështetjen më të madhe në rritjen reale të BPV-së edhe gjatë kësaj periudhe, efekti i tij në rritjen ekonomike pritet të reduktohet gradualisht duke u zëvendësuar me nivel më të lartë të investimeve private dhe eksporteve si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve. Kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë kësaj periudhe pritet të japin edhe investimet. Kontributi i investimeve në rritjen e BPV-së parashihet të ngritet gradualisht duke aritur të ketë pjesëmarrje prej 33% të BPV-së. Nga këto, investimet private parashihet të mbajnë një normë relativisht stabile në pjesëmarrje të BPV-së gjatë periudhës 2011-2015 në mes të 21-22% të BPV-së. Njëkohësisht, investimet publike, të cilat pritet të shënojnë një ngritje të lehtë përgjatë periudhës së parashikuar, parashihet të vazhdojnë me pjesëmarrje prej 11% të BPV-së.

Përkundër zhvillimeve më të ngadalshme në sektorin real, duhet të theksohet se parakushtet për zhvillim më të qëndrueshëm janë në proces të krijimit marrë parasysh investimet në infrastrukturë nga sektori publik si dhe procesi i privatizimit. Inkurajuese gjithashtu është edhe pozicioni fiskal i Kosovës i cili vazhdimisht është karakterizuar me bilanc të kënaqshëm. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2012 ka filluar edhe implementimi i platformës për emetimin e letrave me vlerë të qeverisë, platformë kjo e cila ri-konfirmon pozicionin e favorshëm fiskal marrë parasysh se ofertimi nga akterët primar vazhdimisht ka qenë 2 herë më i lartë se oferta e letrave me vlerë të qeverisë, ndërsa norma e interesit në letra me vlerë ka shënuar rënie të vazhdueshme gjë që konfirmon besimin e sektorit financiar në sektorin publik (BQK, Q4 2012).

² Për të dhëna më të fundit, ju lutem i referoheni KASH-it i cili momentalisht është duke u ri-shikuar dhe pritet të miratohet nga Qeveria në maj 2013.

Sektori financiar i Kosovës në anën tjetër vazhdimisht është karakterizuar me nivel të lartë të qëndrueshmërisë dhe stabilitet në likuiditet dhe kapitalizimit, ndërsa kualiteti i portofolit kreditor mbeten ndër më të mirët në rajon. Edhe zgjerimi i sistemit financiar është karakterizuar me normë të kënaqshme deri në vitin 2012, ndërsa gjatë vitit 2012 është ngadalësuar kjo rritje, që në masë të madhe reflekton besueshmërinë më të ulët të bankave ndaj performancës së sektorit privat (BQK, RSF 2012).

Ndër problemet më të theksuara të ekonomisë së Kosovës vazhdon të jetë performanca tregtare marrë parasysh se deficitin e llogarisë rrjedhëse vazhdimisht ishte mbi 10% të BPV-së. Ky deficit vazhdimisht është shkaktuar nga niveli i lartë i importeve si dhe eksportet tejet të ulëta (AKS, 2013; BQK, 2013).

1. Bruto Produkti Vendor (BPV)

Të dhënat për Bruto Produktin Vendor (BPV) janë të publikuara për periudhën deri në vitin 2011. Përgjegjës për publikimin e të dhënave për BPV-në është ASK, e cila deri më tani, ka publikuar këto të dhëna në bazë vjetore, ndërsa është e nevojshme që të rritet frekuenca në bazë kuartale.

Struktura e BPV-së vazhdimisht dominohet nga shpenzimet e konsumit final, prej të cilave pjesa më e madhe i takon sektorit privat. Në anën tjetër, deficitin në bilancin e tregtisë vazhdon të jetë një kontribuues negativ për rritjen ekonomike në vend. Sidoqoftë, përkundër luhatjeve në ekonomitë rajonale dhe globale, ekonomia e Kosovës vazhdimisht po shënon normë pozitive të rritjes. Rritja reale ekonomike gjatë vitit 2011 ishte 4.5% (ASK, 2012). Në terma nominal, BPV gjatë vitit 2011 ishte rreth 4.77 miliardë EUR. BPV për kokë banori në vitin 2011 ishte 2650 EUR, dhe krahasuar me vendet e rajonit i bie në nivel relativisht të ulët (1/2 e Bosnjës, 1/3 e Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe 1/4 e Serbisë). Sipas disa vlerësimeve Kosova duhet të ketë rritje vjetore prej 10% për një dekadë rresht për të arritur nivelin e Shqipërisë (WB, 2012).




Figura 1: Struktura e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve

BPV për kokë banori sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB) në Kosovë është mbi 7,000 USD, që është në nivel të ngjashëm me vendet si Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina, por në nivel më të ulët në krahasim me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë të cilat BPV për kokë banori sipas PFB e kanë më të lartë se 10,000 USD (BQK, 2011)

Kategoria më e madhe në kuadër të BPV-së ka pasur norma pozitive të rritjes që nga viti 2005 (me përjashtim të vitit 2009). Norma mesatare e rritjes së konsumit të përgjithshëm gjatë periudhës 2005-2011 ishte në 7%, normë kjo e cila në masë të madhe është nxitur nga shpenzimet private, ndërsa shpenzimet e qeverisë u rritën me normë më të ngadalshme (ASK, 2012). Përveç dërgesave të emigrantëve të cilat konsiderohet se kanë kontribut të madh në nxitjen e konsumit, në vitet e fundit edhe rritja e pagave të sektorit publik mund të ketë pasur efekt në këtë normë të rritjes. Gjithashtu, edhe rritja e shpenzimeve qeveritare për konsum në 2010-2011 ka pasur një rol të rëndësishëm në rritje të konsumit. Në anën tjetër, është edhe kreditimi i sektorit bankar që gjithashtu ka pasur rol pozitiv në rritjen e konsumit. Për vitin 2012, konsumi nuk pritet të ndikohet shumë nga ngadalësimi i kreditimit të sektorit bankar marrë parasysh se kreditimi i sektorit bankar ka vazhduar normë relativisht të lartë të rritjes ndaj ekonomive familjare, ndërsa, rënia më e theksuar e kreditimi vërehet te bizneset.

Investimet paraqesin gjithashtu një komponentë të rëndësishme në kuadër të BPV-së marrë parasysh se mesatarisht, në gjashtë vitet e fundit kanë përbërë rreth 28% të BPV-së. Në vitet 2010-2011 kjo përqindje arriti në rreth 32% të BPV-së. Faktorët të cilët më së shumti ndikojnë në nivelin e investimeve në vend konsiderohet se janë investimet publike të cilat në vitet e fundit kanë pasur rritje të konsiderueshme; investimet e huaja direkte, të cilat deri në vitin 2011 karakterizohesh me normë të mirë të rritjes, por që në vitin 2012 kjo normë ishte negative për rreth 40%. Përveç sektorit publik dhe sektorit të jashtëm, ndikim në investimet e përgjithshme në vend kanë edhe investimet e firmave vendore të cilat gjithashtu përkrahen nga kreditimi i sistemit bankar. Vlen të ceket se gjatë vitit 2012 kreditimi i sektorit bankar ndaj firmave u karakterizua me normë pozitive të rritjes por se norma e kësaj rritje ishte relativisht e ulët.

Rritja reale e BPV-së për vitin 2012 është parashikuar të arrijë normën prej 3.8% (FMN, 2012 dhe World Bank, 2013), që është më e ulët se vitin paraprak kur kjo normë arriti në 4.5%. Ngadalësimi i rritjes ekonomike në masë të madhe i adresohet krizës në eurozonë. Parashikimet tregojnë se në vitet 2013 dhe 2014 mund të ketë rritje prej 4.1% respektivisht 3.2%. Përkeqësimi i gjendjes në eurozonë mund të ngadalësoj rritjen përmes rënies së eksporteve, investimeve të huaja direkte dhe dërgesave të emigrantëve.³

Ministria e Financave (MF) parasheh që investimet private dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve në vitet në vijim do të zvogëlojnë efektin e konsumit të përgjithshëm në rritjen ekonomike. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një normë mesatare prej 7.6%, si rezultat i ngritjes së kapacitetit prodhues dhe eksportuese të bizneseve në Kosovë. Në anën tjetër, lëvizja e çmimeve botërore të metaleve dhe kërkesës për

³ BB - Kosovo Country Partnership Strategy 2012-2015, fq. 3.

metale do të ketë ndikim të rëndësishëm në eksportin e Kosovës, meqë metalet përbëjnë pjesën më të madhe të eksportit. Eksporti i shërbimeve pritet të ketë trend pozitiv sidomos nga zhvillimi i sektorëve të ndërtimitarisë, komunikimit, teknologjisë informative, etj. Importi në afat të gjatë pritet të zëvendësohet me produkte vendore, por deri në fund të vitit 2015 pritet të ketë kontribut negativ në rritje të BPV-së.

Meqë lënda e parë për prodhim importohet, parashihet që me rritjen e prodhimit vendorë dhe eksportit të rritet edhe importi, përkundër supozimeve për zëvendësim të eksportit me produktet vendore. Megjithatë deficit i bilancit tregtar parashihet të shënoj rënie të lehtë gjatë periudhës 2013-2015 me rritje më të shpejtë të eksportit të mallrave. Eksporti i shërbimeve ka potencial të madh për një rritje më të shpejtë ekonomike, prandaj parashihet që gjatë periudhës 2013-2015 eksporti i shërbimeve të rritet me një normë reale prej rreth 6.5% dhe duke bërë kështu që eksporti i shërbimeve të jetë më i shpejtë sesa importi i shërbimeve.⁴

Për të ruajtur stabilitetin makro-fiskal dhe përkrahur rritjen ekonomike, zhvillimin e sektorit privat dhe uljen e papunësisë, MF gjegjësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) në kuadër të Vizionit për Zhvillim Ekonomik dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2013-2015 parashohin të realizojnë objektivat që kanë të bëjnë me: Ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale përmes politikave të qëndrueshme, zvogëlimin e ekonomisë joformale, zhvillimin e sistemit të vjeljes dhe administrimit të të hyrave tatimore dhe doganore, ngritjen e cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike, zhvillimit të mëtejme të marrëdhënieve me institucionet ndërkombëtare financiare, krijimin e politikave të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, nxitjen e shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve minerale dhe resurseve frekuencore, furnizimin e sigurt, qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë me energji, shërbime të telekomunikimit përmes tregut konkurrues të integruar në sistemet rajonale dhe ndërkombëtare, reformimit dhe ristrukturimit të NP-ve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve publike për qytetarët.⁵ Qeveria po ashtu ka prioritet zhvillimin e sektorit të bujqësisë i cili momentalisht ka një pjesëmarrje prej 35% në të gjithë të punësuarit në vend.⁶

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për të lëvizur drejt rritjes së qëndrueshme dhe krijimit të vendeve të punës udhëhequr nga sektori privat, nëse arrin t'i tejkaloj sfidat që kanë të bëjnë investimet. Kosova ka disa përparësi krahasuese të rëndësishme për tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja dhe krijimin e një sektori të suksesshëm eksportues. Në këtë aspekt Kosova ka një numër resurcesh të rëndësishme si një fuqi punëtore të re, resurset e pashfrytëzuara natyrore, cilësi të mirë të tokës bujqësore dhe qasje në tregjet rajonale dhe të BE-së. Politikat karakterizohen me sistem të thjeshtë të taksave dhe me norma të ulëta, treg të punës fleksibil në krahasim me rajonin, paga krahasimisht më të ulëta për punëtorë të (gjysmë) kualifikuar. Mirëpo në anën tjetër ekzistojnë disa pengesa në investime, p.sh. ato të identifikuar në Raportin e të bërit Biznes

⁴ KASH 2013-2015, fq. 30-31.

⁵ KASH 2013-20135.

⁶ BB - Kosovo Country Partnership Strategy 2012-2015, fq. 8.

pastaj infrastrukture, sundimi i ligjit, fuqia joadekuate punëtore, qasje e limituar në financa, procedura të ndërlikuara për hyrje dhe dalje nga biznesi, etj.⁷

2. Struktura e tregut të punës

Vlerësimet më të qëndrueshme për tregun e punës mungojnë dhe konsiderohet se ka probleme në krahasimin e të dhënave. Kjo për shkak se anketa e fundit e fuqisë punëtore është realizuar në vitin 2009, kurse rezultate e anketës për gjysmën e vitit 2012 janë në proces të përpilimit nga ASK dhe pritet të publikohen në maj 2013.

Për shkak se që nga viti 2011 është duke u përdorur një metodologji e re, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) nuk posedon të dhëna për tregun e punës në bazë të grup moshave, gjinisë dhe shpërndarjeve regjionale për 5 vitet e fundit. Gjithashtu, në pyetësorët e mëhershëm (2007-2011), ASK nuk ka krijuar statistika të popullsisë në bazë të moshës dhe gjinisë në nivelin komunal.⁸

Shkalla e papunësisë prej 43% është më e larta në Evropë, ku vetëm të rinjtë (15-24 vjeç) përbëjnë 73% të papunëve⁹, por një numër i madh i të rinjve është ende në shkollim dhe nuk bën pjesë në fuqi punëtore aktive. Në anën tjetër grup-moshat më të vjetra kanë shkallë më të lartë punësimi – rreth 34% për grup-moshën mes 25-54, dhe rreth 27% për grup-moshën 55-60.¹⁰ Sipas MPMS-së shkalla e të regjistruarve si të papunë në fund të vitit 2011 ka rënë për 3% krahasuar me 2010, prej të cilëve afro 94% janë të papunësuar afat-gjatë¹¹. Kosova ka shkallë dukshëm më të lartë të papunësisë krahasuar me Maqedoninë (34%), Bosnjën (23%) apo Malin e Zi (17%).¹² Investimet në sektorin privat nuk po ndikojnë në zbutjen e varfërisë, sepse vendet e reja të punës të krijuara me këto investime janë zakonisht me pagë të ulët në një treg të ekspozuar ndaj informalitetit, e që krijon vështirësi në vlerësimin e normës së papunësisë.¹³

Kosova ka një mori ligjesh të harmonizuara me legjislacionin e BE-së mbi mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe sigurisë në punë, por zbatimi i tyre ngec dhe paraqet një kosto të lartë për të gjithë. Sidoqoftë konsiderohet se Ligji i Punës pritet të amandamentohet në vitin 2013 dhe të përafrohet me direktivat e BE-së.¹⁴

⁷ Ibid.

⁸ Të dhënat e ndara në bazë të gjinisë dhe vendeve rurale/urbane pritet të jenë të disponueshme nga maji 2013.

⁹ UNDP - KHDR 2012, fq. 25-27.

¹⁰ ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, 2009, fq. 15.

¹¹ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 340.

¹² UNDP - KHDR 2012, fq. 25-27.

¹³ Ibid, fq. 3-5.

¹⁴ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 322.

Tabela 1: Të regjistruarit e papunë afat-gjatë sipas kategorive¹⁵

Kategoria	2007	2008	2009	2010	2011
Papunësia afatgjate	93. %	93.5%	94.2%	94.0%	93.8%
Të rinjtë (15-24)	98,695	101,658	103,896	106,342	107,122
Femrat	156,679	158,120	161,131	160,856	157,922
Personat me aftësi të kufizuara	1,726	1,814	1,903	1,937	2,030
Të gjitha minoritetet	30,133	30,509	30,695	29,860	29,711

Bazuar në përfundimin e shkollimit të lartë çdo vit tregut të punës i shtohen mes 25,000 dhe 30,000 persona brenda vitit.¹⁶ Në anën tjetër të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) tregojnë për rënie të punëkërkesve të regjistruar. Të dhënat e MPMS pasqyrojnë tregun e punës si në vijim:

Tabela 2: Regjistrimi i papunësisë sipas gjinisë dhe grup-moshës¹⁷

Indikatorët		2007	2008	2009	2010	2011
Regjistrimi i papunësisë		334595	335942	338895	335260	325261
Gjinia	Femra	156679	158120	161131	160856	157922
	Meshkuj	177916	177822	177764	174404	167339
Grup Moshë	15-24	98695	101658	103896	106342	107122
	Meshkuj	47398	48891	50404	52071	53172
25-39		147411	147995	149382	148059	142276
Femra		70080	70639	72022	71796	69636
40-54		66286	65585	65819	63631	59995
Femra		30071	29857	30176	29372	27857
55+		22203	20704	19798	17228	15868
Femra		9163	8774	8551	7674	7349
Etniciteti	Shqiptar	304461	305433	308200	305400	295550
	Serb	13428	13198	13190	13021	12810
Minoritete	Tjera	16706	17311	17505	16839	16901
	Të gjitha minoritetet	30133	30509	30695	29860	29598

Fuqia punëtorë aktive në Kosovë, sipas anketës së fundit të fuqisë punëtore në 2009 të ASK-së, është shumë e ulët dhe sillet rreth 48%. Punësimi është predominant në sektorin

¹⁵ Labor and employment report 2011, Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 133.

¹⁶ UNDP - KHDR 2012, fq. 29-31.

¹⁷ MPMS - Labour market information in Kosovo, Monthly report/LED/MLSW.

privat dhe përgjatë viteve 2007-2011 ka paraqitur përafërsisht 2/3 e punësimit total.¹⁸ Konsiderohet se ekziston edhe një numër i theksuar i të punësuarve në sektorin informal.

Tabela 3: Punësimi në sektorin privat dhe publik, 2007-2011

Viti	2007	2008	2009	2010	2011
Të punësuarit	225,037	218,231	233,338	245,502	251,510
Sektori Publik	74,366	74,701	74,190	77,164	78,068
Sektori Privat	150,671	143,530	159,148	168,338	173,442

Paga mesatare mujore në sektorët me aftësi të ulët është rreth 260 euro – e përafërt me Shqipërinë, sa gjysma e pagës në Serbi dhe Maqedoni, dhe sa 1/8 e pagës në Mal të Zi.¹⁹

Tabela 4: Paga mesatare neto në sektorin publik dhe privat, 2007-2011²⁰

	2007	2008	2009	2010	2011
Paga Mesatare (Euro)	242	248		292	327
Sektori Publik	208	237	270	268	368
Sektori Privat	241	258		303	327

Përkundër rritjes ekonomike dhe investimeve në infrastrukturë, Kosova përballet me normë relativisht të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Kosova është ndër vendet më të varfra në Evropë ku vlerësimet për nivelin e varfërisë dallojnë prej 34 deri në 48% (më pak se 1.55 euro/ditë) dhe prej 12 deri 18% për varfëri të skajshme²¹ (më pak se 1 euro/ditë). Sa i përket nivelit të barazisë në të ardhura matur përmes koeficientit Gini, Kosova qëndron mirë duke qenë nivel i krahasueshëm me shumë vende Evropiane (koeficienti Gini në rreth 0.3 në vitin 2009). Megjithatë ekziston një dallim mes rajoneve të cilat ndryshojnë prej 18% deri rreth 54%. Varfëria konsiderohet të jetë më e shprehur te grupmoshat e reja²².

Rreth 8% e popullatës janë pjesë e programit për ndihma sociale. Për më tepër në Kosovë nuk ka sistem të sigurimit që mbulon papunësinë.

Pakicat (sidomos RAE) janë posaçërisht të ekspozuar ndaj varfërisë dhe marginalizimit në aspektin socio-ekonomik. Përveç kësaj RAE, e në veçanti femrat e tyre, kanë shkallë

¹⁸ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 338.

¹⁹ UNDP – KHDR 2012, fq. 30-31.

²⁰ MPMS - Research on Needs of Labor Market 2011, KBA/MLSW.

²¹ UNDP – KHDR 2012, fq. 11.

²² BB - Kosovo Country Partnership Strategy 2012-2015, fq. 6.

të lartë të analfabetizmit për shkak të braktisjes së shkollës.²³

3. Inflacioni dhe çmimet

Kosova me adoptimin e euros si valutë zyrtare është kufizuar mjaft shumë në politikat monetare për kontroll të inflacionit. Inflacioni gjatë 6 viteve të fundit ka shënuar një mesatare prej 4.1%. Inflacioni në Kosovë luhatet mjaft shumë, ku dy pikat më të larta të inflacionit janë arritur në vitin 2008 me shkallë mesatare vjetore prej 9.4% dhe në vitin 2011 me 7.3% (ASK, 2013), kryesisht për shkak të ngritjes së çmimeve të naftës dhe ushqimit (buka dhe drithërat) në tregun ndërkombëtarë.

Tabela 5: Norma mesatare vjetore e inflacionit (në %)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Norma e inflacionit	4.4	9.4	-2.4	3.5	7.3	2.5

Kosova vazhdimisht karakterizohet me inflacion të shkaktuar nga çmimet e produkteve të importuara. Deri në shtator 2012, çmimet e importit shënuan rritje prej 5.8% krahasuar me shtator 2011, ndërsa çmimet e prodhimit ishin më stabile duke shënuar një normë mesatare të rritjes prej 0.8%. Vlen të theksohet se gjatë viteve të fundit në Kosovës ka pasur ndryshim të peshave në shportën e konsumatorit të disa kategorive si p.sh. produktet ushqimore, duke rënë në 37.8% të gjithsej shportës së konsumatorit krahasuar me 42.7% në vitin paraprak. Rënia e peshës nga kategoria e ushqimit pritet të ndikojë pozitivisht edhe në stabilitetin e çmimeve në vend marrë parasysh se kategoria e produkteve ushqimore përveç peshës së lartë, karakterizohet edhe me ndryshime më të theksuara të çmimeve.

4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i Pagesave në Kosovë në vazhdimësi është karakterizuar me deficit të lartë të llogarisë rrjedhëse si dhe me suficit në llogarinë kapitale dhe financiare. Deficiti i lartë i llogarisë rrjedhëse i cili vazhdimisht shkaktohet nga deficiti i lartë tregtar konsiderohet të jetë ndër faktorët me ndikimin më negativ në rritjen e BPV-së. Deficiti në Kosovë konsiderohet kronik dhe afatgjatë me mesatarisht rreth 11% të BPV-së në çdo vit (BQK, 2013). Financimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë viteve të fundit është mbështetur mirë nga llogaria kapitale dhe financiare, sidomos kategoria e investimeve të huaja direkte (IHD) dhe investimet tjera. Në anën tjetër, duhet të ceket se janë pikërisht dërgesat e emigrantëve komponentë me ndikimin më të lartë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

²³ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 347-348.

4.1. Llogaria rrjedhëse

Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, komponentët kryesore vazhdojnë të jenë tregtia e mallrave në të cilat Kosova ka nivel të lartë të deficitit. Si pjesëmarrëse e marrëveshjes CEFTA, Kosova ka një ekonomi të hapur dhe aktiviteti tregtar paraqet një rëndësi të lartë në komponentët kryesore të Bilancit të Pagesave dhe Llogarisë rrjedhëse. Mirëpo, njëra ndër problemet më thelbësore të ekonomisë së Kosovës konsiderohet të jetë mungesa e konkurrueshmërisë në tregtinë e mallrave kur merret parasysh deficit i thellë tregtar duke bërë ekonominë e vendit të varur nga importet dhe me nivel të ulët të eksporteve. Eksportet gjatë viteve kishin një nivel mesatar prej rreth 10% në mbulueshmërinë e importeve, që paraqet ndër më të ultat në rajon dhe më gjerë. Ndërsa në kontekst të eksporteve, janë metalet bazë ato që dominojnë strukturën e eksporteve.




Figura 2: Eksporti i shërbimeve

Eksporti i mallrave deri në fund të vitit 2012 arriti në 269.3 milionë EUR, ndërsa importi arriti shumën prej 2.5 miliardë EUR që njëherësh paraqet një normë të ulët të mbulueshmërisë së importeve me eksporte prej vetëm 10.8%. Komponentë tjetër me rëndësi në kuadër të bilancit të pagesave vazhdon të jenë dërgesat e emigrantëve të cilat deri në shtator 2012 arritën në 436.7 milionë EUR që paraqet një rritje vjetore prej rreth 2%. Komponentët tjerë të llogarisë rrjedhëse si tregtia me shërbimet dhe të ardhurat kanë bilanc pozitiv por se ndikimi i tyre në ngushtimin e deficitit mbetet i limituar.

Gjithashtu, në kontekst metodologjik, duhet cekur se që nga shtatori 2012, ASK ka filluar të mos përfshijë statistikën mbi tregtinë e energjisë në raportin e saj të tregtisë së jashtme duke ndërprerë serinë e gjatë kohore me ndryshim metodologjik.

Komponentët tjerë të llogarisë rrjedhëse janë eksporti i shërbimeve në të cilën ekonomia e Kosovës është karakterizuar me bilanc pozitiv. Eksporti i shërbimeve gjithashtu mund të paraqesë një rëndësi të lartë në tregtinë e mallrave të cilën duhet të orientohet ekonomia e vendit marrë parasysh parakushtet që krijon fuqia punëtore fleksibile e vendit. Bilanci i llogarisë së shërbimeve deri në shtator 2012 arriti në 204 milionë EUR, duke bërë kështu që kjo llogari të jetë ndër kontribuesit në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.




Figura 3: Dërgesat e emigrantëve

Komponentë tjetër me bilanc pozitiv është edhe kategoria e të hyrave e cila deri në shtator 2012 arriti në 102 milionë EUR. Sidoqoftë, ndër komponentët më të rëndësishme vazhdon të jetë kategoria e transfereve rrjedhëse e cila deri në shtator 2012 arriti në 819 milionë EUR. Në kuadër të kësaj llogarie, pjesëmarrjen kryesore e kanë dërgesat e emigrantëve vlera e të cilave deri në shtator 2012 arriti në 436 milionë EUR, ndërsa mesatarja në 4 vitet e fundit ishte në rreth 590 milionë EUR, nivel ky i cili pritet të jetë i ngjashëm edhe gjatë vitit 2012. Vlen të theksohet se ndikimi i dërgesave të emigrantëve në kontekst të BPV-së është kryesisht i koncentruar në financimin e konsumit të ekonomive familjare. Kjo komponentë është mjaft e rëndësishme për ekonominë e Kosovës marrë parasysh normën e lartë të papunësisë dhe konsiderohet si njëri ndër faktorët kyç që ulë presionet sociale pasi që janë pikërisht ekonomitë familjare që ballafaqohen me papunësi ato që marrin dërgesa nga jashtë. Sidoqoftë, duhet edhe të theksohet se efekti i tyre afatgjatë mund të jetë jo i favorshëm për tregun e punës pasi që dërgesat e emigrantëve ndikojnë negativisht në vendimin e individëve që të hyjnë në tregun e punës si dhe rrisin pagën minimale që kërkohet nga këta individ.

4.2. Llogaria Kapitale dhe Financiare

Në kuadër të bilancit të pagesave, pjesë e rëndësishme është edhe llogaria kapitale dhe financiare. Në Kosovë, ishin pikërisht flukset hyrëse në këtë llogari ato që ndikuan në mbajtjen e nivelit relativisht të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sipas të dhënave të BQK-së, deri në shtator 2012 bilanci i llogarisë kapitale dhe financiare ishte 63.5 milionë EUR. Ky nivel njëherësh paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2008. Faktorët që më së shumti ndikuan që kjo llogari të ketë rënie relativisht të lartë ishin: niveli i ulët i granteve për investime kapitale, rënia e investimeve të huaja direkte si dhe rënia e financimit nëpërmjet investimeve tjera si dhe rritja më e shpejtë e investimeve portfolio të cilat paraqesin fluks dalës për ekonominë e Kosovës.




Figura 4: Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte në Kosovë paraqesin një rëndësi të rëndësishme për rritje ekonomike dhe për burime të reja të financimit në vend. Gjatë viteve, ekonomia e Kosovës ka pasur nivel të kënaqshëm të fluksit hyrës të IHD-ve të cilat mesatarisht kanë pasur një pjesëmarrje prej rreth 7.6% të BPV-së. Të dhënat e paraqitura në grafik për vitin 2012 janë vetëm deri në shtator 2012. Mirëpo, gjatë viteve paraprake, Kosova mesatarisht ka tërhequr IHD në vlerë prej 370 milionë EUR në vit (përfshirë vitin 2012). Investimet e huaja direkte sipas të dhënave të BQK-së i takojnë kryesisht formës së investimeve kapitale gjatë vitit 2012, ndërsa në bazë sektoriale, IHD-të kishin ndryshime të vazhdueshme në pjesëmarrje (BQK, 2013). Siç edhe është paraqitur, IHD-të në pjesëmarrje gjatë vitit 2012 kanë shënuar rritje në sektorin e patundshmerisë, ndërsa sektorët tjerë ekonomik si sektori financiar dhe transporti e telekomunikacioni kanë shënuar rënie në vitet e fundit. Rritje e theksuar e IHD-ve vërehet edhe në sektorin e ndërtimitarisë ndërsa sektori i prodhimitarisë si pjesëmarrje ka treguar një stabilitet me tendencë pozitive në vitet e fundit. Në kontekst të shteteve, IHD-të në Kosovë kryesisht vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian, ndërsa në vitet e fundit është rritur pjesëmarrja e IHD-ve nga Turqia. Vlen të ceket se ndër faktorët që më së shumti e përcaktojnë nivelin e IHD-ve në Kosovë konsiderohet të jenë rritja ekonomike në eurozonë si dhe procesi i privatizimit në vend.




Figura 5: Struktura e investimeve të huaja direkte

Komponentë tjetër me rëndësi në kuadër të llogarisë kapitale dhe financiare është edhe kategoria e investimeve portfolio. Duhet të theksohet se kjo kategori kryesisht përbëhet nga investimet jashtë vendit në instrumente financiare në tregjet ndërkombëtare. Kjo paraqet kryesisht investimet e fondit pensional në tregje të aksioneve si dhe forma tjera. Si rezultat i mungesës së instrumenteve në tregun e Kosovës, kjo kategori vazhdimisht shënon figura negative që nënkupton se ekonomia e Kosovës investon jashtë vendit, por se nuk pranon investime në kuadër të kësaj kategorie. Në anën tjetër, investimet tjera paraqesin format e investimeve të cilat nuk i takojnë kategorive të diskutuara deri më tani. Këto kategori përfshijnë depozitat e ndryshme jashtë vendit si dhe depozitat e jo-rezidentëve në vend, kreditë tregtare etj. Rrjedhimisht komponentë kryesore në kuadër të fluksit hyrës të kësaj kategorie janë kreditë tregtare.




Figura 6: Investimet portfolio

4.3. Kërkesat e BE-së

Specifikisht për bilancin e pagesave nuk ka kërkesa të veçanta në Acquis, që do të thotë se nuk ka kushte për gjendjen e bilancit të pagesave për marrjen e kandidatit për anëtarësim. Mirëpo neni 119 i Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian, në të cilin flitet për Politikën Ekonomike dhe Monetare, thuhet se njëri nga parimet është qëndrueshmëria e bilancit të pagesave, pjesë kjo e cila nuk është e aplikueshme për Kosovën pasi që përkundër deficitit të thellë në bilancin e pagesave, Kosova nuk përballet me rrezik të normës së këmbimit ose valutës pasi që si valutë përdorë euron.

4.4. Korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë

Në Kosovë, rregullativa në fushën e stabilitetit makroekonomik dhe bilancit të pagesave është e shpërndarë në disa akte ligjore, duke përfshirë:

- Ligji për Auditim të Brendshëm
- Ligji për Bankën Qendrore

- Ligji për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar
- Ligji për Borxhet Publike
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
- Ligji për Investimet e huaja
- Ligji për tregti me jashtë
- Ligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, etj

Politikat tregtare, që hyn në kornizën e kompetencave të MTI-së, ndikojnë në bilancin e pagesave. Në anën tjetër përgjegjës për përpilimin e statistikave të bilancit të pagesave është BQK e cila përveç publikimit të rregullt të serive kohore mbi statistikave të bilancit të pagesave, në baza të rregullta publikon raporte me analiza për të gjithë sektorët e ekonomisë si dhe në çdo vit publikon Raportin e Bilancit të Pagesave.

4.5. Statusi dhe sfidat

Bilanci i pagesave përbëhet nga tri llogari: llogaria rrjedhëse, kapitale dhe financiare. Kategoritë nga të cilat përbëhet bilanci tregtar janë: Eksportet e mallrave, pranimi i remitencave, ndihmat e dhëna nga qeveritë e huaja, investimet nga kompanitë e huaja dhe të ardhurat e arkëtuara nga investimet e bëra jashtë vendit. Në anën tjetër, bilanci i pagesave pëson ulje nga: Importi i mallrave, lëshimi i remitencave, të ardhurat e paguara për investimet e huaja, ndihmat e dhënë nga Qeveria e Kosovës dhe investimet e huaja nga banorët e Kosovës. Analiza e transaksioneve hyrëse dhe dalëse në këto kategori mundëson krijimin e projeksioneve për gjendjen e bilancit të pagesave në të ardhmen.

Përshkrimi	Llogaria rrjedhëse					Llogaria kapitale dhe financiare				Gabi- met dhe lëshimet neto
	Mallrat dhe shërbimet				Të hyrat	Transferet rrjedhëse		Llogaria kapitale	Llogaria financiare	
		Mallrat	Shërbi- met							
2004	-208.2	-1001.4	-983.1	-18.3	138.3	654.9	79.4	21.9	57.6	128.8
2005	-247.5	-1086.9	-1078.5	-8.3	139.1	700.3	72.7	18.9	53.8	174.8
2006	-226.1	-1144.1	-1173.1	-29.0	158.8	759.2	-14.9	20.8	-35.7	240.9
2007	-214.0	-1242.3	-1352.9	110.5	186.3	842.0	10.7	16.5	-5.8	203.3
2008	-460.9	-1498.2	-1649.7	151.6	164.0	873.2	298.9	10.5	288.5	162.0
2009	-412.1	-1457.2	-1651.7	194.5	61.8	983.4	213.3	100.3	113.1	198.7
2010	-558.6	-1608.1	-1725.1	144.0	67.0	982.5	297.2	21.3	275.9	216.4
2011	-673.6	-1777.8	-2059.0	281.3	113.8	990.4	419.6	42.0	377.5	254.0
T1	-52.9	-260.9	-319.5	59.6	20.9	187.2	-14.3	-0.5	-13.8	67.1
T2	-139.2	-365.9	-420.0	54.1	26.4	200.2	134.1	4.0	130.1	5.2
T3	-138.2	-406.2	-448.2	42.0	3.0	265.0	-35.2	5.0	-40.2	173.4
2009 T4	-81.8	-424.3	-464.0	39.8	11.5	331.0	128.8	91.9	36.9	-47.0

T1	-53.2	-272.1	-131.7	41.5	23.7	195.3	14.7	4.7	10.0	38.5
T2	-138.2	-391.1	-443.1	51.9	24.3	228.6	146.0	3.7	142.3	-7.8
T3	-241.0	-499.7	-514.6	14.9	-1.5	260.2	6.5	6.9	-0.5	234.6
20010 T4	-126.1	-445.1	-480.7	35.7	20.6	298.4	130.0	6.0	124.0	-3.9
T1	-39.0	-301.3	-382.0	80.7	41.9	220.4	9.5	13.3	-3.8	29.5
T2	-166.4	-440.3	-514.1	73.9	30.0	243.9	216.7	6.0	210.7	-50.3
T3	-213.0	-503.0	-557.4	54.4	21.2	268.7	-17.4	6.3	-23.8	230.4
20011 T4	-255.2	-533.3	-605.5	72.2	20.6	257.5	210.8	16.4	194.4	44.4
T1	-50.0	-332.6	-382.2	49.6	37.4	245.2	12.9	-0.9	13.8	37.1
2012 T2	-166.5	-485.5	-554.6	69.1	44.4	274.7	78.3	2.5	75.8	88.2

Figura 7: Bilanci i pagesave

5. Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF)

5.1. Fondi Monetar Ndërkombëtarë (FMN)

Kosova është bërë anëtare e 186-të e FMN-së me 2009, megjithatë është përkrahur në formë të asistencës teknike nga FMN qysh nga pas lufta. Gjendja fiskale e Kosovës vazhdon të karakterizohet si stabile edhe përkundër rritjes të theksuar të shpenzimeve që nga vitit 2008 në krahasim me vitet paraprake. Periudha para vitit 2008 është karakterizuar më tepër me nivel më të lartë të të hyrave se shpenzime, duke akumuluar suficit buxhetor për këtë periudhë, ndërsa, në vitet e fundit, buxheti karakterizohet me deficit, por në nivel relativisht të ulët.²⁴

Përkundër stabilitetit fiskal, Kosova gjatë vitit 2010 ka hyrë në programin e njohur si Stand-By Arrangement (SBA), që njëherësh paraqet edhe ndihmën e parë financiare nga FMN për buxhetin e Kosovës prej 109 milionë EUR, ekuivalente me 157% të kuotës së Kosovës në FMN. Ky aranzhman 18 muajsh kishte për qëllim adresimin e nevojave buxhetore për të cilën FMN parashihej të shpërndante kredinë e aprovuar në buxhetin e Kosovës në gjashtë këste. Në vitin 2010 Kosova ka tërhequr këstin e parë prej 22 milionë EUR pas përmbushjes së kushteve të dakorduara nga qeveria dhe FMN-ja. Qëllimi kryesor i këtij programi ishte ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale dhe stabilitetit financiar. Për të arritur këto objektiva, autoritetet qeveritare duhet të: kufizojnë shpenzimet rrjedhëse dhe të rrisin nivelin e të hyrave që të akomodohet rritja e shpenzimeve kapitale, sigurimi i financimit të konsiderueshëm nga privatizimi për të ruajtur qëndrueshmërinë e borxhit, implementimin e reformave që kanë për qëllim rritjen e bazës tatimore dhe forcimin e menaxhimit të financave publike, ngritjen e bilancit bankar për të siguruar hapësirë për Fondin Emergjent të Likuiditetit si dhe përmirësimin e gjendjes financiare të sektorit të energjisë (IMF Country Report No. 10/245, 2010). Si pjesë e këtij programi ishin paraparë edhe disbursimi i ndihmave tjera buxhetore nga Komisioni Evropian dhe

²⁴ BB - Kosovo Country Partnership Strategy 2012-2015, fq. 3.

Banka Botërore, mjete të zotuarra gjatë konferencës së donatorëve.

Pas dështimit të SBA për shkak të mos-privatizimit të aksioneve të PTK-së dhe ngritjes së pagave, edhe Komisioni Evropian ka vendosur të mos paguaj 50 milion EUR të premtuara paraprakisht. Kjo bëri që Qeveria në korrik 2011 të vazhdoj bashkëpunimin, këtë herë përmes të Staff-Monitored Programme (SMP) 6 mujor. SMP kishte për qëllim të: i) përshtat gjendjen e strukturës fiskale për 1.5% të BPV në kuadër të buxhetit 2011 dhe 2012 në mënyrë që gradualisht të krijohet një qëndrueshmëri fiskale, ii) përmirësoj planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, iii) fuqizoj fleksibilitetin e sistemit financiar si plotësimi i kornizës ligjore dhe administrative për ofrimin e Fondin Emergjent të Likuiditetit. Zbatimi i SMP-së ka qenë kryesisht i kënaqshëm duke i plotësuar shumicën e kritereve. Qëllimet fiskale janë tejkaluar me deficitin e përgjithshëm fiskal 1.9% për vitin 2011 (krahasuar me cakun prej 2.9%).²⁵ Gjatë vitit 2011 gjendja makroekonomike është përmirësuar dukshëm dhe Kosova ka arritur të bëjë përshtatjen prej 1.5 pp të BPV-së në kuadër të SMP (megjithatë për shkak të dështimit të privatizimit të PTK-së, bilanci në fund të 2011 mbeti për gjysmë më i vogël sesa që nevojitej për t'u siguruar nga rreziqet financiare)²⁶. Pas përmbylljes së suksesshme të SMP në periudhën qershor-dhjetor 2011, FMN në prill 2012 ka miratuar një SBA të re për 20 muaj në total prej rreth 106 mil EUR (prej të cilave 5 milion EUR janë paguar menjëherë) për të përkrahur programin ekonomik të Qeverisë për vitet 2012-2013.²⁷ SBA ka për objektive të: i) restauroj gjendjen e qëndrueshme fiskale dhe një nivel adekuat të bilancin bankar të ashtuquajtur 'cash buffer' për të evituar rreziqe të mundshme fiskale dhe; ii) futë një rregull fiskale ligjor obligative; iii) dizajnoj dhe vlerësoj më mirë iniciativat shpenzuese; iv) përmirësoj efikasitetin e decentralizimit fiskal; v) fuqizoj kornizën ligjore për rregullimin financiar dhe monitorimin; dhe vi) siguroj BQK-në me fonde të nevojshme për asistencë emergjente për likuiditet.²⁸

Më konkretisht për qëndrueshmëri të plotë kërkohet që të bëhet një progres prej edhe 1.5 pp të BPV-së deri me 2014 përmes kufizimit të shpenzimeve dhe masave për rritjen graduale të të hyrave (për të arritur 3% të BPV sikurse që është identifikuar nevoja në SMP). Për të arritur stabilitetin financiar nevojitet që BQK të ka në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme dhe t'i përdor ato sipas nevojës pa ndërhyrje të jashtme. Në këtë drejtim Kuvendi i Kosovës në prill 2012 ka miratuar Ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare (LBIMIFJB) që fuqizon BQK-në në këtë aspekt. Po ashtu nevojiten reforma për përmirësim të mjedisit afarist, rruajtjes së fleksibilitetit të tregut të punës, zhvillimit të sektorëve ekonomik dhe zhvillimit të infrastrukturës, të gjitha këto me qëllim të përmirësimit të konkurrenshmërisë dhe

²⁵ FMN - Republic of Kosovo: Request for Stand-By Arrangement – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, April 2012, fq. 3-5.

²⁶ Ibid.

²⁷ FMN - Survey Magazine: Countries & Regions - Kosovo Receives €48 Million Installment Under FMN Loan, 17 July 2012.

²⁸ FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 16.

rritjes ekonomike. Bilanci bankar pritet të përmirësohet me përfundimin e privatizimit të PTK-së gjatë viti 2013 që do të mundësonte Qeverisë të absorboj goditjet e mundshme financiare. Përdorimi i euros si valutë zyrtare në Kosovë është premium jo vetëm për disiplinën fiskale por edhe për fleksibilitetin e tregut të punës dhe reformat strukturore që risin konkurencshmërinë e ekonomisë. Masat e ndërmarrë për të përmirësuar rangimin e Kosovës në 'Doing Business' janë të mirëseardhura, mirëpo nevojiten reforma të mëtutjeshme për të stimuluar investitorët vendorë dhe të huaj.²⁹ Këto reforma pritet që të kthejnë kredibilitetin e politikave makro-financiare për të mundësuar Qeverisë një qëndrueshmëri në vet-financimin e bilanceve bankare, dhe për të kontribuar në krijimin e një atmosfere më të përshtatshme për tërheqjen e investimeve private dhe të diasporës.³⁰

FMN në vlerësimin e parë të SBA në maj-qershor 2012 thekson se Kosova ka arritur 4 nga 6 kriteret kuantitative dhe strukturore dhe se politikat financiare dhe makroekonomike në përgjithësi janë në pajtim me SBA. Caqet kuantitative për muajin prill në lidhje me bilancin bankar të qeverisë së përgjithshme, bilancin primar, shpenzimet primare, kontraktimin neto dhe garantimin e borxhit jo-koncesionar, dhe për mos-alokim të borxheve lidhur me pagesat e jashtme janë përmbushur. Shumica e kriterëve strukturore janë përmbushur gjithashtu, ndonëse në një rast kriteri strukturor i vazhdueshëm për përfshirje të një klauzole standarde që mundëson kontrollimin e kostos në të gjitha ligjet e reja që krijojnë beneficione nuk është respektuar (p.sh. ligji për FSK apo për pensionet). Masat korrigjuese po ndërmerren në këtë drejtim. Kriteri strukturor lidhur me dorëzimin në Kuvend të Ligjit të rishikuar për sigurim të depozitave nuk është përmbushur për 3 javë për shkak të konsultimeve më të gjata me partnerët.³¹ Në anën tjetër implementimi i buxhetit 2012 është në përputhje me SBA, ku mbledhja e të hyrave nuk e ka arritur cakun përkohësisht, mirëpo bilanci është kompensuar me shpenzime më të ulëta të projekteve kapitale dhe pranimit të dividendës nga PTK më herët sesa që është paraparë. Targeti mbi mbledhjen e detyrimeve të pashlyera (arrears) po ashtu nuk është arritur për një përqindje të vogël që tregon dobësi në monitorimin e obligimeve të pagesave. Prandaj Qeveria së bashku me FMN janë duke ndërmarrë masa për të adresuar këto probleme sikur që janë kursimet shtesë për të mbuluar deficitin që mund të shfaqet nga mos-mbledhja e mjaftueshme e të hyrave, përfshirë mundësinë e përdorimit të rezervës së paraparë në buxhetin 2012 (deri 60 milion EUR të paalokuara si rezervë³²). Buxheti i vitit 2013 pritet të përshtat gjendjen edhe për 0.6% të BPV, që do të bënte gjendjen fiskale edhe më të qëndrueshme.³³ Si rezultat i performancës së mirë

²⁹ FMN - Press Release No. 12/154 - FMN Executive Board Approves € 106.6 Million Stand-By Arrangement for Kosovo, 27 April 2012.

³⁰ FMN - Republic of Kosovo: Request for Stand-By Arrangement – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, April 2012, fq. 14-15.

³¹ MF - Misioni i FMN-së përmyllë vizitën e tij në Kosovë - Politikat makroekonomike dhe financiare në Kosovë janë në rrugë të duhur http://mfq.rks-gov.net/zyratkryesore/zyraperkomunikimpublik/komunikata.aspx?udt_458_param_detail=707.

³² FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 11-12.

³³ Ibid, fq. 3.

të Qeverisë, FMN ka paguar edhe 48 milion EUR duke bërë totalin e mjeteve të paguara 53 milion EUR.

Vlerësimi i FMN-së në fund të vitit 2012 thekson se politikat makroekonomike dhe financiare janë në drejtim të duhur, ku kriteret e performancës kuantitative janë përmbyshur për afatin e gushtit (të hyrat më të ulta janë kompensuar me zvogëlimin e shpenzimeve), caqet strukturore poashtu janë arritur (me vonesë të shpalljes së tenderit për privatizim të PTK-së), kurse caqet indikative nuk janë arritur në aspektin e detyrimeve të pashlyera që potencojnë mangësi në monitorimin e detyrimeve edhe pse institucionet vendore janë duke punuar në këtë drejtim. Progres të theksuar ka edhe në aspektin e arrijtes së qëllimeve të programit. Përshtatja strukturore prej 1.1% të BPV-së është zbatuar në 2012 dhe buxheti 2013 kontribuon në këtë drejtim me 0.6% tjera që pritet të krijoj qëndrueshmëri më të madhe fiskale. Bilanci bankar i Qeverisë në 2012 ka përfunduar me 40 milion EUR më shumë së sa është parashikuar, kurse të hyrat nga privatizimi i PTK-së në 2013 pritet të përmirësojnë gjendjen edhe më tej dhe të ndihmojnë në përbalimin e goditjeve të mundshme fiskale. Në anën tjetër fondi special i rezervave të BQK-së për asistencë emergjente likuide dhe miratimi i ligjit për depozitat e sigurimeve ofrojnë një siguri më të madhe në aspektin e stabilitetit financiar.³⁴

Si rezultat i këtyre zhvillimeve janë propozuar disa modifikime në program, si vijon: do të shtohen dy caqe strukturore i) studimi i fizibilitetit për autoudhën R6 deri në fund të janarit 2013 dhe ii) miratimi i kornizës fiskale nga Kuvendi deri në mars 2013 që do të përbënte sanksionime ligjore për menaxhim makroekonomik; kriteret e performancës të bilancit bankar të qeverisë do të revidohen për të reflektuar transferet e mundshme të paplanifikuara nga AKP, etj.³⁵

5.2. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

Kosova është bërë anëtare e 66 e BERZH-it në dhjetor 2012; anëtarësimi në këtë institucion është i rëndësishëm për reforma dhe zhvillim ekonomik, kjo duke marrë parasysh se BERZH është investuesi më i madh financiar në Evropën Lindore, me investime të theksuara në Ballkan. Momentalisht janë duke u bërë përgatitjet për hapjen e BERZH-it në Kosovë si dhe ligji për BERZH dega në Kosovë është në procedurë të aprovimit në Kuvend.

5.3. Banka Evropiane e Investimeve (BEI)

BEI kishte nënshkruar në vitin 2005 një marrëveshje me UNMIK-un në emër të Kosovës përmes së cilës BEI do të financonte investime kapitale në Kosovë me qëllim që të ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në vend, sidomos zhvillimin rajonal dhe bashkëpunimin trans-evropian. Kosova kohëve të fundit është bërë anëtare e pro-

³⁴ FMN - Second Review under the Stand-by Arrangement, Request for rephrasing of purchases and modification of performance criterion, December 2012, fq. 4.

³⁵ Ibid.

grameve investuese të BEI-së.

5.4. Banka Botërore (BB)

Banka Botërore në Kosovë ka themeluar zyrën e vet pas luftës dhe në bazë të përvojës së deritanishme në vend ka përcaktuar tri prioritetet kryesore: i) rritja ekonomike që kontribuon në zbutjen e papunësisë, në veçanti për të rinjtë dhe femrat, ii) përmirësimi i mjedisit afarist si mjet për nxitjen e sektorit privat dhe investimeve private, dhe iii) rritja ekonomike që mundëson zhvillim të qëndrueshëm, përfshirë minimizimin e degradimit të resurseve natyrore dhe shëndetit njerëzorë. BB përmes marrëveshjes së arritur në qershor 2011 mund të veproj si udhëheqëse e Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimorë (Western Balkans Investment Facility) për të përgatitur projekte të përbashkëta investuese mes Bashkimit Evropian (BE), institucionet financiare të BE-së dhe BB-së, prej të cilave mund të përfitoj edhe Kosova. Qeveria e Kosovës tashmë ka aplikuar me disa projekte për eficientë e energjisë, menaxhimin e mbeturinave, etj. Përveç kësaj, Kosova mund të përfitoj nga propozimet e shteteve tjera të rajonit për projekte studimore rajonale që kanë të bëjnë me implementimin e Unazës së Gazsjellësit të Komunitetit Energjetik, etj.

BB, ndër të tjerat, ka ndihmuar në përpilimin e dy ligjeve, atë për shërbyesit civil dhe për pagat e shërbyesve civil, të cilat përcaktojnë strukturën uniforme të gradimit dhe pagave. Kostoja fillestare e zbatimit të këtyre ligjeve gjatë vitit të parë është supozuar të jetë 9.1 milion EUR, mirëpo është vërejtur se kjo përlllogaritje është shumë e ulët. Numri i rritur i shërbyesve civil nga 2009 (si rezultat i themelimit të ministrive dhe komunave të reja), mbi-gradimi dhe promovimi i shpejtë shtojnë rrezikun e shpenzimeve të larta. Në dhjetor 2011 numri i shërbyesve civil shënon 75,000 (33,000 në nivelin qendrorë dhe 42,000 në nivelin lokal), ndërsa BB sugjeron se numri i përgjithshëm i shërbyesve civil është 13% më i lartë sesa duhet. Prandaj kërkohet që legjislacioni sekondar të përpilohet me kujdes në mënyrë që të kontrollohen shpenzimet në këtë drejtim. Promovimet duhet të kufizohen në 10% të stafit brenda vitit (tani është 50%), puna jashtë orarit duhet të kufizohet në maksimum 10% të pagës bazë, dhe avancimi duhet të bëhet me diferencim adekuat në mes të shkallëve.³⁶

Kosova është bërë anëtarë e Grupit të Bankës Botërore (GBB) në qershor 2009, anëtarësim ky që ka privilegjet por edhe përgjegjësitë e veta. Me këtë anëtarësim Kosova ka pranuar të marrë obligimet e borxheve jugosllave drejt Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në shumën prej 381 milionë EUR. Me këtë rast është themeluar një Fond Mirëbesimi multilateral për të ndihmuar Kosovës të paguaj këto borxhe, dhe deri më tani janë kthyer 125 milionë dollarë nga SHBA-të dhe 5 milionë EUR nga Komisioni Evropian.³⁷

³⁶ FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 14.

³⁷ BB – The World Bank in Kosovo, June 2012, fq. 24.

5.5. Komisioni Evropian

Me 2008 Kosova dhe Komisioni Evropian (KE) kane iniciuar një Mekanizëm për Mbikëqyrje Fiskale në bashkëpunim të ngushtë me FMN. Ky mekanizëm ndihmon Kosovën në përgatitjet për integrimin në kornizën ekzistuese të monitorimit ekonomik dhe fiskal të Bashkimit Evropian (BE) të themeluar për Ballkanin Perëndimorë. Në këtë aspekt Kosova duhet të ofroj programin ekonomik dhe fiskal në baza vjetore.³⁸

Pas studimit të fizibilitetit, kërkesave dhe rekomandimeve të KE-së, Qeveria e Kosovës është duke zbatuar reformat e nevojshme për arritjen e kritereve afat-shkurtra që do të mundësonin hapjen e negociatave për Marrëveshje të Stabilizim Asocimit (MSA). Kosova është duke përgatitur strukturat negociuese dhe pritet që shumica e negociatave do të fokusohen në aspektin e tregtisë së lirë.

³⁸ Kosovo - Fulfilling its European Perspective, 2009, fq. 8.

6. Konkluzione

Avantazhet	Sfidat	Rekomandimet
Banka Qendrore e Kosovës nxjerr statistika çdo tre muaj mbi gjendjen e bilancit të pagesave	- BE kërkon kalkulimin e statistikave mbi gjendjen e bilancit të pagesave në baza mujore	- BQK të vendosë në planin strategjik fillimin e lëshimit të statistikave mujore, që përkojnë me kërkesat e BE-së
Prania e euros si valutë e eliminon mundësinë që Kosova të jetë e ekspozuar ndaj krizës së bilancit të pagesave		
Bilanci pozitiv i eksporteve të shërbimeve ndikon në zvogëlimin e deficitit tregtar.	Bilanci tregtar në mallra ka nivel shumë të lartë të deficitit	Për rritjen e eksporteve, të investohet në krijimin e kapaciteteve për prodhimin e produkteve finale.
IÇK ka shënuar trende pozitive gjatë vitit 2012 që ka ndikuar në zhvlerësimin e NREK dhe konkurencshmërinë e produkteve vendore	Trendet e IÇK-së janë të paqëndrueshme duke u ndikuar nga tregjet ndërkombëtare	Ulja e deficitit të bilancit tregtar do të kishte efekt pozitiv për IÇK
Tregu i punës në Kosovë ka fuqi punëtore të re me mesataren ndër më të mirat në rajon dhe më gjerë	Papunësia e lartë e përcjell me fuqi punëtore me kualifikime joadekuate dhe me mungesë të programeve për mbrojtje sociale.	
Kosova është duke zbatuar kriteret e përcaktuara nga FMN që sigurojnë një qëndrueshmëri makro-financiare.	Financimi i mundshëm i autoudhës R6 pa mbulesë adekuate sikurse edhe skemat sociale mund të shkaktojnë probleme financiare por edhe shkaktojnë të marrëveshjes me FMN	Kërkohet kujdes më i madh në aspektin e hyrjes në detyrime për financim

Kapitulli II - Politikat Tregtare³⁹

Shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve ndërmjet shteteve, përbën një nga konceptet themelore të ekonomisë. Një zhvillim i hovshëm ekonomik nuk mund të mendohet pa kontributin e eksportit dhe importit. Prandaj, kjo bën që secili shtet të ketë politikat e veta të tregtisë që si rrjedhojë krijohen lidhje e marrëveshje tregtare ndërmjet dy apo më shumë shteteve, ku qëllimi është maksimizimi i përgjithshëm i përfitimeve. Në këtë drejtim politikat dhe barrierat tregtare shpesh herë krijojnë konflikte ndërmjet shteteve, gjë e cila si pasojë rëndom ka marrjen e masave të reciprocitetit. Në anën tjetër shtrirja gjeografike e vë Kosovën në një hapësirë kyçe për shkëmbimin e mallrave me vendet tjera dhe si e tillë, Kosova mbetet një shtet transit për shkëmbimin e mallrave ndërmjet vendeve të ndryshme.

1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit

Tregtia është një fushë ku shtjellohet një numër i madh i dokumenteve dhe rregullave të Bashkimit Evropian. Eliminimi i kufijve, si njëra nga shtyllat bazë të BE-së, nënkupton që fleksibiliteti i shteteve të Bashkimit Evropian për krijimin e politikave tregtare është i kufizuar. Në këtë drejtim qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve, brenda BE-së bëhet pa imponimin e tarifave dhe barrierave tregtare ndërmjet shteteve anëtare. Kjo parashihet në kapitullin e parë të Acquis, lëvizja e lirë e mallrave, ku ndër të tjera thuhet: 'principi i lëvizjes së lirë nënkupton që produktet duhet të tregtohen lirshëm nga njëra pjesë e BE-së në tjetrën'. Për të arritur këtë, duhet të ketë një kornizë rregullative të harmonizuar.⁴⁰ Pra, Kosova dhe shtetet që mëtojnë të integrohen duhet të investojnë në masa për qarkullim të lirë të mallrave nëpër pikat kufitare. Përveç kësaj, kapitulli i dytë dhe katërt i Acquis flasin për lëvizjen e lirë të punëtorëve dhe kapitalit që kanë rëndësi të madhe për funksionim të tregtisë së lirë. Relevante për tregtinë është edhe kapitulli 8 in Acquis që ka të bëjë me konkurrencën si dhe kapitulli 29 për Unionin Doganor, etj. Për këtë të fundit parashihen rregulla rreth adoptimit të Kodit Doganor të BE-së, tarifave të përbashkëta doganore, provizioneve rreth klasifikimit të tarifave, e shumë fusha të tjera.⁴¹ Për implementimin e këtyre kërkesave, primare është sigurimi i kapaciteteve për shërbimet doganore.

Rregullorja e Këshillit Evropian me numër 2658/87, për tarifatat, klasifikimet statistikore dhe për Tarifatat e Përbashkëta Doganore, është dokument kyç i BE-së për fushën e tregtisë.⁴² Këtu përshkruhen të gjitha kërkesat për temat në fjalë dhe gjithashtu parashihen rregullore tjera për përmbushjen e këtyre kërkesave. Në këtë kuadër është i rëndësishëm Aneksi 1 i rregullores Klasifikimet e Përbashkëta dhe Tarifatat e Përbashkëta Doganore

³⁹ Për informata më të hollësishme për politikat tregtare shih kapitullin 1 dhe 2 të raportit diagnostifikues të Tryezës për tregti.

⁴⁰ Chapters of the acquis, Enlargement Policy of the European Commission, Conditions for membership.

⁴¹ Ibid.

⁴² Council Regulation No. 2658/87, on the tariff and statistical nomenclature and on the Common Customs Tariff.

ku përshkruhet klasifikimi i llojeve të ndryshme i mallrave, që është e domosdoshme për eliminim e kufijve. Në anën tjetër, tek Tarifatat e Përbashkëta Doganore, përshkruhen tarifatat që përdoren nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në tregti me vendet tjera.

2. Korniza Legjislative dhe Institucionale në Kosovë

Kosova ka një strukturë ligjore mjaft të avancuar për rregullimin e tregtisë me jashtë⁴³ e cila ofron një përparësi të konsiderueshme në proceset integruuese. Më poshtë janë ligjet që direkt apo indirekt e rregullojnë tregtinë e jashtme:

- Ligji për masat anti-dumping dhe masat kundër-balancuese, Nr. 03-L-097
- Ligji për masat mbrojtëse në importe, Nr. 04-L-047
- Ligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, Nr. 03-L-112
- Ligji për tregti me jashtë, Nr. 04-L-048
- Ligji për tregti me naftë dhe derivate të naftës Nr. 2004/5
- Ligji për tregtinë e mallrave strategjike Nr. 03-L-232
- Ligji për Investimet e Huaja, Nr. 02-L33
- Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, Nr. 04/L-039
- Ligji për kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, Nr. 03-L-109
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave Nr.03-L-109, Nr. 04-L-099
- Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, Nr. 04-L-072
- Ligj për markat tregtare, Nr. 04-L-026

Institucioni kryesor në nivelin institucional është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). E formuar në vitin 2002, ndër detyrat dhe përgjegjësit e MTI-së ishin krijimi i kushteve sistemore për tregti, industri dhe pune komerciale si dhe krijimi i politikave të punës dhe zbatimi i legjislacionit për përkrahjen e konkurrencës së mirëfilltë. Sot, ministria i ka 4 agjenci, 8 departamente, 1 drejtori, 4 zyra dhe 2 njësi.

Në kuadër të MTI-së është Departamenti i Tregtisë që ndër të tjerat merret me hartimin e politikave tregtare të Kosovës duke i përafuar dhe harmonizuar ato me legjislacionin tregtarë të BE-së dhe OBT-së. Gjithashtu, Departamenti i Tregtisë merret me zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-s.⁴⁴ Në kuadër të këtij departamenti, operojnë Divizioni për Politika Tregtare dhe Divizioni për Rregullim të Tregut.

3. Statuti dhe Sfidat

Bilanci i lartë negativ tregtar është ajo që e karakterizon Kosovën. Më poshtë paraqiten

⁴³ Commission Communication on a Feasibility Study for a Stabilization and Association Agreement between European Union and Kosovo, October 2012.

⁴⁴ MTI - Departamenti i Tregtisë.

të dhëna rreth vlerës së eksporteve, importeve dhe dallimi ndërmjet tyre.⁴⁵




Figura 8: Bilanci tregtar

Situata e bilancit tregtar është duke u përkeqësuar vazhdimisht nga viti në vit. Rritja e konsiderueshme e importeve nuk është duke u përcjell me rritjen adekuate të eksporteve. Madje, në gjysmën e parë të vitit 2012, eksportet kanë pësuar rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Bilanc pozitiv tregohet kur krahasohet eksporti me importin e shërbimeve. Statistikat tregojnë se numri i eksportit të shërbimeve, është më i madh se sa numri i importit të tyre.⁴⁶

Mos anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) mbetet një problem i cili ndërlidhet drejtpërsëdrejti me implikime të konsiderueshme në pjekurinë e vendit për integrimet evropiane, sidomos në fushën e tregtisë së jashtme. Kosova nuk ka kaluar nëpër reformat e domosdoshme për anëtarësim në OBT.⁴⁷ Sidoqoftë, Kosova është anëtare e CEFTA-s e cila mundëson tregti të lirë ndërmjet anëtarëve, që për momentin janë shtatë: Maqedonia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova. Lidhshmëria me kapitullin e parë të Acquis (Lëvizja e Lirë e Mallrave) bënë që anëtarësimi në CEFTA të jetë mënyra më e mirë për përgatitjen e fushës së tregtisë për integrim në BE. Megjithatë, ndikimi i CEFTA-s për uljen e bilancit tregtar është minimal deri më tani. Për më tepër, Kosova dallon prej anëtarëve tjerë, nënshkrues të marrëveshjes, për shkak se produktet e saja nuk pranohen nga Serbia dhe Bosnja.

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për krijimin e politikave që janë në linjë me kërkesat e Bashkimit Evropian. Kjo më së miri pasqyrohet në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, ku pika 2.4 (Lehtësimi i zhvillimit të tregtisë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe tek parimet dhe kërkesat e bashkimit evropian për të ulur koston dhe barrierat për tregti) i parasheh 9 aktivitete.

⁴⁵ BQK - Buletini Mujor Statistikor, shtator 2012.

⁴⁶ BQK - Buletini Mujor Statistikor, qershor 2012.

⁴⁷ Commission Communication on a Feasibility Study for a Stabilization and Association Agreement between European Union and Kosovo, October 2012.

Ndër të tjerash, përfshihen aktivitete si: ndryshimi i Kodit të ri Doganor duke u bazuar në modelin e Kodit Doganor të BE-së, ndryshimi i ligjit për aktivitetet e tregtisë me jashtë në përputhje me standardet e OBT-së dhe thjeshtësimi i procedurave të importit dhe eksportit. Pra, Qeveria e Kosovës mëton që të krijojë një ambient evropian për tregti, gjë që do të ketë implikime pozitive në procesin e integritimit.

Strategjia e Qeverisjes Elektronike e Republikës së Kosovës 2009-2015 përfshin edhe sistemin doganor. Pika 3.1.11 e kësaj strategjie thotë që gjatë kohës së shtrirjes së saj, sistemet ekzistuese doganore do të avancohen duke e bërë kompletimin e plotë të të dhënave digjitale. Kësaj, të dhënat, përfshirë këtu edhe klasifikimin e mallrave, do të menaxhohen përmes një procesi elektronik.⁴⁸ Sido që të jetë, strategjia dështon të prezantoj një plan të veprimit, me aktivitete dhe afate kohore për arritjen e objektivit të sapo përmendur. Prandaj, ndikimi i Strategjisë së Qeverisjes Elektronike në digitalizimin e sistemit doganor nuk pritet të jetë domethënës.

MTI ka investuar në thjeshtësimin e dokumenteve për eksport dhe import. MTI ka bërë reforma të dukshme duke e zvogëluar numrin e dokumenteve për shërbimet tregtare dhe duke ulur koston.⁴⁹ Kjo është pasqyruar pozitivisht në Raportin Bankës Botërore e të Bërit Biznes për vitin 2013, ku renditja në kategorinë Tregtisë Jashtë Kufijve është përmirësuar për 9 vende.⁵⁰ Thjeshtësimi i dokumenteve për eksport dhe import bëhet crucial në raport me Konventën e BE-së për thjeshtësimin e formaliteteve në tregtinë e mallrave. Kjo konventë i amandamenton një numër vendimesh të mëhershme.⁵¹

BE ofron Masa Autonome për Tregti (MAT) për vendet që ende nuk janë anëtare të saj dhe janë në fazën e Stabilizim Asocimit. Masat Autonome për Tregti, duke mundësuar qarkullim të lirë importeve dhe eksporteve, ofrojnë përfitime të larta për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja e Kosovës për MAT fillimisht ka skaduar me 31 dhjetor 2010 por fatmirësisht, si rezultati i përparimeve në sferën e Stabilizim Asocimit, ka hyrë në fuqi përsëri me 30 dhjetor 2011.⁵²

Studimi i Fizibilitetit për Kosovën i vitit 2012 jep një numër rekomandimesh për institucionet e vendit për të përshpejtuar proceset integruese. Ndër të tjerash ky studim parasheh :

- Krijimin e kapaciteteve administrative për të zhvilluar negociatat lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me tregti. Në këtë drejtim, nga perspektiva e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, kërkohet që të demonstrohet qartë se reformat e kërkuara mund të implementohen pas nënshkrimit të marrëveshjes.
- Përpos krijimit të kapaciteteve administrative për negociata, Kosova duhet të e caktoj një udhëheqës për ekipin negociues dhe duhet të përpiloj prioritetet e

⁴⁸ MAP - Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009-2015, tetor 2008.

⁴⁹ MTI- Reformat e të bërit biznes.

⁵⁰ Doing Business Report 2013, International Bank for Reconstruction & World Bank, 10th Edition.

⁵¹ KE - Convention on the simplification of formalities in trade in goods.

⁵² KE - Autonomous Trade Measures with Kosovo re-enter into force, European Union Office in Kosovo.

saja gjatë negociatave. Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës është duke përgatitur strukturat negociuese.

- Po ashtu në këtë studim potencohet se Kosova ka shënuar progres në krijimin e kornizës ligjore siç kërkohet me Acquis, duke i adoptuar standardet e BE-së dhe duke i eliminuar rregullat të cilat nuk janë në përputhshmëri me ato të BE-së.

4. Konkluzione

Avantazhet	Sfidat	Rekomandimet
- Kosova është anëtare e CEFTA-s dhe gëzon të drejtën për qarkullim të lirë mallrash me vendet anëtare të marrëveshjes. Anëtarësimi në CEFTA është një parakusht i rëndësishëm për përgatitje për integrimet evropiane.	- Zgjidhja e problemeve me Serbinë dhe Bosnjën për fuqizimin e plotë të CEFTA-s	- Rritja e presionit tek këto shtete nga sekretariati i CEFTA-s si dhe BE
- Sistemi doganor është në proces të kompjuterizimit të shërbimeve të tyre.	- Procesi po ecën me hapa jo të shpejtë.	- Të përshpejtohet procesi, duke u bazuar ne Strategjinë për Qeverisje Elektronike
	- Mos anëtarësimi në OBT implikon sfida për përmbushjen e acquis për 'Lëvizën e Lirë të Mallrave'.	- Anëtarësimi në OBT të shndërrohet në prioritet bazë të MTI-së.
- Strukturë e avancuar ligjore për rregullimin e tregtisë me jashtë	- Adoptimi i kërkesave të Aneksit 1 të Rregullores së Këshillit Evropian me numër 2658/87 (Klasifikimet e Përbashkëta dhe Tarifat e Përbashkëta Doganore)	- Të thjeshtësohet korniza ligjore dhe të adoptohen Klasifikimet e Përbashkëta dhe Tarifave të Përbashkëta Doganore.

Kapitulli III – Politikat Buxhetore

Planifikimi buxhetor është një nga sfidat kryesore të çdo ekonomie. Buxheti duhet të reflektoj strategjinë e përgjithshme zhvillimore dhe politikat përcjellëse të një shteti. Në pajtueshmëri me ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi si dhe me qëllim të planifikimit afat-mesën të shpenzimeve, Qeveria e Kosovës përpilon Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dokument i cili është i një rëndësie të veçantë në ndërlidhshmërinë e më efektive të politikave, planifikimit dhe buxhetimit, sidomos kur kemi mungesë të një strategjie kombëtare zhvillimore e cila do të udhëzonte zhvillimin e strategjive sektoriale dhe ndarjen relevante të buxhetit. Në këtë drejtim shumë organizata nga komuniteti ndërkombëtar kanë ofruar ekspertizë dhe asistencë teknike për proceset buxhetore në Kosovë.

1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit

Në *acquis* janë të përmbledhura fushat që duhet të rregullohen për shtetet që mëtojnë t'i bashkëngjiten Bashkimit Evropian. Për buxhetin bënë fjalë kapitulli 3 Provizionet Financiare dhe Buxhetore. Ky kapitull i mbulon rregullat lidhur me burimet financiare për financimin e buxhetit të BE-së.⁵³ Kryesisht, burimet përbëhen nga:⁵⁴

- Të ardhurat nga doganat, taksat nga produktet e agro-kulturës dhe sheqeri,
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe
- Një përqindje që rrjedh nga të ardhurat bruto kombëtare

Në formë më të detajuar, ekziston Rregulla e Këshillit nr 1150/2000 mbi sistemin e burimeve vetanake të Komuniteteve Evropiane. Për TVSH-në është Direktiva 2006/112/EC për Sistemin e Përbashkët të TVSH-së. Megjithatë, Kosova është ende në fazën fillestare të ndërtimit të bazës mbi proceset buxhetore dhe si e tillë, nuk është në fazën kur duhet të punoj specifikisht për *Acquis*. Fillimisht, autoritetet duhet të krijojnë një ambient stabil në mënyrë që *Acquis* të ketë një bazë për të ndërmarrë reformat e duhura.

2. Korniza Legjislative dhe Institucionale

Secili buxhet i vitit përkatës është i mbështetur nga korniza ligjore për atë vit. Për shembull, për vitin e kaluar kemi Ligjin Nr. 04 - L - 079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2012. Kjo njëherit paraqet aktin më të rëndësishëm të vendit për temën në fjalë. Për më tepër, e gjithë kjo është e lidhur ngushtë me planifikimin buxhetor gjë e cila rregullohet me ligjet në vijim:

- Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat
- Ligji për Auditimin e Brendshëm
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike

⁵³ Chapters of the *acquis*, Enlargement Policy of the European Commission, Conditions for membership.

⁵⁴ Where does the money come from?, Financial Programming and Budget.

- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës
- Ligji për Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës
- Ligji për Ndërmarrjet Publike
- Ligji për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë
- Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
- Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
- Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale
- Ligji për Tregti me Jashtë

Duke i rregulluar marrëdhëniet në fushën financiare, tatimore dhe doganore, korniza institucionale kryesisht shtrihet në Ministrinë e Financave (MF). Në kuadër të MF është Departamenti i Buxhetit, që ka për mision ndarjet buxhetore për organizatat buxhetore. Ky departament përmes një buxheti që rritë efikasitetin dhe efektivitetin duhet të ofroj rezultate të paanshme sociale dhe njëherit të qëndrueshme sa i përket burimeve të mundshme.⁵⁵ Detyrat kryesore të Departamentit të Buxhetit janë:

- Përgatitja e Buxhetit,
- Korniza Afatmesme të Shpenzimeve,
- Zbatimi i Buxhetit dhe
- Vlerësimi i kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore

Nuk duhet harruar Komisionin për Buxhet dhe Financa në kuadër të Kuvendit të Kosovës, përmes të cilit kalojnë të gjitha ligjet, lidhur me buxhetin dhe propozimet buxhetore.

3. Statusi dhe Sfidat

Në rastin e Kosovës, Obligimet e Acquis 33 (Provizionet Financiare dhe Buxhetore) nuk do të ishte e udhës t'i analizojmë për shkak se ende flitet për masa të avancuara që duhet të ndërmerren nga shtetet që e kanë statusin e kandidatit. Prandaj, do t'i identifikojmë sfidat që do të kenë implikime në kohën kur Kosova e fiton statusin e kandidatit për BE.

Shtylla e parë e synimeve të Planit të Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014 është ruajta e qëndrueshmërisë makro fiskale. Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike dhe rritjen e të të hyrave buxhetore.

⁵⁵ MF - Departamenti i Buxhetit.

3.1. Struktura e të hyrave buxhetore

Të hyrat në Buxhetin e Kosovës në një masë të madhe janë të varura nga të hyrat doganore. Për vitin 2011, nga ky burim janë siguruar 63.4% e të hyrave të përgjithshme në vendin tonë.⁵⁶ Kategoria e parë dhe më e madhe janë të hyrat nga Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) me afër 51% e të hyrave të përgjithshme doganore, kurse kategoria e dytë janë të hyrat nga akciza me pjesëmarrje prej 34.4%. Në anën tjetër, të hyrat veta-nake përbëjnë vetëm 9% të të hyrave të tërësishme. Pozitive në këtë aspekt është rritja e vazhdueshme e të hyrave doganore që ndikohen nga rritja e importeve dhe nga rritja e çmimit të importeve.⁵⁷ Kjo ndikon dhe në ngritjen e përgjithshme të të ardhurave, siç mund të shihet më poshtë.⁵⁸




Figura 9: Struktura e të hyrave

Varësia e mbledhjes së të hyrave në kufij mbetet sfidë dhe gjithashtu varësia e komunave nga të hyrat e Kosovës.

Anëtarësimi në BE do të thotë që niveli i të hyrave nga doganat do të pëson rënie drastike, si rezultat i lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve. Ngjashëm edhe marrëveshja me tregti të lirë me Turqinë pritet të ketë ndikim në të hyra por se nuk dihet se sa do të jetë ky efekt. Lëvizja e lirë e mallrave, si një nga bazat fundamentale të BE-së, do të bënte që shumica e mallrave që hyjnë në vend të mos doganohen. Gjetja e rrugëve alternative për financimin e buxhetit paraqet një problem përkatësisht një sfidë kyçe për vendin. Përveç kësaj, një sfidë tjetër në këtë drejtim është situata kur përfundon privatizimi i kompanive publike të vendit. Kosova është në përfundim të privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së dhe distribucionit të KEK-ut, dhe gjithashtu aeroporti është lëshuar me konsorcium. Këto të fundit japin një kontribut të konsiderueshëm të lloga-

⁵⁶ BQK - Raporti Vjetor 2011, qershor 2012.

⁵⁷ Ibid.

⁵⁸ MF - Korniza Makro-Fiskale 2013-2015, Draft Buxheti 2013.

rive qeveritare dhe sfida krijohet kur fondet e krijuara nga këto privatizime shpenzohen.

Buxheti i Kosovës është karakterizuar më deficit të konsiderueshëm në vitet e fundit, duke shënuar shifër prej 76 milionë EUR përkatësisht 121 milionë EUR për vitet 2011 dhe 2010.⁵⁹ Shtërngimi i shpenzimeve buxhetore kanë bërë që në gjysmën e parë të vitit 2012 raporti ndërmjet deficitit buxhetor dhe BPV-së të zvogëlohet në 3.7% apo 0.5 pp më i ulët krahasuar me vitin e kaluar.⁶⁰

3.2. Politikat tatimore dhe performanca e të hyrave

Financat publike në përgjithësi kanë shënuar përparim ku vetëm në dallim nga viti 2011 në vitin 2012 janë gjeneruar 13 milion EUR shtesë si rezultat i rritjes së akcizës në duhan nga 25 në 27 euro (me rritje prej 7.2 milion EUR të parashikuar), rritja e bazës së tatimit në pronë nga 0.05 në 0.15 (me rritje prej 3.0 milion EUR të parashikuara) si dhe rritja e tatimit në të ardhura për bizneset nga 5% në 9% (me rritje prej 2.8 milion EUR të parashikuara). Mirëpo me përjashtim të akcizës së duhanit dy ndërhyrjet tjera nuk janë jetësuar për shkak të ligjeve që është dashur të miratohen në Qeveri dhe Kuvend.

Përveç kësaj në pajtim me FMN Qeveria është zotuar për rritjen e të hyrave gjatë vitit 2012 në një vlerë prej 20 milion EUR dhe gjithashtu të hyra shtesë prej 10 milion janë paraparë të inkasohen nga taksa ekologjike e cila tashmë është planifikuar të jetësohet nga korriku 2012.

Në anën tjetër reformat në decentralizimin fiskal në rastin e shpenzimeve publike dhe mbledhjen e të hyrave kanë shënuar përparim të konsiderueshëm ku gjatë planifikimit të buxhetit komunat shfrytëzojnë sistemet BDMS dhe PIP dhe se komunave iu lejohet liri më e madhe e planifikimit dhe shpenzimit sipas kategorive bazuar në nenin 45 të LMFPF.

Prezantimi i rregullës fiskale duke filluar nga vitit 2014 (sidomos kriteri që niveli i deficitit buxhetor të jetë nën 2% të BPV), konsiderohet një mekanizëm që do të ndihmojë në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitet makrofiskal.

3.3. Struktura e shpenzimeve buxhetore

Sipas buxhetit 2013 gjithmonë nën supozimin se shpenzimet buxhetore për vitin 2013 do të ekzekutohet në normën prej 100%, deficit i përgjithshëm i buxhetor për vitin 2013 (përfshirë edhe pagesën e interesit) është parashikuar të jetë në vlerë prej €181 milionë apo rreth 3.5% të BPV-së ndërsa deficitit primar pritet të jetë rreth 2.8%. Ndërsa për periudhën 2013-2015, në përputhje me marrëveshjen e Qeverisë së nënshkruar me FMN, deficitit primar (përjashtuar AKP) pritet të jetë jo më lartë se 2%.

⁵⁹ BQK - Raporti Vjetor 2011, qershor 2012.

⁶⁰ BQK - Buletini Mujor Statistikor, shtator 2012, fq. 11.

Buxheti për vitin 2013 kap shifrën prej 1,591,118,599 euro ku investimet kapitale janë 621,318,384 EUR, që është rreth 39% e buxhetit total. Në krahasim me vitin 2012 parashihet rritje e shpenzimeve prej 4% për vitin 2013. Kjo rritje e shpenzimeve rrjedhëse për vitin 2013 krahasuar me rritjen e projektuar të shpenzimeve kapitale, vjen si rezultat i dy arsyeve : (i) rritjes së konsiderueshme të bazës së shpenzimeve kapitale (reflekton ndërtimin e autoudhës dhe investimeve në infrastrukturë), dhe (ii) rritjes së nevojës për të adresuar kërkesat sociale.

Tabela 6: Shpenzimet në kategori ekonomike 2011-2015 si përqindje të BPV-së

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2013 -
si % e BPV-së							
Shpenzimet e përgjithshme	30%	30%	30%	29%	27%	26%	27.4%
Rrjedhëse	17.8%	17.8%	17.6%	17.7%	16.4%	15.5%	16.5%
Pagat dhe medijtjet	7.4%	8.4%	8.1%	8.0%	7.7%	7.2%	7.6%
Mallrat dhe shërbimet	4.3%	3.8%	4.0%	4.1%	3.9%	3.7%	3.9%
Subvencionet dhe transferet	6.0%	5.6%	5.5%	5.6%	5.6%	5.3%	5.5%
Shpenzimet kapitale	11%	11%	12%	11%	11%	10%	10.9%
Deficiti primar	-2.3%	-1.5%	-2.6%	-2.8%	-3.9%	-2.7%	-3.1%
Bilanci Primar (rregulla fiskale)					-2.0%	-2.0%	-2.0%
Deficiti i përgjithshëm	-2.5%	-1.7%	-3.0%	-3.2%	-4.2%	-3.0%	-3.4%

Burimi: MF, Departamenti i Thesarit, Divizioni i Makroekonomisë⁶¹

Raporti i studimit të Fizibilitetit për Kosovën e cilëson si shqetësuese ndarjen e buxhetit për sektorë siç janë mjedisi⁶² dhe niveli i shpenzimeve në shëndetësi është më i ulëti në rajon si përqindje e BPV-së.⁶³ Në anën tjetër, Ministria e Infrastrukturës thith 51% nga totali i buxhetit të Republikës së Kosovës, duke ju alokuar mbi 810 milion EUR.

⁶¹ Për të dhëna më të fundit, ju lutem i referoheni KASH-it i cili momentalisht është duke u ri-shikuar dhe pritjet të miratohet nga Qeveria në maj 2013.

⁶² Commission Communication on a Feasibility Study for a Stabilization and Association Agreement between European Union and Kosovo, October 2012.

⁶³ BB - Kosova: Rishikimi i shpenzimeve publike, qershor 2010.




Figura 10: Shpenzimet e përgjithshme buxhetore 2010-2015, në miliona euro

Mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore, sipas Raportit të Progresit 2011 edhe sipas raportit të Fizibilitetit 2012, cilësohet si komponentë që ka nevojë për përmirësime. Në këtë drejtim është e nevojshme të ketë mekanizma për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit financiar. Konsultimi i Qeverisë me Kuvendin për Draft Buxhet, siç thuhet edhe në raportin e fizibilitetit ka hapësirë për përmirësim.

Gjithashtu, në kuadër të shpenzimeve buxhetore, nuk ekziston një vlerësim mbi efektin e shpenzimeve, sidomos atyre kapitale si dhe ka mungesë të koordinimit të projekteve ndër-sektoriale që do të rrisnin efektin e investimeve publike.

Procesi i decentralizimit bëri që komunave të ju rriten shpenzimet. Sidoqoftë, decentralizimi krijon mundësi dhe rreziqe në të njëjtën kohë.⁶⁴ Në rastin e buxhetit për arsimin, investimet kapitale mbesin nën kompetencën e nivelit qendror⁶⁵ e që lejon hapësirë për pabarazi në investime nëpër komuna.

Shpenzimet publike të planifikuara sipas ligjit të buxhetit 2012 kanë qenë 1.52 milion EUR, ndërsa me bartjet nga viti i kaluar kjo shifër shkon deri në 1.58 milion EUR.

Kritika ka edhe për procesin e rishikimit të buxhetit, kryesisht për ndryshimet e vogla, ndryshimet jo të bazuara në makro projeksione dhe për mungesën e debatit në institucionet publike. Sfida tjera për vendin janë ndikimet në buxhet nga ndërrimet në partitë qeverisëse si dhe vonesat e shtyrjet gjatë proceseve buxhetore. Për dallim nga

⁶⁴ Joshua et al.- Efficient allocation of resources for decentralised provision of social services in Kosovo.

⁶⁵ BB - Kosova: Rishikimi i shpenzimeve publike, qershor 2010.

viti 2013 vitet e tjera që pas përfundimit të luftës janë karakterizuar me ndërrime të shpeshta në qeverisje dhe buxheti është ndikuar nga këto ndërrime. Në anën tjetër, fazat e proceseve buxhetore karakterizohen me shtyrje përkatësisht vonesa të vazhdueshme, si gjatë procesit të hartimit po ashtu edhe të rishikimit.

4. Konkluzione

Avantazhet	Sfidat	Rekomandimet
- Të hyrat buxhetore janë në trend të rritjes.	- Procesi i privatizimit, si një burim i rëndësishëm i të hyrave, është duke përfunduar dhe kjo nuk garanton qëndrueshmëri gjatë viteve të ardhshme.	- Të merren masa për qëndrueshmërinë më afatgjate të të hyrave.
- Buxheti i Kosovës përfiton shumë nga të hyrat doganore dhe ato janë duke u rritur si rezultat i rritjes së importeve dhe çmimeve importeve.	- Të hyrat doganore do të ulen me kohë si pasojë e MSA-së.	- Për të kompensuar humbjet nga rënia e të hyrave doganore, duhet të rriten të hyrat vetanake.
	- Për shëndetësinë, mjedisin, arsimin dhe drejtësinë është një ndarje e ultë buxhetore që nuk është në përputhshmëri me kërkesat evropiane.	- Të rritet buxheti për këta sektorë
	- Konsultimi i dobët ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë për projekt buxhetin.	- Të krijohen mekanizma për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore.
-Decentralizimi e ka pasuruar buxhetin e nivelit lokal	- Investimet kapitale karakterizohen me ndarje jo proporcionale nëpër komuna	- Për investimet kapitale në sektorë siç është arsimi, linja buxhetore të kaloj nga niveli qendror te niveli lokal.
	-Rishikimi i buxhetit jo gjithmonë bazohet në projeksione makro fiskale dhe nuk shjellohet e debatohet nga institucionet përkatëse.	- Të nxitet debat nga të gjitha palët e interesuara gjatë rishikimit të buxhetit, në mënyrë që të bëhen ndryshimet adekuate
Kosova është duke zbatuar kriteret e përcaktuara nga FMN që sigurojnë një qëndrueshmëri makro-financiare.	Financimi i mundshëm i autoudhës R6 si dhe skemat sociale pa mbulesë adekuate mund të shkaktojnë probleme financiare	Kërkohej kujdes më i madh në aspektin e hyrjes në detyrime për investimet kapitale

Kapitulli IV – Shërbimet Financiare

Ekonomia e Kosovës ka qenë një prej ekonomive me rritje më të shpejtë në Evropë përgjatë 5 viteve të fundit (tok me Shqipërinë dhe Poloninë). Mesatarja e rritjes në 2007 dhe 2008 ishte 7.3%, e përcjell më pas me një normë më të ngadalshme të rritjes në 2009 dhe 2010 (3.4%). Në 2011 dhe 2012 është shënuar një rritje diç më e madhe prej rreth 4.1%. Projektimet e BPV-së për 2013 parashohin rritje të mëtutjeshme ekonomike rreth trajektores prej 4% të rritjes.

Theks i veçantë në këtë dokument i është kushtuar infrastrukturës ligjore të sektorit dhe kushteve rregullative (Banka Qendrore e Republikës së Kosovë), e ndarë në sektorët kryesor:

- Sektorin bankar
- Sektorin e sigurimeve
- Fondet pensionale

1. Sektori bankar në Kosovë

Sektorin bankar i Kosovës karakterizohet me zhvillim stabil që sa vite. Sektori përfaqëson burimin më të rëndësishëm të financimit, dhe është edhe një prej shtyllave më të rëndësishme të stabilitetit të ekonomisë së vendit. Thelbi i sektorit financiar është i përfaqësuar me sistemin bankar, i cili vazhdon të performoj njëjtë edhe kur krahasohet me shumë sisteme bankare me më shumë përvojë, si në regjion ashtu dhe më gjerë.

Që nga themelimi i saj, Banka Qendrore e Kosovë (BQK) ka kompetenca të licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së të gjitha institucioneve financiare në Kosovë, dhe si e tillë kontribuon në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar në Kosovë. Aktualisht, sektori financiar në Kosovë përbëhet nga industria bankare, industria e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucioneve tjera financiare (institucionet mikro-financiare, institucionet financiare jo-bankare, byrotë e shkëmbimit valutator dhe të pagesave, si dhe institucioneve për transferimin e parasë). Tash vonë Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar të lëshojë bono të thesarit – një sektori i ri i rëndësishëm i shtuar sistemit financiar.

BQK ka reviduar planin strategjik 2013-2015, i cili avanco qeverisjen korporative dhe licencimin e institucioneve financiare. Për më tepër, BQK identifikon rreziqet dhe qëndrueshmërinë e bankave komerciale në vend duke siguruar që ato përmbushin kërkesat për kapitalin minimal.

8 banka komerciale operojnë në sistemin bankar të Kosovës, gjashtë prej të cilave në pronësi të huaj dhe dy me pronësi vendore. Në qershor 2012, bankat në pronësi të huaj kanë dominuar tregun me një hise prej 89% të gjithë asetëve totale bankare, ndërsa bankat vendore kanë menaxhuar ngeljen prej 11% (BQK, 2012). Nuk ka kushte të veçanta për hapjen e filialit e/nga banka e huaja dhe rrjedhimisht, prezenca e bankave në pronësi të huaj është shumë e lartë. BQK-ja zbaton praktika ndërkombëtare në fushën e licencimit,

rregullimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare.

Sektori bankar karakterizohet me një funksion relativisht bazik, duke pasur parasysh se është burim i financimit të ekonomisë përmes kredive, të cilat janë gjerësisht të financuara nga depozitimet e marra në kuadër të ekonomisë. Norma e rritjes së kredive ka qenë vazhdimisht e lartë, deri në vitet e fundit kur u ngadalësua, kryesisht si reflektim i zhvillimeve në sektorët e ekonomisë. Deri në tremujorin e parë 2012, rritja e normës së kredive aktive ishte dyshifrore (mesatarisht 14% për periudhën 2009-2011) ndërsa nga tremujori i dytë 2012, norma e kësaj rritje ishte 6%. Në anën tjetër, rritja e depozitimeve ka ngelur stabile sa i përket rritjes, duke reflektuar besimin e ekonomisë në sektorin bankar (norma mesatare e rritjes gjatë 2009-2012 ishte 13%).

1.1. Korniza ligjore dhe institucionale

Korniza rregullative dhe mbikëqyrëse e Kosovës është përmirësuar gradualisht për të përmbushur standardet e BE-së, si për bankat ashtu dhe për institucionet financiare jo-bankare. Tash vonë është adoptuar ligji mbi bankat komerciale, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare, zbatimi i të cilit forcon dhe rregullon më mirë kapacitetin mbikëqyrës të BQK-së në rolin e saj si rregullatorë i sektorit financiar. Ligji i kontribuon forcimit të qeverisjes interne të institucioneve financiare nga vetë ato, dhe çka është më e rëndësishmja, mekanizmat e këtij ligji rrisin efikasitetin e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit financiar.

Kornizës ligjore të sektorit bankar të Kosovës i shtohet edhe ligji mbi sigurimin e depozitimeve. Aprovimi i ka kontribuar pozitivisht rritjes së depozitave me maturim afatgjatë. Përqindja e garantuar pritet të rritet në të ardhmen e afërt; BQK-ja dhe autoritetet relevante janë për momentin duke punuar në modifikimin e rregulloreve. Ligji mbi sigurimin e depozitave (LSD) është duke u ndryshuar për të siguruar konsekuencë. DSP-ja e ndryshuar do të lejoj transaksione blerjeje dhe të supozuara dhe do të mirëmbajë mandatin e ngushtë të fondit të sigurimit të depozitave, i cili limiton përfshirjen e tij në rezolutën e bankës, pasi ligji këtë rol kryesisht ia jep BQK-së.

1.2. Dhënia e licencës nga Banka Qendore

Kriteret dhe kushtet për të marrë një licencë për ushtrimin e aktiviteteve bankare dhe financiare nga bankat dhe institucionet tjera financiare në Republikën e Kosovës janë të parapara në ligjin 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera nënligjore të adoptuara nga BQK-ja. Sipas legjislacionit përkitazi funksioneve, BQK-ja ka kompetenca të përcaktojë kriteret për licencimin e institucioneve financiare, dhe rrjedhimisht, të mos i jep licencë institucioneve të cilat dështojnë të përmbushin këto standarde.

Kriteret e licencimit sipas ligjit, synojnë ofrimin e një tregu fer financiar dhe të rregulluar, përmes një procesi të bazuar në principet e drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të natyrës mbikëqyrëse dhe nuk synojnë të krijojnë

barriera për investitorët.

Banka qendrore e Kosovës i përmbahet rregullave të saja në dhënien e licencave institucioneve financiare, dhe siguron mbikëqyrje të vazhdueshme përmes rregulloreve të saja. Institucionet kreditore i raportojnë rregullisht rregullatorit të tyre dhe i përmbahen rregullave të paraparë në rregulloret aktuale, në mënyrë që të marrin licencë dhe të vazhdojnë me aktivitetet e tyre, ashtu siç është nënshkruar kur është dhënë licenca. Me mbikëqyrjen e saj të vazhdueshme, BQK-ja siguron pajtueshmërinë e institucioneve financiare me rregullat dhe kërkesat tjera rregullative (mjaftueshmërinë e kapitalit, politikat investuese, rreziku kreditor). BQK-ja ka autorizim të tërheq licencën në çdo kohë nëse rregullat dhe kërkesat e tilla nuk janë përmbushur.

1.3. Kushtet për kapital

Korniza rregullative e sistemit bankar është reformuar përmes rekomandimeve të pakos III të Bazelit. Niveli i kapitalizmit i shprehur me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit është një prej kërkesave të parashtruara nga rregulloret e BQK-së, të cilat institucionet kreditore duhet t'i respektojnë. Sipas rregullave të BQK-së, bankat janë të obliguara të mbajnë një nivel minimal prej 12% të raportit kapital – asete me rrezik të peshuar. Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me një nivel të lartë të solvencës, të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili vazhdimisht tejkalon nivelin minimal të kërkuar rregullator.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit paraqet një prej indikatorëve më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së sistemit bankar, duke pasur parasysh se kapitali konsiderohet të jetë shtylla kryesore për mbulimin e humbjeve potenciale në rast të ngjarjeve negative në sistemin bankar. Për më tepër, struktura e kapitalit në sistemin bankar përmban një nivel të konsiderueshëm të kapitalit Tier 1, i cili tregon cilësi të mirë të kapitalit të sistemit bankar të Kosovës (BQK, 2012).

Krahas ndryshimeve në kalkulimin e komponentëve të kapitalit ekzistues, përmes Bazel III rekomandohet se raportimi i treguesve të kapitalit duhet të plotësohet me një raport të ri, gjegjësisht, raportit të levës. Sipas këtij rekomandimi, raporti më mes të kapitalit Teir 1 dhe shumës totale të aseteve dhe zërave jashtë-bilancor të një banke duhet të ruhet në nivel minimumi prej 3%. Përmes këtij raporti, bankat do të detyrohen të reduktojnë financimin në bilanc të gjendjes përmes borxhit ekstern (BQK, 2012). Edhe pse zbatimi i këtyre rekomandimeve konsumon kohë, është shumë e rëndësishme që Kosova të ndjek standardet ndërkombëtare që të sigurojë një sistem të qëndrueshëm bankar.

Kapitali i sistemit bankar të Kosovës vazhdon të ketë kapitalin aksionar dhe profitin e fituar nga bankat si burimet kryesore të financimit. Bankat poashtu kanë filluar të shfrytëzojnë rrugë alternative për të financuar kapitalin, ku mund të specifikojmë shfrytëzimin e borxhit vartës, i cili klasifikohet si komponent i kapitalit Tier 2. Krahas vlerës, një element tjetër i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së sistemit bankar është cilësia e kapitalit të poseduar nga bankat. Cilësia e kapitalit, në mes tjerash, ka një rol të

rëndësishëm në klasifikimin kreditor të bankave, që ka ndikim direkt në koston e financimit ekstern, si dhe në qasjen e bankave në financimin ekstern. Cilësia e mirë e kapitalit poashtu mund të jetë një prej faktorëve që mundëson rritjen konstante të financimit ekstern për sistemin bankar të Kosovës, sikurse në rastin e borxheve vartëse.

1.4. Rreziku kreditor

Raporti i lartë i mjaftueshmërisë së kapitalit vazhdon të jetë karakteristikë e dallueshme e sistemit bankar të Kosovës, duke i kontribuar zvogëlimit të rrezikut të insolvencës, dhe duke forcuar qëndrueshmërinë e këtij sistemi. Në anën tjetër, BQK ka bërë hapa të rëndësishme në fushën e mbikëqyrjes financiare.

Aktiviteti huadhënës i bankave komerciale paraqet një prej burimeve kryesore të financimit të konsumit dhe investimeve në vend. Për këtë arsye, masat e vlerësimit të rrezikut kreditor dhe portofolit kreditor janë esenciale. Fillimisht duhet të përmendet se BQK-ja, si rregullatorë i sistemit bankar, ka siguruar se standardet më të rëndësishme ndërkombëtare përkritazi me njohjen e kredive jo-performuese dhe provizionimit janë në vend.

Bazuar në principet themelore të Bazelit mbi mbikëqyrjen efektive të sistemit bankar, në 2010 janë marrë hapa drejt ndërtimit të kapaciteteve për mbikëqyrjen e rrezikut bazuar-në-profil në sektorin bankar, duke tentuar arritjen e një sinergjie mbikëqyrëse, e cila pritet të reflektohet në një bashkërendim më efektiv të mbikëqyrjes së kujdesshme mikro dhe makro. Poashtu, me qëllim të themelimit të solvencës të bazuar në rrezik – sa më shumë që është e mundur, janë ndërmarrë hapa në industrinë e sigurimeve drejtë adoptimit të parimeve bazike të parashtruara në kornizën Solvenca II.

Raportet e BQK-së tregojnë se bankat komerciale që raportojnë në Kosovë vazhdimisht kanë zbatuar qasje të kujdesshme në menaxhimin e rrezikut. Në këtë kontekst, bankat janë dëshmuar të kujdesshme dhe konservative në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, rrezikut kreditor dhe rrezikut të solvencës. Treguesit e likuiditetit, edhe pse kanë shënuar një rënie të lehtë, vazhdimisht ishin në nivele të kënaqshme që e bëjnë sistemin bankar të aftë për të përmbushur obligimet afatshkurtra. Përkritazi me rrezikun kreditor, është vërejtur një përkeqësim në cilësinë e portofolit kreditor, mirëpo duhet të theksohet se kreditë jo-performuese vazhdojnë të mbulohen mirë nga provizionet e kredisë (me 112% mbulose në dhjetor 2012). Kjo nënkupton se niveli aktual i kredive jo-performuese nuk paraqet ndonjë kërcënim serioz për qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

1.5. Cilësia e portofolit kreditor

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të shquhet si një prej sistemeve me cilësi më të mirë të portofolit kreditor në vendet e rajonit. Qasja e kujdesshme e zbatuar nga sistemi bankar i Kosovës për të mbajtur vetë-qëndrueshmërinë, është shprehur poashtu përmes niveleve vazhdimisht të larta të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili e ka mbajtur nivelin e insolvencës në nivele të ulëta. Rreziku i likuiditetit dhe ai kreditor janë vlerësuar

përmes raportit kredi-depozitë, raportit në mes të asetëve likuide dhe totale, asetëve likuide dhe obligimeve afatshkurtra, përmes analizës së boshllëkut të likuiditetit, nivelit të borxheve, pjesës së kredive jo-performuese. Rreziku i solvencës në anën tjetër është vlerësuar përmes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, kapitalit Tier 1 dhe asetëve me rrezik të peshuar.

Paralel me analizën e gjendjes aktuale të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të solvencës, analizat e stres-testit paraqesin një mjet tjetër shtesë përmes së cilit është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj shokut, si në portofolin kreditor ashtu dhe në asetet likuide.

Mbikëqyrja e bankave ndjek një model mbikëqyrje të bazuar në rrezik, nën kornizën e Bazelit I, vlerësimin e bankave sipas treguesve CAMELS (kapital, cilësia e asetëve, menaxhimi, fitimet, likuiditeti dhe ndjeshmëria ndaj rrezikut). Për filialet e bankave të huaja, ky vlerësim është bërë bashkërisht me mbikëqyrësit e vendit të origjinës. Përmban të paktën një inspektim gjithëpërfshirës në-vend për çdo bankë çdo vit, si dhe mbikëqyrje vëzhgim jo-në-vend (FMN, 2011). Përkitazi me stres-testin, BQK-ja që nga 2010 është duke zbatuar një model të ndjeshmërisë të bazuar në stres-test, i cili i vlerëson shokun kundër sektorit bankar të bazuar në supozime. Tani-për-tani, stres-testi është model i koncipuar për të vlerësuar rreziqet kreditore dhe ato të likuiditetit (BQK, 2012).

1.6. Shqyrtimi i sektorit bankar dhe i portofolit kreditor

Sistemi bankar i Kosovës në dekadën e fundit ka pasur rritje rapide. Asetet e sektorit financiar kanë arritur rreth 97% të BPV-së në qershor të vitit 2012, nga 33% sa ishte në 2003. Sistemi dominohet nga bankat, hisja e të cilave është rreth 75% e gjitha asetëve të sektorit financiar (BQK, 2012). Me gjithë rritjen rapide, bankat kanë arritur të menaxhojnë një strukturë të kujdeshme të financimit. Në fundit të 2012, depozitimet, kryesisht nga amvisëritë (72% e obligimeve) përbënin rreth 80.5% të obligimeve të bankave, pjesa dërmuese e të cilave ishte afatshkurtër me maturim deri në një vit. Përkitazi me depozitimet, kreditë e dhëna sektorit privat paraqesin 36.1 si pjesë e BPV-së në 2012. Pjesa më e madhe e kredive i janë lëshuar sektorit të shërbimit, që - në pjesë të madhe - pasqyron strukturën e ekonomisë së Kosovës. Mirëpo, bankat e Kosovës janë treguar të kujdeshme duke e rritur kriterin e kontrollimit dhe duke e ngadalësuar kreditimin e ekonomisë.

Në përgjithësi, duke pasur parasysh shkallën relativisht të ulët të integritimeve ekonomike të Kosovës përkitazi me eksportimet dhe financat ndërkombëtare, rritja ekonomike gjatë viteve të fundit është prekur relativisht nga kriza globale ekonomike dhe nga kriza në euro zonë.

Vlera totale e kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës shkon deri në 1.7 miliardë EUR në qershor 2012 (34.7% të BPV-së), gjë që paraqet një rritje vjetore prej 3.8%, në krahasim me 1.6% në periudhën e njëjtë të vitit të shkuar. Figurat shpalosin një ngadalësim të dukshëm të huadhënies gjatë vitit 2012, gjë e cila - në masë të madhe - reflekton per-

ceptimet e bankave për performancën e ekonomisë e përgjithshme (BQK, 2013).

Përfundimisht, sistemi bankar i Kosovës ka ngelur profitabil, likuid dhe mirë i kapitalizuar, edhe pse forca financiare e bankave është e ndryshme. Mjaftueshmëria agregate e kapitalit për sistemin bankar në dhjetor 2012 ishte 17.9%, kundruall 12% të kërkuar sipas rregullave. Kreditë jo-performuese janë rritur deri në dhjetor 2012 kur arritën nivelin rekord prej 7.5%, mirëpo provizionimi i tyre ngel në nivel të kënaqshëm prej 111.6%.

Përkitazi me institucionet mikro-financiare, ligji ka ngarkuar BQK-në me përgjegjësinë e licencimit dhe nga institucionet mikro-financiare kërkon të kenë një strukturë qartë të definuar pronësore. Sipas raportit të BQK-së mbi stabilitetin financiar (2012), institucionet mikro-financiare mbajnë 3.4% të asetëve të sistemit financiar.

1.7. Qëndrueshmëria e sektorit bankar

Sistemi financiar i Kosovës është treguar rezilent karshi krizës globale financiare, dhe korniza e saj rregullative dhe institucionale është forcuar thelbësisht. Sistemi financiar është kryesisht i financuar nga depozitat të cilat më pas jepen si kredi. Mirëpo, ekzistojnë brishtësi strukturore të sistemit financiar, pasi asetet e bankës janë shumë të koncentruara dhe me norma relativisht të larta të interesit. BQK-ja rekomandon që bankat komerciale të mbajnë një raport kredi-depozitë prej 80%, i cili gjerësisht është zbatuar nga bankat. Ky raport në dhjetor 2012 ishte 77.4%.

Në vitet e fundit, korniza rregullative dhe mbikëqyrëse e Kosovës është përmirësuar gradualisht drejt përmbushjes së standardeve të BE-së, si për banka ashtu dhe për institucione mikro-financiare. Mirëpo, qasja në shërbimet financiare, edhe pse nuk është akoma në një nivel të parapëlqyer, konsiderohet të jetë pengesa e nëntë për bizneset (Banka Botërore, 2011). Nga të gjitha kreditë e lëshuara në Kosovë (1.7 miliardë EUR), 67% syresh janë lëshuar ndërmarrjeve, ndërsa rreth 30% amvisërive.

1.8. Principet themelore të SHNMS-së

Në aktivitetet e saja licencuese dhe rregullative për bankat komerciale, për kompanitë, ndërmjetësuesit, fondet plotësuese pensionale dhe për institucionet tjera financiare dhe jo-financiare, Drejtoria e Licencimit dhe Metodologjisë udhëhiqet nga principet të cilat janë në pajtim me direktivat e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të prezantuara në “Parimet themelore për mbikëqyrje efektive bankare”, publikuar nga Bank for International Settlements (Banka për aranzhime ndërkombëtare) dhe “Parimet bazike për mbikëqyrje efektive të sigurimeve”, publikuar nga International Association of Insurance Supervisors (Shoqata ndërkombëtare për mbikëqyrësit e sigurimeve), (BQK, 2010).

1.9. Normat e interesit

Normat e interesit në sektorin bankar të Kosovës kanë treguar zhvillime relativisht stabile dhe një zgjerim relativisht të lartë të normave të interesit. Në fund të 2012, normat e interesit të kredive kanë rënë në 13.4% (në krahasim me 14,1% sa ishin në dhjetor 2011), ndërsa interesi në depozitime është rritur në 3.57% (në krahasim me 3.5% sa ishte në dhjetor 2011), duhet rezultuar në një zgjerim të normës së interesit prej 9.58% (BQK, 2012). Dekompozimi aktual i normës së interesit sugjeron se rreziku dhe kostoja operative janë faktorët më të rëndësishëm për normat relativisht të larta (BQK, 2012). Mirëpo, pasi infrastruktura e sektorit bankar është përmirësuar në një nivel të kënaqshëm, pritet rënie e kostove operative, që do të shpie, poashtu, në rënie të normave të interesit.

Normat e interesit të prodhuara nga BQK janë në përputhje me standardet e ECB mbi normat efektive të interesit, dhe rregullat e reja kërkojnë që bankat komerciale t'i raportojnë klientëve mbi normën efektive të interesit.

BQK-ja është institucioni kryesor për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut financiar të Kosovës, mirëpo për shkak se Kosova përdor Euron si valutë zyrtare, BQK-ja ka instrumente të limituara të politikave në dispozicion, siç janë kushtet për rezerva dhe likuiditet. Në mungesë të politikave autonome monetare dhe duke pasur parasysh euronizimin e ekonomisë, lëvizjet e normave reale të interesit dhe kursit real (efektiv) të këmbimit janë të vështira të parashikohet dhe të ndikohet në to. Pasiguria për të drejtat pronësore dhe sundimi i dobët i ligjit vazhdojnë të jenë faktorët kryesorë për premitë e larta të rrezikut të kërkuara nga bankat komerciale (KE, 2009).⁶⁶

Sipas raportit të njëjtë, përderisa sistemi financiar i Kosovës është zhvilluar shpejtë, progresi i mëtutjeshëm është penguar nga kostot e rrezikut të lartë, kapacitetit të limituar ligjor dhe disponibilitetit të limituar të kolateralit për operacione të huadhënies. Këto kufizime i kanë mbajtur normat e interesit të larta, dhe kanë parandaluar ndërmjetësimin financiar që të zgjerohet në pjesë më të gjera të popullsisë. Për më tepër, shpërndarja jo e njëtrajtshme e profiteve në radhët e bankave, të ardhurat relativisht të vogla të komisioneve, orvatjet agresive të lojtarëve të ri të fitojnë hise në treg (konkretisht filialet e bankave turke) dhe rritjet substanciale në normat e depozitave gjatë krizës financiare, sugjerojnë se konkurrenca e pamjaftueshme mund të mos jetë faktori më i rëndësishëm.

Sistemi ligjor në anën tjetër vazhdon të vuaj nga efikasiteti dhe qasshmëria e dobët. Ekzekutimi i dobët i kontratave ngel një prej shqetësimeve kryesore të kompanive dhe investitorëve në Kosovë. Po ashtu, është një prej faktorëve që shpjegon normat relativisht të larta që bankat komerciale ia ngarkojnë sektorit privat.

1.10. Sistemi elektronik ndër-bankar i kliringut

Krijimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm kombëtar të pagesave, si stan-

⁶⁶ Raporti i Progresit, 2009, fq. 23.

dard kyç i infrastrukturës financiare, është një prej funksioneve parësore të BQK-së. Sistemi Elektronik Ndërbankar Kliring (SENK) i operuar nga BQK-ja është i vetmi sistem ndër-bankar i pagesave në Republikës e Kosovës. SENK funksion si një sistem hibrid, i cili mundëson kanalizimin ndër-bankar të një game të gjerë të instrumenteve bankare.

Përgjatë vitit 2011, është shënuar një rritje në vëllimin dhe vlerën e raportit të transaksioneve SENK dhe janë bërë avancime të mëtutjeshme të sistemit. Rritja e vazhdueshme e vëllimit dhe shumës së transaksioneve SENK, pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besimit në sistemin bankar vendor.

Ka disa lloje të veçanta të transaksioneve SENK, si transaksioni i rregullt (individual dhe masiv), prioritar (Individual dhe masiv), Kos-Giro dhe Direct Debit. Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 87.5% të vëllimit të transaksioneve SENK dhe rreth 69% të vlerës së transaksioneve SENK.

Duke pasur parasysh zhvillimin e përgjithshëm e sistemit dhe mbikëqyrjes së tij, duhet të ceket se Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP) është themeluar për të përkrahur zhvillimin dhe rritjen e sistemit efikas të kliringut dhe sistemeve të aranzhimit për të rregulluar pagesat dhe letrat me vlerë në Kosovë.

2. Sektori i sigurimeve në Kosovë

Zhvillimet në sektorët tjerë financiar në Kosovës, gjegjësisht kompanitë e sigurimeve, institucionet financiare dhe degët e tyre, kanë një ndikim dukshëm më të vogël në zhvillimet e përgjithshme në sektorin financiar, si rezultat i hises së tyre në gjithë sektorin financiar. Aktiviteti kryesor i kompanive të sigurimit vazhdojnë të jenë sigurimi i obligimit të palës së tretë, të cilat gjenerojnë pjesën më të madhe të premive të pranuar.

Në kontekst të zhvillimeve të mëtutjeshëm të industrisë së sigurimeve, BQK ja nënshkruar disa marrëveshje lidhur me TPL, mes së cilave me Maqedoninë e cila pranon policën TPL të Kosovës (30% të policës vendore, derisa Kosova ka pranuar Kartonin e gjelbër të Maqedonisë) dhe Shqipërinë e cila rezultoi me pranimin e policës së TPL. Në këtë kontekst, Kosova gjithashtu ka vendosur policin kufitare në kufi me Maqedoninë dhe Serbinë.

2.1. Korniza ligjore dhe institucionale

Në vitin 2011 hyri në fuqi ligji 04/L-018 mbi sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Me hyrjen e këtij ligji në fuqi, në shtator 2011, në koordinim me industrinë e sigurimeve dhe akterët tjerë relevant, BQK-ja themeloi Zyrën e Sigurimeve të Kosovës (ZSK).

Sipas Memorandumit të fundit teknik të Mirëkuptimit të FMN-së, Kosova është duke ecur para me reformat e sektorit të sigurimeve, për të cilën BQK-ja është rregullator. FMN-ja ka bërë një vlerësim të plotë të parimeve themelore të sigurimeve (PHTS) me asistencën e Bankën Botërore. Një këshilltar rezident, i financuar nga thesari i SHBA-së,

është duke punuar me Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve pranë BQK-së në shqyrtimin e deklaratave të detyrës për departamentin në fjalë të BQK-së, shqyrtimin e kushteve të kujdesshme (për raportet aktuale dhe të ardhshme), si dhe kornizën ligjore dhe zbatimin e një doracaku për mbikëqyrje në-vend për sigurimet jetësore dhe jo-jetësore, përfshirë zbatimin e veprimeve kyçe sipas rekomandimeve nga një raport i Bankës Botërore.⁶⁷

2.2. Licencimi nga BQK-ja

Departamenti i BQK-së për Mbikëqyrjen e Sigurimeve është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e industrisë së sigurimeve në Kosovë. Kriteret licencuese janë krijuar sipas legjislacionit aktual dhe parimet e përgjithshme nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara më lartë për sektorin bankar.

Sipas kornizës rregullative dhe licencuese të BQK-së, detyra e Departamentit të Licencimit dhe Rregullimit është të kompletojë kornizën ligjore mbi mbikëqyrjen financiare në pajtim me Direktivat e BE-së dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare, të paraqitura në “Principet themelore për mbikëqyrjen efektive bankare” e publikuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (SHNMSH). Në përmbushjen e këtij misioni, departamenti për licencim është përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe rekomandimin e kërkesave të institucioneve të cilat parashtrojnë kërkesë për licencë, gjegjësisht, regjistrim për të operuar në Kosovë, si bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve, Fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare jo-bankare.

2.3. Mbikëqyrja e BQK-së

Krahas raportimit të koncipuar sipas rregullave të BQK-së, me qëllim të mbrojtjes së interesave të politikë-mbajtësve, departamenti për mbikëqyrjen e sigurimeve ka bërë mbikëqyrje aktive të bazuar në rrezik, duke bërë ekzaminime në-vend dhe jo-në-vend.

Monitorimi i kompanive të sigurimit bëhet përmes Divizionit të Raportimit dhe Analizës (DRA) në mënyrë sistematike dhe në formë të standardizuar, duke lëshuar analiza të rregullta mujore, tremujorëshe dhe vjetore sipas rregulloreve interne të BQK-së dhe në bazë të standardeve të SNRF-së dhe praktikave të SHNMS-së. DRA përgatit raporte për Bordin e BQK-së në baza të rregullta mujore, monitoron performancën financiare të kompanive të sigurimit, kalkulon marzhën e solvencës, likuiditetin dhe treguesit tjerë të rrezikut.

2.4. Statusi dhe sfidat

Edhe pse sistemi i kompanive të sigurimeve ka vazhduar me zgjerimin e aktiviteteve,

⁶⁷ FMN - Letter of Intent, and Technical Memorandum of Understanding, 12 April 2012, fq. 6-7.

hisja e sistemit të sigurimeve në gjithë sektorin financiar është 3.4%. Përgjatë vitit 2012, numri i kompanive të sigurimeve të cilat kanë operuar në Kosovë ishte 13, prej të cilave 10 sosh kompani pa sigurim jetësor. Struktura pronësore akoma dominohet nga kompanitë me kapital pronë të huaj, ku 10 kompani të sigurimeve janë të pronësi të huaj, ndërsa 3 tjera janë vendore. Shuma e premive të pranuar përbëhet nga policat jo-vullnetare të sigurimeve, pra, 54.2% të Obligimeve të Palës së Tretë (OPT) dhe 15% nga policat kufitare. Shuma e kërkesave të paguara në anën tjetër u rrit me tempo të shpejtë prej 14.1%, duke shënuar 30.6% kur kërkesat për OPT dhe policat vullnetare kanë dhënë kontributin më të lartë për rritje. Rrjedhimisht, raporti në mes të kërkesave të paguara dhe premive të pranuar u rrit në 37.5% në vitin 2012 (34.3% në 2011).

3. Tregjet e kapitalit

Tregjet e kapitalit në Kosovë janë në fazën shumë të hershme të zhvillimit. Vetëm tash vonë, MF së bashku me BQK-në kanë publikuar rregulloren mbi tregjet primare dhe sekondare për lëshimin e letrave qeveritare me vlerë. Që nga fillimi i vitit 2012, qeveria është duke lëshuar bono thesari me maturim afatshkurtër prej 91 dhe 182 ditë.

Letrat qeveritare me vlerë lëshohen në baza të konkurrencës dhe jo konkurrencës. Në tenderët konkurrues, pjesëmarrëseve të suksesshëm iu ndahen letrat me vlerë me çmimin e kuotuar, ndërsa në tenderët jo konkurrues, pjesëmarrësit janë marrës të çmimit, me fjalë tjera, letrat me vlerë iu ndahen me një çmim të para-caktuar.

Dokumentet në vijim të aprovuara nga BQK dhe MF, paraqesin bazën foudamentale për nisjen e operacioneve: Rregullorja për tregun primar dhe sekondar të letrave qeveritare me vlerë dhe marrëveshja për shpërndarësit primar.

BQK ka themeluar divizionin e letrave me vlerë në kuadër të departamentit për menaxhimin e asetëve për të zbatuar projektin mbi lëshimin e borxhit. Si agjent fiskal, BQK do të bëjë ankande për letrat me vlerë. Ky aktivitet mundësohet përmes sistemit të letrave depozituese qendrore me vlerë (LDQV). Sistemi LDQV do të ketë funksionet në vijim:

- Lëshimi, regjistrimi, transferimi dhe menaxhimi i letrave jo të materializuara me vlerë;
- Riblerja;
- Aranzhim të transaksioneve;
- Monitorim të pjesëmarrësve;
- Pagesë të interesit në letrat me vlerë qeveritare.

3.1. Statusi dhe sfidat

Përgjatë vitit 2012, janë mbajtur 14 ankande për bono thesari, 12 për 10 milionë EUR me maturim prej 91 ditë dhe 2 prej 20 deri në 24 milionë EUR me maturim prej 182 ditëve. Ofertimi nga shpërndarësit primar vazhdimisht ka tejkaluar shumën e ofruar nga thesari me normë mesatare prej 2.1 herë, ndërkaq normat e interesit vazhdimisht

kanë rënë në më pak se 1% në dhjetor 2012. Zhvillimet e tilla në tregjet e bonove të thesarit sugjerojnë se sektori bankar konsiderohet likuid, dhe në fakt, likuiditeti i bankave në Kosovë është më i lartë se niveli i kërkuar për 54%. Krahas kësaj, normat e ulëta të interesit poashtu reflektojnë rënien e aktivitetit ekonomik në vend përgjatë vitit 2012 dhe sugjerojnë se kapacitetet e sektorit privat për të absorbuar kapitalin e bankës ngel i kufizuar, rrjedhimisht, bankat konkurrojnë për bono thesari me një normë shumë të ulët të interesit.

4. Fondi i trustit pensional

Sistemi pensional është komponent i rëndësishëm i sektorit financiar të Kosovës, dhe kontribuon me 18.6% të gjithë aseteve të sektorit financiar (BQK, 2012). Rreth 99.4% të gjithë aseteve të sistemit pensional në vend menaxhohen nga Trusti, ndërsa pjesa e ngelur prej 0.6% menaxhohet nga fondi pensional Slloven-Kosovar. Deri në qershor të vitit 2012, mjetet e fondeve të pensionit ishin afër 659.1 milionë EUR, që paraqesin 13.4% të BPV-së dhe një normë të rritjes prej 19.5% (BQK, 2012).

Sistemi pensional i Kosovës përbëhet nga tri shtylla. Shtylla e parë financohet nga buxheti i qeverisë që mbulon pensionet bazike për të gjithë popullatën e Kosovës mbi moshën 65 vjeçare, pensionet për personat me aftësi të kufizuara dhe pensionet e hershme për punonjësit e minierave. Krahas kësaj, shtylla e parë poashtu mbulon pensionet e ish anëtarëve të Trupave Mbrojtës të Kosovës (TMK).

Shtylla e dytë e sistemit pensional në Kosovë përfaqësohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti), institucion ky i pavarur përgjegjës për vendimmarrje përkizati me investimet e kontributeve dhe provizioneve të llogarive individuale. Trusti është i licencuar dhe i mbikëqyrur nga BQK. Bordi i Trustit emërohet nga Kuvendi i Kosovës.

Funksioni kryesor i Trustit është mbledhja dhe menaxhimi i kontributeve të obligueshme të të gjithë të punësuarve në Kosovë mbi moshën 18 vjeçare. Kjo skemë është e obligueshme për punonjësin, i cili kontribuon me 5% të bruto rrogës dhe 5% kontribut nga punëdhënësi.

Krahas kësaj, kemi edhe shtyllën III – skemë vullnetare pensionale, ku punëdhënësit mund të ofrojnë pensione plotësuese për punonjësit e tyre, apo individët mund të blejnë pensione individuale plotësuese, përmes ofruesit të shërbimeve pensionale. Skema e pensionit vullnetar paraqet një opsion për bizneset dhe për institucionet tjera financiare, dhe mund të themelohet nga kontributet e punëdhënësve dhe punonjësve. Sistemi pensional plotësues (vullnetar) stimulohet nga koncesionet tatimore. Ky sistem plotësues në Kosovë i cili operon aktualisht, përfaqësohet nga Trusti dhe Fondi Pensional Slloven-Kosovar.

Shtylla III e sistemit pensional në Kosovë ngel relativisht e ulët në krahasim me shtyllën I dhe II, dhe menaxhon më pak se 1% të gjitha mjeteve të sistemit pensional.

Kjo skemë pensionale paraqet një opsion për bizneset dhe për institucionet tjera financiare, dhe mund të financohet nga kontributet e punëdhënësve dhe punonjësve. Sipas ligjit nr. 04/L-101 mbi fondin pensional të Kosovës, vetëm Trusti dhe Fondet pensionale plotësuese të punëdhënësit apo ofruesit e shërbimeve pensionale të licencuar nga BQK mund të ofrojnë pension në Kosovë në shtyllën III.

4.1. Trusti - Korniza ligjore dhe institucionale

Trusti është themeluar në gusht 2002 për të administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë. Me qëllim të avancimit të infrastrukturës ekzistuese ligjore mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, Kuvendi ka aprovuar ligjin nr. 04/L-101 mbi fondet e pensionit në Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi me 30 mars 2012. Trusti është institucion ligjor i pavarur nën mbikëqyrjen e BQK-së, i krijuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, që nënkupton se secili kontribues kursen për pension në një llogari personale. Kursimet mbesin pronë e kontribuesve, dhe duhet të përdoren vetëm për qëllime të pensionimit.⁶⁸

Ligji i ri i jep Trustit kompetencat në menaxhimin, administrimin dhe investimin e mjeteve pensionale të pjesëmarrësve, dhe poashtu parasheh licencimin, mbikëqyrjen dhe investimin e fondeve shtesë pensionale të punëdhënësit dhe fondeve shtesë individuale. Në këtë frymë, Trusti siguron një investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të mjeteve të pensionit dhe pagimin e rrjedhave të parasë nga llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursimet pensionale, si i besuar i cili vepron në emër të kontribuesve dhe përfituesve të tij.

Trusti ka 5 departamente: i) Marrëdhëniet me Klientë, ii) Financat, iii) Marrëdhëniet me Publik dhe Trajnim, iv) Burimet Njerëzore dhe v) Teknologjia Informative, funksionet e të cilave janë të mbajnë shënime të kontributeve, të menaxhojnë llogaritë personale, ofrojnë shërbime për klientë dhe të informojnë publikun në mënyrë efektive. Trusti ka 27 profesionistë të cilët kryejnë funksione në pranimin dhe procedimin e kontributeve dhe ofrimin e këshillave dhe mbështetje për kontribuesit.⁶⁹

Sistemi i pensionit në Kosovë është universal dhe përfshin të gjitha grupet që jetojnë në Kosovë, pa diskriminim në baza gjinie, race apo kombësie. Kriteret e themeluara nga aktet nënligjore nuk përjashtojnë dhe nuk ka mundësi të përjashtimit të ndonjë grupi të caktuar nga e drejta në pension. Mirëpo, për shkak të vetëdijesimit të përgjithshëm mbi përfitimet e sistemit dhe ekonomisë joformale, përfshirja e të gjithë punonjësve në sistemin e pensionit ngel sfidë, përfshirë barazimin e të dhënave në mes të ATK-së dhe Trustit.

Administrata tatimore ka lansuar në maj 2010 një shërbim të deklarimit elektronik dhe pagesës së tatimit në të ardhura dhe kontributet e pensionit. Në fund të tremujorëshit të dytë të

⁶⁸ Trusti - <http://trusti.org/index.php/en/about-the-trust->.

⁶⁹ Trusti - <http://trusti.org/index.php/sq/funksionet-dhe-pergjegjesite>.

vitit 2010, rreth 90% e bizneseve kaluan në sistemin e ri të raportimit mujor dhe elektronik. Trusti ka lansuar shërbimin elektronik (eTrusti), i cili mundëson komunikim më të shpejtë dhe më të lehtë në mes të stafit të Trustit dhe kontribuuesve të tij (Trusti 2012).

Trusti udhëhiqet nga Bordi Qeverisë i cili mbikëqyr funksionet e Trustit, ofron udhëzime, ka përgjegjësinë ekskluzive mbi politikat dhe investimet, dhe është përgjegjës për politikë-bërje me këshillat nga drejtori menaxhues dhe nga stafi. Bordi përbëhet nga 8 anëtarë: 4 anëtarë profesionist, 2 anëtarë përfaqësues, njëri i punëdhënësve dhe tjetri i të punësuarve, një përfaqësues i Qeverisë pa të drejtë vote dhe një përfaqësues ndërkombëtar i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (pozita do të plotësohet nga Komiteti Përzgjedhës). Në qershor 2012, Kuvendi i Kosovës aprovojë ri-emërimin dhe emërimin e anëtarëve të Bordit me mandat 3-vjeçar duke filluar nga gushti 2012 (Trusti, 2012). Bordi ka publikuar raportin vjetor për vitin 2011 dhe ia ka dorëzuar Kuvendit.

Kontributet pensionale bëhen me qëllim të ngritjes së vlerës së kursimeve pensionale të kontribuesve, dhe në afat të gjatë, të mundësojë pensionim më të mirë të mundshëm kur të dalin në pension. Investimet e Trustit bëhen në klase të ndryshme të asetëve, tregjeve dhe industri të ndryshme, për të zvogëluar rrezikun e investimit. Është paraparë se pagesa minimale e kontributeve pensionale nuk mund të jetë më e vogël se rroga minimale në vend (me fjalë tjera, nuk do të paguhet kontributet e pensionit për rroga nën 130 € për punonjësit nën moshën 35 vjeçare, dhe as për rrogat prej 170€ për punonjësit e grup-moshës 35-60 vjeçar).

4.2. Struktura e investimeve të trustit

Struktura e investimeve të Trustit udhëhiqet nga strategjia investuese e Bordit të Trustit (Trusti, 2012). Vendimet për investime janë të izoluara nga ndikimet politike dhe bëhen vetëm në bazë të kujdesit financiar.

Trusti ka angazhuar firma profesionale për menaxhimin e mjeteve (Vanguard, AXA GILB, BNY Mellon, Aquila, Schrodgers, CBK, State Street, European Credit Managment, Raiffeisen Bank, NLB Prishtina), të cilët vetë duhet të përmbushin kriteret strikte të profesionalizimit, fuqisë së kapitalit dhe pavarësisë. Këta menaxherë të mjeteve janë përgjegjës për marrjen e vendimeve individuale të investimit, të cilat i përmbahen instruksioneve të dhëna nga Bordi. Format për menaxhimin e mjeteve janë angazhuar përmes një procesi përzgjedhës duke përdorur praktikën më të mira ndërkombëtare.⁷⁰

Struktura e investimeve është paraparë nga Politikat e Investimit, të cilat janë shqyrtuar formalisht në secilin takim të Bordit, dhe principet e parapara janë në koherencë me ligjin e Kosovës për fondet pensionale.⁷¹ Mjetet janë investuar në pajtim me kriteret eksplicite në vijim:

⁷⁰ Trusti - <http://trusti.org/index.php/en/principles>.

⁷¹ Trusti - <http://trusti.org/index.php/en/investment-policy>.

- Investimi i mjeteve në mënyrë të sigurt;
- Investimet bëhen në instrumente të ndryshme financiare në mënyrë që të sigurohet diversifikimi;
- Kthim maksimal, në pajtimin me sigurimin e mjeteve të pensionit;
- Mirëmbajtja e likuiditetit adekuat; investimi i aseteve në instrumente financiare që shiten lehtë.

Numri i kontribuesve (399,075 në tremujorin e dytë të 2012) dhe vlera e kontributeve pensionale vazhdon të rritet, e përcjellë me një normë pozitive të kthimit në investimet e tyre. Sipas rezultateve të investimeve të Trustit, tremujori i dytë i 2012 karakterizohet me bilanc negativ për shkak të krizës së borxheve në disa vende të BE-së dhe luhatjeve të mëdha në tregjet globale financiare⁷²; mirëpo në gjysmën e parë të vitit 2012 ka pasur një kthim pozitiv në vlerë prej 19 milionë EUR. Rezultatet pozitive të investimit, tok me kontributet e reja pensionale, e bëjnë totalin e mjeteve të menaxhuara nga Trusti të arrijë shumën prej 654 milionë EUR.

Në gusht 2012, struktura e investimeve të Trustit dominohej nga investimet në ekuitete duke e arritur aksion prej 40.3%. Obligacionet në anën tjetër janë kategoria e dytë me aksion prej 24%, prej të cilat 14.6 janë obligacione të lidhura me inflacion. Duhet të theksohet se pjesa e fondeve të Trustit të investuara në Kosovë ngel relativisht e ulët me 7%, ndërsa afër 5% ngelin të painvestuara në BQK.

⁷² Trusti - <http://trusti.org/index.php/en/rezultatet-e-gjysmevitit-te-pare-nga-investimet>.

5. Konkluzione

Avantazhet	Sfidat	Rekomandimet
Sistemi financiar vazhdon të jetë konservativ		
Sistemi financiar vazhdon të jetë stabil dhe me performancë pozitive	Mbajtja e këtij stabiliteti	
Sektori i biznesit vazhdon të jetë kredi-marrësi kryesor në ekonomi	Norma e interesit vazhdon të jetë e lartë, sidomos për industri të cilat kanë kapacitete për gjenerim të punësimit dhe vlerë të shtuar në ekonomi	Të përcillen zhvillimet e përgjithshme në vend si dhe të krijohen kushte më të përshtatshme për sektorin e agro-kulturës dhe prodhimit
Sektori i ekonomive familjare gjithashtu ka një pjesëmarrje solide në kreditë në vend	Shfrytëzimi i kredive hipotekare mbetet në nivel të ulët dhe konsiderohet si njëri ndër segmentet më të pa zhvilluara	Të përkrahet zhvillimi i tregut të hipotekave që do të mundësonte funksionalizimin më të madh të kapitalit në vend
Financimi i bankave vazhdon të jetë i koncentruar në ekonominë vendore	Linjat kreditore ndërkombëtare më pak të zhvilluara	Të përcillet ky trend i cili konsiderohet si njëri faktorët kryesor që ka siguruar stabilitet
Industria e sigurimeve ballafaqohet me probleme në aspektin politik	Sfidë mbetet anëtarësimi në kartonin e gjelbër	
Sistemi pensional konsiderohet se është mjaft modern dhe me performancë të mirë	Orientimi i një pjese të fondeve ndaj ekonomisë vendore dhe mungesë e instrumenteve në vend për investim të këtyre mjeteve	
Ndryshime të rëndësishme rregullative gjatë fundit të vitit 2012 që kanë për qëllim të sigurojnë stabilitet financiar		

Kapitulli V - Statistikat Zyrtare

1. Kërkesat e BE-së në proces të integrimit

Statistikat janë thelbësore për politik-bërje në çdo sferë të shoqërisë. Për të pasur një zhvillim të suksesshëm duhet të ekzistojnë statistika të besueshme, të paanshme dhe me kohë për të ditur nivelin dhe arsyen e varfërisë, papunësisë, arsimimit, shëndetit, pastaj trendet e zhvillimit të industrive dhe aktiviteteve ekonomike, etj, të gjitha në funksion të marrjes së vendimeve mirë të informuara.

Në kuadër të Bashkimit Evropian (BE), Komisioni Evropian është i mandatuar të raportoj te shtetet anëtare për progresin e arritur të 5 shteteve kandidate dhe shteteve potenciale për kandidaturë ku bënë pjesë edhe Republika e Kosovës. Kaptina 18 e Acquis Communautaire ka të bëjë me statistikave dhe kërkon nga shtetet kandidate të kenë statistika të bazuara në këto parime: pavarësi, besueshmëri, transparencë, konfidencialitet të të dhënave personale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Institutet kombëtare të statistikave janë pika referimi për metodologji, prodhim dhe shpërndarje të statistikave. Zyra e statistikave të Bashkimit Evropian, Eurostat qëllim kryesor ka sigurimin e të dhënave kualitative bazuar në praktikave dhe standardet statistikore ndërkombëtare dhe për së afërmi bënë përcjelljen e shteteve anëtare dhe shteteve (potenciale) kandidate që të veprojnë konform rregullatives ligjore të BE-së në fushën e statistikave. Acquis ka të bëjë me metodologjinë, klasifikimin dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave makroekonomike, të çmimeve, demografike dhe sociale, rajonale, të bizneseve, transportit, tregtisë së jashtme, bujqësisë, ambientit, shkencës dhe teknologjisë, etj. Në këtë aspekt nuk kërkohet transpozim i legjislacionit sepse shumica e acquis në fushën e statistikave është në formë të rregulloreve.⁷³

Parimet fundamentale për prodhimin e statistikave të Komunitetit janë të paraqitura në Rregulloren e Këshillit 322/97, e cila njihet si 'Ligji i statistikave' që rregullon çështjet që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, cilësinë, transparencën, qasjen, etj. Format e organizimit dallojnë mes shteteve të BE-së, por kryesisht zyret e statistikave në çdo shtet janë organ koordinues dhe përgjegjës për cilësinë dhe respektimin e parimeve fundamentale. Këto zyre prodhojnë dhe shpërndajnë shumicën e statistikave, edhe duke përdorur burimet e institucioneve tjera si ato fiskale, sigurimet sociale, regjistrin, etj. Disa lloje të statistikave si bilanci i pagesave dhe disa statistika tjera financiare zakonisht përpilohen nga Bankat Qendrore në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me zyret e statistikave. Për vlerësimin e kapaciteteve në këtë aspekt përdoren këto kritere:

- Struktura dhe korniza ligjore: misioni, fushë-veprimtaria dhe fuqia koordinuese e zyrës statistikore, roli i institucioneve tjera në prodhimin e statistikave (ministritë e linjës), Këshilli Statistikorë, Programi vjetor;
- Marrëdhëniet me Qeverinë: marrëdhëniet në kuptimin e funksioneve të

⁷³ http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accesion_process/how_does_a_country_join_the_eu/negotiations_croatia_turkey/index_en.htm.

shumëfishta si përdorues i statistikave, ofrues i burimeve dhe ofrues i të dhënave administrative

- Marrëdhëniet me qeveritë lokale dhe rajonale
- Mbrojtja e pavarësisë: nominimi i presidentit, qasja në të dhëna individuale, etj
- Marrëdhëniet me shfrytëzuesit dhe politikat e shpërndarjes
- Marrëdhëniet me ofruesit: asociacionet profesionale të bizneseve, organizatat sociale, etj
- Organizimi i brendshëm
- Procedurat e planifikimit dhe programimit në zyret e statistikave
- Financat dhe buxheti: buxheti në kushte të rëndomta dhe të jashtëzakonshme (regjistrimi i popullsisë), fleksibiliteti në përdorim të buxhetit, infrastruktura (p.sh. IT), etj
- Staf: rekrutimi i stafit, përbërja gjinore/moshore, shkollimi, trajnimi dhe zhvillimi, etj
- IT: infrastruktura e cila determinon performancën
- Monitorimi i brendshëm i performancës: përcjellja dhe raportimi rreth programeve vjetore dhe Programit Nacional për Adoptimin e Acquis në përgjithësi
- Llogaridhënia e jashtme: cili institucion i jashtëm bënë monitorimin e performancës, si bëhet kjo, etj

BE monitoron këto kritere përmes raporteve vlerësuese, misioneve monitoruese, etj, ndërsa Eurostat-i bënë monitorimin e vazhdueshëm sa i përket pajtueshmërisë së statistikave dhe të gjitha këto rezultate shfrytëzohen për të përcaktuar prioritetet për asistencë teknike për të tejkaluar sfidat e identifikuar.⁷⁴

Udhëzimet rreth prodhimit të statistikave janë të përfshira në kuadër të Kodit të praktikës së statistikave evropiane për autoritetet statistikore kombëtare dhe të komunitetit miratuar me 2005. Kodi paraqet 15 parime si në vijim: pavarësia profesionale, mandati për mbledhjen e të dhënave, përshtatshmëria e burimeve, zotimi mbi cilësinë, konfidencialiteti statistikor, paanshmëria dhe objektiviteti, metodologjia e shëndoshë, procedurat e duhura statistikore, mos-ngarkimi i tepruar i respondentëve, kost-efektiviteti, relevanca, saktësia dhe besueshmëria, afatet kohore dhe përpikëria, koherenca dhe krahasueshmëria, qasja dhe qartësia.⁷⁵

Në procesin e integritit të Kosovës në BE, Qeveria ka themeluar 7 Komitete Ekzekutive, njëri prej të cilëve është për Ekonomi, Financa dhe Statistika, e në kuadër të të cilit monitorohet progresi i zhvillimit të statistikave të Kosovës dhe përafrimit të tyre me parimet dhe standardet e BE-së.

⁷⁴ Guide to the main administrative structures required for implementing the acquis, fq. 61-62.

⁷⁵ ASK - <http://esk.rks-gov.net/kodi-i-praktikes>.

2. Korniza ligjore dhe institucionale

2.1. Mbledhja e të dhënave, prodhimi dhe shpërndarja e statistikave zyrtare

Ligji i ri për statistikave zyrtare 04/L-036 është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në tetor 2011, dhe ka hyrë në fuqi në dhjetor 2011, në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it dhe rregullon parimet fundamentale të organizimit të statistikave zyrtare, standardet për zhvillim dhe cilësi, prodhim dhe publikim të statistikave zyrtare. Ligji thekson se statistikave duhet të jenë të besueshme, të pavarura dhe të rregullta duke mbuluar fushat administrative, demografike, ekonomike, sociale, shëndetësore, arsimit dhe bujqësisë.

Në ligj poashtu përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme në lidhje me statistikave zyrtare, ku ASK ka mandat të kërkoj statistika nga organizatat tjera, e që është shumë inkurajuese në krahasim me gjendjen para miratimit të ligjit.⁷⁶ Prodhuesit kryesor të statistikave zyrtare janë ASK, BQK dhe MF, ndërsa ASK është institucion koordinues dhe harmonizues i statistikave me misionin për të identifikuar nevojat e shfrytëzuesve dhe të publikoj statistika të paanshme. ASK është institucion i pavarur i cili i raporton Zyrë së Kryeministrit. Legjislacioni evropian nuk specifikon se si të organizohen agjencitë e statistikave për t'u siguruar pavarësia e tyre, mirëpo praktikave të shumicës së vendeve anëtare të BE-së tregojnë se agjensionet statistikore i japin llogari Qeverive përkatëse⁷⁷, dhe rasti i Kosovës (sipas rekomandimeve të Eurostat-it) nuk dallon në këtë aspekt. ASK ka përgjegjësinë kryesore për prodhimin e statistikave zyrtare si dhe për çështje tjera që dalin nga programi i statistikave zyrtare. Detyrat e ASK-së përfshijnë edhe përgatitjen e programit në bashkëpunim me organizata lokale e ndërkombëtare me qëllim të krahasimit të statistikave zyrtare me sisteme të ndryshme. ASK angazhohet për prodhimin e statistikave cilësore që reflektojnë besueshëm situatën socio-ekonomike në vend, dhe ofrimin e tyre shfrytëzuesve të ndryshëm. Në këtë drejtim ASK ofron shërbime për këto fusha statistikore sektoriale: statistikave ekonomike dhe llogaritë kombëtare, statistikave të popullsisë, bujqësisë, energjisë, tregtisë së jashtme, sociale etj, të cilat ndahen në nën-sektor të caktuar si mjedisi, niveli i jetesës, popullsia aktive dhe pagat, shëndetësia, arsimit, kultura dhe sporti, ndërmarrjet ekonomike, çmimet, etj.⁷⁸ Objektivi i ASK-së është që të ketë zhvillime në kuptim të volumit dhe shpeshësisë së publikimit të statistikave, p.sh. regjistrimi i bujqësisë, publikimi më i shpeshtë i llogarive kombëtare, etj.

Sistemi i statistikave në Kosovë pritet të konsolidohet me Programin statistikor pesëvjeçar të ASK-së 2013-2017 i cili është aprovuar nga Qeveria në janar 2013. Propozim Plani vjetor i punës për vitin 2013 poashtu është aprovuar nga Qeveria. Ligji ofron kornizën e përgjithshme për organizimin, grumbullimin e të dhënave, procedimin, prodhimin dhe

⁷⁶ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 9.

⁷⁷ Bulgaria, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Latvija, Lituania, Malta, Holanda, Romania, Slovenia, Spanja, Mbretëria e Bashkuar, etj.

⁷⁸ ASK - <http://esk.rks-gov.net/lista-e-sheerbimeve-nga-esk>.

publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës, pastaj ruajtjen e të dhënave zyrtare, sekretin dhe mbrojtjen e tyre, bashkëpunimin ndërkombëtar statistikor, etj. Ligji poashtu rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesve të statistikave zyrtare dhe të Këshillit të Statistikave si dhe jep udhëzime për programin pesëvjeçar, planin vjetor, dhe raportimin.

Rregullorja për riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ASK është aprovuar dhe e njëjta është në proces të implementimit; ndërsa legjislacioni sekondar në fushën e statistikave zyrtare përfshin aktet në vijim: i) udhëzimi administrativ nr. 11/2012 për ruajtjen dhe shfrytëzimin e lëndës statistikore; ii) udhëzimi administrativ nr. 08/2012 për kushtet dhe mënyrën e ofrimit të të dhënave statistikore të fituara me përpunime të veçanta të statistikave zyrtare; iii) propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Statistikor të Kosovës dhe rregullorja për funksionimin e Këshillit Statistikor; iv) rregullorja për zbatimin e standardit për klasifikimin e veprimtarive ekonomike në versionin nga NACE Rev. 2. ASK poashtu ka përgatitur edhe Hartat rru-gore 2012 dhe 2013.⁷⁹

2.2. Koordinimi i të dhënave statistikore

Sipas ligjit të ri, bartësi kryesor i statistikave zyrtare në Kosovë është ASK, MF dhe BQK, ndërsa përgjegjësitë e koordinimit janë të ndara mes Këshillit Statistikor (si mekanizëm këshillëdhënës) dhe ASK-së. Sistemi i tërësishëm i prodhimit të statistikave zyrtare është i njohur e i qartë sipas ligjit të lartcekur dhe në konsolidim e sipër. Për shkak të vështirësive gjatë viteve të pasluftës, prodhimi i statistikave në disa fusha të rëndësishme bëhet nga disa organizata/institucione tjera, p.sh. statistikat e arsimit prodhohen nga MASHT, apo statistikat ekonomike mbledhen dhe prodhohen nga disa institucione të ndryshme.⁸⁰ Në anën tjetër, ASK në disa fusha jo vetëm që nuk mbledh dhe publikon statistika, por nuk është e involvuar fare në proces, si p.sh. në statistikat e migrimit.⁸¹

Aktualisht koordinimi bëhet në atë mënyrë që para publikimit të statistikave makroekonomike, ASK konsultohet me institucionet tjera bartëse të statistikave zyrtare (pjesë e sistemit të statistikave zyrtare) në mënyrë që të siguroj saktësinë dhe konsistencën e të dhënave, p.sh. ASK nuk publikon të dhënat e BPV-së pa u harmonizuar paraprakisht me njësitë tjera të sistemit statistikor si BQK, MF, etj. Në kuadër të ristrukturimit të ASK-së, është themeluar një njësi për koordinim në mes të prodhuesve zyrtar të të dhënave dhe shfrytëzuesve, që të sigurohet një procedurë koordinimi më e mirëfilltë.⁸²

Përgjegjësia kryesore në aspektin e koordinimit, përmirësimit dhe rritjes së besueshmërisë së statistikave i takon ASK-së, mirëpo edhe Këshilli Statistikor ka rol të

⁷⁹ ASK - Raporti Vjetor 2012, fq. 6-7.

⁸⁰ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 10.

⁸¹ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 334.

⁸² Ibid, fq. 246.

rëndësishëm përmes dhënies së këshillave, rekomandimeve, monitorimit dhe vlerësimit me qëllim të rritjes së kualitetit të statistikave zyrtare. Këshilli Statistikor (KS) është themeluar me vendim të Kryeministrit me mandat 5 vjeçar me qëllim të parashtrimit të nevojave të shfrytëzuesve të statistikave, ofrimit të këshillave dhe rekomandimeve për planet e ASK-së, etj. KS është i përbërë nga 12 anëtarë dhe Kryesuesi (BQK) nga këto institucione: ASK, MF, MTI, MASHT, MSH, MPMS, MBPZHR, BQK, ATK, Zyra për Planifikim Strategjik, përfaqësues i akademisë; përfaqësues i shoqërisë civile, dhe përfaqësues i Komunitetit të Biznesit. Përzgjedhja e anëtarëve të KS-së nga radhët e shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit është bërë përmes ftesës publike dhe përzgjedhjes së propozimeve me votim. Mirëpo disa OJQ (p.sh. KCSF) nuk kanë qenë të njoftuara për këtë çështje. KS deri në tetor 2012 ka mbajtur tre takime kur edhe është themeluar Kryesia. KS ka marrë pjesë në hartimin e Programit të statistikave Zyrtare 2013-2017 dhe ka kontribuar në arritjen e një bashkëpunimi më të mirë mes bartësve të statistikave zyrtare dhe shfrytëzuesve. Bashkëpunimi dhe koordinimi është përmirësuar edhe me institucionet tjera publike si dhe me donatorët dhe janë arritur marrëveshje edhe për zhvillimin e hulumtimeve të rëndësishme për shfrytëzuesit.⁸³

2.3. Buxheti dhe stafi

ASK ka strukturën e vet organizative duke u përbërë prej këtyre organeve kryesore: Kryeshefi, Këshilli Statistikorë me grupin e ekspertëve, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim si njësi e re në kuadër të reformimit të brendshëm të ASK-së, Departamenti i Administratës, Departamenti i anketimeve dhe regjistrimeve, Departamenti i statistikave ekonomike & llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, Departamenti i statistikave sociale, dhe Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative. ASK ka 7 zyra rajonale në kuadër të Departamentit të anketimeve dhe regjistrimeve.

ASK është në proces të ristrukturimit ku janë aprovuar edhe 5 pozita të reja për të ngritur numrin total të punëtorëve në 139.

ASK mbulon pothuajse të gjithë territorin e Kosovës sipas strukturës së qarqeve statistikore si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi. Anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore dhe përfillin metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë punës së vet, ASK bashkëpunon me të gjitha institucionet qeveritare (në mënyrë të veçantë me BQK, MF, MPMS, MBPZHR, MASHT, MSH, etj) si dhe me institucionet ndërkombëtare si Eurostat, FMN, BB, SIDA, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe zyret e statistikave të shteteve në rajon.⁸⁴

ASK përballet me sfida të ndryshme, ku ndër më kryesoret janë mungesa e buxhetit dhe stafit të mjaftueshëm për të përballur kërkesat për zhvillim të mëtutjeshëm të statistikave zyrtare. Kosova qëndron më keq në këtë pikëpamje në krahasim me shtetet e

⁸³ ASK - Raporti Vjetor 2012, fq. 9-17.

⁸⁴ ASK - GDP 2004-2010, fq. 11.

rajonit të cilat kanë buxhet dhe staf më të madh (p.sh. Mali i Zi ka 200 të punësuar). Përkundër rritjes së buxhetit të Kosovës, buxheti i ASK-së tani është i ngjashëm me vitin 2002 (shih tabelën më poshtë), ndërsa kategoria e pagave është dyfishuar si pasojë e rritjes së pagave nga Qeveria, gjë që paraqet nevojën për një planifikim më të mirë buxhetor përbrenda ASK-së.

Tabela 7: Buxheti i ASK-së

Vitet	Paga dhe Mëditje	Shërbime dhe Mallra	Kapitale	Komunali	Gjithsej
2002	224,713	403,921	191,734		820,368
2003	313,596	545,404	141,000		1,000,000
2004	361,078	1,098,725	80,000	28,630	1,568,433
2005	387,533	530,000	30,000		947,533
2006	379,190	383,600		84,700	847,490
2007	373,159	197,776		49,631	620,566
2008	391,159	343,550	68,450	37,500	840,659
2009	438,331	471,525		37,500	947,356
2010	516,049	181,737	253,068	37,500	988,354
2011	540,298	232,000	0	37,500	799,299
2012	567,608	281,111	0	27,272	875,991
2013	608,798	302,000	0	37,500	948,298

Burimet: ASK bazuar në gjendjen faktike në fund të viteve kalendarike dhe Ligji i Buxhetit 2013

3. Statusi dhe sfidat

Që nga viti 1999 ish ESK ka filluar punën me ndihmë të UNMIK-ut dhe me formësimin e IPVQ-ve është sistemuar nën menaxhimin e Ministrisë së Administratës Publike, mirëpo pa e bërë ngritjen e nevojshme të kapaciteteve në nivelin e duhur për përpunimin, ekzaminimin dhe publikimin e të dhënave, ku në baza ad-hoc dhe bazuar në kërkesat e agjencive të huaja për statistika është ndihmuar nga po këto të fundit (organizatat si Eurostat, BB, EC, DIFD, SIDA, FMN, agjensionet e OKB-së, apo OJQ).⁸⁵

Me miratimin e Ligji mbi statistikat zyrtare 04/L-036 ESK pushon së ekzistuari duke

⁸⁵ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 9.

u transformuar në Agjenci të Statistikave të Kosovës (ASK) dhe bartur si funksion nën Zyrën e Kryeministrit. Me ndryshimin e statusit konsiderohet që ASK ka bërë një hap përpara dhe do jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës i cili ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm statistikor. Përkundër progresit të shënuar gjatë viteve të fundit, organizatat ndërkombëtare vlerësojnë se gjendja ekzistuese e kapaciteteve si dhe cilësia e të dhënave statistikore konsiderohet jo e nivelit të dëshiruar.⁸⁶ Jo-qëndrueshmëria e pozitive menaxheriale ku Kryeshefi ekzekutiv i ASK-së është ndërruar në mënyrë të vazhdueshme (një drejtor ka qëndruar në pozitë mesatarisht më pak se një vit) ka bartur me vete pasoja në zhvillimin institucional me vonesa dhe ndryshim të prioritetet bazuar në agjendat e Kryeshefëve të ndryshëm. Mirëpo me ligjin e ri, ASK së fundmi ka emëruar Kryeshefin e ri për mandat tre vjeçar.

Menaxhmenti i ASK-së i kushton shumë rëndësi burimeve, prodhimit dhe aspekteve teknike të prodhimit të statistikave. Nga përvoja e kaluar është vërejt se regjistrimi i popullsisë ka vështirësuar punën e ASK-në sepse të gjitha aktivitetet tjera janë ndaluar si pasojë e mungesës së resurseve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare por edhe planifikimit jo të mirë. ASK ka vuajtur nga procesi i mangët i planifikimit sepse mungon një ndarje e informatave mes departamenteve/punëtorëve në mënyrë të strukturuar, planifikimi i përbashkët (planifikimi zakonisht ndodh në formë të izoluar me vetëm disa individë të përfshirë), mekanizmat e raportimit (edhe raportimi është i mbyllur për një grup të vogël individësh), etj. Ana pozitive e kësaj është se ASK është e vetëdijshme për sfidat dhe është në kërkim të zgjidhjes së problemit⁸⁷ dhe kohëve të fundit është duke i kushtuar vëmendje të posaçme planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Gjithashtu sfidë e ASK-së mbetet mungesa e aftësisë të vazhdueshmë dhe pamundësia për të punuar me mjete themelore për përpunimin e të dhënave si STATA dhe programe tjera kompjuterike për përpunimin e të dhënave. Tjetër sfidë është mungesa e një shkollë për përgatitje superiore në statistika pranë institucioneve të arsimit të lartë që krijon vakum institucional për krijimin e kuadrove të reja si dhe pamundësia e tërheqjes së personelit të ri të shkolluar jashtë vendit për shkak të nivelit të ultë të pagave në sektorin publik. Buxheti i pamjaftueshëm bënë që ASK të fokusoj vëmendjen në çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e përditshëm pa mundur të përparoj në tërheqjen e kuadrove profesionale dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit ekzistues.⁸⁸

Në anën tjetër besueshmëria e statistikave të ASK-së është duke u përmirësuar, mirëpo cilësia është jo e nivelit të kënaqshëm karshi standardeve evropiane dhe ka nevojë përmirësimi sidomos në statistikat ekonomike. Përveç cilësisë, statistikat duhet të jenë të dobishme dhe relevante për shfrytëzuesit. Në këtë drejtim ASK ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh në ndërtimin e marrëdhënieve më të mirë me shfrytëzuesit si takime informative, seminare, ligjërata, konferenca, etj.⁸⁹ ASK mirëpret dialogun me shfrytëzuesit e

⁸⁶ DFID - Business Case and Intervention Summary.

⁸⁷ Ibid.

⁸⁸ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 10.

⁸⁹ ASK - Raporti Vjetor 2012, fq. 9.

statistikave, mirëpo ka vështirësi t'i përgjigjet kërkesave. Arsytet për mos-shfrytëzim të të dhënave përfshijnë mos-njohuria për të dhënat e publikuara, kapacitetet e ulëta analitike nga ana e shfrytëzuesve, buxheti i ulët i ASK për të prodhuar statistika cilësore, si dhe politika restriktive e ASK-së për qasje në të dhëna.⁹⁰ Gjithashtu, problematike mbetet edhe mënyra e publikimit në formatin aktual (format në Adobe PDF Reader), ndërsa, publikimi i të dhënave në formatin (MS Office Excel) do të lehtësonte në masë të madhe përdorimin.

Statistikat në Kosovë janë përmirësuar në fushën qeveritare, monetare, tregtisë së jashtme, etj dhe ASK ka filluar të përdor Sistemin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave (angl. General Data Dissemination Standard: GDSS) në prill 2011. ASK është duke përparuar në aspektin e prodhimit të statistikave si p.sh. cilësia e mostrave të anketave, mbledhja e të dhënave nga anketat, protokollet e procedimit të të dhënave,⁹¹ metodologjia dhe kalkulimet janë të sakta, është në bashkëpunim të ngushtë me Eurostat-in për përmirësim të cilësisë së llogarive ekonomike për bujqësi, etj. Statistikat e ASK-së janë përmirësuar në aspektin e besueshmërisë dhe krahasueshmërisë, dhe të njëjtat i raportohen Eurostat-it në baza të rregullta. Mirëpo vlerësohet se ASK është e paqëndrueshme pa ekspertët e huaj dhe në rast të tërheqjes së ndihmave të donatorëve ASK do të përballej me pasoja në aspektin e cilësisë (pa menduar për futjen e metodologjive të reja apo prodhimin e statistikave të reja).

3.1. Statistikat Sociale/Demografike

Kosova është e ndarë në nivel lokal dhe qendrorë të qeverisjes, prandaj edhe të dhënat demografike përgatiten kryesisht në nivel lokal dhe agregohen në nivel kombëtarë.

Departamenti i Statistikave Sociale (DSS), përbëhet nga dy divizione, divizioni i statistikave sociale dhe divizioni i statistikave të popullsisë. Qëllimi i DSS, është menaxhimi dhe prodhimi i statistikave sociale dhe të popullsisë të qëndrueshme dhe në kohë, dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Divizioni i Statistikave të Popullsisë (DSP) ka dy sektorë: Sektori i statistikave vitale dhe Sektori i statistikave të popullsisë. Sektori i statistikave vitale bënë përgatitjen, grumbullimin, analizimin dhe publikimin e statistikave vitale për: lindje, vdekje, kurorëzime dhe shkurorëzime. Sektori i statistikave të popullsisë është përgjegjës për përgatitjen, grumbullimin, klasifikimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave administrative nga fushat e migrimeve të brendshme, migrimeve të jashtme, statistikave gjinore, vlerësimet, prognozat, projeksionet e popullsisë dhe anketat e ndryshme mbi popullsinë. Statistikat më të shpeshta që publikohen nga ASK në këtë fushë janë ato të kurorëzimeve dhe shkurorëzimeve, lindjeve dhe vdekjeve, dhe gjinore.⁹²

⁹⁰ DFID - Business Case and Intervention Summary.

⁹¹ Ibid.

⁹² ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-e-popullsisë>.

ASK nuk posedon të dhëna demografike për 5 vitet e fundit të ndara në grup-mosha apo gjini sepse në anketat e viteve 2007-2011 nuk janë përfshi këto kategorizime. Deri me 2011 është përdorur një metodologji tjetër që përfshinte edhe popullatën jo-rezidente, e që nuk përputhen më të dhënat e regjistrimit të popullsisë.⁹³

Të dhënat rreth numrit të migrantëve mbliidhen nga ASK përmes anketave, ndërsa të dhënat tjera të migracionit janë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe nuk i dërgohen ASK-së sikur që kërkohet më ligjin 04/L-036 në fuqi. Ky bashkëpunim mes ASK-së dhe MPB-së ka nevojë të përmirësohet në mënyrë që ASK të ketë qasje në të dhënat e migracionit.

Sa i përket statistikave të vdekjes, vështirësia qëndron në kodifikimin e vdekjeve - rreth 25% të vdekjeve nuk raportohen fare, kurse në rreth 27% të rasteve nuk raportohen shkaqet e vdekjes (sidomos për vdekjet në shtëpi) të cilat në fund konsiderohen si vdekje të natyrshme. Të dhënat merren nga regjistri civil, mirëpo për shkak të mangësive në databazë pëson edhe cilësia e të dhënave. ASK ka përgatit projektin për digjitalizimin e regjistrimit civil, metodologjia e të cilit përmban rreth 50 pyetje në krahasim me 15 të regjistrimit të tanishëm, e që do të përmirësoj dukshëm cilësinë e të dhënave. Projekti i digjitalizimit ka ngecur për shkak të mungesës së mjeteve financiare, por pritët që kjo të realizohet kur sigurohen mjete financiare. Kjo do të ndihmonte që regjistrimi i popullsisë të bëhet në bazë të këtij sistemi dhe të tejkalohet metodologjia derë-më-derë e përdorur për regjistrimin e fundit.

Në kuadër të DSS hyn edhe Divizioni i statistikave sociale, i cili është përgjegjës për përgatitjen, planifikimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e politikave të punës, përgatit instrumente statistikore, udhëzime, definicione dhe përcakton mostrat, dhe përcjell të gjitha fazat statistikore si grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave të statistikave sociale. Divizioni i Statistikave Sociale koordinon punën me shfrytëzuesit, bashkëpunon me institucionet qeveritare, shkencore, dhe siguron krahasueshmëri të statistikave sociale me ato ndërkombëtare. Divizioni i Statistikave Sociale ka një Divizion dhe 4 sektorë: Sektori i standardit jetësor, Sektori i statistikave të tregut të punës, Sektori i statistikave të jurisprudencës, dhe Sektori i statistikave tjera sociale (statistikat e arsimit, sportit, kulturës, mirëqenies dhe shëndetësisë). DSS ka gjithsej 19 punëtor dhe vlerësohet se në planin afat mesëm ka nevojë për rritjen e numrit të stafit dhe themelimin e një Divizioni për statistika të standardit jetësor dhe të tregut të punës. DSS zhvillon Anketat e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) dhe Anketat e Fuqisë Punëtore (AFP) duke përdorur NACE Rev.2. Deri më tani ASK ka publikuar rezultatet e ABEF nga viti 2001 deri në 2011, me qëllim të ofrimit të dhënave statistikore lidhur me shpenzimet, të ardhurat, konsumin si dhe të dhënat lidhur me varfërinë. Statistikat e varfërisë përgatiten në bashkëpunim dhe sipas standardeve të Bankës Botërore; statistikat e fundit të publikuara në këtë fushë janë ato të vitit 2010. Në ABEF-in është përdorur nomenklatura COICOP, mirëpo disa kalkulime ende bëhen nga ekspertë të jashtëm

⁹³ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 109.

sepse stafi i ASK-së nuk ka kapacitete të mjaftueshme që t'i bëjë këto vet. Anketat bëhen çdo muaj me një mostër prej 200 pjesëmarrësve (2,400 në vit) ku mblidhen të dhënat për të ardhurat, shpenzimet, punësimin, etj dhe publikimi i tyre është në intervale vjetore. Cilësia e të dhënave të ABEF nuk është e nivelit të lartë, kontaktet me shfrytëzuesit janë sipas nevojës, dhe përkrahja nga Departamenti i TI-së dhe Metodologjisë është në proces të përmirësimit.⁹⁴ Për vitin 2012 është futur një variabël shtesë SILC (anketa mbi të hyrat dhe kushtet e jetesës) që do të ndihmojë në plotësimin dhe krahasimin e të dhënave me vendet tjera.⁹⁵

Statistikat e tregut të punës janë publikuar prej vitit 2002 deri me 2009. Në kuadër të sektorit të tregut të punës, zhvillohet Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) e cila nga viti 2002 deri në vitin 2009 është zhvilluar në formë klasike apo përmes pyetësorëve në muajin shtator të vitit si muaj optimal për këtë anketë. Përqindja e të punësuarve në bujqësi prej vitit 2008 është më e ulët, sepse ASK ka bërë anketat në bazë të metodologjisë së Eurostat-it e cila ka ndryshuar. Anketa nuk është bërë për vitet 2010 dhe 2011 për shkak të mungesës së mjeteve financiare, ndërsa nga viti 2012 metodologjia është ndryshuar sa i përket grumbullimit të të dhënave. AFP tani zhvillohet sipas metodës CAPI (laptop) si dhe çdo ekonomi familjare e anketuar ka edhe 3 ri-anketime. Rezultatet për AFP pritet të publikohen në maj 2013, që do të shërbejë për hartimin e Strategjisë për Punësim⁹⁶. DFID planifikon që në bazë të këtyre të dhënave të përgatis 4 publikime që kanë të bëjnë me gjininë, edukimin dhe kualifikimet, profesionet, dhe ndërlidhjen mes varfërisë dhe papunësisë.⁹⁷ Sipas anketës së vitit 2009 në Kosovë janë rreth 265,000 të punësuar⁹⁸, ndërsa një studimi të Riinvest-it në vitin 2003 në Kosovë kanë gjeneruar të hyra rreth 550,000 persona. Një pjesë e kësaj mospërputhje është për shkak se sipas Eurostat-it bujqit që nuk plasojnë produktet në treg nuk konsiderohet të punësuar, ndërsa diferenca tjetër mbetet e pashpjeguar!

Mostrat e AFP 2012 përfshijnë 600 Qarqe regjistruese (QR) ku janë anketuar dhe ri-anketuar 4,800 ekonomi familjare brenda vitit. ASK ka krijuar rrjetin e shfrytëzuesve të cilët i konsulton para se të fillojë në përgatitjen e planit operativ për vitin në vijim, me qëllim që të merren komentet dhe propozimet rreth përmirësimit të pyetësorëve. Përveç zhvillimit të AFP, ASK falë bashkëpunimit të mirë me MPMS përdor të dhëna administrative nga kjo ministri për numrin e punëkërkuësve të paraqitur në zyrat rajonale. Mirëpo të dhënat e ASK-së dhe MPMS-së dallojnë për arsye se të dhënat e MPMS nuk janë të përditësuara, duke mos përfshirë fuqinë punëtore pasive apo punëkërkuësit që tanimë janë të punësuar por nuk regjistrohen. Sidoqoftë, MPMS nuk mund të publikoj statistika zyrtare sepse kjo përgjegjësi me ligj i takon ASK-së e cila përcjell metodologjinë në përputhje me standardet e Eurostat-it.

⁹⁴ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 17.

⁹⁵ ASK - Raporti Vjetor 2012.

⁹⁶ DFID - Business Case and Intervention Summary.

⁹⁷ Ibid.

⁹⁸ Për të dhënat e fundit, ju lutem i referoheni rezultateve që do të publikohen në maj 2013.

Për statistikën e tregut të punës në ASK janë të punësuar 2 profesionist, 12 anketues të rregullt të kontraktuar nga kompanitë por monitorohen nga DSS. Konsiderohet se vetëm 2 profesionist janë të pamjaftueshëm për statistikën e fuqisë punëtore, për më tepër kur kërkohet që këto statistika të publikohen sipas kuartaleve. Sfidë tjetër në këtë drejtim mbetet edhe shkëputja e statistikave të tregut të punës me llogaritë kombëtare, të cilat duhet të jenë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën.

ASK planifikon të fillojë me hulumtime të reja (p.sh. kalimi nga shkolla në treg të punës, produktiviteti i punës, kosto e punës, etj) dhe të shpeshtojë intervalin e publikimeve (p.sh. statistikën e tregut të punës duhet publikuar çdo 3 muaj) sepse përndryshe të dhënat vjetore shpesh mund të jenë edhe të papërdorueshme. Mirëpo mungesa e stafit dhe buxhetit të mjaftueshëm bënë që ASK të ketë vështirësi në përmbushjen e kërkesave për statistika të reja dhe më të freskëta.

Statistikat e jurisprudencës janë publikuar në bazë të të dhënave të marra nga Administrata Gjyqësore e Kosovës prej vitit 2003 deri 2011 duke përfshirë lëndët e zgjidhura penale sipas gjykatave komunale dhe të qarkut, personat e akuzuar për vepra penale (gjykatat komunale dhe të qarkut), personat e dënuar për vepra penale (gjykatat komunale dhe të qarkut), dhe personat e dënuar për kundërvajtje (gjykatat komunale). Sektori i statistikave tjera sociale përfshin statistikën e arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.⁹⁹ Statistikat e kulturës janë publikuar nga viti 2004 deri në vitin 2011, ndërsa statistikën e sportit janë publikuar nga viti 2007 deri në vitin 2010 bazuar në të dhënat nga pyetësorët që përmbajnë të dhënat statistikore lidhur me aktivitetet kulturore dhe sportive si dhe numrin e të punësuarve pranë këtyre institucioneve.¹⁰⁰

Statistikat e arsimit që janë publikuar që nga viti shkollor 2002/2003 deri 2011/2012 në bazë të të dhënave të mbledhura nga pyetësorët sipas nivelit të arsimit ISDCED (parashkollor, shkollat fillore të ulëta dhe mesme, shkollat e mesme, shkollat speciale), ndërsa grumbullimi i të dhënave statistikore për universitet bëhet nga administrata e Universitetit të Prishtinës dhe atë të Prizrenit. MASHT është përgjegjës për sistemin EMIS i cili përmban të dhëna që kanë të bëjnë me sektorin e arsimit të ndara në rajone, shkolla, grup-mosha, gjini, etni, etj, dhe ASK do të kyçet në këtë sistem kur ky të ketë mbulueshmëri të duhur. DSS ka bashkëpunuar me MASHT përmes një grupi specifik punues dhe është përgatitur dokumenti me pyetje që do të përmbajë sistemin. Të dhënat regjistrohen në nivel të shkollave në komuna dhe i përcillen MASHT-it, i cili i analizon dhe publikon në raportet e rregullta vjetore. Vlen të përmendet se të dhënat për institucionet private arsimore, sidomos ato universitare, janë të mangëta dhe nuk ekziston një pasqyrë e saktë e gjendjes në këtë fushë.

Statistikat shëndetësore janë publikuar që nga vitet 2003 e deri me 2011 ku janë përdorur të dhënat e sektorit publik shëndetësor nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë dhe in-

⁹⁹ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-sociale>.

¹⁰⁰ Ibid.

stitucioneve publike shëndetësore në të gjitha nivelet.¹⁰¹ Sistemi i informimit shëndetësor (SISH) është themeluar me 2002 dhe është i rregulluar sipas ligjit për shëndetësi 04-2004. Strategjia e Shëndetësisë 2010-2014 e sheh SISH si shumë të rëndësishme, dhe në këtë drejtim janë edhe Strategjia SISH 2010-2020, Strategjia për E-qeverisje, si dhe udhëzimi administrativ 18/2006 mbi bazën e të dhënave për statistika shëndetësore. Institucionet përgjegjëse në këtë fushë janë: MSH për zhvillimin e politikave, MAP për qasje të institucioneve shëndetësore në rrjetin e Qeverisë, Qendra e Referimit IKSHPK për analizën e të dhënave, dhe ASK për publikimin e statistikave shëndetësore. Sistemi i regjistrimit të të dhënave është i gjysmë-kompjuterizuar, i pa-centralizuar, dhe të dhënat janë të cilësisë së ulët. Prandaj MSH me Strategjinë SISH deri me 2020 parasheh të finalizoj avancimin e sistemit – të përmirësoj mbledhjen e të dhënave përmes konsolidimit të moduleve të statistikave shëndetësore, farmaceutike dhe ato të burimeve njerëzore për planifikim më të mirë dhe prodhim të dhënave më cilësore. Në këtë drejtim MSH është duke e themeluar një departament të veçantë dhe duke e rritur numrin e stafit për funksionalizimin e sistemit. Faza e parë e konsolidimit ka përfunduar ku rreth 40% të institucioneve publike shëndetësore janë pjesë e sistemit (rajoni i Prishtinës dhe Prizrenit). Faza e dytë pritet të gjeneroj raporte në përputhje me standardet e Eurostat-it (Direktivat 2002/22/EC, 2002/58/EC, Rregullorja (EC) no. 2006/2004 dhe EpSOS) dhe OBSH-së.¹⁰² ASK me përkrahje nga UNFPA dhe në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtarë të Shëndetësisë ka analizuar arsyet e vdekjeve në Kosovë gjatë viteve 2006-2009.¹⁰³

Statistikat e mirëqenies sociale janë publikuar që nga viti 2003 deri në 2011 duke shfrytëzuar të dhënat nga departamentet përkatëse nga MPMS, Shtëpia e pleqve, institucioni i Shtimes për nevoja speciale si dhe Shtëpia e fëmijëve të braktisur.¹⁰⁴ Të dhënat sociale janë kryesisht të vendosura në baza të të dhënave në institucionet qendrore dhe lokale që ofrojnë shërbime sociale si MPMS, komunat, etj. Publikimi i të dhënave statistikore të mirëqenies sociale bëhet në baza kuartale që nga viti 2012. Menaxhimi i të dhënave bëhet sipas rregulloreve në fuqi që fillojnë nga regjistrimi i përfituesve e deri te analizimi i tyre nga MPMS, dhe në fund ndahen me ASK. Përgjegjës kryesorë për menaxhimin e këtyre të dhënave është MPMS e cila përmes departamenteve të ndryshme i përditëson, shpërndan dhe proceson ato. Për t'i integruar bazat e ndryshme të të dhënave, MPMS gjatë dy viteve të fundit ka krijuar një softuare të bazuar në ueb, i cili do të ndihmoj në komunikim dhe shkëmbim më të lehtë si dhe vendimmarrje më të informuar.¹⁰⁵

¹⁰¹ Ibid.

¹⁰² Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 371-373.

¹⁰³ Ibid, fq. 375.

¹⁰⁴ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-sociale>.

¹⁰⁵ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 361.

3.2. Regjistrimi i popullsisë

Regjistrimi i popullsisë është zbatuar sipas planeve, me përjashtim të mospjesëmarrjes së popullatës në veri të Kosovës. Rezultatet finale të regjistrimit të popullsisë janë bërë në shtator 2012. Të dhënat janë në formë të shtypur dhe elektronike të publikuara në ueb faqen e ASK-së, duke përfshirë indikatorët sipas etniteteve, gjinisë, moshës, rajoneve, etj, të cilat mund të shkarkohen dhe shfrytëzohen në forma të ndryshme. Databaza e regjistrimit të popullsisë është nën përgjegjësinë e ASK-së dhe nuk është publike, por të dhënat mund të ofrohen në bazë të kërkesave të veçanta. Përndryshe legjislacioni në fuqi nuk lejon qasje të drejtpërdrejt në databazë, por ASK ka publikuar më shumë indikatorë në krahasim me vendet e rajonit (p.sh. Kroacia ka publikuar vetëm 10 indikatorë). Këto të dhëna janë për t'u shfrytëzuar vetëm për politik-bërësit për qëllime planifikimi, institucionet shtetërore, hulumtuesit, analistët, bizneset, shkencëtarët dhe shfrytëzuesit e tjerë. Regjistrimi i popullsisë nuk ka pasur për qëllim të zëvendësoj regjistrin civil. Bazuar në ligjin mbi statistikat zyrtare, ASK do të paraqes planet që në bashkëpunim me institucionet tjera relevante të bëjë harmonizimin e regjistrave si dhe azhurnimin e vazhdueshëm të regjistri të popullsisë. Përveç kësaj ASK planifikon të lidh bazën e të dhënave me GIS dhe ndarjen sipas NUTS kriterëve si dhe publikimin e 13 raporteve tjera.¹⁰⁶ Përkundër disa reagimeve (sidomos të organizatave buxhetore që marrin buxhetin në bazë të numrit të banorëve) rezultatet e regjistrimit të popullsisë paraqesin gjendjen reale të popullsisë rezidente në Kosovë dhe si të tilla janë pranuar nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. Gjatë këtij procesi janë regjistruar ndërtesat, banesat, ekonomitë familjare dhe individët përmes anketimeve në tërë Kosovën (metodologjia klasike e regjistrimit - në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it) prej 1 deri më 15 prill 2011.

3.3. Statistikat ekonomike

Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare (DSELLK) është përgjegjës për Llogaritë Kombëtare, statistikat e çmimeve, statistikat e tregtisë së jashtme dhe statistikat e ndërmarrjeve me regjistrin statistikor të ndërmarrjeve. DSELLK përgatit anketa, mbledh dhe kontrollon kualitetin e të dhënave, analizon dhe bënë publikimin e tyre në baza mujore për publikimet të veçanta (çmimet e konsumit, eksport-import, prodhimi dhe konsumi i energjisë elektrike, prodhimi i thëngjillit, transporti dhe post-telekomunikimi, regjistrimi i automjeteve, hoteleri), në baza tremujore dhe vjetore (çmimet e prodhimit, çmimet e importit, Llogaritë Kombëtare, Llogarite Qeveritare dhe Anketa strukturore e Ndërmarrjeve).¹⁰⁷ DSELLK ka 17 punonjës: 5 për llogaritë kombëtare (tre herë më pak në krahasim me shtetet në rajon, të cilat këtë aspekt të statistikave e kanë të organizuar si departament në vete), 5 për çmimet, 1 për tregti të jashtme dhe 6 për statistika biznesore.

Mungesa e resurseve njerëzore dhe angazhimi i stafit në regjistrimin e popullsisë ka

¹⁰⁶ ASK - Raporti Vjetor 2012.

¹⁰⁷ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-ekonomike/rreth-departamentit>.

shkaktuar vonesa sidomos në publikimin e statistikave ekonomike. Megjithatë janë bërë disa përmirësime në statistika që kanë të bëjnë me formimin e bruto kapitalit fiks, kalkulimin e amortizimit të aseteve qeveritare dhe të OJQ-ve, krijimin e vlerës së shtuar në aktivitetet e transportit dhe hotelerisë. Por për të përmirësuar edhe më tej indikatorët ekonomik, ka nevojë të përmirësohen burimet e të dhënave (anketa e bizneseve, anketa e ekonomive familjare, anketa e bujqësisë, anketa e fuqisë punëtore, organizimi i anketave tjera afat-shkurtra si dhe përmirësimi i të dhënave administrative).¹⁰⁸ Llogaritë Kombëtare përfshijnë kalkulimin e BPV sipas shpenzimeve dhe sipas aktiviteteve ekonomike, si dhe Llogaritë Qeveritare. Analiza dhe përpilimi i Llogarive Kombëtare është bërë sipas metodologjisë ESA95 dhe SNA93 me çmime aktuale dhe konstante për vitet 2006-2011. Burim i të dhënave për publikimet e Llogarive Kombëtare janë institucionet financiare (BQK); institucionet jo financiare (ASK - anketa strukturore e ndërmarrjeve), Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe kompanitë për prodhimin e materialit ndërtimor; Trusti; institucionet qeveritare (MF - Thesari, Tatimi në Pronë, Buxheti i Kosovës - të hyrat dhe shpenzimet, Doganat, MPB - Regjistrimi i Automjeteve); Ekonomike Shtëpiake (Anketa e Buxhetit Familjar); Organizatat jo-profitabile (MAP - të dhënat për OJQ, OSBE për partitë politike), etj.¹⁰⁹ ASK ka publikuar statistikën e BPV-së me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante (çmime të vitit paraprak) për vitet 2004-2011, me qasjen e prodhimit sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale dhe konstante për vitet 2006-2011, dhe sipas sektorëve/industrive për vitet 2007-2011. Objektivi i ASK-së është që të rris cilësinë përmes përmirësimit të mostrave, të rris produktet statistikore (anketa tremujore për industrinë prodhuese, ndërtimtari dhe çmimet e ndërtimit, etj) dhe të shpreshtoj publikimin e statistikave (BPV të publikohet çdo 3 muaj sipas shpenzimeve dhe prodhimit). Mirëpo arritja e këtij objektivi me këtë nivel të stafit është e vështirë. Për më tepër kapacitetet absorbuese të stafit ekzistues janë të limituara. Llogaritë Qeveritare përfshijnë financat qeveritare dhe përpilohen në baza vjetore bazuar në pajtueshmëri me ESA 95 dhe Manualit të FMN duke i ndarë në kategoritë e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare për nivelin qendror dhe atë lokal. Deri më tani ASK ka publikuar statistikën e llogarive qeveritare prej 2002 deri 2011.¹¹⁰

Është shënuar progres në llogaritë kombëtare, sidomos në aspektin e cilësisë së të dhënave të BPV-së sipas shpenzimeve, dhe ASK planifikon aktivitetet për metodologjinë e re SNA 2008 dhe ESA2010 si dhe për përpilimin e BPV në baza tremujore.¹¹¹ BPV sipas të ardhurave nuk llogaritet nga ASK për shkak të mungesës së burimeve të të dhënave reale dhe mungesës së stafit për këtë punë.

Statistikat e Çmimeve përfshijnë kalkulimin e indekseve të çmimeve të konsumit (IÇK), indekseve të çmimeve të prodhimit (IÇP), indekseve të çmimeve të importit (IÇIMP), dhe paritetin e fuqisë blerëse. IÇK është i ndërtuar sipas metodologjive dhe standar-

¹⁰⁸ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 245.

¹⁰⁹ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-ekonomike/llogarite-kombetare>.

¹¹⁰ ASK - Raporti Vjetor 2012.

¹¹¹ Ibid.

deve evropiane dhe publikohet në baza mujore deri në 15 ditë pas periudhës referuese dhe në intervale vjetore 175 ditë pas periudhës referuese. ASK përcjell çmimet e konsumit që nga maji 2002 dhe për çdo muaj publikon: indeksin mujor me bazë muajin maj 2002=100, ndryshimet mujore në % - muaji vijues me muajin paraprak, ndryshimet vjetore në %- muaji i vitit aktual me muajin e njëjtë të vitit paraprak si dhe mesatarja vjetore në %. Gjithashtu publikohen edhe çmimet mesatare për disa artikuj dhe shërbime më reprezentuese. ASK ka publikuar dhe tetë publikime në baza vjetore (2004 - 2011).¹¹² Por të dhënat janë në formatin Excel që është i pasigurt për rruajtjen dhe analizimin e të dhënave. ASK me ndihmën e SIDA-s nga janari 2013 ka filluar të zhvilloj një platformë të re për IÇK me tri module për: i) futjen e të dhënave, ii) rruajtjen dhe analizimin, dhe iii) prezantim të të dhënave (një vit kjo platformë do të jetë vetëm testuese).¹¹³

IÇP është publikuar që nga maji 2009 në baza tremujore 85 ditë pas periudhës referuese. Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese me ndikim në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor i referohen vitit 2007, ndërsa nga tremujori i parë i vitit 2008, është duke u bërë monitorimi dhe llogaritja e indeksit në vazhdimësi, në periudha tremujore dhe vjetore. IÇP është në përputhshmëri me Klasifikimin Standard të Veprimtarive sipas NACE rev.1. IÇIMP ka filluar të publikohet në qershor 2009 në baza tremujore 85 ditë pas periudhës referuese. Çmimet e importit filluan të mbledhen në fillim të 2006 në bazë tremujore dhe mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit për periudhën relevante. Publikimet përmbajnë tabelën e IÇIMP në Kosovë në bazë tremujore, mesataren vjetore për 2006-2011 (2008 = 100) me ndryshime tremujore dhe vjetore në përqindje, si dhe ndryshimet tremujore dhe ndryshimet vjetore për sektorët sipas Sistemit të Harmonizuar. IÇIMP përgatitet në përputhje me standardet dhe metodologjitë evropiane në bashkëpunim me ekspertët nga Statistikat e Suedisë. IÇIMP është në zhvillim e sipër dhe në të ardhmen do të shtohen më shumë vrojtme të çmimeve.¹¹⁴

Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit pritet të publikohet në fillim të vitit 2014. ASK nuk ka bërë asnjë publikim lidhur me Paritetin e fuqisë blerëse. Një pilot anketë e ASK-së ka filluar në vitin 2009 si pjesë e Programit Evropian Krahasues dhe është në vijim e sipër. Ndërsa ASK ka përgatitur Indeksin e Nivelit të Çmimeve për ushqim, pije dhe duhan për vitin 2009.¹¹⁵ Një projekt i ri në mbështetje të SIDA ka filluar për Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN), publikimi pritet në tremujorin e parë 2014. Përmirësimi i cilësisë për statistikave të çmimeve është proces i vazhdueshëm i varur nga mungesa e stafit dhe kapacitetet e ulëta të ASK-së.¹¹⁶

Shfrytëzuesit e rëndësishëm të statistikave (MF, BQK, FMN, BB, etj) tregojnë se ka

¹¹² ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-ekonomike/rreth-departamentit>.

¹¹³ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, p. 15.

¹¹⁴ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-ekonomike/rreth-departamentit>.

¹¹⁵ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 108-109.

¹¹⁶ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 15.

përmirësim të statistikave, mirëpo ato ende kanë nevojë të përmirësohen në aspektin kualitativ dhe mbulueshmërisë. Në anën tjetër duhet pasur parasysh se kualiteti i të dhënave varet edhe nga institucionet tjera si p.sh. doganat për statistikat e tregtisë së jashtme.¹¹⁷

Statistikat e tregtisë së jashtme kanë të bëjnë me eksportin dhe importin e Kosovës. Burimet e të dhënave janë Doganat e Kosovës dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) për energji elektrike. Shqetësuese për statistikat e tregtisë është se që nga shtatori 2012, ASK nuk përfshinë të dhënat e KEK-ut në statistikat e tregtisë duke bërë që seria kohore të ndërpritet dhe të humbë krahasueshmëria e të dhënave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që raportet ndërinsticionale të ndërtohen dhe përmirësohen. Të dhënat e tregtisë së jashtme merren në baza mujore, ndërsa publikimet kanë filluar nga janari i vitit 2001 në baza gjashtëmujore deri në mars 2005, dhe më pastaj në baza mujore 45 ditë pas periudhës referuese dhe vjetore 6 muaj pas periudhës referuese. Të dhëna përfshijnë eksportin dhe importin sipas procedurave statistikore, eksportin dhe importin sipas klasifikimit ndërkombëtarë KSTJ (SITC), eksportin dhe importin sipas sioneve, kapitujve, vendeve dhe pikave kufitare.¹¹⁸ Në intervale tremujore publikohen Statistikat e Hotelerisë (75 ditë pas periudhës referuese), Bilanci i Energjisë në Kosovë (80 ditë pas periudhës referuese), Repertori i ndërmarrjeve në Kosovë (45 ditë pas periudhës referuese) dhe Statistikat e transportit (45 ditë pas periudhës referuese). Përveç kësaj ASK ka publikuar rezultatet e anketës strukturore të ndërmarrjeve për periudhën 2008 -2010 (15 muaj pas periudhës referuese) dhe rezultatet për vitin 2011 (13 muaj pas periudhës referuese) dhe është në proces të përgatitjes së një ueb platforme për shpërndarjen e këtyre statistikave të cilat shfrytëzuesit mund t'i shkarkojnë dhe krijojnë tabela sipas nevojës. Sa i përket statistikave të tregtisë, përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga sektori i tregtisë është edhe Divizioni i Politikave të Tregtisë në kuadër të MTI-së.¹¹⁹ Negociatat për pjesën e tregtisë së lirë me BE udhëhiqen nga MTI, ku në nën-grupet ndër të tjera janë të përfshirë edhe ASK, BQK, MBPZHR, dhe MF si institucione përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore. Për më tepër, është themeluar një Komiteti i statistikave të tregtisë së jashtme i cili merret me statistikat e importit/eksportit.¹²⁰ MTI përballet me mungesë të statistikave më të avancuara për negociimin e MSA-së, të cilak ASK nuk mund t'i prodhoj për shkak të mungesës së stafit. Statistikat e ndërmarrjeve dhe regjistri statistikor i ndërmarrjeve në vitin 2001 kanë përcaktuar për biznese kodin unik të aktiviteteve sipas NACE Rev. 1 dhe ka përcaktuar numrin unik identifikues për biznesin e regjistruar. Nga Janari 2003 MTI, përkatësisht Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), ka marrë përgjegjësinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë dhe tani sistemi është i decentralizuar në nivel të komunave.¹²¹

¹¹⁷ Ibid, fq. 15-16.

¹¹⁸ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-ekonomike/export-importi>.

¹¹⁹ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 179.

¹²⁰ Ibid, fq. 247.

¹²¹ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-ekonomike/regjistri-i-bizneseve>.

Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB) funksionon në kuadër të ASK-së dhe përmban të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës. RSB është ndërtuar duke u bazuar në Rregulloren 2001/14 për statistika zyrtare dhe Rregulloren e Komisionit Evropian (KE) Nr 177/2008 mbi ndërtimin e Regjistrimit të Bizneseve për qëllime statistikore për përgatitjen dhe koordinimin e hulumtimeve, për analizat statistikore të popullsisë dhe demografisë së bizneseve, për përdorimin e të dhënave administrative, për identifikimin dhe ndërtimin e njësive statistikore, etj. RSB bazohet në të dhënat administrative që merren nga ARBK, ATK dhe në hulumtimet statistikore që kryhen nga ASK (hotelieri, anketa strukturore e ndërmarrjeve, etj), dhe nuk përmban Administratën Publike, Organizatat jo-fitimprurëse e as Organizatat Ndërkombëtare. Për shkak të mos azhurnimit të regjistrimit të bizneseve të dhënat mbesin të pasakta, kurse analiza e të dhënave nga anketat a ASK-së merr shumë kohë të gjatë dhe prandaj publikimet vonohen. Në anën tjetër bizneset janë të obliguara sipas ligjit për shoqëritë tregtare të dërgojnë pasqyrat financiare në MTI dhe Këshillin Kombëtarë për Raportim Financiar, por kjo nuk zbatohet në praktikë dhe MTI nuk aplikon ndëshkimet, prandaj statistikatat mbesin të pjesërishtme. Në regjistrin e bizneseve figurojnë rreth 100,000 biznese, ndërsa ATK nga viti 2009 ka lëshuar rreth 65,000 numra fiskal (53,000 për biznese dhe 12,000 për persona fiskal), dhe ky dallim i madh duhet korrigjuar. Përmes qasjes one-stop-shop nga viti i kaluar asnjë biznes nuk mund të regjistrohet pa marrë nga ATK paraprakisht një dokument rreth së kaluarës së personit. Përveç kësaj ATK viziton biznesin 5 ditë pas regjistrimit të biznesit për t'u siguruar se biznesi ekziston në realitet. Për të ndihmuar këtë proces, rekomandohet që para regjistrimit të biznesit të dhënat personale të verifikohen te noteri për t'u siguruar se nuk kemi të bëjmë me biznes fantom. Variablat kryesore në RSB azhurnohen dhe grupohen në variablat e identifikimit (NRB, forma ligjore, pronësia, emri, adresa, komunikimi, etj.); variablat shtresorë (aktiviteti ekonomik kryesor, madhësia sipas të punësuarve, vendndodhja gjeografike), variablat demografik (data e krijimit, data e mbarimit-shuarjes), variablat e vlerës së qarkullimit (vlera e qarkullimit gjatë vitit të ndërmarrjeve aktive, numri mesatare i të punësuarve gjatë vitit për ndërmarrjet aktive). ASK ka publikuar katër botime të Pasqyrës Statistikore të Bizneseve të Regjistruara në Kosovë prej 2001 deri me mars 2003, pastaj në baza mujore dhe tremujore tregues për transportin, post telekomunikimin, numrin e automjeteve të regjistruara, etj.¹²²

ASK planifikon të azhurnoj regjistrin e bizneseve me njësitë lokale, grupin e ndërmarrjeve dhe ka filluar të punoj në kalimin nga NACE Rev.1 në NACE Rev.2 sipas kërkesave të Eurostat-it, i cili besohet se do të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve. Është marrë vendim që kur të filloj regjistrimi i bizneseve të reja me NACE Rev.2 (planifikuar të filloj në 2014), atëherë ASK bashkë me ARBK do të bëjnë kalimin me tabela korresponduese në NACE Rev.2. Për pjesën tjetër të ndërmarrjeve që nuk mund të kalojnë automatikisht me tabela korresponduese është duke u bërë një regjistrim i drejtpërdrejt nëpër biznese. Ndërsa ASK nga viti 2010 në anketën e biznesit për vitin referues 2009 ka filluar të aplikoj kode të dyfishta (NACE Rev.1 dhe NACE Rev.2) dhe ka vazhduar në anketën e vitit referues 2010 dhe 2011, mirëpo asnjë publikim nuk është bërë në NACE Rev.2 për shkak të kornizës së mostrës që nuk ka qenë në NACE

¹²² Ibid.

Rev.2.¹²³ Përveç kësaj ASK planifikon që të bëjë regjistrimin e përgjithshëm të ndërmarrjeve (pjesën jo-bujqësore) në vitin 2016. Kurse për të përafuar statistikat e biznesit më standardet evropiane ASK ka ndërmarrë masat në vijim: i) pyetësi për Anketën e strukturuar të ndërmarrjeve për vitin 2011 është përmirësuar sipas rekomandimeve të ekspertëve dhe rregulloreve për statistika strukturore të ndërmarrjeve, ii) janë mbajtur takime me Zyret rajonale për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave, dhe iii) janë identifikuar dhe eliminuar paqartësitë në pyetësorë për anketën tremujorëshe për industri dhe ndërtim.¹²⁴

3.4. Statistikat monetare financiare dhe të sektorit të jashtëm

Bazuar në Ligjin 03/L-074 BQK është përgjegjëse për përpilimin dhe publikimin e statistikave monetare financiare dhe statistikave të sektorit të jashtëm (bilanci i pagesave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, borxhi i jashtëm). BQK ka 10 të punësuar në Departamentin e statistikave. Për përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësive, Bordi i BQK-së është përqendruar në kompletimin e kornizës ligjore duke miratuar Rregulloren për Plotësimin e Rregullës bankare XVI, Rregulloren mbi Statistikat Monetare – Financiare dhe Llogaritë Financiare, Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, dhe Rregulloren mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave, etj.¹²⁵

Statistikat monetare financiare përfshijnë statistikat e BQK-së, korporatave tjera depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, ndërmjetësve tjerë financiar, dhe ndihmësve financiar. Statistikat monetare dhe financiare përpilohen dhe publikohen bazuar në standardet ndërkombëtare, respektivisht bazuar në Manualin e Statistikave Monetare dhe Financiare (FMN 2000), Udhëzuesin e Përpilimit të Statistikave Monetare dhe Financiare (FMN 2008), Manualin mbi Normat e Interesit të Bankave Komerçiale (ECB 2003), Sistemin i Llogarive Kombëtare (edicionet SNA 93 dhe SNA 2008), dhe Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Regionale (ESA 95).¹²⁶

BQK është bartëse lidhur me Standardin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave (GDDS) që nga prilli 2011 kur ka filluar ky sistem të përdoret në Kosovë. Gjatë vitit 2011 BQK ka përgatitur disa projekte statistikore të cilat kanë filluar të zbatohen në 2012, si Raporti Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare, Raporti mbi Normat e Kamatës së Institucioneve Mikrofinanciare si dhe Raporti Statistikor mbi Agjencitë për Transferimin e Parave. Me këtë është shkurtuar frekuenca e raportimit nga tremujore në raportime mujore.¹²⁷ Në prill 2012 BQK për herë të parë ka publikuar statistika mbi Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare dhe borxhit të jashtëm të Kosovës, të cilat përmbajnë asetet

¹²³ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 246.

¹²⁴ Ibid, fq. 245.

¹²⁵ BQK - Raporti vjetor 2011, fq. 21.

¹²⁶ BQK - Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare, V2.0, fq. 5.

¹²⁷ BQK- Raporti vjetor 2011, fq. 125.

dhe detyrimet e rezidentëve kosovar ndaj jorezidentëve dhe përfshijnë periudhën statistikore që nga viti 2007 në baza vjetore, ndërsa që nga viti 2012 në baza tremujore. BQK përpilon edhe Pasqyrën e Harmonizuar të Investimeve Direkte, Pasqyrën e Harmonizuar të Investimeve Portfolio, ndërsa statistikat mbi importin/eksportin e mallrave BQK i ka publikuar deri në janar 2012, ndërsa që nga janari, nuk i publikon më si rezultat i kërkesës së ASK-së konform publikuesit zyrtar të statistikave të tregtisë së jashtme. Të dhënat rreth IHD-ve mblidhen përmes anketave të drejtpërdrejta me kompanitë e huaja në Kosovë në bazë të regjistrit të bizneseve dhe përmes transaksioneve bankare. Të dhënat për dërgesat e emigrantëve mblidhen përmes transaksioneve bankare në bazë të përshkrimit të transaksionit dhe institucioneve mikrofinanciare dhe nga deklaratimet në polici (rreth 20% të të dhënave). Përveç këtyre burimeve, BQK shfrytëzon edhe burime tjera si anketat e realizuara në vend, tërheqjet nga ATM-të në vend gjatë periudhave me sezonalitet të shtuar etj. Statistikat e sektorit bankar publikohen nga BQK prej vitit 2000, ndërsa ato të sigurimeve prej vitit 2004 në bazë tremujore.

Gjatë vitit 2010 janë implementuar versionet e reja të Raportit Statistikor Bankar (RSB), Raportit mbi Normat e Kamatës (RNK) dhe Sistemit të Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN). Implementimi i versioneve të reja të këtyre projekteve statistikore ka qenë në funksion të përcjelljes të zhvillimeve në tregun bankar në Kosovë konsistent me standardet ndërkombëtare statistikore.¹²⁸

BQK ka rritur frekuencën e publikimit të statistikave të sektorit të jashtëm duke publikuar bilancin e pagesave në baza tremujore, e të cilat hyjnë në kuadër të publikimeve siç janë International Financial Statistics dhe Balance of Payments Statistical Yearbook.¹²⁹

Statistikat e BQK-së janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të statistikave të FMN-së, Bankë Qendrore Evropiane dhe Eurostat-in. Aplikimi i këtyre standardeve siguron një rregullsi dhe pajtueshmëri të statistikave të Kosovës me vendet tjera. Hapat që ka ndërmarrë BQK në këtë drejtim dhe ka përmirësuar besueshmërinë, rregullsinë dhe pajtueshmërinë janë: i) publikimi i metodologjisë, publikimi i kalendarit dhe respektimi i tij, iii) njoftimi rreth revidimit të statistikave, dhe iv) transparenca e publikimit të statistikave.¹³⁰ Që nga gushti 2010 BQK ka raportuar në FMN statistika monetare dhe financiare dhe të bilancit të pagesave që kanë të bëjnë me monitorimin e programit 'Stand-By'¹³¹ por edhe në kuadër të disa publikimeve si International Financial Statistics, Balance of Payments Statistical Yearbook, Financial Access Survey dhe Global Financial Stability Report.¹³² Gjatë vitit 2011 BQK për herë të parë ka filluar me raportimin në Eurostat të indikatorëve statistikor nga fusha e bilancit të pagesave.¹³³

¹²⁸ BQK - Raporti Vjetor 2010, fq. 89-90.

¹²⁹ Ibid.

¹³⁰ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 247.

¹³¹ BQK - Raporti Vjetor 2010, fq. 90.

¹³² BQK - Raporti vjetor 2011, fq. 125.

¹³³ Ibid, fq. 126.

Kapacitetet statistikore të BQK-së janë ngritur dukshëm dhe që nga viti 2010 stafi i Departamentit të Statistikave të BQK-së është përfshirë në listën e ekspertëve të FMN-së për statistika monetare dhe financiare, dhe kjo bënë BQK-në jo vetëm pranuese por edhe ofruese e asistencës teknike për vendet tjera.¹³⁴ Gjatë vitit 2011 Drejtori i DS, ka kryer misionin e tij të parë në cilësinë e ekspertit për statistika monetare dhe financiare të FMN-së në Bankën Qendrore të Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa gjatë vitit 2012 ka kryer me sukses edhe dy misione tjera në Bankën Qendrore të Trinidadit dhe Tobagos. Udhëheqësi i Divizionit për Bilancin e Pagesave në BQK është pranuar në listën e ekspertëve të FMN-së lidhur me statistikat e bilancit të pagesave¹³⁵ dhe me 2012 ka kryer me sukses misionin e tij të parë në Bankën Qendrore të Botsvanës. Në anën tjetër ndër sfidat kryesore mbetet përpilimi i statistikave të kompanive jofinanciare të sektorit real (BQK nuk është bartës zyrtar), të cilat do të ndihmonin shumë në përpilimin më të saktë të llogarisë financiare në kuadër të statistikave të bilancit të pagesave. Poashtu harmonizimi dhe koordinimi duhet përmirësuar në mënyrë që statistikat të publikohen vetëm nga ASK, MF dhe BQK (institucionet tjera mund të mbledhin të dhëna dhe të përpilojnë statistika, por jo të publikojnë ato) dhe të evitohet publikimi i indikatorëve të dyfishtë që nuk përputhen.

- *Publikimet e rregullta të BQK-së dhe statistikat tjera*

Drejtorja për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike (DSFAE) në BQK gjatë vitit 2010 ka publikuar numrin e parë të Raportit të Stabilitetit Financiar, i cili paraqet një vazhdimësi të Buletinit të Sektorit Financiar, por që ofron pasqyrë më të kompletuar të stabilitetit të sektorit financiar në vend. Publikimi i raportit të stabilitetit financiar bëhet në bazë të rregullt kohore dhe është vlerësuar nga institucionet ndërkombëtare si njëri ndër raportet më të mira në vendet e rajonit. DSFAE ka përpiluar rregullisht vlerësimet tremujore në kuadër të Buletinit Mujor Statistikor, ndërsa që nga kuartali i katërt i vitit 2012, DSFAE ka zëvendësuar këtë me Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë. Burimet kryesore të të dhënave për këto publikime janë Seritë Kohore të BQK-së që paraqesin publikimet kryesore statistikore si statistikat monetare dhe financiare dhe ato të bilancit të pagesave.¹³⁶ Për shfrytëzim të brendshëm BQK gjithashtu përpilon Indikatorët të Paralajmërimit të Hershëm (IPH) i cili përpilohet në baza mujore për identifikimin e rreziqeve të mundshme për ekonominë e vendit.¹³⁷ Meqë Kosova përdor euron si valutë zyrtare, është vështirë të përcillen transaksionet jashtë sistemit bankar e që shkaktojnë gabime dhe lëshime të vazhdueshme.¹³⁸

BQK ka përpiluar Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave e cila është e strukturuar në nëntë shtylla kryesore: i) korniza ligjore, ii) pagesat me vlera të mëdha dhe ato urgjente, iii) pagesat me vlera të vogla, iv) transaksionet qeveritare, v) letrat me

¹³⁴ BQK - Raporti Vjetor 2010, fq. 89.

¹³⁵ BQK - Raporti Vjetor 2011, fq. 126.

¹³⁶ BQK - Raporti Vjetor 2010, fq. 90.

¹³⁷ Ibid, fq. 89-90

¹³⁸ FMN - Republic of Kosovo: Request for Stand-By Arrangement – Informational Annex, 12 April 2012, fq. 7.

vlerë, vi) tregu monetar, vii) dërgesat nga jashtë, viii) mbikëqyrja e sistemit të pagesave dhe ix) bashkëpunimi dhe koordinimi mes akterëve të pagesave. Në fushën e monitorimit të sistemit të pagesave (shtylla vii). Rregullorja e re e statistikave për instrumente të pagesave dhe harmonizimi i Metodologjisë për Raportimin e Instrumenteve të Pagesave mundësojnë: i) grumbullimin dhe përsosjen e përpunimit të të dhënave periodike si dhe mirëmbajtjen efikase të bazës së të dhënave mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë, ii) monitorimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave në mënyrë që të vlerësohet shkalla e rreziqeve që përmbajnë këto dhe të sigurohet transparenca në marrëveshjet që kanë të bëjnë me instrumentet e shërbimet e pagesave, iii) përmirësimin e cilësisë së raporteve, analizave dhe publikimeve mbi instrumentet e pagesave në pajtim me raportet nga Banka Qendrore Evropiane, iv) analizimin e zhvillimeve në sferën e instrumenteve të pagesave në Kosovë karshi shteteve në EJQ.

BQK së bashku me Policinë e Kosovës dhe Laboratorin e Forenzikës publikon statistikën mbi kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara në nivel të Kosovës.¹³⁹

Publikimet e BQK-së nuk thirren vetëm në informata nga bazat e të dhënave, por BQK kryen edhe anketa për të plotësuar pasqyrën rreth gjendjes ekonomike në vend; p.sh. BQK ka bërë anketë mbi kreditimin bankar me bankat që operojnë në Kosovë. Rezultatet e anketës janë publikuar në përputhje me parimet ndërkombëtare duke mbrojtur konfidencialitetin e bankave individuale të cilat janë përgjigjur në anketë.¹⁴⁰

Publikimet e rregullta analitike të BQK-së janë:

- 1) Raporti Vjetor i BQK-së
- 2) Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë
- 3) Raporti i Stabilitetit Financiar (frekuencë vjetore)
- 4) Raporti i Bilancit të Pagesave (frekuencë vjetore)

3.5. Statistikat e bujqësisë dhe mjedisit

Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit i ASK-së përbëhet prej dy sektorëve: Sektori i statistikave të bujqësisë dhe Sektori i statistikave të Mjedisit. Departamenti është i koncentruar në tri fusha kryesore: statistikën e bujqësisë, statistikën agro-monetare dhe statistikën e mjedisit.¹⁴¹

Në zhvillimin e statistikave bujqësore në Kosovë, ASK ka bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). MBPZHR, respektivisht Departamenti i Politikave Zhvillimore dhe Statistikave (DPZHS) është përgjegjëse për politikën dhe statistikën bujqësore administrative. Mirëpo ASK është përgjegjëse për përcaktimin e metodave, klasifikimit dhe standardeve për përdorim të institucioneve

¹³⁹ BQK - Raporti vjetor 2011, fq. 107.

¹⁴⁰ Raporti i Stabilitetit Financiar Numër 2, fq. 83.

¹⁴¹ ASK - <http://esk.rks-gov.net/statistikat-e-bujqesise>.

tjera sipas programit për statistika zyrtare dhe planit të punës të ASK-së. Sipas UA 06/2011 DPZHS bënë planifikimin e anketave dhe trajnimin për zbatim të tyre, mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore, përfshirë Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (RRDHKF). Momentalisht DPZHS përbëhet nga 4 sektorë: RRDHKF, tregti (të dhënat për import-eksport), statistikat e çmimeve bujqësore, dhe GIS.

Në mungesë të regjistrimit të bujqësisë që nga viti 2000 ASK ka filluar me realizimin e anketës vjetore të Vlerësimit të Ekonomive Shtëpiake Bujqësore me 4,500 ekonomi familjare ku përfshihen indikatorë të ndryshëm si: popullsia bujqësore dhe struktura e saj, sipërfaqet e shfrytëzuara të tokës, prodhimi i kulturave bujqësore, blegtoria dhe prodhimet blegtorale, pylltaria, shfrytëzimi i plehrave minerale dhe organike, makineria bujqësore, fuqia punëtore në bujqësi, shpenzimet në fermë etj. Faza e grumbullimit të të dhënave në terren për anketën e vitit 2012 pritet të përfundoj në nëntor.

Përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë janë në proces. Ligji për regjistrimin e bujqësisë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe është përgatitur projekt propozimi për regjistrimin e bujqësisë dhe drafti i Planit të aktiviteteve. Projektligji për regjistrimin e bujqësisë ka përcaktuar ASK-në si autoritet menaxhues dhe implementues të regjistrimit dhe ka inkorporuar definicionet e Eurostat-it dhe është në përputhje me Rregulloren e BE-së (EC) No 1166/2008.

Është realizuar regjistrimi testues i bujqësisë në nëntor të vitit 2012. Paraprakisht janë përgatitur dhe testuar këto dokumente gjatë regjistrimit pilot të bujqësisë: Pyetësorët e RB; Udhëzime për zbatimin e regjistrimit pilot; Materiali i trajnimit; listat e ekonomive shtëpiake dhe etiketat e para-shtypura; Hartat e qarqeve regjistruese me ndërtesat (nga RPEFB 2011), programi (aplikacioni) i futjes së shënimeve etj. Objektivi i regjistrimit testues të bujqësisë ishte përgatitja dhe testimi i metodologjisë dhe instrumenteve tjera dhe funksionaliteti i tyre në harmoni me standardet ndërkombëtare. Është testuar gjithashtu edhe logjistika e RB. Nga të gjeturat prej terreni, janë marrë informatat e nevojshme për ndryshimet në pyetësorë (nuk ka rezultuar të ketë nevojë për shumë ndryshime). Në anën tjetër është bërë planifikimi dhe sigurimi i buxhetit sipas aktiviteteve dhe viteve dhe me 2013 pritet të filloj regjistrimi i plotë sipas metodologjisë derë-më-derë.

ASK së bashku me MBPZHR kanë filluar punën zhvillimore në fushën e statistikave agro-monetare në vitin 2003, ku përfshihen indeksi i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, indeksi i çmimeve të inputeve në bujqësi, Llogaritë Ekonomike në Bujqësi (LLEB), Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (RRDHKF), Fuqia Punëtore në Bujqësi (FPB) dhe të Ardhurat në Sektorin e Ekonomive Bujqësore (ASEB). MBPZHR është përgjegjëse për RRDHKF, ndërsa ASK për komponentët tjera¹⁴² dhe ka publikuar Indeksën e çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi si dhe Indeksën e çmimeve të inputeve në bujqësi (në intervale tremujore dhe vjetore 45 ditë pas periudhës referuese)

¹⁴² Ibid.

për vitet 2005-2012. Aktualisht grumbullohen çmimet për 68 inpute të ndryshme bujqësore dhe planifikohet që në të ardhmen të rritet numri i inputeve bujqësore.¹⁴³ Llogaritjet ekonomike në bujqësi janë publikuar për vitet 2005-2009 në intervale vjetore dhe janë dërguar në Eurostat. Llogaritjet ekonomike në bujqësi për vitin 2010 dhe 2011 janë përgatitur si draft për publikim në përputhje me Rregulloren e BE-së (EC) No 138/2004. Të dhënat mbi përqindjen e pjesëmarrjes së bujqësisë në ekonominë e Kosovës në krahasim me industrinë dhe shërbimet mbledhen nga anketat, por këto janë të pjesërishme. Me regjistrimin e bujqësisë të dhënat do të kompletohen dhe do të jenë më të sakta. ASK planifikon që në të ardhmen të zhvilloj statistika të fuqisë punëtore në bujqësi dhe të hyrat në sektorin e bujqësisë.

Statistikat e ASK-së mbi sipërfaqen e tokës sipas komunave dhe zonave kadastrave janë prodhuar duke shfrytëzuar regjistrin nga Agjensioni Kadastral i Kosovës (AKK). AKK dhe Zyrat Komunale të Kadastrës janë përgjegjëse për regjistrimin e tokave të cilat përdoren edhe për bujqësi. Tokat regjistrohen si parcela bujqësore, duke përfshirë edhe klasifikimin e tokës (nuk ka regjistër të ndarë për tokat bujqësore). Agjensioni Kadastral posedon fotografimet e viteve 2004 dhe 2009 të cilat ofrojnë një pasqyrë të gjendjes së parcelave bujqësore.¹⁴⁴

Në vitin 2005 ka filluar mbledhja e RRDHKF si pilot dhe në 2009-2010 është zhvilluar baza e të dhënave që mundëson kalkulimin e Marzhës Bruto të llojeve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Të dhënat e fermerëve janë të ndara sipas anëtarëve të asocioneve, nivelit të arsimit, moshës, kohës së prodhimit, llojeve të shpenzimeve, vlerës së tokës/ndërtesës, amortizimit të aseteve, borxhit, kapitalit, etj. Megjithatë sistemi nuk përfshin fermat e vlerës 1 të Njësisë Evropiane të Madhësisë (angl: European Size Unit - ESU). Të dhënat personale janë konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistike dhe zhvillim të politikave bujqësore. DPZHS e ka obligim të përditësoj këto të dhëna në baza vjetore. Përveç kësaj MBPZHR ka nxjerr edhe një UA 03/2009 i cili përcakton territorin e vreshtave në Kosovë të ndarë sipas rajoneve, nën-rajoneve, fushave të vreshtave, lokalitetet, etj, e të cilat janë të gjitha të integruara në nja sistem të vetëm që mundëson analizimin dhe publikimin e statistikave në këtë fushë.¹⁴⁵

Bashkëpunimi mes DPZHS dhe ASK është i ngushtë; ASK ka qasje në të dhënat e RRDHKF-së dhe anasjelltas – ASK ndanë të dhënat bujqësore me DPZHS-në dhe ky i fundit i proceson për nevoja të MBPZHR (çmimet e produkteve bujqësore, importi-eksporti i produkteve bujqësore, etj). Sistemi Informativ i Tregut ofron të dhëna në baza mujore rreth çmimeve të tregut për rreth 400 produkte bujqësore dhe kontribuon në statistika më të besueshme.¹⁴⁶ Në anën tjetër nuk ekziston një skemë e veçantë për import-eksport

¹⁴³ ASK - Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit; Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi TM1 - 2012 (2005=100).

¹⁴⁴ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 268.

¹⁴⁵ Ibid, fq. 269-270.

¹⁴⁶ Ibid, fq. 270-271.

të produkteve bujqësore, por të dhënat e tregtisë së Kosovës me vende tjera që nga 2009 standardizohen nga MBPZHR sipas sistemit të të dhënave statistikore të BE-së.¹⁴⁷

Statistikat e mjedisit kanë filluar të zhvillohen në vitin 2004. Është përgatitur memorandumi i mirëkuptimit së bashku me institucionet që kanë të dhëna për mjedis i cili harmonizon prodhimin e statistikave të mjedisit, rregullon shkëmbimin e të dhënave dhe bënë ndarjen e përgjegjësi në mes të institucioneve. Publikimi bëhet duke u bazuar edhe në anketat e ASK-së dhe në vitin 2007, 2009 dhe 2011 janë publikuar Disa fakte mbi mjedisin (çdo dy vite), ndërsa rezultatet e Anketave për mbeturinat komunale janë publikuar në vitin 2008, mars dhe dhjetor 2010, 2011 dhe 2012, dhe Anketa e mbeturinave industriale në 2011 dhe 2012 sipas NACE Rev. 1.1 (rregullorja (EC) Nr. 2150/2002). Sipas kërkesës së Eurostat-it ASK planifikon me Programin pesëvjeçar të publikoj edhe të dhëna mbi lirimimin e gazrave nga serat, mirëpo për shkak të mungesës së stafit publikimi i indikatorëve të rinj mbetet sfidë e madhe.

3.6. Teknologjia Informative

Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative është themeluar vonë dhe ka vetëm 1 punonjës nga fusha e TI me kontratë të rregullt, i cili mbulon nevojat e ASK në programim dhe zhvillim softuerik, dhe 2 të tjerë: 1 me kontratë nga SIDA i cili mbulon programe si IÇK dhe AFP, kurse i dyti me kontratë nga ZRP i cili njëherit është personi kyç në fushën e shpërndarjes elektronike të të dhënave statistikore si dhe ndihmon ASK në transmetimin dhe dërgimin e të dhënave përmes teknologjisë eDAMIS. Ky sektor edhe pse me staf mjaft të kufizuar kujdeset për mirëmbajtjen e rrjetit dhe serverëve, menaxhimin me databazat dhe sigurinë e tyre, ofron asistencë stafit të brendshëm të ASK dhe kujdeset për politikatat e bërjes back-up (ruajtjes) në serverët e ASK, zhvillon dhe azhurnon ueb faqen e ASK-së, etj. Me riorganizimin e ueb faqes së ASK dhe ZRP, është rritur volumi i informatave statistikore e sidomos numri i tabelave për çdo temë statistikore në formatin Excel, seri kohore që u mundëson shfrytëzuesve përdorim të mëtejshëm të këtyre të dhënave. Për herë të parë ASK ka bërë shpërndarjen e metadatave në ueb faqen e saj sipas rekomandimeve të EUROSTAT në formatin ESMS. Poashtu ka integruar teknologjinë DaWinci dhe StatPlanet në faqen e regjistrimit për qasje direkte dhe interaktive në të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2011. Zyra e TI-së edhe pse me staf të limituar ka ofruar shërbimet e kërkuara nga departamentet tjera. ASK ka mungesë të madhe të stafit sidomos në aspektin e programimit dhe intranetit.

Në aspektin softuerik, ASK përdor: Windows Server, SQL Server, MySQL, CSProx dhe CSPPro, VB, dotNET, programet për tabulim si SPSS, Excel, Access, etj. Por në anën tjetër ka nevojë të zhvilloj kapacitetet edhe më tutje në aspektin e teknologjisë dhe metodologjisë të re për grumbullimin e të dhënave (CAPI, CAWI dhe CATI), menaxhimin e databazave në një sistem të përbashkët, krijimin e ueb-aplikacionit për nxjerrje të raporteve dhe tabelave nga bazat e të dhënave, krijimin e bazave të të dhënave dhe aplikacioneve

¹⁴⁷ Ibid, fq. 264.

të reja, krijimin e lidhjes VPN me zyret rajonale, etj.¹⁴⁸ Duke marrë parasysh numrin shumë të kufizuar të zyrtarëve të TI-së në ASK, mbetet e paqartë se sa i përdor ASK këto sisteme dhe si planifikon t'i përmbush kërkesat për softuerë të ri.

Bashkëpunimi mes departamenteve tjera dhe atë të TI-së paraqet probleme serioze, p.sh. anketa e ekonomive familjare mbulon një sërë aspektesh (shëndeti, edukimi, etj) të cilat nuk optimalizohen nga ASK,¹⁴⁹ mungesa e politikave për softuerë bënë që një staf të përdor një sistem statistikor që nuk përdoret nga askush tjetër në ASK (disa përdorin Excel, disa Word apo edhe programe/sisteme tjera), që pengon bashkëpunimin mes departamenteve/stafit dhe ndarjen e informatave për një sistem të qëndrueshëm statistikorë.¹⁵⁰ Unifikimi i përdorimit të TI-së është i paraparë në Programin pesëvjeçar, por pritet që edhe projekti ideor i përgatitur nga ASK (të financohet nga IPA) të ndihmoj në zhvillimin e një sistemi të integruar dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit. Përveç kësaj, deri në fund të këtij viti pritet të lansohet një ueb databazë ku do të jenë të publikuara të gjitha informatat nga ASK e që mund të shkarkohen nga shfrytëzuesit për përdorime të ndryshme.

4. Konkluzione

Shihet se sistemi i statistikave në Kosovë ka përparuar viteve të fundit, megjithatë mbeten sfida mjaft serioze për t'u adresuar në të ardhmen e afërt. Përparësia është se stafi menaxhues i ASK-së, MF-së dhe BQK-së kanë identifikuar problemet dhe janë të preokupuar me zgjidhjen e tyre. Derisa mungesa e stafit në ASK konsiderohet të jetë nga sfidat më të mëdha, duhet kushtuar kujdes edhe menaxhimit sepse me një menaxhim efikas mund të arrihet performancë më efektive e resurseve ekzistuese.

Korniza ligjore në masë të madhe është kompletuar me akte nën-ligjore dhe reformat duhet përfunduar sa më shpejt që është e mundur. Kuvendi i Kosovës duhet të informohet rreth problemeve me të cilat ballafaqohen këto institucione dhe të shqyrtohet nëse kërkesat dhe obligimet mund të përmbushen me këtë nivel të mjeteve financiare.

¹⁴⁸ ASK - <http://esk.rks-gov.net/ti-ja-dhe-metodologjija/teknologjija>.

¹⁴⁹ SIDA - Evaluation of cooperation with SOK, fq. 14.

¹⁵⁰ Ibid, fq. 17.

Përparësitë	Sfidat	Rekomandimet
Rekomandimet e Eurostat-it merren parasysh gjatë gjithë kohës.	Statistikat, në gamë dhe strukturë si dhe në numrin e produkteve statistikore nuk është në përputhje me vendet e BE-së.	Ndjekja dhe zbatimi i përpiktë i parimeve statistikore të BE-së.
Ligji për statistikën zyrtare përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve. Ligji siguron pavarësi institucionale të ASK-së sipas praktikave të shteteve anëtare të BE-së.	Ligji nuk siguron pavarësi të mjaftueshme buxhetore të ASK	Të sigurohet pavarësia e ASK-së sipas standardeve të BE-së. Të shfrytëzohen organizatat e huaja të ndihmojnë në periudhën tranzitore prej 2-3 vjetësh për kalim të kapaciteteve në personelin vendor.
Programi statistikor pesëvjeçar është miratuar.		Të konsolidohet sistemi i integruar kombëtarë i statistikave.
Menaxhmenti i ri është zgjedhur dhe ka filluar të përgatis planet zhvillimore. Koordinimi mes departamenteve të ASK-së është në nivel të duhur, sidomos pas formimit të departamentit të ri për planifikim, koordinim dhe komunikim.	Menaxhmenti i ASK-së ka qenë i paqëndrueshëm përgjatë viteve. ASK ka staf të pamjaftueshëm, i cili ka nevojë të vazhdueshme për ngritje profesionale.	Të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve për stafin dhe ndërlidhjen e performancës me zhvillimin në karrierë. Kujdes të veçantë duhet kushtuar fushës së TI-së.
Këshilli Statistikorë përkrah koordinimin e statistikave.	Koordinimi mes institucioneve të ndryshme që mbledhin të dhëna dhe publikojnë statistika nuk është në nivelin e kënaqshëm.	Të zhvillohen procedurat për një koordinim të gjithmbarshëm në nivel të Kosovës.
Volumi i statistikave është në rritje e sipër dhe publikimet bëhen në afate kohore më të rregullta me plane që të shpeshohen në të ardhmen e afërt.	Statistikat nuk mbulojnë të gjitha fushat e domosdoshme si statistikën mjedisore, migrimi, etj. Statistikat duhet të publikohen në afate tremujore apo edhe mujore (p.sh. llogaritë kombëtare, respektivisht bilanci i pagesave). Cilësia e të dhënave, burimet, klasifikimi i regjistrave, besueshmëria, përcaktimi i mostrave, etj në fusha specifike nuk janë në përputhje me standardet e BE-së. Prodhimi i disa statistikave ndihmohet nga ekspertët e huaj.	Të konsolidohet sistemi i integruar kombëtarë i statistikave që do të mbulonte të gjitha fushat statistikore. ASK të kompletohet me staf të mjaftueshëm dhe të aftësohet. Përmirësim i vazhdueshëm në fushat e statistikave të ndryshme, në përputhje me parimet dhe standardet e BE-së, duke përfshirë mbulueshmërinë, besueshmërinë, rregullsinë kohore të publikimeve, etj.
Bashkëpunimi me shfrytëzuesit ka filluar të përmirësohet nga viti 2012		Të vazhdohet bashkëpunimi me shfrytëzuesit dhe të prodhohen statistika sipas nevojave të tyre

<p>Ueb faqja e ASK-së azhurnohet me publikimet më të reja me formatet sipas rekomandimeve të EUROSTAT.</p>	<p>Numër i kufizuar i stafit të TI-së. Koordinimi dhe bashkëpunimi në kuptim të programeve softuerike nuk është në nivelin e kënaqshëm.</p>	<p>Të përfundohet dokumenti mbi politikën e TI-së dhe të zhvillohen platformat e domosdoshme të TI-së. Stafi i TI-së të kompletohet dhe të vazhdon të trajnohet sipas nevojave të ASK-së.</p>
<p>Stafi i BQK-së është në listën e ekspertëve të FMN-së dhe ofron ekspertizë edhe për vendet në rajon dhe më gjerë.</p>		<p>BQK të ofroj asistencë institucioneve relevante statistikore brenda Kosovës.</p>

Kapitulli VI – Privatizimi/Likuidimi dhe Menaxhimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Publike

1. Kërkesat dhe standardet e BE-së për qeverisje korporative dhe privatizim

Qasja e shteteve anëtare të BE-së ndaj privatizimit varet nga kushtet socio-ekonomike të këtyre vendeve, si niveli i papunësisë, rritja ekonomike, investimet e huaja, etj, prandaj edhe nuk ekziston një qasje e vetme e sanksionuar me legjislacionin e BE-së. Pavarësisht kësaj, privatizimi ka qenë elementi kyç i politikave më të gjera reformuese në shumicën e vendeve të BE-së gjatë dy dekadave të kaluara me qëllim të rritjes së efikasitetit ekonomik, ristrukturimit të sektorëve ekonomik, ngritjes së nivelit të të hyrave, ndalimit të subvencioneve dhe përmirësimit të gjendjes financiare të ndërmarrjeve publike, etj.

Parimet e BE-së në fushën e privatizimit janë të ndërlidhura ngushtë me fushat si tregu i brendshëm, konkurrenca, qeverisja korporative, etj. BE ka themeluar parimet kryesore përmes Traktatit të Romës, dhe i ka avancuar me traktatet vijuese, ku përfshihen: hapja dhe liberalizimi i tregut, transparenca, konkurrenca e hapur dhe e drejtë pa e cenuar ofruesin publik të shërbimeve në interes të qytetarëve, eliminimi i monopoleve dhe/apo pozitës dominuese në treg, mënjanimi i qasjes privilegjuese në institucionet financiare, llogaridhënia, ndalimi i diskriminimit në baza nacionale, ndalimi i marrëveshjeve në përcaktimin e çmimeve, ndalimi i kufizimit dhe kontrollimit të prodhimit/tregut dhe investimeve, ndalimi i aplikimit të kushteve të pabarabarta gjatë transaksioneve për të vendosur disavantazh konkurrues, etj.

Konkurrenca mund të evitohet nga institucionet relevante të BE-së vetëm në raste kur është e domosdoshme mbrojtja e ndërmarrjeve të hendikepuara për nga kushtet strukturore apo natyrore, apo kur kjo promovon progres teknik dhe ekonomik e që u ofron konsumatorëve përfitime proporcionale.

Ndihma shtetërore (grante, lehtësira tarifore, ofrimi i kushteve preferenciale, etj) është e lejuar përderisa kjo është e domosdoshme për interesin publik, për zhvillimin ekonomik të rajoneve të pazhvilluara apo promovimin e mbrojtjes së mjedisit, hulumtim dhe zhvillim, etj. Këto ndihma janë të ndaluara në rast se shtrembërojnë apo rrezikojnë konkurrencën e lirë dhe të drejtë apo interesin e përbashkët të BE-së.

Sa i përket qeverisjes korporative, BE ka filluar debatin me 2002 përmes raportit të Grupit të nivelit të lartë të ekspertëve të së drejtës së kompanive. BE ka themeluar Forumin Evropian për Qeverisje Korporative i cili ka për qëllim Qeverisjen e mirë dhe transparente të korporatave e cila është thelbësore për rritjen e konkurrencës dhe efikasitetin e bizneseve në Bashkimin Evropian, si dhe forcimin e aksionarëve me të drejta dhe mbrojtjen e palëve të treta.

Përmes Komunikatës 'Modernizimi i së drejtës së kompanive dhe përmirësimi i qeverisjes korporative në BE - Plani për të ecur përpara' të vitit 2003, BE ka iniciuar procesin e harmonizimit të rregullave të së drejtës së kompanive dhe qeverisjes korporative

me qëllim të mbrojtjes së aksionarëve, rritjes së efijencës dhe konkurrencës, rregullimit të proporcionalitetit në mes të kapitalit dhe kontrollit, rritjes së rolit të drejtorëve ekzekutiv, sigurimit të lirisë për themelim të kompanive, etj.¹⁵¹

Komisioni Evropian në vitin 2010 ka hartuar një Letër të Gjeltër me qëllim të përmirësimit të mekanizmave të qeverisjes korporative. Disa nga parimet kyçe të BE-së në këtë fushë janë:

- Bordet duhet të balancohen mes drejtorëve ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv, ndërsa rolet e Kryesuesit të bordit dhe Kryeshefit ekzekutiv duhet të jenë të ndara.
- Kompozicioni i drejtorëve jo-ekzekutiv të Bordit duhet të jetë i bazuar në kritere të kualifikimit, përvojës, profesionalizmit, pavarësisë dhe diverzitetit të kandidatëve.
- Politikat e rrogave dhe pagesa e drejtorëve duhet të jenë transparente.
- Ndërmarrjet duhet të kenë planet e menaxhimit të rrezikut dhe të monitorohen nga bordet e tyre.
- Konflikti i interesit duhet mënjanuar në çdo aspekt.
- Ndërmarrjet në interes publik duhet të themelojnë Komitetin e auditimit, i cili i ofron këshilla Bordit¹⁵².

Ekzistojnë një numër i madh i direktivave të BE-së që ndërlidhen me parimet e privatizimit dhe menaxhimit të ndërmarrjeve, të cilat i referohen sektorëve apo edhe rasteve specifike.¹⁵³

Si përfundim, mund të thuhet se kërkesat themelore të BE-së për sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi publike/shtetërore janë që procesi të jetë transparent, të garantoj një rezultat të pritshëm dhe të mos ndikohet nga ndërhyrjet politike.

2. Privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore

2.1. Korniza ligjore dhe institucionale

Sektori i ndërmarrjeve shoqërore (NSH) ka punësuar rreth 20,000 njerëz ndërsa numri i njerëzve në lista të punëtorëve arrinte deri në 60,000 (p.sh. 40,000 ishin në pushim pa pagesë). NSH-të kanë operuar në një varietet të sektorëve duke përfshirë përpunimin e metaleve, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, materialet ndërtimore, ndërtim, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me pakicë dhe shumicë, etj. Është llogaritur që NSH-të kanë paraqitur rreth 90% të bazës industriale dhe të minierave të Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore - duke përfshirë tërë tokën komerciale bu-

¹⁵¹ The EU approach to corporate governance, 2008, p. 3-5.

¹⁵² Ibid, 2008, fq. 5-8.

¹⁵³ Pakoja e plotë e dokumenteve relevante mund të gjenden në webfaqen e Komisionit Evropian: http://ec.europa.eu/internal_market/company/official/index_en.htm.

jqësore dhe pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës. Pjesa më e madhe e aseteve industriale të Kosovës si toka bujqësore, pyjet, toka komerciale urbane dhe pronat komerciale janë poseduar nga NSH-të.¹⁵⁴

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është themeluar si agjenci pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 “për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” me ndryshime, të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj janë asete dhe përgjegjësi të AKP-së. Megjithatë AKP nuk ka trashëguar mandatin që kishte AKM mbi ndërmarrjet publike (NP) të cilat tani janë nën mandatin e MZHE-së. AKM ishte themeluar nga UNMIK-u, në vitin 2002 dhe kishte filluar procesin e privatizimit në Kosovë në vitin 2003, megjithëse ishte dizajnuar në atë mënyrë që procesi i likuidimit të NSH të mos përfundoj asnjëherë, sepse fillimisht presupozohej se pronësia i takonte Serbisë dhe afatet e likuidimit zgjasnin 42 muaj.

AKP-ja është themeluar me shpalljen e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008. Ky ligj përshin dispozitat relevante të Propozimit Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 (Shtojca VII, neni 2), që ishte bërë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). AKP-ja është themeluar si organ publik i pavarur dhe ushtron funksionet dhe përgjegjësitë me autonomi të plotë.

Kompetencat e AKP-së i janë dhënë Bordit të Drejtorëve, i përbërë nga tre drejtorë ndërkombëtarë dhe pesë Kosovarë, dhe një vëzhgues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Anëtarëve të Bordit i ka skaduar mandati në korrik 2012 që ka ndikuar negativisht në procesin e vendim-marrjes, sidomos duke marrë parasysh procesin e riorganizimit të Trepçës. Anëtarët e ri janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2013. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë vendim-marrës dhe ka juridiksion të plotë mbi AKP-në, ndërkaq struktura organizative e AKP-së, siç parashihet me Ligjin e AKP-së përveç bordit të drejtorëve përbëhet edhe nga pjesa ekzekutive që udhëhiqet nga drejtori dhe dy zëvendësdrejtorë. Pjesa ekzekutive e AKP-së përbëhet nga Divizioni për Shitjen e Aseteve, Divizioni i Qeverisjes Korporative dhe Dega Ekzekutive nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të menaxhmentit të Agjencisë¹⁵⁵.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKM-në (Dhoma e Posaçme) është themeluar nga UNMIK-u në vitin 2003 si një gjykatë ndërkombëtare për të ofruar një mekanizëm të fortë, të pavarur dhe të paanshëm në procesin e privatizimit në Kosovë. Pas vendosjes së misionit të EULEX-it në Kosovë janë angazhuar një staf prej 30 vetave në këtë institucion. Gjyqtarët e EULEX-it në Dhomën e Posaçme kanë funksione ekzekutive dhe ata përbëjnë shumicën e gjyqtarëve në çdo panel.

¹⁵⁴ Raporti vjetor i AKP-së - http://www.pak-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_AKP-s-alb.ver..pdfq.

¹⁵⁵ AKP - http://www.pak-ks.org/repository/docs/Information_to_Stake_Holders_august_2011_alb_ver_FINAL..pdfq.

Në gusht 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin e ri të AKP-së nr. 04/L-034, si dhe Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës e cila ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë. AKP ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Këto ligje kanë krijuar kushtet për likuidimin e NSH-ve, përshpejtimin e procesit të privatizimit përmes shkurtimit të procedurave për shqyrtim të kërkesave të kreditorëve dhe punëtorëve, përshpejtimin e transferit të aseteve tek investitori privat dhe shpërndarjen e fondit të mirëbesimit tek kreditorët dhe pronarët e ligjshëm, është mundësuar angazhimi i ofruesve të shërbimeve të cilët së bashku me AKP-në përbëjnë Autoritetin e Likuidimit, etj. Puna e Autoritetit ka filluar në Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, ku gjatë procesit të likuidimit është mundësuar që të shqyrtohen edhe borxhet e NSH-ve ndaj NP-ve për shërbimet e tyre, pastaj borxhet e tatimit në pronë, TVSH, etj.

2.2. Statusi dhe sfidat

Pas miratimit të ligjit për AKP, procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH) ka ri-nisur në verën e vitit 2008¹⁵⁶ (pas ndërprerjes së përkohshme si pasojë e përmbylljes së mandatit të AKM-së nga Shtylla IV e UNMIK-ut, e njohur si shtylla e Bashkimit Evropian, në qershor të vitit 2008), por me një ritëm më të ngadaltë dhe pa prodhuar ndonjë ndikim në ekonominë e vendit. Nga viti 2009 procesi është dinamizuar, megjithëse me vonesa¹⁵⁷ dhe me një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve për t'u privatizuar¹⁵⁸.

Për shkak të neutralitetit të EULEX-it ndaj statusit politik të Kosovës, Dhoma e Posaçme prej fillimit refuzonte të njihte AKP-në si pasardhëse ligjore të AKM-së. Për më tepër Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) kishte vendosur autoritet ekskluziv ndaj çfarëdo çështjeje që ka të bëjë me AKM-në (edhe pse AKM-ja më de facto nuk ekzistonte). Kjo gjendje krijoi paqartësi juridike dhe kishte ndikim të konsiderueshëm në zhagjitjen e proceseve që janë zhvilluar nga AKP-ja.

Metodat e përdorura nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit kanë qenë: i) spin-of i rregullt, ii) spin-of i kushtëzuar, dhe iii) spin-of special. Me spin-of të rregullt janë privatizuar ndërmarrjet dhe asetet e tyre në bazë të çmimit më të lartë të ofruar në një raund, pa ndonjë kusht tjetër. Ndërsa spin-of i kushtëzuar dhe ai special kanë përfshirë përveç çmimit më të lartë edhe kushtet si zotimet për punësim dhe zotimet për investime; procesi është zhvilluar në dy raunde dhe në raundin e dytë kanë marrë pjesë vetëm tre konkurrues të përzgjedhur nga raundi i parë.

Sipas ligjit 04/L-034 AKP nuk aplikon më metodën spin-of special për arsye se është dëshmuar të jetë komplekse duke rezultuar me disa privatizime që zhagjisin përmbush-

¹⁵⁶ Progress Report, 2008, fq. 30.

¹⁵⁷ Ibid, fq. 24.

¹⁵⁸ SAPD: Sectoral meeting on Economy, 17 June 2010, Brussels, fq. 6.

jen e zotimeve për punësim dhe investime (për më tepër kontratat janë lidhur në bazë të ligjeve të Anglisë të cilat nuk korrespondojnë me ligjet e Kosovës). Prandaj AKP ka vendosur të aplikoj vetëm metodën spin-of të rregullt dhe shitjen e asetëve përmes likuidimit.¹⁵⁹ Nga përvoja vërehet se shitja direkte e asetëve ishte metoda më efektive, mirëpo fokusi është dashur të jetë më shumë në monitorimin e operacioneve biznesore, punësimin dhe output-in. Prandaj konsiderohet se do duhej të formohej një trup për monitorim të qëndrueshëm të post-privatizimit – investimet dhe punësimin nga investitorët.

Privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha është kryer nga ana e AKM-së. Në tërësi deri tani janë tenderuar 330 NSH dhe janë krijuar 727 ndërmarrje të reja. Në anën tjetër janë shitur asetet e 297 ndërmarrjeve. AKP ka trashëguar nga AKM rreth 200 kontrata të panënshkruara, ndërsa tani nuk ekziston asnjë e tillë. Deri tani në total janë përfunduar 675 kontrata të shitjes, ndërsa derisa AKM nuk kishte likuiduar asnjë NSH, AKP për një periudhë relativisht të shkurtër ka likuiduar 4 prej tyre. Ekzistojnë 180 NSH në proces të likuidimit, kërkesat e të cilave duhet të shqyrtohen deri në prill 2013. Nga 25 NSH të privatizuara me spin-of special, janë punësuar 7,108 punëtorë krahasuar me 8,340 të zotuar.

Sa i përket privatizimit të tokave bujqësore, kjo bëhet në përputhje me Ligjin 02/L26 për tokat bujqësore dhe Ligjin 2003/14 për planifikim hapësinor, për të siguruar që tokat bujqësore të privatizuara nuk përdoren për qëllime ndërtimi. Deri më tani janë privatizuar 28,842ha dhe në proces janë 17,303ha tjera nga gjithsej 46,145ha¹⁶⁰.

Deri më 30 shtator 2012, të hyrat e përgjithshme nga privatizimi janë 572,040,806 EUR, ndërkaq të hyrat nga likuidimi 60,565,419 EUR¹⁶¹. Për shkak të vështirësive të ndryshme legislative dhe operacionale ankesat/kërkesat e kreditorëve nuk janë zgjidhur ende, prandaj AKP-ja ka kontraktuar Deloitte Central Europe për të përsheptuar zgjidhjen e ankesave/ kërkesave, dhe pritet që deri në mesin e vitit 2013 të zgjidhen të gjitha ankesat për 180 NSH në proces të likuidimit.

Të hyrat nga ky proces gjenden në një fond mirëbesimi në BQK. 20% të fondeve janë rezervuar për punëtorët e NSH-ve që kanë të drejtë në një pjesë të aksioneve, 5% janë tarifa administrative për AKP, ndërsa 75% të fondeve të mbetura shërbejnë për zgjidhjen e ankesave/kërkesave të kreditorëve.¹⁶²

Shpërndarja e mjeteve nga procesi i likuidimit bëhet pasi që lista të aprovohet nga

¹⁵⁹ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 138-139.

¹⁶⁰ Ibid, p. 266. 2,508ha janë privatizuar me spin-of special; 25,334 me spin-of të rregullt.

¹⁶¹ Likuidimi deri më tani ka qenë më pak i suksesshëm, dhe të ardhurat nga ky proces nuk janë futur në planifikimin buxhetor. Shënimet më të fundit për të hyrat nga privatizimi dhe likuidimi janë nga burimet zyrtare të AKP-së.

¹⁶² FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 13.

Dhoma e Posaçme. Në mungesë të efikasitetit të Dhomës, Bordi i AKP-së ka miratuar shpërndarjen e përkohshme të mjeteve. Deri më tani kreditorëve u është paguar vetëm rreth 45,000 EUR që kanë të bëjnë me NSH-të e likuiduara nga AKP-ja, të cilat mund të përdoren për investime kapitale. Dhoma e Posaçme ka aprovuar vetëm 2 lista përfundimtare për shpërndarjen e 20% për punëtorët. Në mungesë të efikasitetit të Dhomës, Bordi i AKP-së ka miratuar një Strategji për shpërndarje të përkohshme deri në 15% të mjeteve. Në bazë të kësaj Strategjie, deri më 30 shtator 2012 AKP-ja ka publikuar 86 lista të punëtorëve, ku rreth 33,000 punëtorë kanë përfituar shumën prej rreth 67 milion EUR.¹⁶³ Në anën tjetër duhet të ceket se AKP nuk ka zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të paguar 20% e mjeteve për punëtorët e fabrikës në Ferizaj!

Ekzistojnë rreth 40,000 kërkesa për ndërmarrjet në likuidim, prej të cilave Serbia vetëm për 3 muaj ka dërguar në AKP 20,000 sosh. Rreth 60-70% të këtyre kërkesave kanë të bëjnë me pagat e papaguara në kuadër të Fondit të dikurshëm për zhvillimin e Serbisë. Mbetet për Dhomën e Posaçme të shqyrtoj të gjitha këto kërkesa. Në rast se ka kërkesa për ndërmarrje të cilat nuk janë në proces të likuidimit, AKP nuk është e obliguar të përgjigjet. Ana pozitive e kornizës ekzistuese është se kërkesat e kreditorëve mund të përmbushen vetëm sa është vlera e shitjes, që do të thotë se shpërndarja e fondeve kreditorëve nuk mund të tejkaloj vlerën e shitjes së ndërmarrjes së caktuar.

Deri në vitin 2011 aktivitetet e AKP-së janë financuar kryesisht nga grantet e donatorëve, ndërsa operacionet janë mbikëqyrë nga Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO). Por, si pjesë e tranzicionit të Kosovës nga pavarësia e mbikëqyrur në pavarësi të plotë, AKP është integruar në buxhetin e përgjithshëm qeveritar.¹⁶⁴ Prej vitit 2013 AKP financon investimet kapitale nga të hyrat e gjeneruara nga privatizimi. Për më tepër 5% të të hyrave nga procesi i privatizimit konsiderohen si tarifa administrative dhe do të jenë në dispozicion të AKP-së për të mbuluar shpenzimet e veta administrative dhe operacionale¹⁶⁵ për pesë vitet e ardhshme¹⁶⁶. Kësisoj AKP nuk është pjesë e kufijve shpenzues të përcaktuar nga qeveria, sepse është e vet-financueshme dhe cakton shpenzimet në mënyrë të pavarur.¹⁶⁷ Buxheti i AKP-së për tri vitet e ardhshme është parashikuar të jetë si në Tabelën 8.

¹⁶³ Shënimet më të fundit për shpërndarjen e mjeteve të 20 përqindëshit janë nga burimet zyrtare të AKP.

¹⁶⁴ FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 6.

¹⁶⁵ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 138-139.

¹⁶⁶ FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 13.

¹⁶⁷ Ibid, fq. 6.

Tabela 8: Limiti i shpenzimeve të aprovuara

	2013	2014	2015	Totali
Totali	6,857,010	9,894,880	9,849,880	26,601,770
Paga dhe shtesa	3,600,000	3,600,000	3,600,000	10,800,000
Mallra dhe shërbime	2,889,010	5,971,880	5,971,880	14,832,770
Komunali	98,000	98,000	98,000	294,000
Subvencionet dhe transferet	100,000	100,000	100,000	300,000
Shpenzimet kapitale	170,000	125,000	80,000	375,000
Numri i stafit	271	271	271	

Burimi: KASH 2013-2015

Privatizimi pritet të përfundoj në dy vitet e ardhshme, megjithatë likuidimi i NSH-ve do të vazhdoj¹⁶⁸, ndërsa sipas parashikimeve të fundit të Qeverisë i gjithë procesi i privatizimit dhe likuidimit do të përfundoj më 2016.¹⁶⁹

Megjithatë, duke pasur parasysh ritmin e deritanishëm të zhvillimit të këtyre proceseve dhe duke e ditur që portfolio e NSH-ve që kanë mbetur për t'u privatizuar/likuiduar është më problematike për shkak të mungesës së dokumenteve kadastrale dhe çështjeve të tjera pronësore, ky parashikim mund të mos jetë real. Për më tepër, performanca e AKP-së është ndikuar edhe nga mos emërimi i anëtarëve të Bordit të drejtorëve nga korriku 2012, që ka vështirësuar vendim-marrjen strategjike të saj.

Gjatë kohës së administrimit të UNMIK-ut është bërë po ashtu edhe komercializimi i disa ndërmarrjeve shoqërore duke nënshkruar kontrata për koncesion me kohëzgjatje 10 vjeçare. Nga 18 kontrata të nënshkruara, nëntë prej tyre janë ndërprerë për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuese, një është ende në fuqi ndërsa ndërmarrjet tjera janë privatizuar. Për shkak të dobësive të shprehura gjatë aplikimit të këtij procesi dhe rezultateve modeste në përbushjen e obligimeve nga ana e investitorëve, AKM-ja kishte vendosur që të ndërpres këtë proces dhe të vazhdoj me procesin e privatizimit.

Në parim privatizimi pritet të ketë efekte pozitive në ekonominë e vendit në gjenerimin e punësimit, krijimin e ambientit më të përshtatshëm për biznese dhe investime, etj. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë si një komponentë e rëndësishme e ekonomisë së tregut nuk ka arritur të prodhojë efektet e dëshiruara për ekonominë e vendit. Në këtë aspekt kanë ndikuar disa faktorë, si paqartësitë politike si pasojë e prolongimit të definimit të statusit politik të Kosovës; hezitimi i administratës së UNMIK-ut

¹⁶⁸ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 138-139.

¹⁶⁹ FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012, fq. 13.

për të filluar këtë proces deri në vitin 2003 (dhe ndërprerja e tij pas valës së 2-të të privatizimit) që ka ndikuar në uljen e vlerës së aseteve, humbjen e mëtejshme të tregjeve të NSH-ve dhe dekurajimin e investitorëve potencial; mbajtja e fondeve të privatizimit në statusin e “ngrirë” (me arsyetimin e paqartësive pronësore-juridike) që ka pamundësuar përdorimin e këtyre mjeteve për projekte të rëndësishme që do të ndikonin në rritjen e zhvillimit ekonomik, etj.

Mësimet e nxjerra nga ky proces tregojnë se privatizimi është bërë pa objektiva të matshme ekonomike dhe sociale duke u karakterizuar me komercializim i cili rezultoi dëmshëm në zhvillimin e Kosovës. Në këtë mes, komunikimi mes AKM-së dhe institucioneve tjera nuk ka qenë i duhur, pavarësisht se me kalimin e kohës ky komunikim ka shënuar përmirësim të dukshëm. Në të ardhmen kërkohet kujdes në lidhje me përmirësimin e komunikimit me grupet e interesit. Ky proces vlerësohet të jetë karakterizuar me afëri dhe praktika korruptive. Gjithashtu si pasojë e mos njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe kontrollit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) në enklava dhe veriun e vendit nga ana e Serbisë, ky proces në vazhdimësi është përballë me ndërhyrje dhe implikime politike. AKP ka hapur zyra satelitore në enklava dhe në veri (Leposaviq) ku është bërë privatizimi i disa ndërmarrjeve të vogla. Procesi poashtu është përcjellë me barriera të ndryshme sikurse politikat fiskale (pagesa e TVSH-së në kufi), mungesa e mbrojtjes ligjore të investimeve, si dhe barrierat tjera burokratike në nivelin qendror dhe lokal të cilat marrë së bashku kanë ndikuar në nivelin e ulët të investimeve si brenda ashtu edhe nga investitor të jashtëm.

Fondet e ngrira në BQK (rreth 600 mil EUR ekuivalente me 40% të të hyrave buxhetore për vitin 2012) mbetet përvoja më e keqe e kësaj procesi. Është paradoksale që një anë Kosova merr borxh nga FMN përderisa fondet e privatizimit kanë mbetur të ngrira. Për më tepër norma e interesit për këto fonde është 0.1% (në vendet tjera kjo normë interesi sillet prej 12 deri 14%) apo 3% për investimet në letra me vlerë, ndërsa bizneset përballen me norma dyshifrore interesi në bankat komerciale. Në vendet tjera fondet e privatizimit janë përdorur për investime kapitale në arsim, shëndetësi, mjedis, shkencë, teknologji, etj. Prandaj duhet liruar këto fonde sa më shpejtë që është e mundur, sepse shqyrtimi i të gjitha kërkesave nga Dhoma e Posaçme do të merr shumë kohë. Arsyetimi më i shpeshtë për ngrirje të këtyre fondeve është se komuniteti ndërkombëtarë shtron nevojën për siguri dhe stabilitet financiar. Derisa stabiliteti financiar me të vërtetë duhet ruajtur, duhet menduar edhe për aspektet e zhvillimit socio-ekonomik të vendit dhe në këtë drejtim duhet mësuar edhe nga përvojat e vendeve tjera; një mundësi është që 15% të fondeve të rezervohen për kreditorët (dhe të plotësohet nga Qeveria në rast nevoje), kurse pjesa tjetër të përdoren për zhvillim ekonomik. Përkundër privatizimit të rreth gjysmës së NSH-ve, efektet në gjendjen socio-ekonomike të vendit nuk vërehen: rritja e ekonomike e mbështetur në investime publike është e paqëndrueshme, papunësia dhe varfëria është e lartë, mbulimi i importit me eksport është rreth 10%, dhe kontributi i sektorit të prodhimit në BPV është shumë i ulët. Për më tepër procesi është duke u konstatuar në aspektin politik, ekonomik dhe social nga palë të ndryshme dhe shoqërohet me mungesë të konsensusit të gjerë.

Në vazhdim është paraqitur një përshkrim i shkurtër i disa prej ndërmarrjeve shoqërore që kanë rëndësi strategjike e që nuk janë privatizuar ende.

2.3. Minierat e Trepçës

Trepça është konglomerat në rajonin e Mitrovicës me asete dhe degë tjera të shpërndara në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe ish-Jugosllavisë. Në të kaluarën ka qenë një prej ndërmarrjeve më të mëdha të ish-Jugosllavisë që në një periudhë ka pasur mbi 20,000 punëtorë. Konglomerati Trepça ka tri elemente kryesore: minierat, parkun industrial të Mitrovicës dhe kompleksin e shkrirjes së metaleve në të cilin është themeluar konglomerati. Gjithashtu ka aktivitete të shumta përcjellëse për të cilat në proces përdoren plumbi, zinku, kadmiumi ose argjendi. Si tërësi, përfshihen rreth 41 vendndodhje duke përfshirë një numër të tyre që gjenden jashtë Republikës së Kosovës.

Gjatë viteve 1990, Trepça ka kaluar në një numër transformimesh të dyshimta. Me 1990 Qeveria e Serbisë ka paraqitur masat e dhunshme në 14 prej 19 kompanive që i përkisnin grupit Trepça në atë kohë. Masat e dhunshme kanë rezultuar me largimin dhe zëvendësimin e menaxherëve shqiptarë me ata serbë. Kjo ka nxitur protesta me shtrirje të gjerë dhe greva të punëtorëve që si pasojë kanë pasur humbjen e vendit të punës të shumë punëtorëve shqiptarë, sidomos në periudhën 1990-1992.

Më 1999, pasi që forcat NATO kanë hyrë në Kosovë, në pjesën veriore të Trepçës ka vazhduar funksionimi i biznesit, përderisa në pjesën jugore punëtorët shqiptarë nuk kanë mundur të hyjnë në vendet e tyre të punës deri në dhjetor 1999 kur është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet UNMIK-ut dhe Sindikatës së Trepçës që lejonte 214 punëtorë të hynin në Stantërg për të bërë gati minierën për prodhim. Në Gusht 2000, KFOR-i dhe UNMIK-u janë detyruar të mbyllin kapacitetet metalurgjike në Zveçan për shkak të ndotjes së ambientit.

Në nëntor 2005 UNMIK ka nxjerr Rregulloren 2005/48 (ngjashëm me Kapitullin 11 në SHBA) që në thelb lejonte emërimin e administratorit i cili mund të bëjë ri-organizimin e ndërmarrjes (me qëllim që të përzgjedh asetet produktive që do të mund të riaktivizoheshin dhe të përcaktojë asetet të cilat duhet t'i nënshtroheshin likuidimit). Në dhjetor 2005, Bordi i AKM-së ka autorizuar Dhomën e Posaçme për administrimin e Trepçës dhe më pas në mars 2006, Dhoma e Posaçme ka lëshuar "Vendimin për Moratorium" për riorganizimin e "Trepçës nën Administrimin e AKM-së".¹⁷⁰

Kjo nënkuptonte që deri në momentin e emërimit të administratorit, Dhoma e Posaçme është pajtuar për moratoriumin e përkohshëm që të ngrijë veprimet në gjykatat e Kosovës dhe të parandaloj pagesën dhe ekzekutimin e ankesave të kërkuara nga gjykatat jashtë Kosovës kundër ndërmarrjes. Rregullorja për Riorganizim gjithashtu ka përcaktuar orarin brenda të cilit AKM-ja është obliguar të organizoj tenderin për shërbimet e një administratori. Autoritetin final për emërim të Administratorit e kishte Dhoma e

¹⁷⁰ Raporti vjetor i AKP - <http://www.pak-ks.org/?page=1,9>.

Posaçme dhe jo AKM. Sidoqoftë, AKM-ja nuk ka qenë në gjendje të paraqes raportin me rekomandimet e saj në Dhomën e Posaçme për ofertuesin më të përshtatshëm për administrator dhe procesi i riorganizimit ka ngecur që atëherë.¹⁷¹

Ligji Nr. 04/-L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre është miratuar dhe hyrë në fuqi në tetor 2011, por shqetësuese është se ligji ende përmban vokabular të UNMIK-ut. Ligji i ri ka hapur rrugën për privatizimin e Trepçës, mirëpo riorganizimi dhe ristrukturimi i Trepçës varet nga efikasiteti i Dhomës së Posaçme. Sipas ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 50 të Ligjit Ligji Nr. 04/L-035 lidhur me Vendimin e Dhomës së Posaçme Nr. SCR-05-001, të datës 9 mars 2006, si dhe vendimit pasues të Dhomës së Posaçme Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, të datës 19 maj 2011, AKP ka shpallur njoftim lidhur me Ndërmarrjet Thelbësore të Trepçës dhe Ndërmarrjet Tjera të Trepçës.¹⁷² Prej datës 8 Nëntor 2011 të gjitha veprimet, procedurat dhe veprimet e çfarëdo lloji që kanë për qëllim përcaktimin e vlefshmërisë, zbatimin apo përmbushjen e kërkesave apo interesave lidhur me ndërmarrjet e cekura në këtë njoftim¹⁷³, apo Pasurisë së tyre, pezullohen dhe mund të vazhdojnë vetëm me lejen e Dhomës së Posaçme për Çështjet Lidhur me AKP. Nga 8 Nëntor 2011, AKP shërben si Administratore e Ndërmarrjeve të cekura në Njoftim gjatë tërë procesit të riorganizimit.¹⁷⁴

Në përputhje me Nenin 17 të Ligjit, AKP brenda 360 ditëve do të publikojë edhe një njoftim (“Njoftimi për Afatin e Kërkesave”) që do të ofrojë hollësi për mënyrën e parashtrimit të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit dhe caktimin e afatit për parashtrimin e këtyre.¹⁷⁵ Kjo do të shërbejë që të mblidhen të gjitha informatat e nevojshme lidhur me kreditorët, nivelit të borxhit, kohës kur është hyrë në borxh, etj të cilat do të ndihmojnë në shqyrtimin e të gjitha kërkesave. Deri më tani është e njohur se ka kreditorë nga Greqia dhe Franca.

Stërzgjatja e moratoriumeve ndikon negativisht në vlerën e asetëve dhe rrit koston e

¹⁷¹ Raporti vjetor i AKP - http://www.pak-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_AKP-s-alb.ver..pdfq.

¹⁷² Njoftim për Moratorium - <http://www.pak-ks.org/repository/docs/Moratoriumi-shq.pdfq>.

¹⁷³ Lista e ndërmarrjeve në këtë Njoftim: Trepça Ndërmarrjet Thelbësore që përbëhen nga: (a) NSh Minierat dhe Flotacionet Stantrg Fi 690/89, (b) NSh Minierat dhe Flotacionet Kishnicë dhe Novo Berdo Prishtinë, (c) NSh Minierat dhe Flotacionet Trepça Kopaonik, Leposaviç Fi 804/89, (d) NSh Metalurgjia Plumbit Zveçan Fi 684/89, (e) NSh Metalurgjia Zinkut, Mitrovicë Fi 983/90, (f) NSh Industria Kimike, Mitrovicë (g) NSh Industria Akumulatorëve Trepça, Mitrovicë Fi 697/89, (h) NSh Fabrika e Pajisjeve Përpunuese, Mitrovicë Fi 683/89, (i) NSh Trepça Energjitika, Zveçan - (j) NSh Intituti Trepça, Zveçan (k) NSh Trepça Trans, Zveçan (l) NSh Qendra Llogaritare, Mitrovicë, (m) NSh Trepça Komerc, Mitrovicë Fi 669/89, (n) NSh Standard Trepça, Mitrovicë Fi 666/89, (o) NSh Laboratori Trepça, Zveçan Fi 762/89, (p) Mjekësia e Punës, (q) Banka Trepça, Institucion Financiar, Zveçan Fi 85/77 dhe Fi 705/89, (r) Mbrojtja Pronës, Zveçan - së bashku me entitetin që i referohen si “KXMK Trepça” (Kombinati Xehtar, Metalurgjik, Kimik Trepça) Fi 881/89, dhe Trepça Ndërmarrjet e Tjera që përbëhen nga: (s) PTP Proleter, Leposaviq.

¹⁷⁴ AKP - Njoftim për Moratorium - <http://www.pak-ks.org/repository/docs/Moratoriumi-shq.pdfq>.

¹⁷⁵ Ibid.

mirëmbajtjes dhe të sigurimit të aseteve të Trepçës. Gjithashtu, vonesa në riorganizimin e këtij konglomerati minerar është pengesë për tërheqjen e investimeve për zëvendësimin e teknologjisë së vjetruar dhe riaktivizimin e kapaciteteve prodhuese që do të mundësonin hapjen e vendeve të reja të punës dhe revitalizimin e zingjirit të industrisë minerare. Për të proceduar me privatizimin e Trepçës kërkohet të bëhet një studim i rezervave, për ç'arsye në bashkëpunim me GIZ (Gjermania ka përvojë në rehabilitim të minierave të ish Gjermanisë Lindore) janë themeluar grupet punuese.

2.4. Qendra e Skijimit Brezovica

NSH Qendra e Skijimit Brezovica është qendra e vetme e turizmit dimëror në Kosovë që ka kushte të jashtëzakonshme natyrore për skijim. Ajo ofron pamje atraktive në malet e Sharrit dhe ofron kushte të shkëlqyeshme klimatike që mundësojnë skijimin prej muajit nëntor deri në maj. Shtrihet në lartësinë mbidetare prej 900m deri në 2.500m. Vetëm hapësira e skijimit vlerësohet se i ka afër 230 hektarë. Si kompleks atraktiv turistik veror dhe dimëror, në mes tjerash, përbëhet nga dy hotele, pesë teleferikë, shtigje të skijimit me gatësi mesatare prej 3.000m dhe 300 vila të ndryshme.

AKM i kishte filluar përpjekjet për privatizimin e Brezovicës në vitin 2006, por pas reagi-meve të fuqishme nga Republika e Serbisë në Kombet e Bashkuara, UNMIK-u i kërkoi AKM-së që të anuloi procesin e privatizimit. Ish shefi i Shtyllës së IV të UNMIK-ut Paul Acda, kishte deklaruar në shtator të viti 2006 se "privatizimi i Brezovicës është shtyrë pas kërkesës së Kryetarit të Komunës (së Shtërpçës) dhe të menaxherëve të kompleksit Brezovica" dhe se "privatizimi i këtij kompleksi nuk do të ndodhë deri sa të definohej statusi i Kosovës".¹⁷⁶

Në valën e 40-të të privatizimit në Kosovë, AKP-ja kishte shpallur në ankand të shitjes kafeterinë "Shtërpca", restorantin "Kasollja Brezovicë", dhe kasollen e vogël "Murzhicë-Brezovicë". Me këtë AKP-ja paralajmëronte se ka filluar privatizimi i kompleksit që atëbotë kishte zgjuar interesimin e shumë blerësve potencial, por AKP-ja i tërhoqi nga ankandi këto tri njësi nga vala e 40-të dhe të njëjtat i barti në ankandin e valës vijuese. Megjithatë ato u tërhoqën sërish nga shitja duke dëshmuar kështu edhe një herë që privatizimi i aseteve të kompleksit Brezovica kërkon një konsensus më të gjerë të institucioneve qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës si edhe përkrahjen e institucioneve ndërkombëtare prezente në Kosovë për të ndërmarr hapat e nevojshëm në drejtim të futjes së kapitalit privat në këtë kompleks.

Ndërkohë me 2012 Zyra e BE-së në Kosovë ka financuar një Masterplan, i cili do të shërbejë si bazë për zhvillimin e një qendre turistike në Brezovicë, në pjesën perëndimore, afër qendrës ekzistuese të skijimit. Qendra e re do të ketë kapacitet për të akomoduar mbi 10 mijë mysafirë. Plani ka për qëllim që të bëjë Brezovicën një vend tërheqës për investitorë duke u kujdesur njëkohësisht edhe për ambientin unik natyral.¹⁷⁷

¹⁷⁶ http://www.eciks.org/english/lajme.php?action=total_news&main_id=460.

¹⁷⁷ http://www.eciks.org/english/lajme.php?action=total_news&main_id=1217.

3. Qeverisja korporatave, korporatizimi, restrukturimi, koncesionimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve publike

3.1. Korniza ligjore dhe institucionale

Ndërmarrjet publike (NP) janë me rëndësi strategjike për vendin. Ato ofrojnë shërbime vitale për qytetarët dhe punësojnë rreth 14,000 punëtorë, prej të cilëve 88% meshkuj dhe vetëm 12% femra¹⁷⁸.

Që nga viti 1999 NP-të kanë qenë nën mbikëqyrje të UNMIK-ut, ndërkaq me themelimin e AKM në qershor 2002, ato u vendosën nën menaxhimin e saj. AKM-ja ka korporatizuar të gjitha NP-të (gjithsej 25) që i kishte në portfolio dhe kishte formuar një strukturë të re të qeverisjes korporative, duke themeluar Bordet e Drejtorëve si organi më i lartë vendim-marrës në të gjitha NP-të. Pas përfundimit të misionit të AKM-së, shumica e anëtarëve të emëruar nga AKM-ja janë dorëhequr dhe për shkak të vonesës së emërimeve të reja nga ana e Qeverisë, bordet e NP-ve mbeten de facto jo-funksionale. Si rrjedhim, në momentin kur Qeveria mori kontrollin mbi menaxhmentin e NP-ve, më 1 korrik 2008, NP-të (me përjashtim të KEK-ut) nuk kishin borde.

Më 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe ka sqaruar pronësinë e NP-ve; NP-të qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës (d.m.th. publikut), ndërsa NP-të lokale janë në pronësi të Komunave. Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit në NP qendrore. Për NP-të lokale komunat bëjnë monitorimin dhe emërimin e anëtarëve të Bordit të drejtorëve. Për qindja e aksioneve në këto NP varet nga numri i konsumatorëve të komunave përkatëse, ashtu si është përcaktuar me Udhëzim të Qeverisë.

Ligji për NP është amendamentuar në mes të vitit 2012 dhe ka përmirësuar nivelin e komunikimit mes nivelit qendror dhe lokal. Tani NP-të nuk mund të miratojnë Plane të biznesit në kundërshtim me planet strategjike komunale dhe ato të ministrive relevante. Tani komunat mund të krijojnë NP lokale, sipas një rregulloreje të miratuar nga Qeveria në janar 2013, pasi që konstatohet se komunat kanë përmbushur kriteret të caktuara. Amendamenti i ligjit mbi NP ka mundësuar edhe pjesëmarrjen e komunave në Bordet e Kompanive Rajonale të Ujit (KRU), si dhe pjesëmarrjen e popullatës shumicë. Mënyra e nominimit të përfaqësuesve të komunave është rregulluar me Rregulloren e miratuar nga Qeveria.

Ligji për NP përcakton qartë se aksionari nuk mund të menaxhojë një NP, por ka të drejtë të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së së caktuar. Mirëpo mbikëqyrja nuk do të ushtrohet në një mënyrë që ndërhyr në veprimtarinë ose pavarësinë e Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit.

¹⁷⁸ Raporti i NP-ve 2010, fq. 19-20.

Baza ligjore për privatizimin e plotë apo të pjesshëm të një NP-je në Republikën e Kosovës gjendet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Shitjen e aksioneve e mundëson Ligji mbi NP-të, në veçanti neni 4, sipas të cilit të gjitha NP-të duhet të organizohet si shoqëri aksionare (SHA). Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përkatësisht neni 126, një SHA “është një person juridik që zotërohet nga aksionarët e saj, por që legalisht është i ndarë dhe i veçuar nga aksionarët e saj”. Ligji mbi Shoqëritë Tregtare nuk e kufizon transferimin e aksioneve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në ndonjë subjekt tjetër. Në mënyrë specifike, neni 9 i këtij Ligji rregullon privatizimin e NP-ve qendrore. Këto ligje përcaktojnë edhe mënyrën e funksionimit të NP-ve, mënyrën e financimit, caktimin e anëtarëve të bordeve, rekrutimin e drejtorit dhe stafit menaxherial dhe mënyrën e përcaktimit të nivelit bazë të pagave, etj.

Transformimi i një NP në pronësi private mund të bëhet në dy mënyra: i) përmes një procesi të rëndomtë të privatizimit (shitja e aksioneve të NP-së një subjekti privat përmes tenderit publik), dhe ii) përmes një partneriteti publiko-privat dhe/ose dhënies me koncesion për të ndërtuar, përdorur dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike, si dhe për të ofruar shërbime publike.

Sipas nenit 9.1 të Ligjit mbi NP-të, procedurat për privatizimin e një NP-je qendrore janë si në vijim: 1) Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim (KQP) për të vazhduar pastaj me tenderimin dhe shitjen e aksioneve të NP-së; 2) Vendimi i Qeverisë duhet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe 3) KQP vazhdon me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, përkatësisht me privatizim të plotë ose të pjesshëm të NP-së.

Në bazë të këtij Ligji, tenderimi dhe shitja e aksioneve të një NP-je qendrore duhet të bëhet në një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, por që formati i kësaj procedure përcaktohet nga KQP. Ligji thekson se kjo procedurë së paku duhet të jetë në përputhje me kërkesat procedurale të Ligjit mbi Procedurat për Dhënien e Koncesioneve.

AKP-ja është eliminuar nga procedura e privatizimit të NP-ve, pa marrë parasysh përvojën e saj në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha. Privatizimi i NP-ve i është lënë në kompetencë ekskluzive të Qeverisë.

Partneriteti publiko-privat është një tjetër mënyrë për të pasur një NP të privatizuar për një kohë të caktuar edhe këtë duke e dhënë atë në koncesion. Procedurat dhe çështjet e tjera për partneritetin publiko-privat rregullohen me Ligjin mbi Partneritetin Publiko-Privat.

Qëllimi i Ligjit të PPP-së është të caktojë kornizën ligjore për dhënien e partneritet publik-privat dhe të koncesioneve për të ndërtuar, përdorur dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike dhe për të ofruar shërbime publike. Veçanërisht, Ligji mbi PPP “rregullon të drejtat për të shfrytëzuar dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike dhe/ose për të ofruar shërbime publike në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror”.

Siç parashikohet nga neni 2, Ligji mbi PPP zbatohet për një gamë të gjerë fushash duke përfshirë, por jo kufizuar, atë të transportit, energjisë, ngrohjes, ujit, telekomunikacionit, arsimit, shëndetësisë, dhe shumë fusha të tjera. Rrjedhimisht, marrëveshjet mund të jenë bërë midis Republikës së Kosovës dhe një subjekti privat për të hyrë në një partneritet në lidhje me marrjen në pronësi dhe menaxhim të një entiteti të caktuar publiko-privat, apo në mënyrë më të thjeshtë dhënia në tërësi e këtij entiteti me koncesion një personi privat, dhe çdonjëra deri në 45 vjet. Procesi për realizimin e një PPP ose dhënia e një NP-je me koncesion për një palë private është përcaktuar në mënyrë strikte të jetë nën autoritetin e Qeverisë.

Çështjet kryesore që kanë të bëjnë me NP-të, me qëllim të përgatitjes së debatit në Qeveri, shqyrtohen nga Komisioni Ndërmintor për NP-të (që përbëhet nga ministrat përkatës të MF, MMPH, MZHE, MI dhe MTI)¹⁷⁹ dhe vepron si aksionar i autorizuar në Takimet e Përgjithshme Vjetore të NP-ve dhe në takimet tjera të aksionarëve. Ndërsa Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) mbështet Ministrin dhe Qeverinë në ushtrimin e përgjegjësisë ligjore ndaj NP-ve; mbikëqyr dhe monitoron ndërmarrjet publike, mbledh të dhëna, analizon dhe rekomandon lidhur me çështjet e NP-ve që janë në kompetencën e Ministrisë dhe Qeverisë, ofron përkrahje departamentit të buxhetit për aspektet buxhetore të NP-ve, etj. NJPMNP funksionon në kuadër të MZHE, udhëhiqet nga Drejtori, dhe ka një asistente dhe 5 analistë ekonomik të përgatitur në nivel të lartë profesional.¹⁸⁰ NJPMNP publikon raportin vjetor mbi monitorimin e NP-ve; raporti i vitit 2011 është në proces të miratimit dhe do të publikohet së shpejti. Vonesa në publikim është për shkak të vonesës së raporteve të auditimit të NP-ve të cilat duhet patjetër të inkorporohen në raportin e NJPMNP-së.

Veprimtaritë e NP-ve mbikëqyren dhe ndikohen në një mënyrë a tjetër edhe nga agjencitë e pavarura si Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në fushën e prokurimit publik; Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) që kryen auditimin e ligjshmërisë së buxhetit të konsoliduar të Kosovës, organizatave të tij buxhetore dhe subjekteve të tjera që marrin më tepër se 50% të buxhetit nga buxheti i Kosovës; Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK) si një organ kuazi-gjyqësor që mbikëqyr rregullat e konkurrencës nga të gjitha subjektet në Kosovë.

3.2. Statusi dhe sfidat

Kosova ka një sektor publik mjaft të madh i cili ka ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e vendit me një mesatare prej mbi 20% gjatë 5 viteve të fundit.

¹⁷⁹ Ibid, fq. 1.

¹⁸⁰ MZHE - <http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/?page=1,2>.

Tabela 9: Pjesëmarrja e sektorit publik në ekonomi

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
% e GDP					
Të hyrat totale	29.0%	24.2%	29.3%	27.8%	28.4%
Të hyrat tatimore	21.2%	20.6%	20.8%	21.3%	23.0%
Shpenzimet totale	19.5%	24.5%	29.0%	30.1%	29.9%
Shpenzimet aktuale	14.9%	15.4%	18.4%	17.8%	17.8%
Shpenzimet kapitale	4.6%	9.0%	10.2%	10.9%	11.5%
Konsumi publik	9.6%	9.7%	10.5%	11.5%	12.2%

Burimi: Ministria e Financave (Answers to the questionnaire for the feasibility study for the SAA, p.142-143)

AKM-ja ka qenë aksionari i vetëm i të gjitha NP-ve duke i mbajtur në mirëbesim 100% të aksioneve të NP-ve. Megjithëse korporatizimi nuk e ka ndryshuar statusin e pronësisë së NP-ve (për shkak se UNMIK-u nuk kishte qëndrim të qartë ndaj pronësisë së NP-ve, si pasojë e mos-definimit të statusit politik të Kosovës, AKM-së nuk i ishte dhënë mandati për t'i privatizuar NP-të), ky proces i ka vendosur ato në një kornizë të qartë ligjore duke i afruar ato një hap më afër privatizimit.

Procesi i emërimit të anëtarëve të bordeve të drejtorëve të NP-ve, si organi më i lartë vendim-marrës në NP ka qenë mjaft sfidues dhe është përcjellë me ndërhyrje nga akterë të ndryshëm. Një vështrim më i përafërt i këtij procesi, i analizuar nga organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare ka konstatuar se emërimet e anëtarëve të rinj të bordeve nuk kanë rezultuar çdoherë me borde profesionale dhe të pavarura. Edhe procesi aktual i emërimit të anëtarëve të bordeve është shoqëruar me vonesa të shumta që kanë rrjedh nga vonesat në miratimin e amandamentimit të ligjit mbi NP-të dhe Rregullores me të cilën është rregulluar mënyra e nominimit të përfaqësuesve të komunave në bordet e KRU-ve e që kanë pasur një ndikim negativ në vendim-marrjen strategjike dhe funksionimin efikas të NP-ve. Tanimë është shpallur konkursi për të gjitha bordet e NP qendrore dhe së shpejti do të kemi të emëruar bordet e reja.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës definon që "Republika e Kosovës është pronare e të gjitha ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, që njihen si NP ... Të gjitha obligimet që burojnë nga kjo pronësi do të jenë obligime të Republikës së Kosovës... Të drejtat pronësore në një NP që ofron shërbime vetëm në një komunë të caktuar ose në një numër të kufizuar të komunave do t'i takojnë asaj/atyre komunave, ... sikurse edhe obligimet përkatëse ...".

NP në Kosovë janë të ndara në Ndërmarrjet Publike Qendrore (NPQ) të cilat Qeveria mund t'i privatizojë, japë me koncesion ose me qira, dhe Ndërmarrjet Publike Lokale (NPL) ku pronare janë komunat, përcaktuar sipas Ligjit 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 03/1-087 për ndërmarrjet publike. Qeveria dhe komunat administrojnë me NP-të në pronësi të tyre vetëm përmes mekanizmave të parapara në ligjet në

fjalë, dhe nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në menaxhimin dhe pasurinë e një NP-je.

Portfolio momentale e NP-ve është 60, 18 prej tyre NPQ dhe 42 NPL.

Tabela 10: Lista e NPQ-ve dhe NPL-ve

Sektori	Ndërmarrjet Publike Qendrore	Ndërmarrjet Publike Lokale
Telekomuni- kimi	Posta e Kosovës Sh.A. Vala dhe Telekom i Kosovës Sh.A. (PTK)	
Energjetika	Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK) Kompania Kosovare për Distribucion dhe Furnizim (KKDFE) Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A (KOSTT) NPH Ibër Lepenci Sh.A [e njëjta kompani me atë të ujitjes, më poshtë]	Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A (Prishtinë) Ngrohtorja e Qytetit Sh.A (Gjakovë) Ngrohtorja e Qytetit, Mitrovicë [nuk është funksionale]
Transporti	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” Sh.A (ANP) [e ndarë në dy kompani: i) kompania e fluturimeve dhe shërbimeve të udhëtarëve (në koncesion), dhe ii) kompania e kontrollit të hapësirës ajrore (në pronë dhe menaxhim shtetëror)] Hekurudhat e Kosovës Sh.A [e ndarë në dy NP: TrainKos dhe Infrakos]	22 stacione të autobusëve Trafiku Urban (Prishtinë)

<p>Uji dhe mbeturinat</p>	<p>Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive Sh.A (KMDK) Kompania Rajonale e Ujësllësimit Prishtina Sh.A (Prishtinë) Kompania Rajonale e Ujësllësimit Radoniqi Sh.A (Gjakovë) Kompania Rajonale e Ujësllësimit Hidromorava Sh.A (Gjilan) Kompania Rajonale e Ujësllësimit Hidroregjioni Jugor Sh.A (Prizren) Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë Sh.A Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A Kompania Rajonale e Ujësllësimit Hidrodriani Sh.A (Pejë) Kompania Rajonale e Ujësllësimit Mitrovica Sh.A (Mitrovicë) NPH Ibër Lepenci Sh.A [e njëjta kompani me atë të energjisë, më lartë]</p>	<p>Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti Sh.A (Pejë) Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabрати Sh.A (Gjakovë) Kompania Rajonale e Mbeturinave Ekoregjioni Sh.A (Prizren) Kompania Rajonale e Mbeturinave Higjiena Sh.A (Gjilan) Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia Sh.A (Ferizaj) Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A (Prishtinë) Kompania Rajonale e Mbeturinave Uniteti Sh.A (Mitrovicë) Kompania e Mbeturinave JKP Standard (Mitrovicë) Kompania e Mbeturinave JKSP (Zveçan) Kompania e Ujësllësimit dhe Mbeturinave, Ibri (Zubin Potok) Kompania e Ujësllësimit dhe Mbeturinave, 24 Nëntori (Leposaviq) Hortikultura (Prishtinë)</p>
<p>Tregtia</p>		<p>NP Tregu, Mitrovicë Sport-Marketingu (Prishtinë)</p>
<p>Strehimi</p>		<p>Ndërmarrja Publike Banesore, Prishtinë Ndërmarrja Publike Banesore (Podujevë) Ndërmarrja Publike Banesore (Pejë)</p>

Burimi: NJPMNP - Raporti i NP-ve 2010 (me plotësime sipas vendimeve më të fundit për ristrukturim)

Në aspektin e qeverisjes korporative, NP-të kanë përzgjedhur dhe emëruar Bordet e drejtoreve; është bart pronësia në regjistrat e biznesit nga ish AKM në emër të Republikës së Kosovës; është bërë shuarja e të gjitha NP Holding që ishin krijuar në kohën e UNMIK-ut; janë formuar Komisionet e Auditimit; janë hartuar model aktet nënligjore (Statuti dhe Kodi) të cilat janë miratuar nga Bordet e NP-ve, janë nënshkruar zotimet për respektimin e ligjit dhe Kodit nga Bordi dhe Zyrtarët e lartë dhe janë mbajtur Mbledhjet e

Përgjithshme vjetore me Aksionarin.

Dokumentet Strategjike të NP-vë të miratuara nga Bordet respektive të drejtoreve përfshijnë:

- Statuti i NP;
- Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative;
- Plani i Biznesit;
- Raportet tremujore dhe Vjetore;
- Raporti i Auditorit të jashtëm;
- Rregulloret e brendshme të NP

Planet e biznesit përpilohen çdo vit dhe miratohen më së largu deri me 30 tetor për vitin vijues. Bordet e drejtorëve miratojnë edhe raportet e auditimit të jashtëm.

Pavarësisht përmirësimit të dukshëm në menaxhimin e NP-ve, mbeten një sërë sfidash që duhet adresuar në të ardhmen e afërt. NP-të kanë filluar punën nga viti 1999 me një gjendje të trashëguar jo të mirë për shkak të nivelit të ulët të investimeve dhe keqmenaxhimit të asetëve gjatë periudhës 1990-98. NP-të kanë nivel të lartë të borxheve të këqija, humbje të mëdha teknike dhe komerciale, si dhe përballen me nivel të ulët të inkasimit. Të gjitha këto ndikojnë në nivelin e ulët të investimeve në NP e që si pasojë pamundësojnë përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në çdo ligj vjetor të buxhetit parashihen fondet për blerjen e rrymës, mazutit për ngrohje në Prishtinë dhe Gjakovë, dhe për investime kapitale në NP, etj. Kështu shumë NP vazhdojnë të jenë barrë e buxhetit qeveritar, për shkak të pamundësisë për të arritur nivelin e duhur të qëndrueshmërisë financiare. Atyre u ofrohen subvencione direkte, grante për investime kapitale apo kredi për të mbuluar shpenzimet operative, financim i projekteve specifike, etj. Bazuar në politikat e projektuara në KASH, subvencionet ndaj NP-ve kanë trendin e rënies nga 2009 për 35% si rezultat i përmirësimit të performancës financiare të ndërmarreve¹⁸¹ (shih tabelën më poshtë) dhe pritet që në dy vitet e ardhme kjo përkrahje e qeverisë të zvogëlohet edhe më tej. Kjo është shumë e rëndësishme në drejtim të negociatave të pritura për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, sepse sipas standardeve të BE-së ndihma shtetërore është e lejuar vetëm në rastet kur është në interes të përgjithshëm dhe kur nuk shtrembëron konkurrencën.

¹⁸¹ Raporti i NP-ve 2010, fq. 9-10.

Tabela 11: Subvencionimi i NP-ve dhe Trepçës gjatë 5 viteve të fundit

Përshkrimi	Shpenzimet 2011	Shpenzimet 2010	Shpenzimet 2009	Shpenzimet 2008	Shpenzimet 2007
Energji - KEK	27,350,000	29,035,995	64,221,073	23,000,000	11,451,000
Importi i energjisë - rastet sociale	4,483,494	4,499,979	4,499,764	-	4,500,000
Hekurudhat e Kosovës	500,000	500,000	500,000	-	45,581
Ngrohja Qendrore	1,947,996	1,403,289	1,933,000	999,962	2,486,904
Uji dhe Mbeturinat	1,266,111	587,896	780,892	651,335	1,862,057
Minierat e Trepçës	1,911,380	3,082,870	4,739,431	984,058	3,089,431
Total	37,458,981	39,110,029	76,674,161	25,635,355	23,434,973

Burimi: MF (Answers to the questionnaire for the feasibility study for the SAA, fq.210)

Në aspektin e performancës operative, ka përmirësime të dukshme në sektorë të ndryshëm. Por pavarësisht kësaj, shumë NP përkundër subvencioneve dhe investimeve nga ana e Qeverisë nuk po arrijnë të maksimizojnë investimet e as të përmirësojnë kualitetin e shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve. Po ashtu, niveli i inkasimit nga konsumatorët për shërbimet e ofruara është shumë i vogël, sidomos në sektorin e mbeturinave ku shkalla e inkasimit sillet rreth 60%, në sektorin e ujërave rreth 67%, ndërkaq KEK ka rritur ndjeshëm shkallën e inkasimit gjatë vitit 2011, duke inkasuar rreth 13% më shumë se në vitin 2010 kur shkalla e inkasimit ishte 88 %.¹⁸²

Me qëllim të ristrukturimit të ekonomisë së vendit dhe ofrimit të një hapësire më të madhe për sektorin privat, si një parakusht për vendosjen e ekonomisë së tregut në të gjithë sektorët e ekonomisë, Qeveria është në përmbyllje të procesit të privatizimit të dy NP-ve më të rëndësishme në vend (PTK dhe KEK) dhe ka dhënë në koncesion afatgjatë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Përfshirja e sektorit privat në sektorin publik mbështetet në Ligjin mbi NP-të dhe në ligjin për Partneritetin Publiko Privat¹⁸³ si dhe në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014.

Në vazhdim janë dhënë përshkrimet e shkurtra të ndërmarrjeve kryesore publike.

3.3. KEK

KEK është NPQ e cila ka në pronësi dhe operon me asete të gjenerimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të mihjes së linjitet. Në planin afatgjatë linjiti është burimi kryesor për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë. Performanca operative dhe financiare e KEK-ut që nga viti 1999 është duke u përmirësuar në aspektin e prodhimit të thëngjillit, prodhimit të energjisë, zvogëlimit të humbjeve dhe rritjes së inkasimit. Përkundër këtyre përmirësimeve dhe ndihmave teknike dhe buxhetore, KEK-u ende

¹⁸² KEK - <http://www.kek-energy.com/defaultdetails.asp?ID=141>.

¹⁸³ Raporti i NP-ve 2010, fq. 17.

vuan shumë nga problemet teknike (teknologji e vjetruar), të personelit (numër i madh i të punësuarve) dhe menaxheriale. Humbjet komerciale janë të larta, niveli i vjedhjes dhe mospagesës është i lartë që shkakton rritjen e kërkesës për energji (në shpërputhje me rritjen ekonomike), importin e energjisë si dhe zvogëlimin e të ardhurave të KEK-ut.

Ndërtimi i Kosovës së Re nuk do të përfundoj deri me 2017. Ndërkohë KEK vazhdon të mbështetet nga Qeveria për rritjen e performancës financiare, për investimet kapitale dhe financimin e një pjesë të importit të energjisë elektrike, si parakushte për stabilizim të sistemit të energjisë elektrike. Për një zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit të energjisë, Qeveria në kuadër të Strategjisë së Energjisë 2009-2018 ka caktuar caqet strategjike 10 vjeçare në përputhje me direktivat e BE-së për promovimin e energjisë elektrike të ripërtërishme, për promovimin e shfrytëzimit të bio-karburanteve dhe karburanteve tjera të ripërtërishme për transport, mbrojtje të mjedisit, etj.¹⁸⁴

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT) u themelua në vitin 2006, në pajtim me dispozitat, mbi shthurjen/risstrukturimin e sektorit elektro-energetik, të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe kushtet e Traktatit për Komunitetin e Energjisë. KOSTT është NP përgjegjëse për operimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të bartjes dhe interkoneksionet e tij me sistemet energjetike fqinje, në mënyrë që të ruaj sigurinë për furnizim në Kosovë. KOSTT është përgjegjëse edhe për funksionimin dhe operimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë. Kosova është pjesë e Komunitetit Rajonal të Energjisë dhe është e lidhur në sistemin rajonal përmes interkoneksioneve me Serbinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Shqipërinë. Burimi kryesor i të ardhurave për KOSTT vjen në formën e pagesave për bartje që paguhen nga KEK sipas përcaktimit të ZRRE.¹⁸⁵

Me 2008 Qeveria ka miratuar ndarjen e re të KEK-ut dhe formimin e kompanisë së re për distribuim dhe furnizim me energji elektrike (KEDS), sipas kërkesave të BE-së, me qëllim të privatizimit.¹⁸⁶ Me privatizimin e KEDS-it synohet rritja e nivelit të inkasimit, zvogëlimi i humbjeve gjatë distribuimit, ndalimi i subvencioneve shtetërore dhe hapja e tregut të energjisë.¹⁸⁷ Nënshkrimi i marrëveshjes së shitblerjes me konsorciumin fitues Çalik-Limak (me ofertën financiare prej 26.3 mil) është bërë më 17 tetor 2012 dhe operimi pritet të filloj në maj 2013.

Sa i përket Kosovës së Re, Strategjia e Energjisë 2009-2018 me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm së sektorit të energjisë parashih kyçjen e ekspertizës dhe kapitalit privat nga jashtë. Sipas Strategjisë Projekti “Kosova e Re” duhet të ndërtohet në faza, ku faza e parë (1000 MW) do të mundësonte zëvendësimin e termocentralit Kosova A (de-komisionimin e tij), do të përmbushte nevojat vendore, dhe do të mundësonte rehabilitimin

¹⁸⁴ Strategjia e Energjisë 2009-2018, fq. 10-16.

¹⁸⁵ Ibid, fq. 12.

¹⁸⁶ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 142-143.

¹⁸⁷ SAPD: Sectoral meeting on Economy, 17 June 2010, Brussels, fq. 7.

e termocentralit Kosova B, në mënyrë që të ngritet besueshmëria e tij dhe të silltet në pajtueshmëri me standardet mjedisore të BE-së. Një sasi nga prodhimi i TC Kosova e Re do të mund të eksportohej. Faza e dytë (1000 MW) do të përmbushte kërkesën në rritje dhe do të mundësonte mbylljen e mëvonshme të Termocentralit Kosova B.¹⁸⁸

Ftesa për ofertim dhe Marrëveshjet e projektit janë finalizuar gjatë vitit 2011 dhe plani ka qenë që fituesi të shpallet në vitin 2012. Mirëpo qasja e Qeverisë në këtë drejtim ka ndërruar disa herë dhe kjo ka shkaktuar vonesa në proces dhe ka ndikuar që të humbin interesimin edhe kompani me renome në fushën e energjisë. Kosova B megjithatë është vendosur të ndahet nga projekti Kosova e Re për arsye të krizës në eurozonë dhe moshatshmërisë së investitorëve që të investojnë në Kosova B, por edhe me qëllim që investitori i ri të mos krijojë monopol në prodhimin e energjisë. Planit tani është të ndërtohet Kosova e Re me kapacitet 600 MW dhe të rehabilitohen dy blloqet e Kosovës B si dhe të hapet një minierë e re linjiti në Sibovc, të gjitha përmes PPP ku pronësia shtetërore do të jetë 31% në gjenerim dhe 49% në miniera.¹⁸⁹

Në mars 2012 Qeveria ka shpallur kërkesën për ofertim për katër investitorët e para-kualifikuar, dhe ka planifikuar që të përfundoj procesin deri në mes të vitit 2013¹⁹⁰. Ndërsa planet janë që të tri projektet të përfundojnë deri në fund të vitit 2017 në përputhje të plotë me direktivat e BE-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit, eficientë e energjisë, etj.

Megjithëse Strategjia parasheh mbylljen e Kosovës A, Qeveria ka vendosur të kryej rehabilitimin e disa blloqeve për furnizim të rreth 40% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë në vend, dhe të vazhdoj operimin e tyre deri më 2017. Ky vendim është marrë për shkak të vonesave me Kosovën e Re, rritjen e kërkesës për energji, zvogëlimin e importit, etj.¹⁹¹

Çmimet e energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) sipas autoritetit të dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë 03/L-185 dhe në bazë të Rregullës mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve). ZRRE cakton tarifat e energjisë elektrike për amvisëri. Tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët tjerë caktohen nga ZRRE vetëm në rastet kur konstatohet, bazuar në kriteret e ZRRE-së, se konkurrenca në tregun e energjisë elektrike nuk është efektive. Momentalisht nuk ka konkurrencë efektive në sektorin e energjisë elektrike, prandaj ZRRE ka rregulluar tarifat për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Në bazë të Rregullës së Çmimeve, tarifat e rregulluara të energjisë elektrike janë: Tarifat për Shitjen e Energjisë Elektrike Furnizuesit Publik; Tarifat për Shitjen e Energjisë Elektrike nga Furnizuesi Publik; Tarifat e Transmisionit

¹⁸⁸ Strategjia e Energjisë 2009-2018, fq. 25.

¹⁸⁹ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 447.

¹⁹⁰ Ibid.

¹⁹¹ Ibid, fq. 459-460.

(Bartjes); dhe Tarifat e Shpërndarjes. Për shkak të problemeve financiare të KEK-ut, ZRRE ka vendosur në gusht 2012 për ngritjen e tarifave për energji elektrike dhe pritjet që në një të ardhme të afërt të ketë edhe një ngritje tjetër veçanërisht për amvisëri, me pasojë amnistimin e mos-paguesit dhe ndëshkimin e paguesit të rregullt. Faturat shumë të larta të dy-tri muajve të fundit kanë shkaktuar pakënaqësi të lartë dhe protesta të qytetarëve. Tarifat për ngrohjen qendrore caktohen në bazë të Ligji 03/L-116, sipas të cilit ZRRE cakton çmimet dhe tarifat bazuar në propozimin vjetor të distributorit. Bordi udhëheqës i ZRRE-së kryesohet nga Kryesuesi dhe ka pesë anëtarë. Secili nga ta emërohet në afat alternues prej pesë vitesh.

Një pjesë e aktiviteteve të KEK-ut rregullohen nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) i cili rregullon veprimtaritë minerare në Kosovë në pajtim me ligjin dhe legjislacionin dytësor. Autoriteti i tij është përkufizuar në Ligjin për Miniera dhe Minerale. KPMM siguron hulumtimin e rregullt dhe eksploatimin e burimeve minerare në Kosovë; lëshon, bart, vazhdon, pezullon dhe revokon licencat dhe lejet; vendos dhe mirëmban databazën e informatave gjeografike të minierave. KPMM ofron ndihmë teknike për qeverinë në fushat e veta të ekspertizës. KPMM ka një Bord drejtues prej pesë anëtarësh dhe një drejtori të udhëhequr nga një Drejtor.

3.4. PTK

Në dhjetor 2008 Qeveria ka themeluar Komisionin ndër-qeveritar për të analizuar opsionet e privatizimit të PTK-së. Është bërë vlerësimi i të gjitha aspekteve të PTK-së dhe tregut potencial. Me propozim të këtij Komisioni dhe të Qeverisë, në korrik 2010 Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim privatizimin e 75% të PTK-së ndërsa në mars 2011 ka dhënë miratimin final për privatizim. Paralelisht, në vitin 2010 Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) me rekomandim të Qeverisë ka vendosur moratorium pesë vjeçar në lëshimin e licencave të reja për telefoni mobile në mënyrë që procesi i privatizimit të jetë transparent. Mirëpo sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, ky vendim i ART-së shpërfill interesat e konsumatorit dhe zvogëlon konkurrencën në sektor.¹⁹²

Nga pesë kompanitë që kishin aplikuar në fazën e para-kualifikimit, në qershor 2011 janë përzgjedh Hrvatski Telekom dhe Telecom Austria për të vazhduar garën. Pas tërheqjes së Hrvatski Telekom, Komisioni ka propozuar të ri-fillojë procesi dhe në ndërkohë të bëhen disa reforma për rritjen e vlerës së PTK-së, si ndarja e Postës, efektiviteti i kostos, etj. Ndarja e Postës ka filluar në nëntor 2011 dhe ka përfunduar në gusht 2012, ndërsa ri-tenderimi i PTK-së është iniciuar në mars 2012. Ndërkohë, Qeveria ka përgatit planin e implementimit të privatizimit të PTK-së dhe ka kontraktuar këshilltarin e ri të transaksionit.¹⁹³

¹⁹² Progress Report 2010, fq. 29.

¹⁹³ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 142-148.

Në qershor 2012 është shpallur thirrja për para-kualifikim të investitorëve potencialë. Kompanitë të cilat janë para-kualifikuar janë: Albright Vapital Management LLC (SHBA); Avicenna Capital LLC në konsorcium me Twelve HORNBEAMS (Mbretëria e Bashkuar dhe Poloni); Columbia Capital në konsorcium me ACP Axos Capital GmbH (SHBA dhe Gjermani); M1 International Limited (Mbretëria e Bashkuar dhe Virgin Islands); Turkcell (Turqi).

Qeveria ka planifikuar që procesi i privatizimit të PTK-së të përfundoj deri në fund të vitit 2012, mirëpo Komisioni Qeveritar ka vendosur që të shtyj afatin e aplikimit deri në fund të janarit 2013. Në prill 2013 konsorciumi Axos Capital është shpallur fitues me ofertën prej 277 milion EUR (shumë më ulët sesa që është pritur), dhe përmbyllje e privatizimit është në proces. Privatizimi pritet të kontribuoj jo vetëm në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë por edhe në përmirësimin e bilancit bankar gjatë viti 2013 e që do të mundësonte Qeverisë të absorboj goditjet e mundshme financiare.

PTK që nga gushti 2012 është ndarë në dy kompani që funksionojnë si të ndara: i) Posta e Kosovës që do të mbetet në pronësi shtetërore, dhe ii) Telekomunikacioni që përfshin shërbimet e telefonisë mobile, fikse dhe internetit është në proces të privatizimit.

Shërbimi i telefonisë mobile mbulon rreth 99% të popullsisë dhe 88% të territorit të Kosovës, prej të cilëve Vala mbulon mbi 67% të tregut Kosovar; shërbimit të internetit (broadband) mbulojnë rreth 34% të tregut, ndërsa Telekom i Kosovës mbulon shërbimet e telefonisë fikse rreth 93% të tregut. Në anën tjetër Posta ofron shërbime postare lokale dhe ndërkombëtare. PTK ka përmbyllur vitin 2010 me rreth 34 mil EUR fitim neto, apo rreth 11 mil EUR më pak se viti paraprak. Ndërkaq fitimi neto në vitin 2011 ishte rreth 46 mil EUR.

PTK operon në një treg me konkurrencë. Në tregun e telefonisë mobile Vala ka qenë për disa vite i vetmi operator i shërbimeve në Kosovë. Në dhjetor 2007 ka hyrë në treg operator i ri IPKO që ka marr një përqindje të konsiderueshme të tregut të dikurshëm të PTK-së. Përveç IPKO-s, në tregun e telefonisë mobile operon edhe Z-Mobile i cili është themeluar si MVNO në partneritet në mes të PTK-së dhe një operatori privat. Poashtu, në disa pjesë të territorit të Kosovës funksionojnë edhe operatorë të paligjshëm, por edhe operatorë të shteteve fqinje që operojnë në pjesë të caktuara duke përdorë pajisje për transmetim tejkuftar. Këta operatorë nuk kanë bazë të konsumatorëve në Kosovë, por për shkak të mbulueshmërisë së madhe marrin një pjesë të konsiderueshme të përdoruesve të roming-ut.

Tregun e telekomunikacionit e rregullon Autoriteti i Rregullatorit të Telekomunikacionit (ART), i cili është përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të telekomunikimit në Kosovë. Përcakton standardet për ofruesit e shërbimeve të telekomunikimit, inkurajon konkurrencën e tregut dhe siguron mbrojtjen e konsumatorit. Roli i tij është përcaktuar në Ligjin për Telekomunikacion. Bordi përbëhet nga pesë anëtarë secili me mandat pesë vjeçar.

3.5. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) “Adem Jashari” është ndërmarrje që vepron në fushën e qarkullimit civil dhe ushtarak, duke mundësuar fluturime në dhe prej Kosovës në shumë vende të botës. Përveç fluturimeve ANP ofron edhe shërbime të tjera si kargo - ofrimin e bartjes së mallrave, duty free shop dhe restorante/dyqane tjera, bankat dhe zyrat postare, etj. ANP si aset strategjik për qytetarët e Kosovës dhe për zhvillimin e vendit, në vitin 2010 është futur në PPP nga Qeveria për të krijuar një ambient më të mirë, infrastrukturë dhe shërbime të nivelit më të lartë, në pajtim me normat ndërkombëtare.¹⁹⁴

Para koncesionimit, Aeroporti ishte ndarë në dy kompani: i) kompania që merret me operacionet e fluturimeve dhe shërbimeve të udhëtarëve e që i është dhënë në koncesion për 20 vite konzorciumit Lion Limak-ut, dhe ii) kompania që merret me kontrollin e hapësirës ajrore, e cila mbetet në pronë dhe menaxhim shtetëror. Koncesionimi i Aeroportit është projekti i parë PPP në Kosovë dhe investitori pritet të ndërtoj terminal të ri, platforma të reja për aeroplanë, parkingun e ri, etj. Investitori është zotuar që të sigurojë punësimin për të gjithë punëtorët ekzistues për tri vitet e ardhshme.

Veprimtaria e aviacionit në Kosovë rregullohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC) që është themeluar me Ligjin për Aviacionin Civil si agjension rregullator. Është përgjegjës për të garantuar sigurinë e aviacionit civil, rregullimin ekonomik të aeroporteve, dhe shërbimet e navigimit ajror në Kosovë. Lëshon licenca dhe urdhërsa të navigimit ajror në pajtim me ligjin. Bordi Mbikëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë, dy prej tyre kanë mandat dy vjeçar (përfshirë kryesuesin), ndërsa tre të tjerët janë me mandat katër vjeçar. Anëtarët e Bordit emërohen nga qeveria. AAC i raporton direkt Kuvendit.

3.6. Hekurudhat e Kosovës

Ligji 04/L063 dhe UA 2-2012 mbi Hekurudhat vendos qasje të hapur dhe jo-diskriminuese për operatorët që ofrojnë shërbime në fushën e hekurudhave. Strategjia për Modelin e Transportit është aprovuar në nëntor 2009 dhe parasheh zhvillimin e hekurudhave deri në vitin 2030, përfshirë ndarjen e infrastrukturës hekurudhore në dy NP: TrainKos dhe Infrakos (e cila ka përfunduar në shtator 2011) dhe investimet kapitale në rreth 252 km të rrjetit hekurudhor.

Transporti hekurudhor ofron transport të mallrave, të udhëtarëve dhe transportin me kontejnerë. Hekurudhat kanë arritur që gjatë vitit 2010 të zvogëlojnë humbjet operative për 75% dhe humbjet neto financiare për 82% në krahasim me vitin 2009.¹⁹⁵ Raportet vjetore apo financiare/të auditimit të TrainKos dhe Infrakos nuk janë të disponueshme në uebfaqet e tyre respektive (për arsye se ndarja e tyre ka ndodhur në shtator 2011d

¹⁹⁴ SAPD: Economy, Financial Issues, Statistics, 1 June 2011, fq. 11.

¹⁹⁵ Raporti i NP-ve 2010, fq. 29-30.

he vlerësimi i performancës së tyre financiare në krahasim me vitin 2010 nuk është i mundur.

Rregullimi i sektorit të hekurudhave bëhet nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) i cili funksionon si organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës. ARH përcakton rregullat dhe kriteret për qasje në tregun e hekurudhave dhe bënë licencimin e operatorëve hekurudhorë, lëshon certifikata të sigurisë për operatorët hekurudhorë, dhe lëshon udhëzime të sigurisë, në përputhje me Licencat Evropiane, dhe SEETO. Operatorët aktual në Kosovë (TrainKos dhe Infrakos) janë në proces të licencimit dhe certifikimit të sigurisë.¹⁹⁶ Monitorimi i sigurisë së hekurudhave bëhet nga Departamenti i Sigurisë së Hekurudhave, në kuadër të ARH-së, derisa hetimi i aksidenteve hekurudhore bëhet nga Komisioni në sektorin e aviacionit dhe hekurudhave në ZKM sipas vendimit të Kryeministrit 03/68 dhe Ligjit për Hekurudha 03/L076.¹⁹⁷

Në vitin 2011 transporti i mallrave në Hekurudhat e Kosovës është rritur për 24%.

3.7. Stacionet e autobusëve

Stacionet e autobusëve trajtohen si ndërmarje shoqërore dhe rrjedhimisht kanë qenë nën administrimin e AKP-së. Në disa qytete të Kosovës, si në Prizren, Ferizaj, Gjilan, janë privatizuar transporti, mirëmbajtja dhe objektet jashtë stacionit të autobusëve që kanë qenë pjesë e NSH "Kosovatrans", ndërsa të gjitha NSH-të "Kosovatrans" që kanë pasur të organizuar transportin, i njëjti nuk operon më për shkak të konkurrencës së operatorëve privat që kanë gllabëruar tregun e tyre të dikurshëm. Pas privatizimit, në disa raste, stacionet e autobusëve e kanë humbur destinimin e mëparshëm të tyre dhe ato janë shit-blerë më shumë si patundshmëri, pasi që nuk është kërkuar garanci për vazhdimin e shërbimeve të stacioneve të autobusëve, pas privatizimit.

Sipas ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, 22 stacione të autobusëve kanë kaluar në pronësi komunale. Do të ishte me interes që udhëheqjet komunale në bashkëpunim me qeverinë të gjejnë zgjidhje sa më të përshtatshme për të maksimizuar përfitimet nga këto asete të rëndësishme, duke pasur si qëllim ofrimin e kushteve sa më të mira për operatorët gjë që do të ndikonte në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Një model i mundshëm për të arritur këto objektiva do mund të ishte partneriteti publiko-privat.

3.8. Kompanitë e ujërave dhe mbeturinave

Sipas ligjit për ujërat, menaxhimi i resurseve të ujit janë në kompetencë të Republikës së Kosovës zbatuar përmes ministrive, komunave dhe institucioneve tjera relevante si dhe ndërmarrjeve publike. Pavarësisht se përgjegjësinë kryesore e ka Ministria e Mjedisit

¹⁹⁶ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, f .443-444.

¹⁹⁷ Ibid, fq. 437-438.

dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ligji i ndryshuar i NP-ve përcakton se gjysma e Bordit të drejtorëve të NP-ve të ujësjellësit emërohen me propozim të komunave dhe këto NP raportet e tyre i dërgojnë edhe Kryetarëve të komunave përkatëse, duke i ofruar kështu mundësinë komunave të jenë më të përfshira në menaxhimin e shërbimeve të ujësjellësit.

Veprimtaritë e kompanive të ujërave dhe mbeturinave rregullohen nga Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRUM), e cila bën mbikëqyrjen e shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë, licencon ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave dhe përcakton tarifën e tyre. Poashtu ruan standardet e shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve. Zyra funksionon sipas kornizës ligjore të Ligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave. Kryesohet nga një Drejtor dhe një Zëvendës Drejtor të cilët emërohen nga Kuvendi me mandate pesë vjeçar.

ZRRUM ka licencuar të gjitha NP-të që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe momentalisht nuk ka asnjë operator privat në këtë fushë.¹⁹⁸

Performanca e NP-ve të ujësjellësit është përmirësuar viteve të fundit në prodhim (rreth 6 mil m³) dhe inkasim (3%), por përkeqësim në humbje (1%) dhe lë shumë për të dëshiruar në kuptim të humbjes së madhe të ujit (rreth 60%; 30% vetëm në veri të vendit), shkallë të ulët të arkëtimit (rreth 65%), pakënaqësi nga konsumatorët, bilanc të përgjithshëm negativ në aspektin financiar, etj.¹⁹⁹ Viteve të fundit ka pasur investime të mëdha nga donatorët e ndryshëm. Për më tepër Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS) është duke përgatitur një Strategji për reduktimin e humbjeve të ujit. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza ka filluar në Pejë, Prizren dhe Gjakovë dhe pritet që impianti në vlerë prej 22 mil EUR të ndërtohet në Prizren. Pritet që studimi të bëhet edhe në komuna tjera në të ardhmen e afërt. Këto impiante do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes së ambientit në Kosovë, mirëpo nuk pritet të ketë përfitime materiale për vet kompanitë.

Ligji për mbeturina parashih dy nivele të autoriteteve përgjegjëse për menaxhim të mbeturinave: Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me institucione tjera të nivelit qendror përgjegjëse për hartimin e politikave, licencimin, identifikimin e metodologjive për caktimin e tarifave, monitorim, etj dhe komunat për administrimin e mbeturinave dhe krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve nga kompani publike apo private.²⁰⁰

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) dhe 7 NP rajonale janë NPQ, ndërsa të gjitha ndërmarrjet tjera në sektorin e mbeturinave janë NPL. 7 NP ra-

¹⁹⁸ Ibid, fq. 143-144.

¹⁹⁹ Raporti i NP-ve 2010, fq. 45-47.

²⁰⁰ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 491-492.

jonale i kanë borxh KMDK-së 2.5 mil EUR që bënë operimin e kësaj të fundit shumë të vështirë. Nga pamundësia e trajtimit të mbeturinave në deponi (si pasojë e mospagesës), mund të vie deri te kanosja e ambientit. Përveç kësaj sektori ballafaqohet me të njëjta probleme - investime të ulëta dhe të hyra të ulëta nga inkasimi. Me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave komunale është përfshirë 47% të numrit të përgjithshëm të popullatës.²⁰¹

ZRRUM ka licencuar NP-të që ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave, dhe nuk ka licencuar asnjë operator privat, por ky funksion sipas ligjit të ri mbi mbeturinat i takon MMPH. Operatorët për mbledhjen e mbeturinave mund të kontraktohen nga NP-të dhe kjo është bërë në disa komuna. Deponitë sanitare janë NPQ, mirëpo ato pritet të transferohen në kompetencë komunale.²⁰²

Sikurse NP-të e ujësjellësit edhe NP-të që ofrojnë shërbime të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave subvencionohen nga Qeveria si pasojë e bilancit negativ financiar. Për më tepër, këto NP përballen me investime të ulëta dhe të hyra të ulëta për shkak të inkasimit të dobët. Mbeturinat në Kosovë duhet të riciklohen në mënyrë që të përmbushen standardet evropiane (sasia e mbeturinave në deponitë sanitare është në rritje nga viti në vit). IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare) është kontraktuar nga Qeveria për të analizuar gjendjen dhe mundësitë për futjen e kapitalit privat në këtë sektor.²⁰³

3.9. Kompanitë e ngrohjes qendrore

Kompanitë e ngrohjes qendrore ekzistojnë në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë si NPL (kjo e fundit nuk funksionon). Këto së bashku gjenerojnë vetëm rreth 3% të kërkesës së Kosovës për ngrohje (vetëm Prishtina përbën rreth 80% të këtij kapaciteti). Ato furnizojnë pjesët më të dendura të qyteteve dhe objekteve publike si spitalet, shkollat dhe ndërtesat administrative. Këto sisteme vuajnë nga teknologjia e vjetruar, menaxhimi i dobët, humbje shumë të mëdha komerciale të shkaktuara nga mospagesa e faturave që shkaktojnë paqëndrueshmëri, pa subvencionet shtetërore.²⁰⁴ Projekti i ko-gjenerimit mes Kosovës B dhe Termokosit është në implementim e sipër, e që pritet të jetë më i pastër për ambientin, të zvogëloj shpenzimet e Termokosit dhe zvogëlimin e kërkesës për energji elektrike për ngrohje.²⁰⁵

4. Konkluzione

Përkundër progresit që është arritur deri më tani në përmirësimin e infrastrukturës

²⁰¹ Ibid, fq. 491.

²⁰² Ibid, fq. 491-492.

²⁰³ Raporti i NP-ve 2010, fq. 82-84.

²⁰⁴ Strategjia e Energjisë 2009-2018, fq. 6-14.

²⁰⁵ Answers to the questionnaire for the feasibility study for the stabilisation and association agreement, fq. 448-451.

fizike dhe ligjore të Kosovës, duhet të bëhet edhe shumë punë për të krijuar një ambient të favorshëm për investitorë. Disa prej sfidave kryesore të cilat duhet adresuar, e që janë dekurajuese për investitorët e huaj, janë:

- **Ambienti ligjor dhe rregullativ:** ambienti ligjor i Kosovës ka ende mungesa të rëndësishme, me një sistem gjyqësor ende në konsolidim dhe jo-efiçent që nuk ofron siguri të mjaftueshme për investitorët. Disa ligje të rëndësishme ende mungojnë apo duhet të ndryshohen.²⁰⁶ Megjithëse rregullatorët e pavarur janë themeluar në kohën e administrimit të UNMIK-ut, pas qershorit të vitit 2008, janë vërejtur tendenca nga disa ministri të linjës për të ndërhyrë në mandatin e rregullatorëve duke bartur kompetenca të caktuara prej rregullatorëve tek qeveria.²⁰⁷ Disa rregullatorë kanë pasur vështirësi në funksionim për shkak të vakumeve të shkaktuara nga vonesa në emërimin e anëtarëve të bordeve nga ana e Kuvendit.²⁰⁸ Vendet e lira të punës mbeten të hapura për periudha të zgjatura kohore duke penguar seriozisht funksionimin e institucioneve përkatëse. Për më tepër nuk ka përkrahje të mjaftueshme politike për punën e institucioneve të pavarura që si rrjedhojë ndikon në legjitimitetin e zbehur të tyre dhe në reagimin e dobët nga ana e ekzekutivit.²⁰⁹ Praktikant kanë dëshmuar se ndërhyrjet politike në caktimin e menaxherëve dhe anëtarëve të bordeve dobësojnë qeverisjen korporative në NP, ndërkaq mungesa e mbrojtjes adekuate të konsumatorit, ka ndikim negativ në liberalizimin e tregut dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.
- **Qasja e kufizuar e NP-ve në lokalitetet e banuara me popullatë jo-shumicë:** Në disa lokalitete të Kosovës të banuara kryesisht me popullatë serbe, NP-të kanë mundësi të kufizuar për ushtrimin e veprimtarisë së tyre ose nuk kanë fare mundësi për operim. Për shembull, KEK nuk ka qenë në gjendje të faturoj e as të arkëtoj për energjinë elektrike që u ka ofruar popullatës serbe në komunat në veri të vendit. Për shkak të arsyeve politike, KEK-u nuk ka qenë në gjendje për t'i ç'kyçur konsumatorët në këto lokalitete. Adresimi i kësaj çështjeje do të ndikonte pozitivisht në tërheqjen e investitorëve kredibil.
- **Statusi ndërkombëtar i Kosovës:** Kosova nuk ka arritur të anëtarësohet në disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare, si Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (UNT). Kjo ka pamundësuar që Kosova të ketë kodin e saj ndërkombëtar të thirrjeve që ndikon jo vetëm në zbehjen e interesimit të investitorëve potencial, por ka edhe implikime të mëdha komerciale për PTK-në.

Përkundër këtyre sfidave, argumenti i përgjithshëm pro privatizimit të NP-ve të cilat funksionojnë në një ambient normal komercial është se pronarët privat kanë më shumë mundësi që të menaxhojnë më me profitabilitet një biznes. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në rastin e PTK-së, ku kufizimet në fushat si prokurimi publik paraqesin një pengesë të jashtëzakonshme për funksionimin e suksesshëm komercial të kompanisë duke pasur parasysh që PTK operon në një treg ku ka konkurrencë. Për më tepër, duhet theksuar që menaxhmenti i një NP-je është shpesh subjekt i ndërhyrjeve dhe instruk-

²⁰⁶ Communication from the Commission to the European Parliament and the Council on a Feasibility Study for a Stabilization and Association Agreement between the European Union and Kosovo, fq. 7.

²⁰⁷ ICO: Economic Regulators in Kosovo - An overview of the state of their independence, fq. 11.

²⁰⁸ Ibid, fq. 6.

²⁰⁹ OSBE: Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë. Korrik, 2012, fq. 4.

sioneve politike, që kanë një efekt negativ në imazhin e përgjithshëm të NP-ve dhe ndikojnë në efikasitetin komercial. ²¹⁰ Menaxhmenti privat është sigurisht më imun në këtë drejtim.

Disa prej aspekteve më të rëndësishme për privatizimin e NP-ve në Kosovë janë:

- Arritja e një përfitimi më të lartë financiar se sa dividenda që paguhet nga NP-ja (dhe natyrisht pranimi i këtyre fondeve në mënyrë të njëhershme si 'avans'), fonde të cilat mund të përdoren në implementimin e projekteve të rëndësishme strategjike që kanë për qëllim rritjen e zhvillimit ekonomik dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës.
- Ofrimi i shërbimeve më të mira për konsumatorë dhe reduktimi i mundësive për korrupsion i cili perceptohet të jetë në nivel shumë të lartë tek kompanitë në menaxhim publik.
- Eliminimi i subvencioneve për NP-të.
- Rritja e atraktivitetit të Kosovës si një destinacion për investimet e huaja.

Sido që të jetë, është shumë e rëndësishme që privatizimi të bëhet në mënyrë të duhur dhe transparente në mënyrë që të mos pengohen operacionet e NP-ve.

²¹⁰ Në vitin 2010, Qeveria mori vendim që të ndërpresë disa investime të rëndësishme kapitale në PTK, nën arsyetimin se kjo NP pritej të privatizohej.

Prednosti	Izazovi	Preporuke
Privatizacija/likvidacija društvenih preduzeća i javnih preduzeća		
<p>Strateška aktiva i imovina preduzeća koja može neposredno da doprinese socio-ekonomskom razvoju zemlje</p> <p>Zakonodavni okvir u skladu sa načelima EU</p> <p>Značajno iskustvo KAP u procesu privatizacije</p> <p>Uneta dinamika u procesu, posebno posle uspostavljanja KAP i ispunjenja ugovora nasleđenih od PAK</p> <p>Potraživanja u likvidaciji 180 DP biće razmotrena do aprila 2013. god.</p> <p>Završetak procesa privatizacije i likvidacije DP u 2016. god.</p> <p>KAP je otvorila pomoćne kancelarije i privatizovala je neka mala preduzeća na severu</p>	<p>Mungesë e strategjive të përshtatshme për privatizim/likuidim me objektiva të qarta matëse ka ndikuar në mosarritjen e efekteve të dëshiruara për zhvillim socio-ekonomik të vendit</p> <p>Vështirësitë në shtrirjen e kontrollit menaxherial në të gjithë njësitë, asetet dhe pronat, sidomos në veri të vendit</p> <p>Zhagjitjet në riorganizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve dhe implementimin e proceseve tenderuese</p> <p>Procesi është përcjellë me barriera të ndryshme që kanë ndikuar në uljen e vlerës së asetëve, humbjen e tregjeve të ndërmarrjeve dhe dekurajimin e investitorëve potencial</p> <p>Ndërmarrjet e privatizuara nuk monitorohen për të siguruar se investitorët përbushin të gjitha obligimet/zotimet (punësimi, investimi, destinimi, etj)</p> <p>Mos-efikasiteti i Dhomës së Posaçme, në zgjidhjen e kërkesave dhe aprovimin e listave për shpërndarjen e mjeteve të privatizimit, shkakton vonesa</p> <p>Të hyrat nga privatizimi mbeten të bllokua në BQK, me normë shumë të ulët të interesit, pa u shfrytëzuar për investime të rëndësishme dhe gjenerim të zhvillimit ekonomik</p> <p>Procesi nuk ka mbështetje të gjerë shoqërore dhe perceptohet se ka ndërhyrje politike dhe korrupsion</p> <p>Kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore për të përshpejtuar procesin e likuidimit</p> <p>Procesi i privatizimit/likuidimit mund të mos përfundoj me 2016 duke pas parasysh portfolion e ndërmarrjeve dhe mungesën e dokumentacionit kadastral, mos-ekzistimin e dokumenteve të pronësisë dhe regjistrave të vjetër të kadastrës</p>	<p>Privatizimi duhet të planifikohet dhe të përcaktohen objektivat e qarta matëse</p> <p>Përkrahja institucionale e blerësve të rinj dhe monitorimi i përbushjes së kushteve dhe obligimeve kontraktuese</p> <p>Dhoma e Posaçme duhet të përshpejtoj procedurat për zgjidhjen e rasteve që t'i mundësojë AKP-së punë më efektive</p> <p>Së paku një përqindje e konsiderueshme e të hyrave nga privatizimi duhet të zhblokohen sa më shpejtë që është e mundur, sepse shqyrtimi i të gjitha kërkesave nga Dhoma e Posaçme mund të merr shumë kohë, dhe të futen në ekonominë e vendit.</p> <p>Të respektohen parimet dhe standardet e BE-së për një proces transparent dhe të përmirësohet komunikimi me grupet e interesit për të siguruar një konsensus sa më të gjerë shoqëror dhe për të evituar gabimet eventuale sa i përket pronësisë së ndërmarrjeve, e që do të mundësonin përshpejtimin e procesit të privatizimit dhe likuidimit</p> <p>Të vazhdohet përkrahja financiare dhe institucionale ndaj AKP-së për të përfunduar i gjithë procesi në vitin 2016</p> <p>Institucionet vendore duhet të shtojnë përpjekjet për sigurimin e dokumenteve origjinale të pronësisë</p> <p>Të nxjerren mësimet nga privatizimet e deritanishme dhe ato të aplikohen në proceset e ardhshme</p>
Qeverisja korporative e NP-ve		

<p>Kornizë legjislative e qeverisjes korporative që përcakton qartë mënyrën e funksionimit të NP-ve, financimit, caktimin e anëtarëve të bordeve, rekrutimin e drejtorëve dhe stafit menaxherial, mënyrën e përcaktimit të nivelit bazë të pagave, ndarjen e aksionarëve nga menaxhimi, etj</p> <p>NP-të kanë filluar dhe tanimë përfillin obligimet ligjore (formimi i Komisione ve të Auditimit; hartimi dhe miratimi i Statutit dhe Kodit; nënshkrimi i zotimit për respektimin e ligjit dhe Kodit nga Bordi dhe Zyrtaret e lartë; Mbledhjet e Përgjithshme vjetore me Aksionarin, Planet e biznesit përpilohen dhe miratohen çdo vit, etj)</p> <p>Performanca e NP-ve është duke u përmirësuar dhe përkrahja financiare e qeverisë pritet të zvogëlohet në dy vitet e ardhme</p> <p>Është themeluar një strukturë e mirë dhe funksionale për të gjithë rregullatorët ekonomik, kryesisht në pajtim me parimet e BE-së</p> <p>Hapësirë për futjen e kapitalit privat në sektorë të ndryshëm (p.sh. menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi, telekomunikim, etj)</p>	<p>Vonesat dhe ndërhyrje eventuale në emërimet e anëtarëve të bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të NP-ve dhe rregullatorëve, duke mos rezultuar çdoherë me borde profesionale dhe të pavarura e që kanë ndikim negativ në vendim-marrjen strategjike dhe funksionimin efikas të NP-ve</p> <p>Mbikëqyrja e bordeve dhe menaxhmentit të NP-ve nuk është sa duhet rigorozë dhe transparente duke publikuar raportet vjetor në baza të rregullta</p> <p>Neni 7.6 i ligjit thirret në pavarësinë e bordit dhe shpesh e pengon mbikëqyrjen efektive</p> <p>NP-të kanë nivel të lartë të borxheve të këqija, humbje të mëdha teknike dhe komerciale, si dhe përballen me nivel të ulët të inkasimit, që ndikojnë në nivelin e ulët të investimeve në NP dhe pamundësojnë përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve</p> <p>Ndërhyrjet në mandatin e rregullatorëve, bartja e kompetencave të caktuara prej rregullatorëve tek qeveria përmes amandamentimit të ligjeve</p> <p>Përkrahja e pa-mjaftueshme politike për punën e institucioneve të pavarura</p> <p>Pavarësi e pamjaftueshme financiare e rregullatorëve</p>	<p>Të respektohen dispozitat ligjore gjatë emërimit të anëtarëve të bordeve dhe menaxhmentit të NP-ve dhe rregullatorëve për të siguruar emërimet profesionale, meritore dhe pa ndikime</p> <p>Monitorimi më efikas i NP-ve kërkon numër më të madh të stafit brenda NjPMNP</p> <p>Të respektohen parimet dhe standardet e BE-së dhe OECD-së për qeverisje korporative. Të sigurohet vlerësimi sa më objektiv dhe i rregullt i performancës së bordeve dhe menaxhmentit të NP-ve</p> <p>Të gjenden forma praktike që sigurojnë rritjen e performancës operative dhe financiare të NP-ve për të evituar humbjet teknike dhe komerciale, që do të mundësonte investime më të mëdha dhe përmirësim të shërbimeve.</p> <p>Duhet punuar në drejtim të forcimit të sundimit të ligjit, ndoshta edhe të krijimit të një Ode të veçantë për lëndët e NP-ve</p> <p>Ndalja e ndihmës nga Qeveria, gjë që është shumë e rëndësishme në procesin e negociimit të MSA-së</p> <p>Të përmirësohet bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës me qëllim të gjetjes së një modeli të qëndrueshëm financimi që ruan pavarësinë financiare të rregullatorëve</p>
--	---	--

Kapitulli VII – Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike (KBFP)

1. Kërkesat e BE-së në proces të integritimit

Koncepti i Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) është zhvilluar nga Komisioni Evropian gjatë viteve 1990 dhe sot përdoret për të drejtuar dhe mbështetur vendet candidate në përpjekjet e tyre për të zhvilluar sisteme moderne publike të kontrollit të brendshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira të BE-së. KBFP është një sistem i përgjithshëm i kontrollit financiar i cili synon të sigurojë se menaxhimi dhe kontrolli i buxhetit është në përputhje me kornizën ligjore dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar si transparencja, efikasiteti, efektiviteti, etj. KBFP përmban të gjitha masat për kontroll të të hyrave, shpenzimeve, asetëve dhe detyrimeve qeveritare. KBFP përfaqëson kontrollin e brendshëm në kuptim më të gjerë duke përfshirë, mes tjerash, kontroll financiar ex ante dhe auditim të brendshëm ex post. Ka shumë arsye për zbatimin e KBFP-së. Një sistem i KBFP-së që funksionon siç duhet, ndër të tjera, siguron menaxhim të shëndoshë financiar, rrit besimin e publikut në qeverisjen kombëtare, lehtëson menaxhimin për të arritur objektivat organizative, ofron palëve të interesuara pritje të qarta në lidhje me kapacitetin e menaxhimit buxhetor dhe siguron për Kuvendin një pasqyrë të qartë të mjedisit të kontrollit dhe performancës në sektorin publik. Në këtë aspekt, KBFP ofron një qasje sistematike të menaxhimit dhe zhvillon përgjegjësinë dhe llogaridhënien e menaxhmentit.

KBFP është sistem shumë i rëndësishëm për përkrahje të strukturave në kuadër të sistemit të decentralizuar të implementimit të fondeve të BE-së.

1.1. Menaxhimi i Financave Publike (MFP)

Përmirësimet në sistemet e menaxhimit të financave publike shihen si thelbësore për zbatimin e duhur të politikave të Bashkimit Evropian si dhe për arritjen e qëndrueshme të objektivave të zhvillimit.

Përmirësimet në menaxhimin e financave publike cilësohen nga Komisioni Evropian si kritere të kualifikueshmërisë dhe objektiv për mbështetje buxhetore.

Komisioni Evropian aplikon interpretim rigoroz dhe dinamik të punës së tij mbi vlerësimin e kësaj fushe – nuk është bërë ndonjë përpjekje për të krijuar kushtet minimale; për më tepër, theksi bie mbi përkushtimin e një vendi partner për të ndryshuar dhe drejtuar në të ardhmen sistemet e tij të menaxhimit të financave publike.

MFP duhet të kuptohet në kuadër të kontekstit social, politik dhe ekonomik që përfshin institucionet, fasilitatorët dhe kornizën e menaxhimit. Ky kontekst, duke përfshirë edhe faktorë të tjerë si stabiliteti makro-ekonomik dhe normat kulturore, kushtëzon efektivitetin e tij. MFP gjithashtu është e lidhur ngushtë me sferën e menaxhimit efektiv publik më në përgjithësi, duke përfshirë lidhshërinë, menaxhimin e performancës, transparencën dhe llogaridhënien, si dhe temat ndër-sektoriale të tilla si qëndrueshmëria, efika-

siteti dhe standardet etike.

1.2. Kapitulli 32 i Acquis Communautaire

Kapitulli 32 mbulon dy fusha kryesore të politikave: (a) kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP) dhe Auditimin e Jashtëm (AJ), dhe (b) mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe mbrojtjen e euros nga falsifikimi.

Për sa i përket fushës së KBFP-së dhe Auditimit të Jashtëm, nuk ka legjislacion specifik të BE-së që do të përdorej në përafrimin e ligjeve kombëtare. Në vend të kësaj, vendet angazhohen që të përvetësojnë standardet ndërkombëtare të kontrollit dhe auditimit të jashtëm si dhe praktikatat e mira të BE-së. Për këtë qëllim, vendi kandidat duhet të diskutojë me Komisionin dhe të miratojë një Dokument të Politikave të KBFP-së me një plan afatshkurtër dhe afatgjatë veprimi me afate realiste.

Kapitulli 32 ka të bëjë me miratimin e standardeve dhe metodave të KBFP-së sipas parimeve të pranuar ndërkombëtarisht, që duhet të aplikohen në tërë sektorin publik, duke përfshirë edhe shpenzimin e fondeve të BE.

Në veçanti, Acquis kërkon ekzistencën e:

- sistemeve efektive dhe transparente të kontrollit dhe menaxhimit financiar (përfshi inspektimet dhe kontrollet financiare adekuate ex-ante, të vazhdueshme dhe ex-post);
- sistemeve funksionale të pavarura të auditimit të brendshëm;
- strukturave përkatëse organizative (përfshi koordinimin qendror); dhe
- auditimin e jashtëm funksional dhe financiarisht të pavarur, ndër të tjera, duke vlerësuar cilësinë e sistemeve të krijuara të KBFP-së.

1.3. Komunikata e Komisionit Evropian lidhur me Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit 2012

Bashkëpunimi me BE-në në kuadër të MSA-së, sipas Komunikatës, do të përqendrohet në kontrollin e brendshëm të financave publike dhe auditimin e jashtëm. Objektivi i bashkëpunimit do të jetë “ngritja dhe zbatimi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe për të forcuar rolin e auditimit të jashtëm në përputhje me kornizat dhe standardet ndërkombëtare”.²¹¹

Përkufizimi i Komisionit të BE-së dhe pritjet për sistemin e KBFP-së mund të gjenden në Aneksin 1.

Më poshtë është dhënë konkluzioni i Komisionit Evropian mbi atë se si të adresohet

²¹¹ Standardet ndërkombëtare për auditimin e jashtëm mund të gjenden në www.issai.org dhe për auditimin e brendshëm në <https://na.theiaa.org>.

sektori i KBFP-së (raporti mbi Studimin e Fizibilitetit):

“Për të përmbushur obligimet e veta në kuadër të MSA-së, Kosova duhet të përmirësojë praktikën e përditshme të kontrollit të brendshëm. Duhet të bëhet më shumë për të zhvilluar një mjedis të kontrollit të bazuar në rrezik, për të përmirësuar efektivitetin, efikasitetin dhe ekonominë e aktiviteteve, për të rritur besueshmërinë e raportimit (financiar) dhe për të bërë rregullime më të mira buxhetore dhe planifikuese. Gjithashtu nevojitet mirëkuptim dhe pranim më i madh i llogaridhënies brenda organizatave buxhetore për të krijuar një kulturë të delegimit të përgjegjësive dhe autoriteteve. Kosova duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë pavarësisë së funksionit të auditimit të brendshëm, veçanërisht në nivel lokal”.

Më tutje, ZAP “duhet të përmirësojë kapacitetin e saj për të kryer auditimin e performancës”, dhe pasi ZAP “është pjesë e shërbimit civil, zbatimi i legjislacionit të ligjit të shërbimit civil është tepër normativ dhe kufizon në praktikë pavarësinë funksionale të ZAP-it”.

Duhet të theksohet se Komisioni në raportin e studimit të fizibilitetit ka adresuar sfidat aktuale në një perspektivë të gjerë të MFP-së, duke përfshirë edhe fushat të cilat në përgjithësi nuk janë mbuluar në përkufizimin më të ngushtë të KBFP-së. Më konkretisht Komisioni Evropian nga Qeveria e Kosovës kërkon adresimin e sfidave në vijim:

- Ngritja e kapaciteteve të NjQH-MFK-së dhe OB-ve
- Përditësimi i praktikave të kontrollit të brendshëm
- Përmirësimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomizimit për paranë publike
- Mirëkuptimi më i madh i pranimin të përgjegjësive dhe llogaridhënies
- Krijimi i kulturës së delegimit të përgjegjësive
- Krijimi dhe zbatimi i procedurave të brendshme për menaxhim të rrezikut në arritjen e objektivave të përcaktuara
- Harmonizimi i akteve ligjore primare dhe sekondare me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe të BE-së
- Rritjen e besueshmërisë së raporteve
- Planifikim dhe shpenzim më të mirë të buxhetit, etj.

2. Korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë

Kjo pjesë shqyrton gjendjen aktuale në Kosovë në lidhje me kornizën ekzistuese ligjore lidhur me KBFP-në dhe institucionet për zbatimin e tij.

Në mënyrë që KBFP të funksionojë efektivisht duhet të ekzistojë një mjedis koherent i kontrollit që mbulon përgjegjësitë e menaxhimit financiar të menaxherëve dhe organizatave, si dhe funksionin e aftë dhe me vlerë të shtuar të auditimit të brendshëm. Në Kosovë, kjo kornizë është përcaktuar nga legjislacioni dhe një aparat institucional për zbatimin e legjislacionit. Këto janë përshkruar më poshtë.

2.1. Korniza ligjore

Në Kosovë, ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legislative që rregullon fushën e KB-FP-së, duke përfshirë: udhëzimet, standardet e tjera autoritative; politikat e Qeverisë së Kosovës; legjislacionin primar dhe legjislacionin mbështetës sekondar dhe terciar, si më poshtë:

- Baza e Politikave të BE-së: Acquis Communautaire (kryesisht Kapitulli 32)
- Standardet e tjera autoritative: standardet INTOSAI dhe COSO për kontrollin dhe menaxhimin e riskut dhe Modeli i CIPFA për Menaxhimin Financiar;
- Politikat e Qeverisë së Kosovës: Dokumenti i Politikave të KBFP-së 2005, rishikuar me 2011;
- Legjislacioni primar: Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji nr. 03/L-048, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L116) dhe Ligji mbi Auditimin e Brendshëm (Ligji nr 03/L-128) i cili është rishikuar në vitin 2009; me këtë është krijuar një bazë solide ligjore për funksionimin e KB-FP-së.
- Legjislacioni sekondar dhe terciar: Rregullat e Thesarit 1 - për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, Rregulla Financiare e Thesarit 2- Shpenzimi i parasë publike dhe Rregulla Financiare e Thesarit 03- Të hyrat; Manuali i Procedurave të Thesarit; Udhëzimi Administrativ për krijimin dhe funksionimin e Njërive të auditimit të brendshëm Nr. 23/2009; Udhëzimi Administrativ për krijimin dhe funksionimin e komiteteve të auditimit Nr. 11/2010; Udhëzimi Administrativ për licencimin e auditorëve të brendshëm Nr. 22/2009; Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për procedurën e pajisjes me licencë profesionale të auditorëve të brendshëm të sektorit publik; Standardet e rifreskuara dhe të harmonizuara të auditimit të brendshëm me praktikën më të mira profesionale të BE-së; Doracak i auditimit të brendshëm i rifreskuar me 2011. .

Përveç këtyre, ka edhe ligje të tjera që kanë ndërlidhje me KBFP, duke përfshirë:

- Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111);
- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/L- 049);
- Ligjet vjetore mbi Miratimin e Buxhetit të Kosovës
- Ligjin për Prokurimin Publik (Ligji nr. 04-L-042);
- Ligjin për Administratën Shtetërore (Ligji nr. 03/L-189);
- Ligjin për Themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral (Ligji nr. 03/L-075);
- Ligjin Anti-Korrupsion (Ligji nr. 2004/34);
- Ligji mbi Shërbimin Civil (Ligji nr. 2010/03-L-149);
- Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil (Ligji nr. 03-L-147) dhe
- Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (Ligji nr. 03/L-215)

Përveç këtyre, edhe ligjet e ndryshme që krijojnë institucionet publike dhe rregullojnë kushtet e punës po ashtu janë me interes.

Konceptet e KBFP-së janë relativisht të reja sidomos në rajon dhe Kosovë, sidoqoftë ato janë përfshirë në legjislacionin dhe politikat vendore, mirëpo zbatimi i këtyre kon-

cepteve dhe standardeve përballet me sfida të shumta dhe mbetet për t'u përmirësuar.

2.2. Korniza institucionale

Qeveria ka krijuar një kornizë institucionale të përbërë nga organizatat e sektorit publik duke punuar me drejtimin e Njësive Qendrore Harmonizuese, përkatësisht për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe Auditimin e Brendshëm dhe nën mbikëqyrjen e auditorit të jashtëm për të krijuar një zinxhir të llogaridhënies siç është përshkruar më poshtë.

- *Subjektet e sektorit publik*

Llogaridhënia përbëhet nga një zinxhir i pjesëmarrësve ku secili është përgjegjës për arritjen e qëllimeve të caktuara dhe secili duhet t'i jap llogaridhënie një autoriteti të nivelit më të lartë për arritjen e këtyre qëllimeve. Niveli më i lartë i autoritetit në këtë zinxhir mbahet nga qytetarët të cilët përfaqësohen nga deputetët e zgjedhur në Kuvend dhe në qeveritë komunale. Kështu Kuvendi apo qeveria komunale bëhet përfaqësues kushtetues i qytetarëve. Zinxhirët aktual të llogaridhënies për këto dy nivele të qeverisë janë disi të ndryshme, duke pasqyruar rregullimet e tyre kushtetuese.

Në rastin e qeverisë kombëtare, Qeveria del nga Kuvendi dhe vepron si e besuar e tij. Qeveria pastaj cakton përgjegjësinë për Ministrat e saj për të zbatuar politikat e Qeverisë që, nga ana tjetër dhe brenda diskrecionit të mundësuar nga legjislacioni, më tej cakton kompetenca dhe përgjegjësi nëpërmjet rregulloreve, politikave dhe aranzhimeve administrative me menaxhmentin e lartë të organizatave buxhetore. Qeveria ka miratuar Politikën e KBFP-së duke kërkuar nga subjektet e sektorit publik të zbatojnë KBFP-në dhe të krijojnë kornizën legjislative dhe kapacitetin institucional për ta zbatuar këtë politikë.

Ministrat janë përgjegjës për veprimet e Ministrive të tyre dhe i japin llogaridhënie Kuvendit për ato veprime. Ky parim është thelbësor për të siguruar llogaridhënien e përfaqësuesve të zgjedhur për çdo vendim të qeverisë. Në të njëjtën kohë, proceset e përditshme të punës janë deleguar tek nëpunësi civil më i lartë, Sekretari i Përgjithshëm.

Në vartësi të Ministrave janë nëpunësit civilë dhe të tjerët që kryejnë punë publike.

Ky zinxhir i llogaridhënies është ilustruar në Aneksin 2 (figura 1), që gjithashtu tregon rolet e ndryshme të Auditorit të Përgjithshëm, i cili kryen mbikëqyrjen në emër të Kuvendit, si dhe njësitë e auditimit të brendshëm që mbështesin menaxherët e lartë.

Funksioni i auditimit të brendshëm është deleguar (në përputhje me parimet e KBFP), në atë mënyrë që çdo subjekt i sektorit publik është përgjegjës për krijimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm, në përgjithësi duke krijuar një Njësi të Auditimit të Brendshëm që i raporton menaxhmentit të lartë. Mundësitë ekzistojnë për të ndarë së bashku

shërbimet e auditimit të brendshëm dhe të Komisioneve të Auditimit në organizatat e vogla buxhetore.

Për qeverinë komunale, Kryetari i Komunës zgjidhet nga populli dhe prandaj është drejtpërdrejt përgjegjës para popullit. Kjo është treguar në Aneksin 2 (figura 2).

Ndryshe nga organizatat e buxhetit qendror, ku roli politik i Ministrit është i ndarë nga përgjegjësia e nëpunësit civil administrativ sa i përket administrimit dhe funksionimit, Kryetari i Komunës drejton qeverinë komunale dhe administratën/funksionimin e saj si dhe është përgjegjës para popullit për veprimet e këtyre dy niveleve.

Çdo menaxher i lartë në një subjekt të sektorit publik mban përgjegjësinë e plotë për zbatimin e KBFP-së dhe është përgjegjës për performancën e tyre në përdorimin e resurseve publike për të arritur objektivat organizative. Menaxhmenti i lartë i çdo subjekti të sektorit publik duhet të krijojë një njësi funksionalisht të pavarur të auditimit të brendshëm e cila do të sigurojë një vlerësim objektiv të përshtatshmërisë së dizajnit dhe të sistemeve të MFK-së.

Është e qartë se qytetarët e Kosovës janë hisedarët kryesorë pasi që ata do të jenë përfituesit final të përmirësimeve në KBFP. Teoria moderne e KBFP-së sugjeron se “nevojitet një qasje e re e menaxhimit publik për të krijuar fokusin në klientin e shërbimeve publike si dhe në performancë, çështje këto për të cilat auditori i brendshëm duhet të jetë vigjilent”.

- *Mbështetja për aplikimin e KBFP-së*

Ashtu siç kërkohet në kuadër të KBFP-së, Qeveria ka krijuar dy Njësi Qendrore Harmonizuese për të nxitur zhvillimin dhe përhapjen e menaxhimit efektiv financiar dhe kontrollin, si dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

- *NjQH-MFK*

Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (NjQH-MFK) është themeluar më 2007 fillimisht si organ këshillëdhënës dhe me 2009 si një njësi e varur brenda Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave. NjQH-MFK-ja i raporton Ministrit përmes Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit. Me 2012 NjQH-MFK ka përgatitur për herë të parë Raportin vjetor mbi MFK (për vitin 2011) bazuar në vet-vlerësimin e bërë nga Organizatat Buxhetore (OB) i cili është diskutuar nga Qeveria. Raporti për vitin 2012 ende nuk është bërë publik.

Përgjegjësitë e NjQH-MFK përfshijnë zhvillimin e politikave, rregullave dhe procedurave të detajuara të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për funksionimin e sistemeve të qeverisë për menaxhimin financiar dhe të kontabilitetit, koordinon zbatimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të parimeve të MFK-së në të gjitha OB-të, monitoron zbatimin

e MFK-së përmes listave kontrolluese të vet-vlerësimit të praktikave të mira të MFK-së për udhëheqësit e organizatave buxhetore, etj. Më tej, NjQH-MFK është përgjegjëse për trajnimin (programet e trajnimit për Zyrtarët Kryesor Administrativ - Zyrtarët llogaridhënës, dhe Menaxherët - Mbajtësit e buxhetit) dhe ofrimin e mbështetjes teknike për të gjitha palët në lidhje me zbatimin e rregullave të MFK-së. Në këtë kapacitet, ajo duhet të veprojë si pikë fokusi për zbatimin e MFK-së dhe në mënyrë që të arrihet kjo, NjQH-MFK duhet të plotësohet me një task forcë të nivelit shumë të lartë për të ofruar mbështetje në nivel të politikave dhe promovim që i nevojitet MFK-së. Ajo duhet të ketë rol më aktiv në sigurimin e pronësisë së reformës së MFK-së, si dhe zbatimin e saj adekuat në tërë sektorin publik. Gjithashtu nevojitet të ketë edhe koordinim më të mirë të projekteve të ndryshme të donatorëve në fushën e MFK.

- *NjQH-AB*

Që nga viti 2000 Auditimi i Brendshëm (AB) ka filluar të funksionoj në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal. Me aprovimin e Ligjit për auditim të brendshëm nga Kuvendi në prill 2008 NjQH-AB është themeluar si një departament i veçantë në kuadër të Ministrisë së Financave dhe për fushëveprimin e saj i raporton drejtpërdrejtë Ministrin në baza tremujore. Në baza vjetore NjQH-AB mbledh planet dhe raportet e auditimit nga të gjitha OB-të dhe prodhon një raport të konsoliduar vjetor për Ministrin e Financave, ku përfshihen çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet në sektor dhe statistikat lidhur me numrin e auditimeve dhe rekomandimeve të lëshuara, zbatuara në OB-të, etj. Ky raport pastaj përcjellët nga Ministri në Qeveri, Kuvend dhe ZAP.

Roli i Njësisë është të vendos një sistem efektiv dhe efikas të AB në tërë sektorin publik që do të përkrah zinxhirin e llogaridhënies dhe transparencën për paratë publike. NjQH-AB është përgjegjëse për zhvillim të legjislacionit, politikave dhe metodologjisë për funksionimin e AB sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare; mbikëqyrjen dhe monitorimin me qëllim të rritjes së cilësisë së AB; zhvillimin dhe zbatimin e programit për trajnim dhe certifikim të detyrueshëm profesional; etj. Kjo është e ndarë nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministri që është përgjegjëse për auditimin e sistemeve të MFK-së së vetë Ministrisë.

- *Mbikëqyrja parlamentare dhe Auditimi i Brendshëm*

Auditori i Përgjithshëm është një institucion kushtetues. Në përgjithësi Kushtetuta i jep Auditorit të Përgjithshëm një mandat të qartë dhe të pavarur. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është e mandatuar në bazë të Ligjit mbi ZAP. Auditori i Përgjithshëm emërohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Auditori i Përgjithshëm aktual do të jetë në këtë pozitë deri në Shtator të vitit 2014. Më pas Kuvendi do të caktojë Auditorin e ri të Përgjithshëm - një strategji dalëse që synon sigurimin e pronësisë dhe qëndrueshmërinë.

ZAP-ja mbyll zinxhirin e llogaridhënies ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë duke përgatitur një raport vjetor të auditimit mbi ekzekutimin dhe aktivitetet e buxhetit të Qeverisë.

ZAP është e autorizuar të kryejë auditime të tjera në përputhje me mandatin e saj, rezultatet e të cilave ajo i raporton si para organeve të audituara po ashtu edhe para Qeverisë. Përveç kësaj, Kuvendi informohet rregullisht për aktivitetet e ZAP-së dhe gjetjet e auditimit. Raportet e ZAP janë në dispozicion të publikut, duke iu ofruar informacione qytetarëve në lidhje me punën e Qeverisë. Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrjen e Financave Publike rregullisht diskuton raportet e auditimit të përgatitura nga ZAP.

Strategjia e ZAP-së për zhvillimin e saj ka të njëjtën bazë konceptuale si ajo e politikës së KBFP-së për të siguruar konsistencën në mes të Qeverisë dhe iniciativave të ZAP-së. Ligji për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm është aktualisht në rishikim nga ana e një komisioni të udhëhequr nga Ministria e Financave.

Përkundër përmbushjes së pritjeve të një Institucioni Suprem të Auditimit, ZAP nuk mund të anëtarësohet në INTOSAI për shkak të faktit se Kosova nuk është njohur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë ajo merr pjesë në grupe të ndryshme punuese të INTOSAI-it, si dhe në forume të auditimit të jashtëm si vëzhgues.

- *Marrëdhëniet ndërmjet palëve të përfshira*

Palët e përfshira punojnë së bashku në kuadër të kornizës së KBFP-së siç vijon më poshtë:

- KE përcakton parimet e KBFP-së dhe rekomandon kornizën ligjore dhe institucionale për aplikimin e tij.
- Qeveria është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe udhëzimeve ligjore, së bashku me organizimin institucional për zbatimin e KBFP-së.
- NjQH-të interpretojnë kërkesat ligjore duke ofruar udhëzime për menaxherët dhe auditorët e brendshëm në lidhje me standardet dhe metodat profesionale/teknike që duhet të zbatohen.
- Menaxhmenti i lartë është përgjegjës për krijimin e auditimit të brendshëm dhe kapacitetet e MFK-së në çdo organizatë buxhetore në mënyrë që të zbatohet KBFP-ja.
- Auditimi i Brendshëm në çdo organizatë buxhetore është përgjegjës për të vlerësuar funksionimin e sistemeve të MFK-së dhe nxjerr rekomandime për përmirësimin e tyre.
- Auditori i Përgjithshëm merret me Ministrinë e Financave dhe komisionet parlamentare për të promovuar menaxhimin efektiv të burimeve të buxhetit shtetëror.

3. Statusi dhe sfidat

Kosova përballlet me objektiva ambicioze dhe një buxhet të kufizuar krahasuar me nevojat – për të përmbush këto nevoja dhe objektiva nevojitet që menaxhimi i financave publike të jetë më efikas dhe efektiv.

Në vitin 2005 Qeveria e Kosovës ka miratuar Politikën e parë të KBFP-së me qëllim të krijimit të sistemeve të shëndosha të menaxhimit të burimeve të financave publike. Kjo politikë më pas është amendamentuar në vitin 2007. Politika e re e KBFP-së u miratua në vitin 2011. Procesi i krijimit të legjislacionit sekondar relevant me KBFP-në është plotësuar dhe tani ekziston kornizë e reviduar ligjore dhe institucionale e cila mundëson zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit.

Dihet mirë se ekzistenca e ligjeve dhe institucioneve nuk përfaqëson zbatimin efektiv të MFK-së dhe, në fakt, MFK-ja ka një rrugë të gjatë për të bërë para se ajo të mund të konsiderohet si një pjesë integrale e menaxhimit të aktiviteteve qeveritare në Kosovë. Derisa ligjet dhe politikat janë në përputhje me kërkesat e përgjithshme të BE-së, këto shpesh nuk përkojnë me nevojat dhe kapacitetet administrative të vendit.

MFK zbatohet përmes Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Financave i zhvilluar sipas sistemit të llogarive kontabël të harmonizuara me Standardet e Kontabilitetit të Sektorit Publik në bazë të parasë së gatshme dhe Statistikave Financiare Qeveritare të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Kjo nënkupton regjistrimin e të gjitha transaksioneve buxhetore dhe financiare që nga momenti i aprovimit të buxhetit, inkasimin dhe shpenzimin e parasë publike sipas: burimit të financimit, organizatës buxhetore, programit, klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, klasifikimit funksional dhe sipas projekteve. Si i tillë ky sistem përfaqëson një element të rëndësishëm në aspektin e kontrollit duke ndarë detyrat dhe ofruar të drejta dhe autorizime për ekzekutim të fazave të ndryshme të procesit.

Në fund të vitit 2010 është bërë delegimi i regjistrimit të shpenzimeve nga Thesari të OB-të, që konsiderohet si hap në drejtim të duhur. OB-të nga zyrat e tyre regjistrojnë të gjitha kërkesat për blerje, zotimet, urdhër-bletjet, pranimin e mallit, regjistrimin e shpenzimit, aprovimin e shpenzimit për pagesë, nxjerrjen e raporteve financiare mbi gjendjen e llogarive të tyre kontabël, etj. Përgjegjës për vendosjen e procedurave për inkasim dhe shpenzim të parasë është Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA). Mirëpo vlerësimet tregojnë se delegimi i përgjegjësive tek OB-të nuk është kryer në përputhje të plotë me qasjen e re qeveritare të MFK-së dhe rrit nivelin e rrezikut. Derisa ky sistem ka arritur një nivel mjaft të lartë, ka mendime se sistemet e Kontrollit të Brendshëm në disa raste nuk janë të dizajnuara në mënyrë efikase dhe në disa raste të tjera nuk ishin efektive në praktikë. Për më tepër edhe ZAP vazhdimisht potencon opinionin negativ mbi pasqyrat financiare të OB-ve për shkak të parregullsive në proces të prokurimit dhe kontabilitetit.

Qeveria deri tani ka krijuar parakushtet themelore për një kontroll të fortë financiar në lidhje me organizatat buxhetore. Por zbatimi i politikave të KBFP-së ende nuk është duke dhënë rezultatet e synuara, të cila janë potencuar edhe në raportin vjetor të NjQH-MFK. MFK është vështirë për tu zbatuar sepse nuk ka një definim të qartë të konceptit për ta kuptuar më lehtë. Ky koncept nuk është i aplikueshëm vetëm për një grup të caktuar të profesionistëve dhe kërkon angazhim të një spektri të gjerë të praktikave menaxheriale. Pra MFK-ja është më shumë se një metodë teknike: ajo është një perspektivë e veçantë kulturore në menaxhimin strategjik të organizatave dhe përgjegjësive të

menaxherëve individual brenda tyre. Ajo ka të bëjë me krijimin e llogaridhënies menaxheriale (në lidhje me përdorimin e burimeve publike në arritjen e objektivave formale të performancës) në të gjitha organizatat buxhetore.

Procesi i zbatimit të MFK-së është një ndryshim themelor në mënyrën e realizimit të procesit të punës së qeverisë. Ai duhet të adresohet nëpërmjet një programi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të ndryshimit i drejtuar nga nivelet më të larta të qeverisë, këshilltarët e tyre dhe komuniteti ndërkombëtar. Zbatimi i MFK-së kërkon ndryshime themelore në sjelljen e menaxherëve të shërbimit civil, në mënyrën se si ata i kuptojnë rolet e tyre dhe qëllimet e institucioneve ku ata punojnë, si dhe në kulturën burokratike që përshkon mënyrën se si administrohet Qeveria e Kosovës, kështu që ky ndryshim nuk do të ndodhë shpejt ose me lehtësi dhe se ai kërkon një periudhë të qëndrueshme të ndërhyrjeve. Kjo nënkupton se kërkohet një fokus i ri mbi: rregullat e brendshme të OB-ve për planifikim, delegimin, menaxhimin e rrezikut, transparencën, llogaridhënien, përgjegjësinë personale dhe vendim-marrjen e fuqizuar për realizimin efektiv dhe eficient të objektivave të caktuara.

Për ata individë të cilët janë rrit në një mjedis “modern” të menaxhimit të orientuara në rezultate, konceptet e MFK-së janë aq të zakonshme sa që nuk ka nevojë për asnjë shpjegim të gjerë. Për ata që janë mësuar në strukturat burokratike të orientuara në detyra, MFK-ja përfaqëson një largim të madh, jo vetëm në metoda, por edhe në mënyrën e të menduarit në lidhje me menaxhimin.

Menaxherët e lartë në të gjitha OB-të nuk janë përshtatur ende me kërkesat e KBFP-së në lidhje me llogaridhënien menaxheriale për vlerën e arritur për paratë, rezultatet dhe ndikimin. Qasja aktuale e Menaxhimit të Financave është më shumë e orientuar në kontroll dhe rregullsi (pajtueshmëria me alokimet buxhetore, planet për rrjedhën e parasë, rregulloret administrative, etj) dhe shumë më pak e fokusuar në menaxhim eficient dhe efektiv të parasë dhe matjen e performancës lidhur me objektivat dhe rezultatet. OB-të kërkohet të raportojnë rreth performancës së tyre në relacion me objektivat dhe indikatorët e caktuar, mirëpo raportimi menaxhimentit të lartë nuk bëhet sipas kërkesave ligjore dhe si pasojë progresi në zbatimin e projekteve dhe programeve nuk përcjellët në mënyrë efektive. Planet për menaxhimin e rrezikut në OB nuk janë të zhvilluara sa duhet dhe institucionet përballen me menaxhim të dobët të buxhetit duke bartur borxhet dhe mjetet e pashfrytëzuara prej vitit në vit, duke hyrë në borxhe pa zotime paraprake, etj, që paraqet një sfidë të veçantë edhe sa i përket absorbimit të fondeve të BE-së të cilat pritet të rriten me avancimin e procesit të integritit evropian. Hyrja në obligime pa zotime paraprake është përgjegjësi edhe e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, i cili duhet të kërkoj dëshmi për zotimin e mjeteve nga OB-të në momentin kur ato bëjnë shpalljet e prokurimit. Rregullat e Thesarit qartësojnë se asnjë pagesë nuk mund të bëhet pa pasur zotimin e mjeteve, dhe sistemi nuk lejon një gjë të tillë. Për më tepër Thesari është në proces të avancimit të sistemit Freebalance i cili pritet të funksionalizohet në pjesën e parë të vitit 2013.

Prandaj, duhet të bëhet shumë më tepër për të ndërtuar kapacitetet teknike dhe profe-

sionale, si dhe për të siguruar zbatimin më të fokusuar të qasjes së MFK-së. Fokusi duhet të jetë në rezultate në format e shërbimit ndaj qytetarëve dhe tregut. Në këtë drejtim mbetet të punohet më shumë në drejtim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies, planifikimit operativ, prokurimit publik, kontrollit të brendshëm, raportimit të të hyrave vetanake, mbikëqyrjes së Ndërmarrjeve Publike (zgjedhjen e anëtarëve të kualifikuar në Borde, humbjet komerciale, etj), menaxhimit të investimeve kapitale, etj. Sfidë serioze paraqet regjistrimi dhe zhvlerësimi joadekuat i asetëve (më e theksuar në komuna dhe NP-të), ku OB-të amortizojnë asetet në vlerë zero por ende vazhdojnë t'i përdorin ato! Prandaj kërkohet që Thesari të jetë më këmbëngulës në zbatimin e rregullave.

Regjistrimi i asetëve është i rregulluar me Udhëzim Administrativ mbi menaxhimin e pasurive qeveritare, ku asetet me vlerë mbi 1,000 EUR duhet të regjistrohen në sistemin e KBFP, ndërsa asetet nën këtë vlerë duhet regjistruar në librat e brendshme të OB-ve, dhe të dy regjistrat përbëjnë pasqyrën e përgjithshme të asetëve. Janë formuar dy Komisionet për të avancuar procesin:

- Komisioni për regjistrimin e asetëve dhe statusin (asetet që janë në përdorim, ato të shitura, të dhuruara, etj). Asetet e regjistruara duhet futur në pasqyrat financiare dhe statusi i tyre mund të verifikohet përmes sistemit Freebalance
- Komisioni për vlerësim të asetëve

Thesari organizon seminare të rregullta vjetore përmes së cilave kërkohet nga OB-të që t'i përmbahen dhe t'i zbatojnë rregullat e përcaktuara. Është përgjegjësi e ZKA-ve për të siguruar zbatimin e tyre në përpikëri. Në anën tjetër Ministria e Administratës Publike (MPA) para dy viteve ka krijuar një platformë të e-qeverisjes me një modul E-Asset System, por i cili nuk funksionon si duhet (sidomos pjesët që kanë të bëjnë me amortizimin e asetëve,) dhe për më tepër nuk është kompatibil me sistemin e KBFP-së. Sipas kësaj del se OB-të duhet të regjistrojnë asetet e tyre dy herë që krijon mundësi për gabime. Derisa sistemet tjera si E-Asset mund të përdoren brenda institucioneve, Freebalance është sistemi kryesor i menaxhimit financiar në Kosovë, dhe asetet nuk do të figurojnë në pasqyrat financiare nëse nuk regjistrohen në Freebalance.

Në përgjithësi, menaxherët e organizatave buxhetore me përkrahje nga NjQH-MFK duhet të jenë përgjegjës për adresimin e çështjeve të ndryshimit dhe për ekzekutimin e aktiviteteve të menaxhimit të ndryshimit të identifikuar në Dokumentin e Politikave të KBFP-së.

NjQH-MFK-ja është e fokusuar kryesisht në zhvillimin e legjislacionit lidhur me MFK dhe në një masë më të vogël ishte përfshirë në mbështetjen e zbatimit praktik të tij në tërë OB-të. Për këtë qëllim, ajo ka zhvilluar një seri të re të rregullave financiare dhe ka organizuar sesione trajnimi për menaxherët e lartë në lidhje me kërkesat e reja të MFK-së me qëllim të njoftimit për rëndësinë e MFK-së gjatë procesit të menaxhimit dhe vendimmarrjes lidhur me shpenzimin e parasë publike. NjQH-MFK vazhdimisht inkurajon Zyrtarët Kryesor Financiar të OB-ve që të zbatohet MFK në përpikëri. Në kontekstin e mbështetjes së zbatimit praktik të MFK-së, ajo ka ndërmarrë pilot-projektet e para të

MFK në dy OB të ndryshme duke rishikuar sistemet dhe praktikat e tyre të përcaktuara. Përveç kësaj, ajo ka mbështetur menaxherët e lartë në kryerjen e një vetë-vlerësimi të sistemeve të MFK-së në shtatë komuna.

Përveç kësaj, NjQH-MFK është angazhuar për të ndërmarrë veprime për të forcuar përgjegjësinë menaxheriale dhe për të ndryshuar qëndrimet e lidershit, për zhvillimin e mëtejshëm të metodologjisë së MFK-së dhe për të përmirësuar aranzhimet e trajnimeve për menaxherët e lartë publikë. Ajo ka hartuar një plan të detajuar veprimi që përcakton objektivat, prioritetet, përgjegjësitë dhe kornizën kohore për ta arritur këtë.

Kosova mjaft shumë udhëhiqet nga partnerët ndërkombëtarë, të cilët zhvillojnë sisteme që nganjëherë bien ndesh mes vete (p.sh. mjetet e vet-vlerësimit të zhvilluara nga BE për Thesarin janë në kundërshtim me ato të zhvilluara nga BB për komunat). Sistemi i prokurimit publik është decentralizuar ku janë krijuar 160 autoritete kontraktuese dhe janë licencuar mbi 5000 zyrtarë të prokurimit – a është kjo e domosdoshme apo sistemi mund të funksionoj më mirë në forma tjera? Në nëntor 2011 është themeluar Agjensioni Qendror i Prokurimit i cili pritet të zvogëloj barrën administrative dhe rris ekonominë e shkallës (p.sh. mirëmbajtja e automjeteve zyrtare mund të bëhet me një prokurim). Mirëpo kërkohet që autoritetet vendore të marrin përgjegjësinë e plotë dhe të udhëheqin proceset e zhvillimit edhe në sektorin e financave publike.

Auditimi i brendshëm në sektorin publik është duke shkuar në rrugën e duhur dhe deri më tani janë bërë përmirësime të konsiderueshme. Funkzioni i auditimit të brendshëm ushtrohet nga 67 njësi të auditimit të brendshëm (NjAB) në nivel qendror dhe lokale me 133 auditorë të brendshëm. 9 subjektet e sektorit publik, përkundër përmbushjes së kriterëve ligjore të parashikuara, nuk kanë krijuar njësi të pavarura të auditimit të brendshëm. Janë duke u bërë disa vlerësime për të krijuar një njësi qendrore të auditimit të brendshëm vetëm për këto OB dhe në anën tjetër është duke u shqyrtuar mundësia që Kuvendi i Kosovës të krijoj një njësi për auditim të autoriteteve varëse. Sfidë e veçantë mbetet krijimi i NjAB-ve kryesisht në tri komunat në veri të Kosovës. Disa NjAB janë shumë të vogla dhe kryesisht joefektive me nga një apo dy auditorë, prandaj SIGMA rekomandon shqyrtimin e themelimit të NjAB-ve më të mëdha për disa OB. Disa prej NjAB-ve janë me nga një auditor edhe pse i plotësojnë kriteret për rritjen e numrit të tyre sipas UA 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NjAB-ve në sektorin publik.

Shumica e NjAB-ve (mbi 92%) kanë përgatitur planet strategjike dhe planet vjetore të auditimit, mirëpo është identifikuar se planet e AB-së nuk përcaktojnë gjithmonë prioritetet në fushat me rrezik të lartë. Gjatë vitit 2011/2012 janë kryer 451 auditime të brendshme nga NjAB-të, dhe numri i rekomandimeve të zbatuara është në rritje e sipër. Mirëpo këto rekomandime kanë të bëjnë më shumë me çështje të rregullsisë duke lënë anash çështjet më të rëndësishme si menaxhimi i rrezikut, efikasiteti dhe efektiviteti i shpenzimeve, funksionaliteti i sistemit, etj. Rekomandimet që nuk zbatohen janë rezultat kryesisht i mungesës së llogaridhënies së menaxherëve.

Numri i Komiteteve të Auditimit të themeluara është rritur (praktikë që nuk ekziston në vendet e rajonit), dhe momentalisht këto mungojnë vetëm në 9 OB. Të gjitha këto

të dhëna janë tregues pozitiv për zbatimin dhe zhvillimin e sistemit të AB-së, mirëpo funksionaliteti i Komiteteve të Auditimit (mungesa e anëtarëve të kualifikuar, pavarësia e tyre, parregullsia e takimeve, mospërcjellja e rekomandimeve, etj) dhe kapacitetet e auditimit të brendshëm çalojnë sidomos në nivelin lokal, dhe kjo ngrit pyetjen nëse Kosova është e gatshme për një sistem aq të avancuar të AB-së? Ndoshta duhet rishqyrtuar modalitetin e Komiteteve të Auditimit sidomos duke pasur parasysh kapacitetet e ulëta administrative?

NjQH-AB është duke shënuar progres në përmbushjen e përgjegjësive të saj si njësi koordinuese qendrore për auditimin e brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore qeveritare. Arritjet kryesore të saj janë: miratimi i Planit Strategjik 2013-2015; raportimi vjetor për vitin 2012; përditësimi dhe publikimi i doracakut për auditimin e brendshëm; përditësimi dhe harmonizimi i auditimit të brendshëm me standardet ndërkombëtare; avancimi i bazës së të dhënave të NjQH-AB nga Excel në Access; seminarët për Kryesuesin dhe anëtarët e Komisioneve të Auditimit si dhe me menaxhmentin e lartë të OBE, në bashkëpunim me ZAP dhe partnerët e tjerë relevantë, me qëllim të adresimit të rekomandimeve të auditorëve të brendshëm dhe jashtëm; promovimi i rolit të auditimit të brendshëm para zyrtarëve financiarë të sektorit publik nëpërmjet projektit të USAID-it i zbatuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK); trajnimet dhe certifikimet profesionale për auditorët e brendshëm, etj.

Në Kosovë ekzistojnë dy sisteme të certifikimit të auditorëve në sektorin publik:

- auditorët e jashtëm certifikohen nga ShKÇAK në koordinim me IFAC. INTOSAI ka zhvilluar standarde të reja dhe Kosova është vendi i parë në botë që është duke zhvilluar një skemë të re certifikimi sipas këtyre standardeve. ZAP ka kontraktuar ShKÇAK që të zhvilloj këtë skemë e cila do të filloj këtë vit.
- auditorët e brendshëm janë certifikuar në bashkëpunim me CIPFA.

Certifikimi i auditorëve mund të bëhet edhe jashtë vendit nga institucionet legjitime, certifikimi i të cilëve vlen edhe në Kosovë. Duhet pasur mekanizma për monitorimin e auditorëve të sektorit privat, sepse ka raste kur institucionet publike kontratojnë kompani të auditimit e të cilat nganjëherë nuk arrijnë të kryejnë punën me standardet e kërkuara (p.sh. rasti kur AKP ka kontraktuar një kompani për të audituar nëse investitorët kanë përmbushur obligimet nga privatizimi me spin-of special).

Nga 54 auditorë të brendshëm të përfshirë në programin e certifikimit nga CIPFA (Britania e Madhe) në bashkëpunim me CEF (Slloveni), 32 janë certifikuar dhe 22 auditorë janë në proces të certifikimit; kurse nga CIPFA janë certifikuar 12 trajner vendor për të vazhduar programin e trajnimit dhe certifikimit. Mirëpo ende mbetet për tu definuar modaliteti i partnerit vendor për ofrimin e trajnimeve dhe organizimin e provimeve në përputhje me standardet e CIPFA-s. NjQH-AB rregullisht ofron trajnime për auditorët e ri në nivel lokal dhe qendror, pastaj për drejtorët dhe auditorët e brendshëm të sektorit publik si dhe për kryesuesit dhe anëtarët e Komiteteve të auditimit.

Përderisa kjo konsiderohet si sukses i madh i sistemit të AB-së në vend, ka pikëpamje se

Kosova nuk ka nevojë për aq shumë auditorë të brendshëm të certifikuar, sepse vendet tjera më të mëdha kanë numër proporcionalisht më të vogël të auditorëve. Pavarësisht kësaj, NjQH-AB ka filluar këtë vit vazhdimin e programit për certifikim për grupin e dytë i cili bëhet nga trajner vendor në bashkëpunim me CIPFA. NjQH-AB është në përpjekje për tu liruar nga varësia e institucioneve ndërkombëtare dhe për të krijuar një sistem të qëndrueshme me pronësi vendore të rrënjosur në standardet ndërkombëtare për ofrimin e arsimit të vazhdueshëm profesional për auditorët e certifikuar/licencuar.

Përveç ngritjes së kapaciteteve të auditorëve, kërkohet edhe ngritja e kapaciteteve institucionale duke plotësuar NjAB-të me numër të mjaftueshëm të stafit të domosdoshëm për të kryer funksionin e AB (disa prej institucioneve kanë ndërruar auditorët e brendshëm), pastaj krijimi i Komiteteve të Auditimit në 9 institucione ku mungojnë këto organe, zhvillimi i kapaciteteve për auditim të performancës të cilat momentalisht janë minimale, krijimi i një njësie të përbashkët të AB për agjencitë e pavarura në varësi të Kuvendit të Kosovës të cilat në total menaxhojnë rreth 2.6% nga buxheti i tërësishëm i Kosovës.

Në aspektin e Auditimit të Jashtëm, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka arritur progres solid. Sot ZAP ka rreth 136 të punësuar dhe kryen rreth 100 auditime vjetore të rregullsisë ku përfshihen shumica e institucioneve publike. Që nga viti 2011 ZAP ka filluar të zvogëloj numrin e auditiveve të kontraktuara, dhe ka vendosur auditime të përkohshme me qëllim të parandalimit dhe sigurimit që rekomandimet e auditimit adresohen në mënyrë të adekuate.

Raporti Vjetor i Auditimit (2011) u diskutua së fundi nga Kuvendi në seancë plenare. Auditori i Përgjithshëm e prezantoi atë për herë të parë. ZAP ka vendosur marrëdhënie të mira me Komisionin e Kuvendit për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) i cili është duke përdorur ZAP-në si input për të kërkuar llogaridhënie nga menaxherët publikë dhe për të zhvilluar format e bashkëpunimit ndër-institucional. Mirëpo diskutimi i këtyre raporteve në Kuvend fokusohet më shumë në probleme sesa në rezultatet e arritura dhe ndikimi i tyre në jetën e qytetarëve. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (2008) kërkon nga OB-të të përgatisin raportin rreth arritjes së objektivave deri në qershor, raport të cilin Qeveria duhet ta dërgoj në Kuvend deri në gusht të çdo viti. Për katër vite, sa është ligji në fuqi, kjo është zbatuar shumë pak!

Në anën tjetër bashkëpunimi mes auditimit të jashtëm dhe të brendshëm është në nivel jo të lartë, edhe pse ekzistojnë interesa të përbashkët në drejtim të përmirësimit të efikasitetit financiar, trajnimeve dhe certifikimit.

ZAP ka përditësuar Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë të raporteve të auditimit i cili ka kontribuar dukshëm në cilësinë e auditimeve dhe raporteve në aspekt të qartësisë, kuptueshmërisë dhe pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe praktikave të mira evropiane. Me gjithë përparimin, mbetet shumë punë për të arritur nivelin e cilësisë së dëshiruar, prandaj cilësia mbetet prioritet i ZAP pa e dëmtuar sasinë e auditimeve. ZAP ka përditësuar edhe Doracakun e Auditimit të Rregullsisë bazuar në përvo-

jat e marra nga terreni; ka vendosur rishikime specifike analitike mbi pasqyrat vjetore financiare dhe një regjim për diskutim të gjetjeve me Ministrinë e Financave me qëllim të zvogëlimit të rrezikut për gabime dhe lëshime; ka integruar bashkëpunimin me institucionet e nivelit lokal dhe qendror, etj.

Strategjia e ZAP fokusohet në krijimin e një platforme të qëndrueshme me pronësi vendore, me mandat të qartë dhe pavarësi të plotë në përputhje me parimet e INTOSAI që do të kontribuonte në fuqizimin e qeverisjes së mirë. Më konkretisht ZAP planifikon të konsolidoj auditimin e rregullsisë dhe të fuqizoj auditimin e performancës, të rris volumin e auditimeve me cilësi të lartë duke rritur numrin e stafit dhe nivelin e profesionalizmit.

ZAP gjatë auditimit mundohet të identifikoj arsytet prapa të gjeturave, të cilat janë zakonisht të ndërlidhura me probleme sistematike ku duhet të kontribuojnë partnerët e ndryshëm. Adresimi i rekomandimeve të auditorëve është në rritje dhe ndikon pozitivisht në performancën e institucioneve. Gjetjet tregojnë se ka përmirësime në menaxhimin e shpenzimeve, mirëpo ka mangësi serioze të cilat identifikohen në mënyrë të vazhdueshme për vite me radhë. RTK paraqet rastin më eklatant duke mos kthyer raportin me adresimin e rekomandimeve të auditorëve; në anën tjetër menaxhimi financiar në komuna në përgjithësi është duke u përmirësuar por me ritëm shumë të ngadalshëm ku tri komuna ende nuk paraqesin të dhënat e duhura kurse dy prej tyre kanë shënuar regres.

ZAP ka filluar vitin e kaluar me një auditim të performancës, dhe këtë vitet pritët të ketë më shumë. Suksesi i përdorimit të buxhetit nuk matet me indikatorë adekuat për të vlerësuar se cili është efekti/rezultati i shfrytëzimit të mjeteve në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Për vlerësimin e arritjes së objektivave/rezultateve kërkohet të zhvillohen indikatorët matës jo vetëm të inputit, por edhe të njësive së kostos të cilët tani nuk ekzistojnë.

Në këtë drejtim me rëndësi të veçantë është planifikimi i buxhetit nga OB-të (projektet për investime kapitale - PIP), sistem ky që përdoret gjatë procesit të buxhetimit, por duket se nuk funksionon si duhet. Konkurrimi/rangimi i projekteve sipas prioriteteve dhe cilësisë (analiza cost-benefit) nuk bëhet sa duhet. Kështu projektet hyjnë në buxhet në mënyrë subjektive/arbitrare, kurse ka raste kur studimi i fizibilitetit të tyre planifikohet të bëhet një vit më vonë. Prandaj edhe shpenzimi i financave publike nuk arrin objektivat/rezultate e pritura. Ekzistojnë sisteme dhe procedura të qarta për këtë çështje (Zyra e planifikimi strategjik në Kryeministri, sistemi PIP që përfshin analizën cost-benefit sipas standardeve të BE-së, etj) por ato nuk përdoren në mënyrë adekuate për shkak të kapaciteteve të ulëta dhe mungesës së rigorozitetit nga ana e ZKA-ve për të siguruar se vetëm projektet më të mira hyjnë në planet buxhetore. Kështu do të evitohej jo vetëm financimi i projekteve jo të mira, por edhe zvogëlimi i nivelit të bartjes së mjeteve të pashfrytëzuara.

Për të adresuar këto probleme janë disa hapa relativisht të lehtë që mund të ndërmerren:

duhet planifikuar në afat më të gjatë (jo vetëm plan ifikim vjetor) e që mundësohet nga PIP; duhet shikuar se cilat janë shpenzimet më të mëdha në secilën OB dhe në bazë të analizave të nxjerrët njësia e kostos si indikator matës (e që mund të futet si aneks në pasqyrat financiare).

Përkundër progresit të arritur, pavarësia dhe kapaciteti i auditimit të jashtëm duhet të forcohet. Për këtë qëllim, Komisioni për Ligjin e ri mbi Auditorin e Përgjithshëm tani është duke finalizuar një draft që do të dërgohet për komente.

ZAP ka filluar një projekt 30-muajsh binjakëzimi i cili do të ofroj mbështetje për strategjinë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm, për ardhjen e Auditorit të Përgjithshëm, mentorimin dhe trajnimin për auditim të rregullsisë dhe për auditimin e shërbimeve publike që kryhen jashtë organizatave buxhetore. Përveç kësaj, do të ketë edhe një projekt bashkëpunimi me ZKA të Suedisë për 3+2 vjet dhe kryesisht do të adresojë auditimin e performancës. Një tjetër partneritet dyvjeçar është i gatshëm me Bankën Botërore për të adresuar auditimin e sistemeve të prokurimit.

4. Konkluzione

Përparësitë	Sfidat	Rekomandimet
<p>Ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative (primare dhe sekondare) që rregullon fushën e KBFP-së e cila mundëson zhvillimin e mëtuftëshëm të sektorit.</p> <p>Nuk ka legjislacion specifik të BE-së në fushë ne KBFP dhe auditimit që do të përdorej në përafërmin e ligjeve kombëtare, dhe vendet angazhohen të përvetësojnë standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira të BE-së.</p> <p>Kapitulli 32 i Acquis Communautaire përcakton kriteret që kanë të bëjnë me kontrollin financiar</p> <p>MFK, në përgjithësi, është zhvilluar në rrugë të drejtë</p> <p>NjQH-MFK është funksionale; ka zhvilluar një seri të re të rregullave financiare dhe ka organizuar sesione trajnimi për menaxherët e lartë lidhur me kërkesat e reja të MFK-së.</p> <p>Me 2012 NjQH-MFK ka përgatitur për herë të parë Raportin vjetor mbi MFK</p> <p>Shumë nga funksionet e ekzekutimit të buxhetit janë deleguar tek shfrytëzuesit e buxhetit në ministrinë e linjës dhe pushtetin lokal</p> <p>Programi i Investimeve Publike (PIP) përdoret gjatë procesit të buxhetimit</p> <p>Auditimi i brendshëm në sektorin publik është duke shkuar në rrugën e duhur dhe deri më tani janë arritur përmirësime të konsiderueshme</p> <p>Korniza e AB është përditësuar dhe plotësuar përfshirë Planin Strategjik 2013-2015, Manualin e AB, etj në përputhje me standardet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare</p> <p>NjQH-AB ka qenë aktive në ngritjen e cilësisë së AB në Kosovë dhe në zhvillimin e aftësive të nevojshme teknike për auditorët e brendshëm.</p>	<p>Kosova përballet me objektiva ambicioze dhe një buxhet të kufizuar krahasuar me nevojat</p> <p>Efektiviteti dhe aplikimi konsistent i menaxhimit financiar mbetet ende një sfidë</p> <p>Derisa ligjet dhe politikatat janë në përputhje me parimet e përgjithshme të BE-së, këto shpesh nuk përkojnë me nevojat dhe kapacitetet administrative të vendit</p> <p>Kosova gjendet mjaft larg zbatimit të kriterëve të përcaktuara në Kapitullin 32 të Acquis Communautaire, dhe kjo do të luaj rol shumë të rëndësishëm në proces të përgatitjeve për themelimin e Sistemit të Decentralizuar të Implementimit të fondeve të BE-së</p> <p>NjQH-MFK është fokusuar kryesisht në zhvillimin e legjislacionin lidhur me MFK dhe më pak në mbështetjen e zbatimit praktik të tij në tërë OB-të</p> <p>Delegimi i përgjegjësive tek OB-të nuk është kryer në përputhje të plotë me qasjen e re qeveritare të MFK-së dhe rrit nivelin e rrezikut.</p> <p>Zbatimi i politikave të MFK-së ende nuk është duke dhënë rezultatet e synuara sepse qasja aktuale është më shumë e orientuar në procese dhe shumë më pak e fokusuar në objektiva dhe rezultate;</p> <p>Menaxherët e lartë në të gjitha OB-të nuk janë përshtatur ende me kërkesat e KBFP-së në lidhje me llogaridhënien menaxheriale për vlerën e arritur përparë, rezultatet dhe ndikimin</p> <p>Menaxhimi i rrezikut në OB nuk është i zhvilluar dhe kërkon mbështetje të mëtejshme;</p> <p>Sistemet e kontrollit të brendshëm në disa raste nuk janë të dizajnuara në mënyrë efikase dhe nuk ishin efektive në praktikë.</p>	<p>Për të përmbush nevojat dhe objektivat, kërkohet që menaxhimi i financave publike të jetë më efikas dhe efektiv</p> <p>Duhet punuar në drejtim të ngritjes së nivelit të transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies</p> <p>Kosova duhet pasur vizion në zhvillimin e kontrollit financiar në kuptim të menaxhimit të fondeve të BE-së</p> <p>NjQH-MFK duhet të rrisë përpjekjet në drejtim të reformave të vazhdueshme të MFK; të ketë në pronësi dhe të koordinojë në nivel qendror funksionet ndërqeveritare të MFK-së</p> <p>NjQH-MFK duhet të fokusohet në shpërndarjen e informatave profesionale dhe shkëmbimin e praktikave të mira;</p> <p>NjQH-MFK duhet të plotësohet me një task forcë të nivelit shumë të lartë për të ofruar mbështetje në nivel të politikave dhe promovim që i nevojitet MFK-së</p> <p>Zbatimi i MFK-së kërkon ndryshime themelore në sjelljen e menaxherëve, në mënyrën se si ata i kuptojnë rolet e tyre dhe qëllimet e institucioneve ku ata punojnë, si dhe në kulturën burokratike</p> <p>Kërkohet një fokus i ri mbi: rregullat e brendshme të OB-ve për planifikim, delegimin, menaxhimin e rrezikut, transparencën, llogaridhënien, përgjegjësinë personale dhe vendim-marrjen e fuqizuar për realizimin efektiv dhe eficient të objektivave të caktuara</p> <p>Hartimi dhe zbatimi efektiv i Sistemeve të kontrollit të brendshëm ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm; Planifikimi i projekteve kapitale duhet të bëhet sipas procedurave dhe sistemeve në fuqi dhe me analiza të plota para se të merret vendimi për financim do të evitonte shpenzimet në projekte të panevojshme dhe bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara për shkak të planifikimit joadekuat</p>

<p>Nga 54 AB të përfshirë në programin e certifikimit, 32 janë certifikuar dhe 22 auditorë janë në proces të certifikimit; janë certifikuar 12 trajner vendor</p> <p>NjQH-AB ka bërë planet që në vitin 2013 të vazhdoj me certifikimin e grupit të dytë të AB-ve</p> <p>NjQH-AB ofron seminare të vazhdueshme për Kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve të Auditimit si dhe për menaxhmentin e lartë të OB-ve, me qëllim të adresimit të rekomandimeve të auditorëve</p> <p>Shumica e OB-ve kanë themeluar njësitë e auditimit të brendshëm me mbi 133 auditorë në total</p> <p>Shumica e OB-ve kanë themeluar Komitetet e Auditimit</p> <p>Janë duke u bërë vlerësime për të krijuar një njësi qendrore të AB vetëm për OB që nuk kanë themeluar NjQH-AB dhe që Kuvendi i Kosovës të krijojë një njësi për auditim të autoriteteve varëse.</p> <p>Shumica e NjAB-ve (mbi 92%) kanë përgatitur planet strategjike dhe planet vjetore të auditimit</p> <p>Numri i rekomandimeve të zbatuara është në rritje e sipër dhe ndikon pozitivisht në performancën e institucioneve</p> <p>ZAP ka arritur progres solid dhe kryen rreth 100 auditime individuale brenda një sezoni të auditimit.</p> <p>Ligji për ZAP është në rishikim, ndër të tjera, për të siguruar pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare</p> <p>ZAP merr pjesë në INTOSAI-it si dhe në forume të auditimit të jashtëm si vëzhgues</p> <p>Që nga viti 2011 ZAP ka filluar të zvogëloj numrin e auditimeve të kontraktuara</p> <p>Trajnimi dhe certifikimi i auditorëve të jashtëm është në pronësi vendore</p> <p>ZAP ka ngritur cilësinë në prezantimin e të dhënave në pasqyrat financiare dhe ka një numër më të madh të raporteve të pakualifikuara të auditimit</p> <p>ZAP ka filluar me auditim të performancës dhe pritet që numri i këtyre auditimeve të rritet gradualisht</p>	<p>OB-të nuk raportojnë rreth performancës së tyre në relacion me objektivat dhe indikatorët e caktuar, siç kërkohet me ligj</p> <p>Planifikimi, ekzekutimi dhe monitorimi i buxhetit ende nuk është në përputhje me kërkesat e Qeverisë për MFK</p> <p>Menaxhimi i dobët dhe kontrolli i pamjaftueshëm mbi planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit sidomos në lidhje me investimet kapitale. Akumulimi i buxhetit dhe angazhimi në rritje për ta shpenzuar atë në fund të vitit, në mënyrë që të shmangen nën-shpenzimet; paraqet sfidë të veçantë për absorbim të fondeve të BE-së në të ardhmen</p> <p>Prokurimi i centralizuar përmes CPA është ende i kufizuar. Menaxhmenti i organizatave buxhetore shpesh nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur nevojës për analizë, ecurisë së procesit të prokurimit dhe cilësisë së ekzekutimit të projekteve.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të aseteve nuk është efikas (më e theksuar në komuna dhe NP-të), ku OB-të amortizojnë asetet në vlerë zero por ende vazhdojnë t'i përdorin ato</p> <p>NjQH-AB duhet të vazhdojë me forcimin e kapacitetit teknik të auditorëve si dhe përmirësimin e performancës së punës së tyre dhe promovimin e qëndrueshmërisë së funksionit të AB</p> <p>Kapacitetet e AB kanë nevojë për ngritje të konsiderueshme përmes certifikimit dhe programit për edukim të vazhdueshëm profesional, sidomos në nivelin lokal</p> <p>Sistemi i trajnimit dhe certifikimit të AB-ve është i varur nga institucionet ndërkombëtare dhe si i tillë nuk siguron qëndrueshmëri të lartë</p> <p>9 OB ende nuk kanë krijuar njësi të auditimit të brendshëm. Sfidë e veçantë mbetet krijimi i NjAB-ve në tri komunat në veri të Kosovës.</p> <p>Shumica e NjAB-ve janë shumë të vogla dhe kryesisht joefektive me nga një apo dy auditorë</p>	<p>Sigurimi i pavarësisë së institucioneve të pavarura në procesin e buxhetit dhe proceset e zhvilluara të llogaridhënies në raport me Kuvendin;</p> <p>Në bazë të analizave të shpenzimeve aktuale të nxjerrët njësisë e kostos si indikator matës për efikasitetin dhe efektivitetin e buxhetit.</p> <p>Prokurimi publik duhet përmirësuar qysh nga përgatitja e dosjes e deri te kontraktimi, vlerësimi dhe auditimi me qëllim të efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomizimit të parasë publike; autoritetet për prokurim dhe Thesari duhet qenë më këmbëngulës në monitorimin e hyrjes në obligime pa zotimin e mjeteve.</p> <p>Prokurimet e centralizuara dhe kontratat kornizë duhet aplikuar siç duhet për mallrat e zakonshme në autoritetet publike, ku ekonomia e shkallës është e dukshme</p> <p>Duhet harmonizuar sistemet e regjistrimit të aseteve dhe regjistri duhet të jetë i plotë dhe i saktë, përndryshe nuk mund të ketë zhvillim në menaxhimin e efikas të aseteve/mjeteve publike. Kërkohet që Thesari të jetë më rigoroz në zbatimin e rregullave Të ri-fokusohet NjQH-AB nga zhvillimi i rregulloreve procedurave në atë që të bëhet një rrjet brenda profesionit të AB, duke ofruar udhëzime praktike, shkëmbimin e praktikave të mira dhe duke vazhduar edukimin profesional Duhet vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të AB-ve, dhe në të njëjtën kohë të shqyrtohet mundësia për mbulimin e AB me numër më të vogël të auditorëve me qëllim të ekonomizimit të buxhetit</p> <p>NjQH-AB duhet vazhduar përpjekjet për të krijuar një sistem të qëndrueshëm të trajnimit dhe certifikimit me pronësi vendore</p> <p>Duhet vazhduar përpjekjet për themelimin e NjAB-ve më të mëdha për të mbuluar disa OB</p>
---	---	---

<p>Adresimi i rekomandimeve të auditorëve të jashtëm është në rritje dhe ndikon pozitivisht në performancën e institucioneve</p> <p>Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrje të Financave Publike i përdor raportet e ZAP si input për të kërkuar llogaridhënie nga menaxherët publikë</p>	<p>Shumica e NjAB-ve janë shumë të vogla dhe kryesisht joefektive me nga një apo dy auditorë</p> <p>Komitetet e Auditimit mungojnë në 9 OB. Funksionaliteti i Komiteteve të Auditimit është duke çaluar për shkak të mungesës së anëtarëve të kualifikuar, pavarësisë së tyre, parregullsisë së takimeve, mos-përcjelljes së rekomandimeve, etj, dhe kjo ngrit pyetjen nëse Kosova është e gatshme për një sistem aq të avancuar të AB-së</p> <p>Planet e AB nuk përcaktojnë gjithmonë prioritetet në fushat me rrezik të lartë. Auditimi përqendrohet më shumë në procese/sisteme sesa në performancë</p> <p>Rekomandimet e zbatuara kanë të bëjnë më shumë me çështje të rregullsisë duke lënë anash çështjet më të rëndësishme si menaxhimi i rrezikut, efikasiteti dhe efektiviteti i shpenzimeve, funksionaliteti i sistemit, etj.</p> <p>Rekomandimet që nuk zbatohen janë rezultat kryesisht i mungesës së llogaridhënies së menaxherëve ZAP nuk mund të anëtarësohet në INTO-SAI për shkak se Kosova nuk është anëtare e OKB</p> <p>Trajnimi nuk është në përputhje me ISSAI për certifikimin e auditorëve të rregullsisë</p> <p>ZAP ka nevojë të përmirësojë kapacitetin e saj për të kryer funksionin e auditimit të performancës dhe për të ngritur edhe më tej cilësinë.</p> <p>Suksesi i përdorimit të buxhetit nuk matet me indikatorë adekuat për të vlerësuar se cili është efekti/rezultati i shfrytëzimit të mjeteve në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.</p> <p>Raportet e auditimit tregojnë se ka mangësi serioze të cilat identifikohen në mënyrë të vazhdueshme për vite me radhë.</p> <p>Tri komuna ende nuk paraqesin të dhënat e duhura kurse dy prej tyre kanë shënuar regres</p> <p>Diskutimi i raporteve në Kuvend fokusohet më shumë në probleme sesa në rezultatet e arritura dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve</p>	<p>Duhet vazhduar përpjekjet e Kuvendit për themelimin e një NjAB për agjencitë e në varësi të Kuvendit</p> <p>Duhet rishqyrtuar modalitetin e Komiteteve të Auditimit sidomos duke pasur parasysh kapacitetet e ulëta administrative</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve për auditim të performancës të cilat momentalisht janë minimale</p> <p>Kërkohet trysni më e madhe tek menaxhmenti i lartë në OB për të siguruar zbatimin e të gjitha rekomandimeve të auditorëve</p> <p>Duhet të miratohet një ligj i ri për ZAP duke siguruar pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare; Duhet të futet në funksion një skemë e re, në përputhje me ISSAI, për Certifikimin e Auditorëve të Rregullsisë në sektorin publik</p> <p>Auditimi i jashtëm përveç anës financiare/rregullsisë duhet të përfshijë edhe performancën, kthimin e investimit, ndikimin në punësim dhe mirëqenien e qytetarëve.</p> <p>Duhet krijuar dhe zbatuar procedurat e brendshme për menaxhim të rrezikut në arritjen e objektivave dhe zhvilluar indikatorët dhe kostot e njësisë për të bërë krahasime</p> <p>Kërkohet trysni më e madhe tek menaxhmenti i lartë në OB për të siguruar zbatimin e të gjitha rekomandimeve të auditorëve</p> <p>Kuvendi të fokusohet në mbikëqyrjen e arritjes së objektivave/rezultateve</p>
---	---	---

Aneks 1: Pritjet e Komisionit Evropian në lidhje me KBFP

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike paraqet një model të strukturuar për të drejtuar qeveritë kombëtare në krijimin e një mjedisi adekuat të kontrollit në qendrat e tyre të shpenzimeve dhe të të hyrave. Ai synon të sigurojë që sistemi i tyre i MFK-së të përputhet me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, transparencë, efikasitet, efektivitet dhe të jetë ekonomik si dhe me legjislacionin përkatës dhe përshkrimet e buxhetit. Ai përfaqëson kuptimin e gjerë të kontrollit të brendshëm. Kjo përfshin, por nuk kufizohet, një kontroll ex-ante financiar (EAFC) dhe Auditimin e Brendshëm ex post (EPIA).

Qëllimi i sistemit të kontrollit të brendshëm modern është për t'u siguruar që fondet publike janë duke u përdorur për qëllimin e synuar dhe në përputhje me ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin. Ai fokusohet në transparencë, e cila është një manifestim i parimit të llogaridhënies së qeverisë ndaj publikut që e ka zgjedhur atë për të rritur të hyrat dhe për të shpenzuar në emër të publikut.

KBFP nuk fokusohet në teknikat e buxhetimit ose të kontabilitetit (ndonëse kontrolli i brendshëm gjithashtu mund të rekomandojë përmirësime në këto sisteme) dhe as nuk përfshin detyrat e inspektimit të tilla siç është hetimi dhe ndëshkimi i rasteve individuale të mashtrimit apo parregullsive serioze. Kontrolli i brendshëm publik për kah natyra e tij është parandalues dhe synon të sigurojë që sistemet adekuate janë në vend për të penguar sa më shumë që është e mundur shfaqjen e korrupsionit dhe mashtrimit. Vetë kontrolli i brendshëm publik është objekt i vlerësimit të jashtëm nga ana e Institucionit Suprem të Auditimit.

KBFP-ja bazohet në 3 shtylla – llogaridhënien menaxheriale (sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit), auditimin e brendshëm funksionalisht i pavarur (sistemet e AB) dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese (NjQH) për zhvillimin e metodologjive dhe standardeve që kanë të bëjnë me dy shtyllat e para.

Llogaridhënia menaxheriale (menaxhimi financiar dhe kontrolli) - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli ka të bëjë me forcimin e performancës së organizatës, në mënyrë që:

- të merren vendime më të mira (vendim-marrje më e mirë);
- të ofrohen shërbime më të mira; dhe
- të arrihet vlera më e mirë për paratë.

Menaxherët e qeverisë të të gjitha niveleve duhet të jenë përgjegjës për aktivitetet që ata kryejnë - jo vetëm në politikat operative, por edhe në politikat e kontrollit dhe menaxhimit financiar. Çdo menaxher publik është përgjegjës për themelimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve adekuate të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) për të kryer detyrat e planifikimit, programimit, buxhetimit, kontabilitetit, kontrollit, raportimit, arkivimit dhe monitorimit.

Është e rëndësishme që të theksohet se MFK-ja mbështetet në krijimin e “llogaridhënies menaxheriale”. “Llogaridhënia menaxheriale” paraqet pritjen që menaxherët e lartë përgjatë qeverisë janë përgjegjës për vendosjen dhe përmbushjen e objektivave të performancës për programet e tyre, kontrollin e kostove të tyre, duke zbutur rreziqet negative për aktivitetet e tyre dhe për të siguruar se programet janë menaxhuar me integritet dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

Prandaj të gjithë menaxherët duhet të jenë të vetëdijshëm për qëllimet e tyre operative dhe duhet të raportojnë në lidhje me (a) arritjen e këtyre qëllimeve dhe (b) përdorimin nga ana e tyre të burimeve për arritjen e qëllimeve të tyre. Këto synime shkojnë përtej thjesht natyrës financiare, siç është qëndrimi brenda buxhetit apo në përputhje me procedurat financiare, për të përfshirë sigurimin që burimet janë konsumuar për arritjen e objektivave organizative.

Auditimi i brendshëm funksionalisht i pavarur - Buxheti dhe qendrat shpenzuese duhet të kenë një auditor të brendshëm funksionalisht të pavarur në mënyrë që të mbështesin menaxhimin nëpërmjet dhënies së vlerësimeve objektive të sistemeve ekzistuese të kontrollit të brendshëm. Auditorët i raportojë drejtpërdrejt menaxherit të lartë në kuptimin hierarkik, por ata janë të pavarura nga opinioni i menaxherit për mënyrën se si ata duhet të auditohen. Kjo ilustron nga fakti se auditori i brendshëm nuk është pjesë e Departamentit të Shërbimeve Financiare, por është i bashkangjitur direkt në nivelin më të lartë të menaxhimit. Roli i auditorit është të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm që janë vënë në vend nga menaxhmenti, për të nxjerrë në pah dobësitë/jep rekomandime për përmirësime kur është e nevojshme.

Auditimi nuk duhet të ngatërrohet me funksionet e inspektimit. Auditori auditon përshtatshmërinë e sistemeve ekzistuese në aspektin e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, me synim që të nënvizojë ndonjë dobësi të mundshme që do të mund ta rrezikonte përmbushjen e objektivave të organizatës.

Auditori pastaj jep rekomandime për menaxherin se ku/si duhet përmirësuar sistemet.

Auditorët asnjëherë nuk duhet të përfshihen në detyra menaxheriale (përveç detyrave të tyre) për të cilat ata nuk mund të mbajnë përgjegjësi. Auditori vlerëson dhe rekomandon; megjithatë, është menaxheri ai që vendos nëse do të ndjekë sugjerimet e auditorit apo jo. Kështu që menaxheri është përfundimisht përgjegjës. Auditori nuk sanksionon dhe as nuk ndëshkon; kjo i është lënë menaxherit në rastet e gabimeve njerëzore ose sistematike, ose për autoritetet gjyqësore në rast të parregullsive serioze dhe/ose mashtrimeve.

Njësia Qendrore Harmonizuese si një shtytës për ndryshime - Objektivi kryesor i NjQH-së është që të sigurojë se qasja e KBFP-së është harmonizuar në tërë sektorin publik. Ajo është përgjegjëse për zhvillimin dhe promovimin e metodologjive të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit mbi bazën e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikave të mira, si dhe për koordinimin e zbatimit të legjislacionit të ri lidhur

me llogaridhënien menaxheriale (sistemet e kontrollit dhe menaxhimit financiar) dhe auditimin e brendshëm. NjQH është shumë mirë e vendosur në Ministrinë e Financave. NjQH si e tillë është një kusht themelor për aplikimin dhe zhvillimin e suksesshëm të KBFP-së e që, në realitet, koncepti të bëhet pjesë e vetë KBFP-së.

Auditimi i Jashtëm duhet të sigurojë funksionimin adekuat të KBFP-së – Komentet e mëparshme i referohen KBFP-së si kornizë e kontrollit të brendshëm qeveritar. Megjithatë, është esenciale që sistemi i KBFP dhe cilësia e funksionimit të tij t'i nënshtrohen një kontrolli të jashtëm apo vlerësimi të pavarur nga një Institucion Suprem i Auditimit (ISA) që është përgjegjës para deputetëve të legjislaturës.

ISA duhet të miratojë dhe zbatojë në mënyrë aktive standardet e duhura të auditimit të sektorit publik dhe parimet etike. ISA duhet të informojë / diskutojë rregullisht aktivitetet dhe gjetjet e auditimit të tij me Parlamentin dhe mund të propozojë ndryshime legjislative që synojnë përdorimin më efektiv të burimeve buxhetore. Raportet e ISA duhet të publikohen, pasi që shqyrtimi dhe opinioni publik në masë të madhe mund të ndihmojë për të fokusuar vëmendjen mbi veprimet e nevojshme përmirësuese.


INTOSAI ka miratuar Udhëzimin për Rregullat e Auditimit, i ashtuquajtur "Deklarata Lima 5" që ofron parimet institucionale për ISA. Ndër të tjera, kjo adreson:

- Kërkesën për pavarësinë e ISA dhe stafit të tij. Kjo pavarësi duhet të garantohet me Kushtetutë dhe të mbrohet nga Gjykata Supreme;
- Kërkesën që kompetencat e auditimit për ISA të mishërohen në Kushtetutë dhe legjislacion. Mandati i ISA duhet të mbulojë të gjitha aktivitetet financiare publike
- Marrëdhënien me legjislativin - duke përfshirë faktin se ISA duhet të fuqizohet dhe të kërkohet të raportojë çdo vit para legjislaturës;
- Kërkesën që qeveria të mbetet plotësisht dhe e vetmja përgjegjëse për veprimet dhe lëshimet e saj dhe nuk mund ta shfajësojë veten duke iu referuar gjetjeve të auditimit.


Nevojitet të ketë kuptim të përbashkët ndërmjet ISA dhe KBFP = Ministria e Financave, në rolin e saj si agjenci kryesore e qeverisë për menaxhimin financiar duhet, nëpërmjet NjQH-së, të veprojë si ndërfaqe (interfejs) ndërmjet ISA dhe sistemit të KBFP-së. Bashkëpunimi i ngushtë dhe ndjekja e një dialogu konstruktiv ndërmjet ISA si auditor i jashtëm dhe Ministrisë së Financave si pika më e lartë e sistemit të KBFP-së është thelbësor në mënyrë që të arrihet një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv për menaxhimin dhe kontrollin e resurseve të buxhetit të shtetit . Në mënyrë që të arrihet dhe të ruhet një bashkëpunim dhe dialog i tillë, sugjerohet që kontaktet në mes të ISA dhe Ministrisë të mbulohen nga një grup punues këshillëdhënës i nivelit të lartë që do të takohej rregullisht për të diskutuar problemet e menaxhimit financiar të qeverisë dhe kontrollit të brendshëm ashtu siç shfaqen ato dhe të përpiqet të gjej zgjidhje të përshtatshme.

Aneks 2: Zinxhiri i llogaridhënës

1: Zinxhiri i llogaridhënies i KMF për organizatat e buxhetit qendror



2: Zinxhiri i llogaridhënies i KMF për komunitat



Aneksi A

1. Rënia e rritjes ekonomike - gjenerimi i rritjes është zhvendosur nga sektori privat në sektorin publik. Ka rënie të investimeve të huaja dhe nivel të ulët të investimeve në sektorin real.
2. Deficit i lartë tregtar dhe ofertë e ulët konkurruese. Ekziston një ofertë e reduktuar eksportuese e produkteve dhe shërbimeve si pasojë e mungesës së aftësisë konkurruese nga firmat vendore.
3. Nivel joadekuat i qeverisjes ekonomike dhe vendimmarrjes për projekte kyçe.
4. Vendosja e prioriteteve në kuadër të KASH dhe Buxhetit të Kosovës është e paqëndrueshme.
5. Niveli i lartë i papunësisë dhe varfërisë me efekte negative në stabilitetin social dhe kohezionin social në vend.
6. Ekziston një burim i kufizuar i financimit me norma të larta të interesit që ndikon negativisht në kapacitetet produktive dhe rritje ekonomike.
7. Kapacitete ende të pamjaftueshme në ASK për të publikuar statistika në baza të rregullta dhe afate më të shkurtra, sidomos në aspektet e llogarive kombëtare dhe papunësisë të domosdoshme për dizajnimin dhe monitorimin e politikave ekonomike dhe zhvillimore.
8. Sektori financiar ndonëse stabil, ende nuk është aftësuar për të furnizuar ekonominë me mjete për investime, sidomos duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme më mjeteve janë të imobilizuara jashtë vendit.
9. Nivel joadekuat i efikasitetit në procesin e privatizimit, sidomos nga Dhoma e Posaçme, që paraqet sfidë për përfundimin e procesit me afatet e parapara.
10. Niveli joadekuat i qeverisjes korporative me mungesë të pavarësisë së plotë të Bordeve, të transparencës dhe llogaridhënies si dhe me monitorim joefikas.
11. Derisa sistemi i menaxhimit të financave publike është në përputhje me standartet ndërkombëtare, raportet e auditimit të brendshëm dhe jashtëm nuk gjejnë përgjigjen e duhur për të përmirësuar menaxhimin e financave dhe përcjellë efektet e investimeve.
12. Konkurrenca jo gjithmonë e drejtë ku roli dhe pavarësia e rregullatorëve nuk është në nivelin e duhur.
13. Ekziston një mobilitet i kufizuar në aspektin e afarizmit dhe punësimit në BE.
14. Mungesë e një dokumenti integral strategjik për zhvillim ekonomik, që do të ndërlidhte të gjitha dokumentet strategjike ekzistuese si KASH, Programin ekonomiko-fiskal, etj.
15. Nuk ekziston një model i qartë ekonomik që do të shërbente për gjenerim të zhvillimit ekonomik.
16. Ekziston një mungesë e koordinimit të donatorëve për zbatim më efektiv të KASH.
17. Skemat sociale kanë potencial që të shkaktojnë jo-stabilitet financiar nga viti 2014 dhe probleme në aspektin e kohezionit social.
18. Ekziston mungesë e dukshme e politikave sektoriale/industriale që shkaktojnë mungesë potenciali për ri-industrializim të vendit.
19. Gjyqësia joefikase dhe mangësi në mbrojtjen e kontratave, ku ndoshta një Odë e Veçantë do të mundësonte tejkalimin e gjendjes.

Lista e Referencave

- AKP - http://www.pak-ks.org/repository/docs/Information_to_Stake_Holders_august_2011_alb_ver_FINAL..pdf.
- AKP - Raporti vjetor i AKP-s: http://www.pak-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_AKP-s-alb.ver..pdf
- ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, 2009
- ASK - GDP 2004-2010
- ASK - <http://esk.rks-gov.net>
- ASK - Indeksi i Çmimeve të Konsumit, qershor 2012
- ASK - Raporti Vjetor 2012
- ASK - Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit; Indeksi i çmimeve të inpleteve dhe çmimet në bujqësi TM1 - 2012
- BB - Kosova: Rishikimi i shpenzimeve publike, qershor 2010.
- BB - Kosovo Country Partnership Strategy 2012 - 2015
- BB - The World Bank in Kosovo, June 2012
- BB - Vlerësimi Fiduciar i Kosovës, 2012
- BQK - Buletini Mujor Statistikor, nëntor 2012
- BQK - Buletini Mujor Statistikor, qershor 2012
- BQK - Buletini Mujor Statistikor, shtator 2012
- BQK - Metodika mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave, versioni 2.0
- BQK - Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare, V2.0
- BQK - Raporti i Bilancit të Pagesave, nr.11 - mars 2012
- BQK - Raporti i stabilitetit financiar nr. 2, 2011
- BQK - Raporti i stabilitetit financiar nr.3, dhjetor 2012
- BQK - Raporti Vjetor 2011, qershor 2012.
- BQK - Vlerësimi ekonomik tremujor për tremujorin e katërt 2012, 2013
- DFID - Business Case and Intervention Summary
- Doing Business Report 2013, International Bank for Reconstruction & World Bank, 10th Edition
- Dokumenti i Politikave në lidhje me Sistemi e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Kosovë, 2011
- ECIKS - <http://www.eciks.org/english/lajme>
- Ex-post Evaluation of Exceptional Financial Assistance Operation to Kosovo, shtator 2012
- Answers to the questionnaire for the feasibility study for the SAA, tetor 2012
- FMN - Balance of Payments Manual
- FMN - IMF Survey Magazine: Countries & Regions - Kosovo Receives €48 Million Installment Under IMF Loan, 17 korrik 2012
- FMN - Letër Qëllimi, dhe memorandumit teknik i mirëkuptimit, 12 Prill 2012
- FMN - Press Release No. 12/154 - IMF Executive Board Approves € 106.6 Million Stand-By Arrangement for Kosovo, 27 prill 2012
- FMN - Republic of Kosovo: First Review Under the Stand-By Arrangement, and Request for Modification of Performance Criteria – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, July 2012
- FMN - Republic of Kosovo: Request for Stand-By Arrangement – Informational Annex, 12 April 2012
- FMN - Republic of Kosovo: Request for Stand-By Arrangement – Staff Report; Press Release on the Executive Board Discussion, April 2012

- FMN - Second review under the Stand-by Arrangement, Request for rephrasing of purchases and modification of performance criterion, December 2012
- FMN - Survey Magazine: Countries & Regions - Kosovo Receives €48 Million Installment Under IMF Loan, 17 July 2012
- GAP - Remittances from Afghanistan and their impact in Kosovo's economy, nëntor 2011
- ICO: Economic Regulators in Kosovo - An overview of the state of their independence
- Inputi i Studimit të Fizibilitetit Faza II, Qershor-Gusht 2012.
- Joshua et al. - Efficient allocation of resources for decentralised provision of social services in Kosovo,
- KASH 2013-2015
- KE - Annual Programme for Kosovo under the IPA Transition Assistance and Institution Building Component for 2011
- KE - Autonomous Trade Measures with Kosovo re-enter into force, European Union Office in Kosovo
- KE - Chapters of the acquis, Enlargement Policy of the European Commission, Conditions for membership
- KE - Communication from the Commission to the European Parliament and the Council on a Feasibility Study for a a Stabilization and Association Agreement between European Union and Kosovo, October
- KE - Compendium of the public internal control systems in the EU Member States, 2012
- KE - Convention on the simplification of formalities in trade in goods
- KE - Council Regulation (EC) No. 332/2002, establishing a facility providing medium-term financial assistance for Member States' balances of payments, 18 shkurt 2002
- KE - Council Regulation No. 2658/87, on the tariff and statistical nomenclature and on the Common Customs Tariff
- KE - Enlargement Policy of the European Commission, Conditions for membership
- KE - Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013, Eurooepan Commission, tetor 2012
- KE - Guide to the main administrative structures required for implementing the Acquis, 2005
- KE - Instrument for Pre-Assistance (IPA), Multi-Annual Indicative Planning Document (MIPD) 2011-2013
- KE - Kosovo - Fulfilling its European Perspective, 2009
- KE - Mirë se vini në botën e KBFP-së, 2006
- KE - Progress Report, 2008
- KE - Progress Report, 2009
- KE - Progress Report, 2010
- KE - The EU approach to corporate governance, 2008
- KE - Treaty on the functioning of the European Union, Official Journal of the Eurooepan Union, mars 2010
- KE - Where does the money come from?, Financial Programming and Budget
- KEK - <http://www.kek-energy.com/defaultdetails.asp?ID=141>.
- MAP - Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009-2015, tetor 2008
- MF - Buxheti i Nivelit Qendror, Draft Buxheti 2013
- MF - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës,

prill 2012

- MF - Korniza Makro-Fiskale 2013-2015
- MF - Misioni i FMN-së përmbyllë vizitën e tij në Kosovë - Politikat makroekonomike dhe financiare në Kosovë janë në rrugë të duhur
- MF - Pasqyra Makroekonomike nr.7
- MF - Raporti Vjetor i NjQH/MFK për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2011
- MF - Raporti Vjetor për Funksonimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik në Kosovë për vitin 2011
- MIE - SAPD: Economy, Financial Issues, Statistics, 1 June 2011
- MIE - SAPD: Sectoral meeting on Economy, 17 June 2010, Brussels
- MPMS - Labor and employment report 2011
- MPMS - Labour market information in Kosovo, Monthly report/LED/MLSW
- MPMS - Research on Needs of Labor Market 2011, KBA/MLSW
- MTI- Reformat e të bërit biznes
- MZHE - <http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/?page=1,2>
- MZHE - Raporti i NP-ve 2010
- MZHE - Strategjia e energjise 2009-2018
- Njoftim për Moratorium: <http://www.pak-ks.org/repository/docs/Moratoriumi-shq.pdf>.
- OSBE: Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë. Korrik, 2012
- Qeveria e Kosovës - Zyra e Kryeministrit - Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, korrik 2011.
- SIDA - Evaluation of cooperation with SOK
- Trusti - Buletini tremujor: Trustorja, Fondi i kursimeve personale të Kosovës, 2012
- Trusti - <http://trusti.org>
- UNDP - KHDR 2012
- UNDP - Studimi mbi remitencat në Kosovë 2012
- USAID - Kosovo Economic Performance Assessment, maj 2008
- WEO - <http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2012/01/weodata/index.aspx>
- ZAP - Raporti vjetor i auditimit për vitin 2011

Lista e Pjesëmarrësve

Adem Ahmetaj	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Aferdita Grapci	Komuna e Pejës
Afrim Shala	Ministria e Financave
Agim Demukaj	Banka Botërore
Agim Krasniqi	Ministria e Financave
Agron Istogu	Kuvendi i Kosovës
Ahtere Loxha	Kuvendi i Kosovës
Alban Fejza	Ministria e Financave
Albulena Bektashi	Ministria e Financave
Alejtin Berisha	Kolegji Universitar Universum
Ali Sadriu	Kuvendi i Kosovës
Almir Hyseni	AZHR Lindje
Alush Sejdiu	BSPK
Ardiana Qela	Shoqata Afariste e gruas SHE-ERA
Ardit Berisha	Kolegji Universitar Universum
Arlind Limani	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
Armend Ademaj	Kuvendi i Kosovës
Artan Mehmeti	Ministria e Financave
Artan Venhari	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
Avni Jashari	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
Avni Kastrati	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Bajram Rexha	Doganat e Kosovës
Bashkim Bellaqa	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Bashkim Ibishi	KAAD
Behije Tahiri	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Behxhet Haliti	Administrata Tatimore
Bekim Canolli	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Besfort Rrecaj	Ministria e Integritit Evropian
Besnik Dermaku	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Besnik Vasolli	GIZ
Blerim Ahmeti	Ministria of Tregtisë dhe Industrisë

Daniela Zampini	UNDP
Dardan Fusha	Banka Qendrore e Kosovës
Dielleza Arifi	Ministria e Financave
Elis Qyqalla	
Enis Spahiu	Ministria e Financave
Ertan Munoglu	GIZ
Esin Muzbeg	Oda Tregtare Kosovaro-Turke
Fatime Qorri	Kuvendi i Kosovës
Fatmir Curri	KCSF
Fatmir Haxholli	GIZ
Fatmir Plakiqi	Ministria e Financave
Fatmir Sylejmani	GIZ
Fatos Azemi	Komuna e Prishtinës
Fetije Begolli	Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal
Florije Zabergja	Ministria e Financave
Granit Voskhi	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
Hafiz Leka	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Haki Kurti	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Hakile Xhaferi	Ministria e Bujqësisë
Hasan Neziri	AZHR Qendër
Ibrahim Gjylderen	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
Ibrahim Rrustemi	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Ilir T. Berisha	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Ilire Dajja-Buza	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
Irfan Lipovica	Ministria of Tregtisë dhe Industrisë
Isa Krasniqi	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Ismail Muçiçi	Humanitas
Ismail Xhaku	Ministria e Financave
Jeton Gashi	Ministria e Financave
Jeton Karaqiça	Ministria e Integritit Evropian
Jose Sulemane	FMN
Kimete Zekaj	Ministria e Financave
Kosum Aliu	Ministria e Financave

Lage Olofsson	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
Levent Koro	Konsulent i pavarur
Lindita Daija	Asociacioni i Komunave të Kosovës
Lindita Toçi	Ministria e Financave
Luan Sylaj	KAAD
Lucas Fischer	GIZ
Luljeta Berisha	GIZ
Lulzim Karaxha	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Lumbardh Zagragja	GIZ
Lumir Abdixhiku	Instituti RIINVEST
Lumnije Hetemi	Ministria e Financave
Medain Hashani	Universiteti AAB
Mentor Geci	Banka Qendrore e Kosovës
Michael Wolff-Mors	GIZ
Mirjana Cvetic	Ministria e Financave
Muhamet Mustafa	Kuvendi i Kosovës
Muhamet Sadiku	Instituti RIINVEST
Nahit Sharku	Administrata Tatimore
Naim Huruglica	Doganat e Kosovës
Nehat Islami	Ministria e Integritit Evropian
Nikson Mirdita	Administrata Tatimore
Nysret Koca	Ministria e Financave
Olivera ceni	Oda Ekonomike e Kosovës
Petrit Popova	Ministria e Financave
Petrit Gashi	Universiteti i Prishtinës
Ramadan Islami	GIZ
Ramadan Sejdiu	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ramiz Krasniqi	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
Ramiz Ulaj	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Rexhep Vasolli	Ministria e Financave
Ruzhdi Halili	Zyra e Kryeministrit
Ruzvellt Frrokaj	Ministria e Punëve të Jashtme
Ryzhdi Baloku	BSPK

Safete Hadergjonaj	Kuvendi i Kosovës
Samir Hyseini	GIZ
Samir Lleshi	Oda Ekonomike e Kosovës
Sanije Uka	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Selim Thaci	FMN
Shar Kurtishi	Konsulent i pavarur
Shkelzen Kuqi	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Shkelzen Llluka	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
Shkëlzen Morina	Ministria e Financave
Sokol Havolli	Banka Qendrore e Kosovës
Teuta Sahatqija	Kuvendi i Kosovës
Valbona Dibra	Kuvendi i Kosovës
Valdete Krasniqi	Doganat e Kosovës
Valentin Hoxha	AZHR Jug
Valmira Rexhëbeqaj	Ministria e Financave
Vehbi Zeqiri	START
Vilson Ukaj	Kuvendi i Kosovës
Vjosa-Rogova Damoni	IKS
Witold Sartorius	GIZ
Xhevat Meha	Luani sh.a.
Ylber Sela	Universiteti AAB
Zef Dedaj	Ministria of Tregtisë dhe Industrisë
Zilif Lufi	Ministria e Financave